

**Grup autorësh**

# **Libër për mësuesin**

## **Matematika 5**

**BOTIME**



## BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI  
Redaktorë letrarë: Brunilda MENO, Arlon LIKO  
Paraqitja grafike: Elidor KRUIJA  
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, prill 2019

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

---

**Botime Pegi:** tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;  
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al  
**Spektori i shpërndarjes:** cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;  
**e-mail:** marketing@botimepegi.al  
**Shtypshkronja Pegi:** cel: +355/ 069 40 075 01;  
**e-mail:** shtypshkronjapegi@yahoo.com

---

# **Përmbajtje**

Planifikimi vjetor

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Periudha e parë

Periudha e dytë

Periudha e tretë

Modele ditësh



**FUSHA: Matematikë**  
**LËNDA: Matematikë**  
**Shkalla 2**  
**Klasa V**

**Struktura e orëve**

35 javë x 4 orë/java = 140 orë

Periudha e parë 12 javë x 4 orë/java = 48 orë

Periudha e dytë 12 javë x 4 orë/java = 48 orë

Periudha e tretë 11 javë x 4 orë/java = 44 orë

	NUMRI	MATJA	GJEOMETRIA	ALGJEBRA DHE FUNKSIONI	STATISTIKE DHE PROPABILITET	Përsëritje për provimin e klasës së pestë	ORË VJETORE
Sasia e orëve vjetore të sugjeruara sipas programit	70 orë	23 orë	22 orë	4 orë	11 orë	10 orë	140 orë gjithsej
							115 orë të temave 15 orë përsëritje, projekte, testime 10 orë përsëritje për provimin e klasës së pestë

<b>Linja</b>	<b>Shtator – dhjetor 12 javë</b>	<b>Janar – mars 12 javë</b>	<b>Prill – qershor 11 javë</b>	<b>Totali</b>
Numri	48 orë (1 orë përsëritje + 3 orë testimi + 1 orë projekt)	22 orë (1 orë përsëritje + 1 orë testimi)	-----	<b>70 orë</b>
Matja		6 orë (1 orë projekt)	17 orë (1 orë projekt)	<b>23 orë</b>
Gjeometria		16 orë (1 orë përsëritje + 1 orë testim)	6 orë	<b>22 orë</b>
Algjebra dhe funksioni		4 orë		<b>4 orë</b>
Statistika dhe probabiliteti			11 orë	<b>11 orë</b>
Orë përsëritjeje për provimin e klasës së pestë.			10 orë	<b>10 orë</b>

Kompetencat / Tematikat	Përmbajtja e lëndës për klasën e pestë Shtator – dhjetor (48 orë)	Janar – mars (48 orë)	prill – qershor (44 orë)
<b>NUMRI (70 orë)</b>	<b>48 orë</b> <b>Numri dhe vendvlera</b> 2-Diskutojmë së bashku 2- Vendvlera 2- Të dhjetat dhe të qindtat 2- Rrumbullakimi 2- Rendi i krahasimit 2- Vargjet e numrave 2- Numra tek dhe çift 2- Numri dhe vendvlera (Përmbledhim dhe përforcime) 1- Testim për njohuritë e marra në kapitullin e parë  <b>Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjesëtimi</b> 1- (Diskutojmë së bashku) 2- Thyesat e barabarta 2- Thyesat e parregullta 2- Thyesat dhe numrat dhjetorë-të dhjetat 2- Të qindtat 2- Përqindjet 2- Përpjesëtimi 2- Raporti 2- Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjesëtimi (Përmbledhim dhe përforcime) 1- Testim për njohuritë e marra në kapitullin e dytë	<b>22 orë</b> <b>Strategjitë e veprimeve me mend</b> 1-Cilën strategji? 1-Strategjitë e shumëzimit 2-Strategjitë të tjera të shumëzimit 2-Dyfishimi dhe përgjysmimi 1-Strategji të veprimeve me mend  <b>Veprime me shkrim</b> 1-Diskutojmë së bashku 2-Mbledhja dhe zbritja 2-Më shumë për mbledhjen dhe zbritjen 2-Shumëzimi 2-Shumëzimi i numrave dhjetorë 2-Pjesëtimi 2-Më shumë për pjesëtimin 1-Përsëritje njohurish 1-Testim për njohuritë e marra	



<p><b>Strategji të veprimeve me mend</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1-Diskutojmë së bashku</li> <li>2-Çiftet e numrave</li> <li>2-Fakte të shumëzimit dhe të pjesëtimit</li> <li>2-Vetitë e numrave</li> <li>2-Llogaritja e shumave dhe e ndryshesave</li> <li>1-Shumëfishat më të afërt</li> <li>1-Projekt</li> <li>1-Përsëritje njohurish</li> <li>1-Testim përmbledhës (për periudhën e parë)</li> </ul>	<p><b>6 orë</b></p> <p><b>Gjatësia, masa dhe vëllimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1- Diskutojmë së bashku</li> <li>2-Njësitë e matjes</li> <li>2-Matja e gjatësisë</li> <li>1-Projekt</li> </ul>	<p><b>17 orë</b></p> <p><b>Gjatësia, masa dhe vëllimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>2-Centimetra dhe milimetra</li> <li>2-Matja e masës</li> <li>2-Matja e vëllimit</li> <li>2-Gjatësia, masa dhe vëllimi</li> </ul> <p><b>Koha</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1-Diskutojmë së bashku</li> <li>1-Këmbimi ndërmjet njërive të kohës</li> <li>1-Përdorimi i orës me sistem 24-orësh</li> <li>1-Leximi i tabelave të orareve</li> <li>1-Llogaritja e intervaleve kohore</li> <li>1-Përdorimi i kalendarëve</li> <li>1-Koha (përsëritje)</li> <li>1-Testim për njohuritë e marra rreth matjes</li> <li>1-Projekt</li> </ul>
---	--	--

MATJA  
(23 orë)

<b>GJEOMETRIA</b> <b>(22 orë)</b>		<b>16 orë</b> <b>Format gjeometrike</b> 1-Diskutojmë së bashku 1-Trekëndëshat 1-Simetria 1-Trupat gjeometrikë 1-Drejthëzat 1-Këndet 1-Shumëkëndëshat 1-Format gjeometrike  <b>Vendndodhja dhe lëvizja</b> 1-Diskutojmë së bashku 1-Koordinatat 2-Simetria në lidhje me një drejtëz 1-Zhvendosjet 1-Vendndodhja dhe lëvizja 1-Përsëritje 1-Testim përmbledhës (për periudhën e dytë)	<b>6 orë</b> <b>Perimetri dhe syprina</b> 1-Diskutojmë së bashku 1-Kuptimi për perimetrin 1-Kuptimi për syprinën 1-Llogaritja e syprinës dhe e perimetrit të drejtkëndëshave 2-Perimetri dhe syprina
<b>ALGJEBRA DHE FUNKSIONI</b> <b>(4 orë)</b>		<b>4 orë</b> <b>Veprime me shkrim</b> 2-Kllapat 2-Veprime me shkrim	

<b>STATISTIKA PROBABILITETI (11 orë)</b>			<b>11 orë</b> <b>Përpunimi i të dhënave</b> 1-Diskutojmë së bashku 2-Tabelat e dendurive dhe piktogramet 1-Grafikët me shtylla dhe grafikët me vijë 1-Grafikët me vijë 2-Probabiliteti 2-Përpunimi i të dhënave 1-Përsëritje njohurish 1-Testim përmbledhës (për periudhën e tretë)
--	--	--	---

**Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së matematikës për shkollën e dytë**

### **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit**

#### **Nxënësi/ja:**

dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me pyetje, komente apo sqarime; prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në një kohëzgjatje deri në 10 minuta.

Kompetenca e të menduarit

#### **Nxënësi/ja:**

klasifikon objekte duke shprehur mendimin e tij; zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë në matematikë, duke dhënë shembuj nga jeta e përditshme për situata të ngjashme; paraqet dhe argumenton mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar në matematikë në një kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

Kompetenca e të nxënës

#### **Nxënësi/ja:**

identifikon dhe krahason informacionet e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh. duke i shënuar me shenja të ndryshme); zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes; krahason përpunimin e tij, me përvijën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një veprimtarie të caktuar; përdor portofolin personal si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara, duke hartuar një plan pune me hapa konkretë për përmirësim; identifikon cilësitë, që zotëron dhe ato që duhen zhvilluar për të nxënë gjatë zhvillimit të një detyre apo veprimtarie të caktuar duke bashkëpunuar me të tjerët; përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informacionin/njohuritë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar, përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo burimeve të tjera; prezanton për 6-10 minuta përvijën e vet.

### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

#### **Nxënësi/ja:**

përgatit një projekt të vogël duke theksuar veprimtaritë kryesore për një çështje që e shqetëson në shkollë ose komunitet dhe përcakton kohën, vendin, materialet, mjetet;

identifikon dhe llogarit shpenzimet personale ose familjare përgjatë një jave dhe i paraqet ato në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër; paraqet në formë tabelare, grafike, vizatimi apo formë tjetër; veprimtaritë e përkujdesjes për qeniet e gjalla, të cilat mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij.

### **Kompetenca personale**

#### **Nxënësi/ja:**

propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal duke analizuar rrethanat, që çuan në konflikt dhe ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit; bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

### **Kompetenca qytetare**

#### **Nxënësi/ja:**

shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët; prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet në familje apo komunitet (si, objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet, mënyrën e të ushqyerit, menaxhimit të ekonomisë familjare, të drejtat dhe përgjegjësitë në familje etj.), si dhe disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit, duke dalluar ndryshimet dhe ngjashmërinë ndërmjet të tashmes dhe së shkuarës.

### **Kompetenca digjitale**

organizon, mbledh dhe shfaq të dhënat e gjetura nga burimet e informacionit elektronik; kupton rëndësinë e ruajtjes së të dhënave individuale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë, moshë...) dhe mos publikimit të tyre në asnjë burim informacioni të pa licencuar.

### **Lidhja e lëndës së matematikës me temat ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballlet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Matematika ka një shumëllojshmëri të aplikimeve në jetën e përditshme dhe është e lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e dyfishtë sepse ajo jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Të drejtat e njeriut; Vendimmarrja morale; Zhvillimi i qëndrueshëm; Mjedis; Ndërvlerësia; Bashkëjetesa paqësore*, nxënësi duhet të zgjidhë situata dhe probleme, duhet të përdorë arsyetimin matematik dhe elemente të gjuhës matematikore, në mënyrë që të qartësojë dhe shpjegojë çështje të ndryshme që lidhen me realizimin e tyre. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

### Lidhja e lëndës së matematikës me fushat e tjera kurrikulare

Matematika u shërben të gjitha fushave, me koncepte dhe me aftësi. Lidhja e matematikës me fushat e tjera pasuron situatat e të nxënësve, në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Nga ana tjetër edhe përmbajtja e matematikës (p.sh., numrat, raportet, figurat, kuptimi për hapësirën, përpunimi i të dhënave etj.) mund të përdoren në studimin e fushave të tjera. Ajo është një mjet ndihmës i domosdoshëm për shkencat e natyrës, por njëkohësisht luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera.

Në studimin e shkencave apo teknologjisë, nxënësi/ja përdor arsyetimin dhe komunikimin me gjuhën e matematikës për të shpjeguar fenomenet me diagrame apo modele të ndryshme. Në gjuhët apo shkencat shoqërore ai përdor interpretimin e informacioneve të dhënave, shkallën, hartën, paraqitjet me diagrame dhe grafikë, periudhat kohore si dhe përpunimet statistikore. Raportet, format, hapësira dhe modelimet e ndryshme dëshmojnë për përdorimet e matematikës në ndërtimin e veprave të ndryshme të artit.

### Kompetencat matematikore që zhvillohen nëpërmjet tematikave

Kompetencat matematikore që zhvillohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Zhvillimi i kompetencave nëpërmjet tematikave
Zgjidhja e situatës problemore	Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore të nivelit praktik, të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt, duke zhvilluar kapacitetin e tij intelektual dhe intuitën krijuese. Treguesit kryesorë janë: përcaktimi i të dhënave të situatës problemore; modelimi i një situatë problemore; zbatimi i hapave të ndryshme për zgjidhjen e situatës problemore; vlefshmëria e zgjidhjes së situatës problemore; paraqitja e zgjidhjes së situatës problemore.	Nxënësi përdor numrat, veprimet me to, llogaritjet me mend, matjet, konceptet gjeometrike, shprehjet algjebrike, grafikët, interpretimin e problemave, identifikimin e të panjohurave, zgjidhjen e ekuacioneve, diagramet, grafikët etj., për zgjidhjen e situatave problemore etj.
Arsyetimi dhe vërtetimi matematik	Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës. Arsyetimi ka të bëjë me organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita. Treguesit kryesorë janë: identifikimi i elementeve të situatës matematikore; përdorimi i koncepteve matematikore dhe proceset e përshtatshme për situatën e dhënë; arsyetimi për zbatimin e koncepteve dhe proceseve në situatën e dhënë.	Nxënësi përdor arsyetimin për veprimet me numrat, krahasimet, renditjet, zgjidhjen e ekuacioneve, interpretimin e shprehjeve algjebrike, për karakteristikat e figurave dhe trupave, transformimet gjeometrike, për interpretimin dhe formulimin e konkluzioneve etj.

Të menduarit dhe komunikimi matematik	<p>Nxënësi përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik. Nxënësi gjatë komunikimit në gjuhën matematikore mëson konceptet, proceset dhe përforcon të kuptuarit e tyre. Ai kupton se kjo gjuhë përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.</p> <p>Treguesit kryesorë janë: familjariteti me gjuhën e matematikës; lidhja e gjuhës së matematikës me gjuhën e përditshme; interpretimi i koncepteve matematikore.</p>	Nxënësi përdor komunikimin për veprimet me numra, përkthimet me simbole, rezultatet e zgjidhjes së problemave, për interpretimin e vetive të figurave e trupave, për interpretimin e të dhënave, tabelave, diagrameve etj.
Të menduarit dhe komunikimi matematik	<p>Nxënësi përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik. Nxënësi gjatë komunikimit në gjuhën matematikore mëson konceptet, proceset dhe përforcon të kuptuarit e tyre. Ai kupton se kjo gjuhë përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.</p> <p>Treguesit kryesorë janë: familjariteti me gjuhën e matematikës; lidhja e gjuhës së matematikës me gjuhën e përditshme; interpretimi i koncepteve matematikore.</p>	Nxënësi përdor komunikimin për veprimet me numra, përkthimet me simbole, rezultatet e zgjidhjes së problemave, për interpretimin e vetive të figurave e trupave, për interpretimin e të dhënave, tabelave, diagrameve etj.
Lidhja konceptuale	<p>Nxënësi kupton ndërtimin e koncepteve matematike për të formuar një të tërë dhe përdor varësitë ndërmjet këtyre koncepteve. Arsytimi matematik zhvillon lidhjen ndërmjet koncepteve duke i ndërtuar dhe zbatuar ato në proceset matematikore përkatëse.</p>	Nxënësi përdor lidhjet konceptuale të numrave me ekuacionet, shprehjet algebrike, problemave algebrike dhe gjeometrike, drejtëzave, matjeve, të dhënave dhe probabilitetit, tabelave etj.

Modelimi matematik	<p>Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Modelimi është procesi i paraqitjes së situatës nga jeta reale me gjuhën matematikore. Nëpërmjet përdorimit të teknikave përkatëse, gjendet zgjidhja matematikore, e cila më pas interpretohet në jetën reale.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>përcaktimi i situatës në jetën reale;</li> <li>modelimi në gjuhën matematike;</li> <li>gjetja e zgjidhjes matematike;</li> <li>përkthimi i zgjidhjes matematike në zgjidhje të situatës në jetën reale.</li> </ul>	<p>Nxënësi modelon me anë të numrave, të simboleve, të shndërrimeve gjeometrike, në tabela, formulon ligjësi, formulon problema nga situata reale, ndërton e përdor formula etj.</p>
Përdorimi i teknologjisë në matematikë	<p>Nxënësi përdor teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet, si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione.</p>	<p>Nxënësi përdor makina llogaritëse për të kryer llogaritje të veprimeve me numra, përdor programe kompjuterike për prezantime, hulumtime, përpunime të dhënash etj.</p>



**Koha mësimore****Lënda e matematikës zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 4 orë secila, gjithsej 140 orë.**

	Numri	Matja	Gjeometria	Algebra dhe funksioni	Statistika dhe probabiliteti	Orë përgatitjeje për provimin e klasës së pestë	Gjithsej orë
Klasa e pestë	70	23	22	4	11	10 orë	140 orë

**KLASA E PESTË****Tematika: Numri (70 orë)**

**Përshkrimi i Tematikës:** Nxënësi përdor kuptimin e numrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe algoritmin e veprimeve me numra për të paraqitur sasi në botën reale. Nxënësi mëson numrat deri në 1000000. Rëndësi i kushtohet rumbullakimit dhe dobisë së tij në gjetjen e rezultateve të përafërta. Njohuritë për thesaret pasurohen me kthimin e thesave në emërues të njëjtë dhe formimin e thesave të barabarta. Bashkësisë së numrave i shtohen numrat dhjetorë dhe numrat e plotë negativë dhe pozitivë. Nxënësi trajton algoritmet e veprimeve me numra natyrorë, rëndësi i kushtohet edhe zbatimit të vetive të veprimeve dhe përdorimit të makinës llogaritëse. Për numrat dhjetorë e thesaret trajtohen shprehitë bazë për mbledhjen e zbritjen e tyre.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

*Zgjidhja probleme:* kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; zbaton strategji të zgjidhjes së problemave.

*Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:* demonstroi të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, figurave, adhësive, vizatimeve dhe objekteve; dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.

*Të menduarit dhe komunikimit matematik:* komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me numra.

*Lidhja konceptuale:* bën lidhje të thjeshta mes numërimit.

*Modelimi matematik:* krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur numrat dy shifror; paraqet numrat, konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

*Përdorimi i teknologjisë në matematikë:* përdor mjete të thjeshta për kalkulime në mënyrë që të zgjidh probleme të ndryshme matematikore.

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Shkathësitë për realizimin e kompetencave matematikore
<p><b>Numrat natyror, dhjetorë dhe të plotë</b></p> <p>Vendvlera e secilës shifër në numrat pesë-gjastëshifrorë.</p> <p>Kuptimi i numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta).</p> <p>Rrumbullakimi i numrave katërshifrorë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt.</p> <p>Rrumbullakimi i një numri dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt.</p> <p>Krahasimi dhe renditja e numrave deri në një milion duke përdorur simbolet e krahasimit <math>&lt;</math> dhe <math>&gt;</math>.</p> <p>Rendit dhe krahason numra pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit.</p> <p>Rendit numra dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes.</p> <p>Numra çift dhe tek.</p> <p><b>Thyesat</b></p> <p>Marrëdhënia ndërmjet <math>1/2</math>, <math>1/4</math> dhe <math>1/8</math>; <math>1/3</math> dhe <math>1/5</math> dhe <math>1/10</math>;</p> <p>Barazimi ndërmjet thesave dhe numrave dhjetorë, p.sh. thesa gjysma, të dhjetat dhe qindtat.</p> <p>Thyesat më të mëdha se 1 dhe numrat e përzierë.</p>	<p><b>Numrat natyror, dhjetorë dhe të plotë</b></p> <p>numëron në rritje dhe në zvogëlim duke filluar nga 0;</p> <p>kupton vlerën e secilës shifër në numrat pesë-gjastëshifrorë dhe i ndan në mijëshe, qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe;</p> <p>përdor kuptimin e numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta) dhe gjen vlerën për secilën shifër;</p> <p>rrumbullakos numrat katërshifrorë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt;</p> <p>rrumbullakos një numër dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt;</p> <p>krahason dhe rendit numrat deri në një milion duke përdorur simbolet e krahasimit <math>&lt;</math> dhe <math>&gt;</math>;</p> <p>rendit dhe krahason numra pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit;</p> <p>rendit numra dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes;</p> <p>një numrat çift dhe tek;</p> <p>një shumëfisha të 5, 10, 25, 50, 100 deri në 1000;</p> <p>krijon pohime të ndryshme lidhur me mbledhjen dhe zbritjen e numrave çift dhe tek.</p> <p><b>Thyesat</b></p> <p>një marrëdhënie ndërmjet <math>1/2</math>, <math>1/4</math> dhe <math>1/8</math>; <math>1/3</math> dhe <math>1/5</math> dhe <math>1/10</math>;</p> <p>një barazimin ndërmjet thesave dhe numrave dhjetorë, p.sh. thesa gjysma, të dhjetat dhe të qindtat;</p> <p>kthen një thesë më të madhe se 1 në numër të përzierë; p.sh. <math>7/4</math> në <math>1\frac{3}{4}</math>;</p> <p>rendit numrat e përzierë në një bosht numerik;</p> <p>lidh thesën me pjesëtimin;</p> <p>njehson pjesën e një sasi në situata të thjeshta;</p> <p><b>Përqindja</b></p> <p>kupton përqindjen si numri i pjesëve ndër 100 dhe njehson përqindje të thjeshta;</p> <p>shpreh gjysmën, të dhjeta dhe të qindta si përqindje;</p>

<p>Renditja e numrave të përzierë në një bosht numerik.</p> <p>Lidhja e thyesës me pjesëtimin.</p> <p>Pjesa e një sasi në situata të thjeshta.</p> <p><b>Përqindja</b></p> <p>Përqindja si numri i pjesëve ndër 100.</p> <p><b>Raporti dhe përpjesëtimi</b></p> <p>Thyesa si raport ose përpjesëtim i thjeshtë.</p> <p><b>Mbledhja dhe zbritja</b></p> <p>Mbledhja e më shumë se tre numrave dy-treshifrorë.</p> <p>Mbledhja ose zbritja e dy numrave tre-katërshifrorë.</p> <p>Mbledh ose zbritja e dy numrave dhjetorë me të njëjtën numër shifrash mbas presjes.</p> <p><b>Shumëzimi dhe pjesëtimi</b></p> <p>Shumëzimi i numrave deri në 10 000 me 10 ose 100.</p> <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifrorë.</p> <p>Shumëzimi i dy numrave dyshifrorë.</p> <p>Shumëzimi i një numër dhjetor me një shifër mbas presjes me një numër njëshifrorë.</p> <p>Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifrorë (përfshirë edhe pjesëtimin me mbetje).</p> <p>Shprehjet deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat.</p> <p>Pjesëtimi si veprim i kundërt i shumëzimit.</p> <p>Përdorimi i makinës llogaritëse.</p>	<p><b>Raporti dhe përpjesëtimi</b></p> <p>përdor thyesën për të përshkruar një raport ose përpjesëtim të thjeshtë, p.sh. <math>1/5</math> e ruazave janë të verdha;</p> <p>përdor raportin për të zgjidhur situata të thjeshta problemore, p.sh.; si të adaptohet një recetë gatimi e dhënë për 6, 3, 12 persona;</p> <p><b>Mbledhja dhe zbritja</b></p> <p>mbledh më shumë se tre numra dy-treshifrorë;</p> <p>mbledh ose zbrit dy numra tre-katërshifrorë;</p> <p>mbledh ose zbrit dy numra dhjetorë me të njëjtën numër shifrash mbas presjes;</p> <p><b>Shumëzimi dhe pjesëtimi</b></p> <p>shumëzon numrat deri në 10 000 me 10 ose 100;</p> <p>shumëzon dhe pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifrorë;</p> <p>shumëzon dy numra dyshifrorë;</p> <p>shumëzon një numër dhjetor me një shifër mbas presjes me një numër njëshifrorë, p.sh. <math>3,6 \times 7</math>;</p> <p>pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifrorë (përfshirë edhe pjesëtimin me mbetje);</p> <p>fillon të shprehë mbetjen si thyesë në pjesëtimin e numrit dyshifrorë me një numër njëshifrorë;</p> <p>rumbullakos rezultatit në një pjesëtim për të zgjidhur një situatë problemore;</p> <p>njihson rezultatit e shprehjeve deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat;</p> <p>kupton pjesëtimin si veprim i kundërt i shumëzimit;</p> <p>zgjidh situata problemore duke përdorur veprimet dhe algoritmin e tyre;</p> <p>verifikon rezultatet duke përdorur makinën llogaritëse;</p> <p><b>Strategji të veprimeve me mend</b></p> <p>kryen mbledhjen me mend të dy numrave dhjetorë me një shifër mbas presjes me shumë 1, p.sh. <math>0,8 + 0,2</math>;</p> <p>kryen mbledhjen me mend të dy numrave dhjetorë me shumë 10;</p> <p>kryen veprime me tabelën e shumëzimit;</p> <p>pjesëton me 2, 5, 10 dhe 100;</p> <p>njëh katrorët e numrave deri në 10, p.sh. <math>10 \times 10</math>;</p>
--	---

<p><b>Strategji të veprimeve me mend</b> Strategji të kryerjes së veprimeve me mend për mbledhjen, zbritjen shumëzimin dhe pjesëtimin.</p>	<p>gjen faktorët e numrave dyshifrorë; numëron në rritje dhe zbritje me mijëshe, qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe; mbledh dhe zbrit numra të afërt me shumëfisha 10, 100 dhe 1000 p.sh. 4387 – 299, 5026 – 4998; shumëzon shumëfishat e 10 -90 dhe 100 -900 me një numër njëshifrorë; shumëzon numrat afër shumëfishave të dhjetës, p.sh. 19 ose 21 me 20; shumëzon me 0,25 duke pjesëtuar me 4; dyfishon një numër deri në 100 dhe gjen gjysmën e një numri deri në 200; dyfishon numrat 10 – 100 dhe 100 – 10 000, p.sh. dyfishi i 360 ose 3600 dhe pastaj gjej gjysmën respektive.</p>
	<p><b>Numrat natyror, dhjetorë dhe të plotë</b> numëron në rritje dhe në zvogëlim duke filluar nga 0; kupton vlerën e secilës shifër në numrat pesë-gjashëshifrorë dhe i ndan në mijëshe, qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe; përdor kuptimin e numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta) dhe gjen vlerën për secilën shifër; rrumbullakos numrat katërshifrorë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt; rrumbullakos një numër dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt; krahason dhe rendit numrat deri në një milion duke përdorur simbolet e krahasimit &lt; dhe &gt;; rendit dhe krahason numra pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit; rendit numra dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes; njeh numrat çift dhe tek; njeh shumëfisha të 5,10, 25, 50, 100 deri në 1000; krijon pohime të ndryshme lidhur me mbledhjen dhe zbritjen e numrave çift dhe tek.</p> <p><b>Thyesat</b> njeh marrëdhënien ndërmjet <math>\frac{1}{2}</math>, <math>\frac{1}{4}</math> dhe <math>\frac{1}{8}</math>; <math>\frac{1}{3}</math> dhe <math>\frac{1}{6}</math>; <math>\frac{1}{5}</math> dhe <math>\frac{1}{10}</math>; njeh barazimin ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë, p.sh. thyesa gjysma, të dhjetat dhe të qindtat; kthen një thyesë më të madhe se 1 në numër të përzierë; p.sh. <math>\frac{7}{4}</math> në <math>1\frac{3}{4}</math>; rendit numrat e përzierë në një bosht numerik; lidh thyesën me pjesëtimin;</p>

<p><b>Numrat natyror, dhjetorë dhe të plotë</b> Vendvlera e secilës shifër në numrat pesë-gjashëshifrorë.</p> <p>Kuptimi i numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta).</p> <p>Rrumbullakimi i numrave katërshifrorë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt.</p> <p>Rrumbullakimi i një numri dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt.</p> <p>Krahasimi dhe renditja e numrave deri në një milion duke përdorur simbolet e krahasimit <math>&lt;</math> dhe <math>&gt;</math>.</p> <p>Rendit dhe krahason numra pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit.</p> <p>Rendit numra dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes.</p> <p>Numra çift dhe tek.</p> <p><b>Thyesat</b> Marrëdhënia ndërmjet <math>1/2</math>, <math>1/4</math> dhe <math>1/8</math>; <math>1/3</math> dhe <math>1/6</math>; <math>1/5</math> dhe <math>1/10</math>;</p> <p>Barazimi ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë, p.sh. thyesa gjysma, të dhjetat dhe të qindtat.</p> <p>Thyesat më të mëdha se 1 dhe numrat e përzierë.</p>	<p>njehson pjesën e një sasive në situata të thjeshta;</p> <p><b>Përqindja</b> kupton përqindjen si numri i pjesëve ndër 100 dhe njehson përqindje të thjeshta; shpreh gjysmën, të dhjeta dhe të qindta si përqindje;</p> <p><b>Raporti dhe përpjesëtimi</b> përdor thyesën për të përshkruar një raport ose përpjesëtim të thjeshtë, p.sh. <math>1/5</math> e ruazave janë të verdha;</p> <p>përdor raportin për të zgjidhur situata të thjeshta problemore, p.sh.; si të adaptohet një recetë gatimi e dhënë për 6, 3, 12 persona;</p> <p><b>Mbledhja dhe zbritja</b> mbledh më shumë se tre numra dy-treshifrorë; mbledh ose zbrit dy numra tre-katërshifrorë; mbledh ose zbrit dy numra dhjetorë me të njëjtën numër shifrash mbas presjes;</p> <p><b>Shumëzimi dhe pjesëtimi</b> shumëzon numrat deri në 10 000 me 10 ose 100; shumëzon dhe pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifrorë; shumëzon dy numra dyshifrorë; shumëzon një numër dhjetor me një shifër mbas presjes me një numër njëshifrorë, p.sh. <math>3,6 \times 7</math>;</p> <p>pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifrorë (përfshirë edhe pjesëtimin me mbetje);</p> <p>fillon të shprehë mbetjen si thyesë në pjesëtimin e numrit dyshifrorë me një numër njëshifrorë;</p> <p>rrumbullakos rezultat në një pjesëtim për të zgjidhur një situatë problemore; njehson rezultat në shprehjeve deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat; kupton pjesëtimin si veprim i kundërt i shumëzimit;</p> <p>zgjidh situata problemore duke përdorur veprimet dhe algoritmin e tyre; verifikon rezultatet duke përdorur makinën llogaritëse;</p> <p><b>Strategji të veprimeve me mend</b> kryen mbledhjen me mend të dy numrave dhjetorë me një shifër mbas presjes me shumë 1, p.sh. <math>0,8 + 0,2</math>;</p>
---	---

<p>Renditja e numrave të përzierë në një bosht numerik.</p> <p>Lidhja e thyesës me pjesëtimin.</p> <p>Pjesa e një sasi në situata të thjeshta.</p> <p><b>Përqindja</b></p> <p>Përqindja si numri i pjesëve ndër 100.</p> <p><b>Raporti dhe përpjesëtimi</b></p> <p>Thyesa si raport ose përpjesëtim i thjeshtë.</p> <p><b>Mbledhja dhe zbritja</b></p> <p>Mbledhja e më shumë se tre numrave dy-treshifrorë.</p> <p>Mbledhja ose zbritja e dy numrave tre-katërshifrorë.</p> <p>Mbledh ose zbritja e dy numrave dhjetorë me të njëjtin numër shifrash mbas presjes.</p> <p><b>Shumëzimi dhe pjesëtimi</b></p> <p>Shumëzimi i numrave deri në 10 000 me 10 ose 100.</p> <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifrorë.</p> <p>Shumëzimi i dy numrave dyshifrorë.</p> <p>Shumëzimi i një numër dhjetor me një shifër mbas presjes me një numër njëshifrorë.</p> <p>Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifrorë (përfshirë edhe pjesëtimin me mbetje).</p> <p>Shprehjet deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat.</p> <p>Pjesëtimi si veprim i kundërt i shumëzimit.</p> <p>Përdorimi i makinës llogaritëse.</p> <p><b>Strategji të veprimeve me mend</b></p> <p>Strategji të kryerjes së veprimeve me mend për mbledhjen, zbritjen shumëzimin dhe pjesëtimin.</p>	<p>kryen mbledhjen me mend të dy numrave dhjetorë me shumë 10; kryen veprime me tabelën e shumëzimit; pjesëton me 2, 5, 10 dhe 100;</p> <p>një katrorët e numrave deri në 10, p.sh. <math>10 \times 10</math>;</p> <p>gjen faktorët e numrave dyshifrorë;</p> <p>numëron në rritje dhe zbritje me mijëshe, qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe;</p> <p>mbledh dhe zbret numra të afërt me shumëfisha 10, 100 dhe 1000 p.sh. 4387 – 299, 5026 – 4998;</p> <p>shumëzon shumëfishat e 10 –90 dhe 100 –900 me një numër njëshifrorë;</p> <p>shumëzon numrat afër shumëfishave të dhjetës, p.sh. 19 ose 21 me 20;</p> <p>shumëzon me 0,25 duke pjesëtuar me 4;</p> <p>dyfishon një numër deri në 100 dhe gjen gjysmën e një numri deri në 200;</p> <p>dyfishon numrat 10 – 100 dhe 100 – 10 000, p.sh. dyfishi i 360 ose 3600 dhe pastaj gjej gjysmën respektive.</p>
--	---



**Qëndrime dhe vlera:**

Nxënësi/ja:

- zbaton algoritmin e veprimeve me mend dhe me shkrim;
- demonstroi kërshëri dhe kuriozitet për numrat;
- organizon lidhjen konceptuale të njohurive;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve me numra;
- vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta;
- demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;
- beson në përdorimin e teknologjisë për kalkulime me numra.

**Tematika: Matjet (23 orë)**

<p><b>Përshkrimi i Tematikës:</b> Nxënësi/ja zbaton proceset e matjes, përzgjedh teknika dhe formula të përshtatshme për të kryer matje direkte dhe indirekte në situata reale. Nxënësi/ja përqendrohet në njehsimet të gjatësive, masës, kohës kryesisht në situata praktike dhe me njësi të ndryshme matjeje brenda të njëjtit lloj. Ai sensibilizohet për konceptet e perimetrit, sipërfaqes dhe vëllimit me anë të veprimtarive praktike, duke i njehsuar ato.</p>
<p><b>Rezultatet e të nxënësve për kompetencat e fushës:</b></p> <p><i>Zgjidhja probleme:</i> identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; bën vërtetime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehjeve matematike.</p> <p><i>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:</i> demonstroi të kuptuarit e konceptit të numërimit, figurave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; zbaton shprehjet të arsyesimit për të bërë hamendësime.</p> <p><i>Të menduarit dhe komunikimi matematik:</i> komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.</p> <p><i>Lidhja konceptuale:</i> bën lidhje të thjeshta mes koncepteve themelore të matjeve me situata nga jeta e përditshme.</p> <p><i>Modelimi matematik:</i> paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p> <p><i>Përdorimi i teknologjisë në matematikë:</i> përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.</p>

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Shkathësitë për realizimin e kompetencave matematikore
<p><b>Gjatësia dhe masa.</b>  Njësitë standarde: km, m, cm, mm, kg, g.  Numrat dhjetorë gjatë matjeve.  Këmbime me njësi të ndryshme.  Rrumbullakimi i matjeve në njësinë më të afërt;  Vizatimi i vijës në cm dhe mm më të afërt.</p> <p><b>Koha</b>  Njësitë e kohës sekonda, minuta, ora, dita, muaji, viti.  Matja e kohës me sistemin 24-orësh;  Kalendari.  Tabela e orareve, intervalet.</p> <p><b>Perimetri dhe syprina</b>  Perimetri i shumëkëndëshit të rregullt dhe jo të rregullt.  Njësitë e sipërfaqes <math>\text{cm}^2</math>.  Formula për syprinën e drejtkëndëshit.</p> <p><b>Vëllimi</b>  Litri, mililitri.</p>	<p><b>Gjatësia dhe masa</b>  zgjedh dhe përdor njësitë standarde për gjatësinë dhe masën;  këmben njësitë kilometrit, metrit, centimetrit dhe milimetrit, kilogramit dhe gramit për të kryer matje me situata praktike, p.sh. 2,6 kg në 2600 g.  rendit matje me njësi të përbëra;  rrumbullakos matjet në njësinë më të afërt;  përdor mjete të shkallëzuara;  zgjidh situata problemore nga jeta e përditshme ku përfshihen matjet;  vizaton dhe mat vija në centimetrim dhe milimetrim më të afërt.</p> <p><b>Koha</b>  përdor njësitë e kohës: sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti;  përdor sistemin 24 orësh për të treguar orën;  lexon tabelat e orareve me sistemin 24 orësh;  llogarit intervale të thjeshta në orë, minuta dhe sekonda;  përdor kalendarin dhe llogarit intervalet në ditë dhe javë nga situata të jetës reale;  llogarit intervalet e kohës në muaj dhe vite.</p> <p><b>Perimetri dhe syprina</b>  mat dhe njehson perimetrimin e shumëkëndëshit të rregullt dhe jo të rregullt;  kupton që syprina matet me katrorin e njësisë së gjatësisë, p.sh. <math>\text{cm}^2</math>;  përdor formulën për syprinën e drejtkëndëshit;</p> <p><b>Vëllimi</b>  njeh lidhjen ndërmjet litrit, centilitrit dhe mililitrit;  përdor mjete të shkallëzuara.</p>



**Qëndrime dhe vlera:**

Nxënësi/ja:

- kupton sistemet e njësive standarde;
- përdor matjet në zgjidhjen e situatave praktike;
- është inovativ dhe prezanton idetë e reja të tij;
- demonstroi kërshëri dhe kuriozitet për matjet e gjatësive, masave, kohës;
- organizon lidhjen konceptuale të njohurive;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve me njësitë;
- vetëvlerësohet, përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta;
- demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;
- respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë;
- demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve.

**Tematika: Gjeometria (22 orë)**

**Përshkrimi i Tematikës:** Nxënësi përdor arsyetimin dhe vërtetimin për të zbuluar dhe provuar marrëdhëniet gjeometrike ndërmjet figurave 2D (2 dimensionale) dhe objekteve 3D (3 dimensionale). Nxënësi/ja ndërton njohuritë për figurat gjeometrike dhe trupat gjeometrikë nëpërmjet evidentimit të vetive të tyre. Ai dallon këndin e drejtë dhe zgjeron njohuritë për këndet e ngushtë dhe të gjerë. Shndërrimet gjeometrike pasurohen me njohuri, që kanë lidhje me simetrinë boshtore, rrotullimin dhe me zhvendosjen.

**Rezultatet e të nxënësit për kompetencat e fushës:**

*Zgjidhja probleme:* identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve.

*Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:* zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësime.

*Të menduarit dhe komunikimi matematik:* komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.

*Lidhja konceptuale:* bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme; identifikon vetitë e figurave dhe objekteve të ndryshme; klasifikon figurat dhe objektet sipas këtyre vetive.

*Modelimi matematik:* krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur emërtimet përkatëse; paraqet figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore

Shkathësitë për realizimin e kompetencave matematikore

<p><b>Gjeometria në plan</b></p> <p>Trekëndëshi dybrinjëshëm, barabrinjës dhe i çfarëdoshëm.</p> <p>Drejtëzat paralele dhe pingule.</p> <p>Këndet e drejtë, të ngushtë dhe të gjerë.</p> <p>Gjeometria në hapësirë</p> <p>Hapja e trupave gjeometrikë.</p> <p>Shndërrimet gjeometrike</p> <p>Simetria.</p> <p>Drejtëza e simetrisë.</p> <p>Njohuri fillestare për zhvendosjen paralele.</p> <p>Rijeta koordinative.</p>	<p><b>Gjeometria në plan</b></p> <p>identifikon dhe përshkruan vetitë e trekëndësheve dhe i klasifikon dybrinjëshëm, barabrinjës dhe i çfarëdoshëm;</p> <p>njeh drejtëzat paralele dhe pingule në figurat 2D dhe i vizaton ato;</p> <p>kupton që këndi matet me gradë, mat këndet në <math>5^0</math> më të afërt;</p> <p>identifikon, përshkruan dhe vlerëson masat e këndeve duke i klasifikuar ata në kënde të drejtë, të gjerë dhe të ngushtë;</p> <p>mat kënde të vizatuara;</p> <p>Gjeometria në hapësirë</p> <p>vizaton hapjen e trupave 3D nëpërmjet figurave 2D;</p> <p>Shndërrime gjeometrike</p> <p>ndërton figura simetrike;</p> <p>krijon modele nëpërmjet dy simetrive boshtore të njëpasnjëshme;</p> <p>lexon dhe vendos koordinatat në kuadratin e parë të rrjetit koordinativ;</p> <p>gjykon se cilat mund të jenë koordinatat e një shumëkëndëshi gjatë lëvizjes më anë të një simetrie me bosht simetrie njëri prej boshteve koordinativë;</p> <p>kupton zhvendosjen si një lëvizje paralele në një vijë të drejtë;</p> <p>jep instruksione për zhvendosjen e një shumëkëndëshi.</p>
<p><b>Qëndrime dhe vlera:</b></p> <p>komunikon marrëdhënien ndërmjet formave 2D dhe 3D;</p> <p>është inovativ dhe prezanton idetë e reja të tij;</p> <p>demonstron kërshëri dhe kuriozitet për figurat 2D dhe trupat 3D;</p> <p>përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve gjeometrike;</p> <p>vetëvlerësohet, përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta;</p> <p>demonstron besim në forcat vetjake;</p> <p>beson në përdorimin e teknologjisë për vizatimin e figurave 2D dhe objektet 3D;</p> <p>respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë;</p> <p>demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.</p>	

### Tematika: Aljebra dhe Funksioni (4 orë)

<p><b>Përshkrimi i tematikës:</b> Nxënësi/ja zbulon ligjësi, përdor kuptimin për numrin që mungon dhe përdor simbolet për të modeluar marrëdhënie në situata praktike. Ekuacionet janë në funksion të veprimeve me numra, duke u kufizuar në mbledhje e zbritje me numra të vegjël. Lidhur me funksionin, nxënësi/ja mëson të dallojë një ligjësi, nëpërmjet modeleve konkrete, kryesisht me karakter zbavitës.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat matematikore:</b></p> <p><i>Zgjidhja probleme:</i> Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.</p> <p><i>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:</i> Zbaton shprehje të arsytimit për të bërë hamendësime. Dallon dhe klasifikon ligjësi për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.</p> <p><i>Të menduarit dhe komunikimi matematik:</i> Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore. Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.</p> <p><i>Lidhja konceptuale:</i> Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</p> <p><i>Modelimi matematik:</i> Paraqet numrat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i lidhur ato me situata konkrete.</p>	
<b>Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës</b>	<b>Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës</b>
<p><b>Ekuacione, inekuacione, sisteme të ekuacioneve</b></p> <p>Kutiza si vendmbajtëse numrash në barazime me mbledhje të dy numrave me katër-pesë shifra.</p> <p><b>Funksioni</b></p> <p>Dallimi i ligjësive dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie.</p>	<p><b>Zgjidhja e ekuacioneve, inekuacioneve, sistemeve të ekuacioneve</b></p> <p>gjen numrin që duhet vendosur në kutizë në barazime me mbledhje ose me zbritje.</p> <p><b>Funksioni</b></p> <p>përshkruan dhe vazhdon një model duke numëruar sipas një ligjësie.</p>

### Qëndrime dhe vlera

Nxënësi/ja:

- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- organizon lidhjen konceptuale të njohurive;
- përdor imagjinatën për zgjidhjen e problemeve me të panjohura;

- vetëvlerësohet në situata të thjeshta;
- pavarësi në mendime dhe veprime;
- demonstroi besim në forcat vetjake;
- respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë;
- demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve.

### **Tematika: Statistika dhe Probabiliteti (11 orë)**

**Përshkrimi i Tematikës:** Nxënësi lexon, kupton dhe interpreton të dhënat statistikore për të marrë vendime në jetën e përditshme. Ai lexon dhe plotëson një tabelë me të dhëna nga mjedisi i tyre. Nxënësi, gjithashtu, paraqet të dhënat me tabela ose diagrame.

#### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

*Zgjidhja probleme:* identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve; bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.

*Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:* zbaton shprehje të arsyesimit për të bërë hamendësime.

*Të menduarit dhe komunikimi matematik:* përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore; ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor; komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.

*Lidhja konceptuale:* bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.

*Modelimi matematik:* paraqet numrat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

*Përdorimi i teknologjisë në matematikë:* përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

<p><b>Rezultatet e të nxënësve për kompetencat e fushës:</b>  <i>Zgjidhja probleme:</i> identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve; bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.  <i>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:</i> zbaton shprehje të arsytimit për të bërë hamendësime.  <i>Të menduarit dhe komunikimi matematik:</i> përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore; ndërton struktura themelore të përshatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkolle; komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.  <i>Lidhja konceptuale:</i> bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.  <i>Modelimi matematik:</i> paraqet numrat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.  <i>Përdorimi i teknologjisë në matematikë:</i> përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.</p>	<p>Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore</p> <p>Shkathësitë për realizimin e kompetencave matematikore</p> <p><b>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</b>          Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektesh, sipas një ose dy cilësive të përbashkëta.          Diagramet në shtyllë dhe grafikët me vijë.          Intervallet në diagramet në shtyllë.          Moda.          Probabiliteti          Mundësi që një ngjarje të ndodh.</p> <p><b>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</b>          i përgjigjet një pyetje nga jeta e përditshme duke grumbulluar ose klasifikuar të dhëna në një listë ose tabelë;          përmblledh konkluzione në mënyrën e tij duke identifikuar pyetje të tjera;          përdor piktogramin, tabelën e dendurive, diagramin shtyllë për të prezantuar rezultatet;          përdor intervallet me 2, 5, 10, 20 ose 100 njësi në diagramin shtyllë;          ndërton grafik të thjeshtë me vijë, p.sh., për të paraqitur ndryshimin e temperaturës me kohën;          krahasimi i grafikëve me vijë, p.sh. paraqitja e ndryshimit të temperaturës me kohën dhe ardhja e nxënësve në shkollë çdo ditë të javës;          gjen modën në një grup të dhënash;          Probabiliteti          përshkruan mundësinë që një ngjarje familjare të ndodh.</p>
--	---

### **Qëndrime dhe vlera**

Nxënësi/ja:

paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;  
është inovativ dhe paraqet idetë e reja të tij;  
përdor imagjinatën për klasifikimin e objekteve;  
demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;  
demonstron besim në forcat vetjake;  
respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë;  
respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

### **Udhëzime për vlerësimin**

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive matematikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*p.sh., vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, test objektiv, vëzhgim me një listë të plotë treguesish, portofol, prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj.*) Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve duhen pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe i strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimi qartë i qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim;
- vlerësimi u adresohet njohurive, shprehjeve e aftësive;
- reflekton besimin që të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;
- informacioni për rezultatet e vlerësimit duhet të motivojë nxënësin, të ndikojë që nxënësi të pranojë se gabimi është pjesë e të nxënit dhe të ndihmojë progresin e mëtejshëm;
- vlerësimi duhet të konsiderohet si pjesë e procesit mësimdhënie-nxënie dhe jo si veprimtari më vete;



- vlerësimi ndihmon nxënësit të marrin përgjegjësi për veten e tyre, duke përfshirë strategji të vetëvlerësimit, të vlerësimit të njërit-tjetrit;
- vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës në kuptimin që t'u sigurojë të gjithë nxënësve të demonstrojnë arritjet e tyre dhe të arrijnë më të mirën e mundshme.

### **Vlerësimi i nxënësve ndahet në tri tipe kryesore:**

**Diagnostikues** që zakonisht kryhet në fillim të shkollës apo vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxëniet e nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë.

**Formues** që është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar procesin e mësimdhënie-nxënies. Fokus i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vlerësimi me notë i nxënësit.

**Përmbledhës** që kryhet për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxëniet.

Gjatë vlerësimit mësuesi/ja duhet të mbështetet në një sasi të konsiderueshme të dhënash që përfshihen në këto elemente:

- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;
- vlerësimi i punës në grup;
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;
- vlerësimi i detyrave të shqipërisë;
- testet për një grup temash të caktuara;
- testet në përfundim të një kohe të caktuar;
- testet në përfundim të gjysmës së parë ose në fund të vitit mësimor.
- Detaje, që kanë lidhje me vlerësimin në arsimin bazë, gjenden në dokumente zyrtare të posaçme për këtë qëllim.

### **Materiale dhe burime mësimore**

Gjatë mësimit të matematikës për realizimin e kompetencave, mësuesi/ja përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai përdor mjete pamore, teknologji të nevojshme, bën vizatime, modelime, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedise për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në matematikë duke ndihmuar

nxënësin të eksplorojë situata të ndryshme, të përpunojë të dhëna, të llogarisë duke zhvilluar aftësitë e tij në studimin e matematikës. Mësuesi/ja përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta dhe me një fjalor të pasur. Mësuesi/ja siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai u prezanton/sqaron nxënëseve përmbajtje të caktuara ose shkathësitë që ata duhet të demonstrojnë.

Mësuesi/ja u krijon mundësi nxënëseve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të mediave detyra dhe projekte të ndryshme.

### **Rezultatet e të nxënit sipas tematikave:**

#### **Tematika: Numri**

**Përkshkrimi i tematikës:** Nxënësi përdor kuptimin e numrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe algoritmin e veprimeve me numra për të paraqitur sasi në botën reale. Nxënësi mësion numrat deri në 1000000. Rëndësi i kushtohet rrumbullakimit dhe dobisë së tij në gjetjen e rezultateve të përafërta. Njohuritë për thesaret pasurohen me kthimin e thesave në emërues të njëjtë dhe formimin e thesave të barabarta. Bashkësisë së numrave i shtohen numrat dhjetorë dhe numrat e plotë negativë dhe pozitivë. Nxënësi trajton algoritmet e veprimeve me numra natyrorë, rëndësi i kushtohet edhe zbatimit të vetive të veprimeve dhe përdorimit të makinës llogaritëse. Për numrat dhjetorë e thesaret trajtohen shprehitë bazë për mbledhjen e zbritjen e tyre.

### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

**Zgjidhja problemore:** kryen veprimet themelore matematikore me numra dysifrorë; identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve.

**Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:** demonstroi të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, figurave, adhësive, vizatimeve dhe objekteve; dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.

**Të menduarit dhe komunikimi matematik:** komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me numra.

**Lidhja konceptuale:** bën lidhje të thjeshta mes numërimit.

**Modelimi matematik:** krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur numrat dy shifror; paraqet numrat, konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

**Përdorimi i teknologjisë në matematikë:** përdor mjete të thjeshta për kalkulime në mënyrë që të zgjidh probleme të ndryshme matematikore.

#### **Tematika: Matjet**

**Përkshkrimi i tematikës:** Nxënësi/ja zbaton proceset e matjes, përzgjedh teknika dhe formula të përshtatshme për të kryer matje direkte dhe indirekte në situata reale. Nxënësi/ja përqendrohet në njehsime të gjatësive, masës, kohës kryesisht në situata praktike dhe me njësi të



ndryshme matjeje brenda të njëjtit lloj. Ai sensibilizohet për konceptet e perimetrit, sipërfaqes dhe vëllimit me anë të veprimtarive praktike, duke i njehsuar ato.

### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

*Zgjidhja probleme:* identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimit të shprehive matematike.

*Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:* demonstroi të kuptuarit e konceptit të numërimit, figurave, madhësi, vizatimeve dhe objekteve; zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësi.

*Të menduarit dhe komunikimi matematik:* komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.

*Lidhja konceptuale:* bën lidhje të thjeshta mes koncepteve themelore të matjeve me situata nga jeta e përditshme.

*Modelimi matematik:* paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

*Përdorimi i teknologjisë në matematikë:* përdor mjete të thjeshta për kalkule dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

### **Tematika: Gjeometria**

**Përshkrimi i tematikës:** Nxënësi përdor arsyetimin dhe vërtetimin për të zbuluar dhe provuar marrëdhëniet gjeometrike ndërmjet figurave 2D (2 dimensionale) dhe objekteve 3D (3 dimensionale). Nxënësi/ja ndërton njohuritë për figurat gjeometrike dhe trupat gjeometrikë nëpërmjet evidentimit të vetive të tyre. Ai/ajo dallon këndin e drejtë dhe zgjeron njohuritë për këndet e ngushtë dhe të gjerë. Shndërrimet gjeometrike pasurohen me njohuri, që kanë lidhje me simetrinë boshlore, rrotullimin dhe me zhvendosjen.

### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

*Zgjidhja probleme:* identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; zbaton strategji të zgjidhjes së problemave.

*Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:* zbaton shprehje të arsyetimit për të bërë hamendësi.

*Të menduarit dhe komunikimi matematik:* komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.

*Lidhja konceptuale:* bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme; identifikon vetitë e figurave dhe objekteve të ndryshme; klasifikon figurat dhe objektet sipas këtyre vetive.

*Modelimi matematik:* krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur emërtimet përkatëse; paraqet

### **Tematika: Algjebra dhe Funksioni**

**Përshkrimi i tematikës:** Nxënësi/ja zbulon ligjësi, përdor kuptimin për numrin që mungon dhe përdor simbolet për të modeluar marrëdhënie

në situata praktike. Ekuacionet janë në funksion të veprimeve me numra, duke u kufizuar në mbledhje e zbritje me numra të vegjël. Lidhur me funksionin, nxënësi/ja mëson të dallojë një ligjësi, nëpërmjet modeleve konkrete, kryesisht me karakter zbavitës.

**Rezultatet e të nxënësve për kompetencat matematikore:**

*Zgjidhja probleme:* Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.

*Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:* Zbaton shprehje të arsyesimit për të bërë hamendësime. Dallon dhe klasifikon ligjësi për të gjykuar për hamendësime

nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.

*Të menduarit dhe komunikimi matematik:* Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore. Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.

*Lidhja konceptuale:* Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.

*Modelimi matematik:* Paraqet numrat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i lidhur ato me situata konkrete

*Zgjidhja probleme:* Bën vrojtime dhe hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.

*Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:* Zbaton shprehje të arsyesimit për të bërë hamendësime. Dallon dhe klasifikon ligjësi për të gjykuar për hamendësime

nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.

*Të menduarit dhe komunikimi matematik:* Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore. Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.

*Lidhja konceptuale:* Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.

*Modelimi matematik:* Paraqet numrat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i lidhur ato me situata konkrete.

**FUSHA: MATEMATIKË**  
**LËNDA: MATEMATIKË**

**KLASA : V**

**PLANIFIKIMI PËR PERIUdhËn e parë (Shtator-Dhjetor) (48 orë)**

Numri	Matja	Gjeometria	Algjebra dhe funksioni	Statistika dhe probabiliteti	Përgatitje për provimin e klasës së pestë	Orë gjithsej
48 orë	----	-----	-----	-----	-----	48 orë

### PERIUDHA E PARË (SHTATOR-DHIJETOR)

Nr.	Tematika	Tema mësimore	JAVA	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet materialele didaktike	Data
1 2	(NUMRI) Numri dhe vendvlera (17 orë)	Diskutojmë së bashku Rreth njohurive të klasës së 4	1	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	Lojë, Punë në çifte, Diskutim	Vlerësim formal për: krahasimin, arsyetimin dhe kuptimin e vlerës së numrit	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
3 4		Vendvlera Vendvlera	1	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	Lojë, Punë në grup, diskutim	Vlerësim formal për: krahasimin, arsyetimin për llojet e vlerës së numrit	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
5 6		Të dhjetat dhe të qindtat Të dhjetat dhe të qindtat	2	Situatë konkrete	Punë në grup, diskutim	Vlerësim formal për: krahasimin, arsyetimin për gjetjen e thyesave më të mëdha se 1 me numër të përzier	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	

<b>7</b> <b>8</b>	Rrumbullakimi Rrumbullakimi	<b>2</b>	Situatë konkrete	Punë në grup, diskutim	Vlerësim formal për: krahësimin, rrumbullakimin e numrave	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>9</b> <b>10</b>	Renditja dhe krahësimi Renditja dhe krahësimi	<b>3</b>	Situatë konkrete	Bashkëbisedim, diskutim Punë në çifte	Vlerësim formal për: krahësimin, arsyetimin për gjetjen e saktë	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>11</b> <b>12</b>	Vargjet e numrave Vargjet e numrave	<b>3</b>	Situatë konkrete	Punë në grup, Diskutim Punë e pavarur	Vlerësim formal për: vendosjen e numrave sipas rendeve	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>13</b> <b>14</b>	Numra tek dhe çift Numra tek dhe çift	<b>4</b>	Situatë konkrete	Bashkëbisedim, diskutim Punë në çifte	Vlerësim formal për: vendosjen e numrave sipas rendeve	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>15</b> <b>16</b>	Numri dhe vendvlera (Pëmbledhim) Numri dhe vendvlera (Përforcim)	<b>4</b>	Situatë problemore nga jeta	Diskutim Punë në dyshe	Vlerësim formal Diagnostikues Njohuri të e marra	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	



<b>25</b> <b>26</b>	Të qindtat Të qindtat	<b>7</b>	Situatë konkrete	Diskutim; Shpjegim- demonstrim Punë e pavarur, Punë në grup	Vlerësim formal për: arsyetim, komunikim përdorimin sipas kritereve të tyre	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
<b>27</b> <b>28</b>	Përqindjet Përqindjet	<b>7</b>	Situatë konkrete	Punë në grup Punë e pavarur, diskutim	Vlerësim formal për: arsyetim- komunikim gjetjen e përqindjes	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
<b>29</b> <b>30</b>	Përpjesëtimi Përpjesëtimi	<b>8</b>	Ndarja në pjesë	Punë në grupe, diskutim, Punë në çifte	Vlerësim formal për: arsyetim- komunikim gjetjen e përpjesëtimin	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
<b>31</b> <b>32</b>	Raporti Raporti	<b>8</b>	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	Diskutim, Punë në grup, Punë e pavarur	Vlerësim formal për: arsyetim- komunikim gjetjen e raportit	Materiale të ndryshme Libri, fletore pune objekte të ndryshme	
<b>33</b> <b>34</b>	Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjesëtimi (Përmbledhim dhe përforcime)	<b>9</b>	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	Diskutim; Shpjegim- demonstrim Punë e pavarur, Punë në grup	Vlerësim formal për: arsyetim- komunikim	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	

35	Testim për njohuritë e marra në kapitullin e dytë	9	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	Diskutim; Shpjegim-demonstrim Punë e pavarur, Punë në grup	Vlerësim formal diagnostikues njohuritë e marra	Materiale të ndryshme, libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
36	(NUMRI) Strategji të veprimeve me mend (13 orë)						
37	Çiftet e numrave	10	Situatë jetësore	Diskutim, punë në dyshe Punë e pavarur	Vlerësim formal për: kryerjen shpejt të veprimeve brenda kohës dhe dhënien e përgjigjeve të sakta.	Materiale të ndryshme libri, fletore pune, objekte të ndryshme	
38	Çiftet e numrave						
39	Fakte të shumëzimit dhe të pjesëtimit	10	Zbulojmë dhe eksplorojmë	Lojë, Diskutim, Punë në dyshe	Vlerësim formal për: kryerjen shpejt të veprimeve brenda kohës dhe dhënien e përgjigjeve të sakta.	Foto, Internet, flete, gërshtë, libri i nxënësit	
40	Fakte të shumëzimit dhe të pjesëtimit/ve						



<b>41</b> <b>42</b>	Vetitë e numrave Vetitë e numrave	<b>11</b>	Situatë konkrete	Bisedë, Punë në grup Punë në çifte, Punë unë e pavarur	Vlerësim formal për: kryerjen shpejt të veprimeve brenda kohës dhe dhëniën e përgjigjeve të sakta.	Materiale të ndryshme Libri, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>43</b> <b>44</b>	Llogaritja e shumave dhe e ndryshesave Llogaritja e shumave dhe e ndryshesave	<b>11</b>	Situatë konkrete	Bisedë, Stuhi mendimesh, Punë e pavarur	Vlerësim formal për: kryerjen shpejt të veprimeve brenda kohës dhe dhëniën e përgjigjeve të sakta.	Foto, Internet flete, gërshtë, libri i nxënësit	
<b>45</b> <b>46</b>	Shumëfishat më të afërt Projekt	<b>12</b>	Zbulojmë dhe eksplorojmë	Diskutim; Shpjegim-demonstrim Punë. e pavarur, Punë në grup	Vlerësim formal për: kryerjen shpejt të veprimeve brenda kohës dhe dhëniën e përgjigjeve të sakta.	Foto, Internet, fletë, gërshtë, libri i nxënësit	
<b>47</b> <b>48</b>	1- Përsëritje njohurish 1- Testim përmbledhës për periudhën e parë	<b>12</b>	Situatë konkrete	Diskutim; Shpjegim-demonstrim Punë e pavarur, Punë në grup	Testim përmbledhës për periudhën e parë.	Foto, Internet, fletë, gërshtë, libri i nxënësit	

**FUSHA: MATEMATIKË**  
**LËNDA: MATEMATIKË**  
**KLASA: V**

**PLANIFIKIMI PËR PERIUdhËN E DYTË (Janar – mars)**

(48 orë)

Numri	Matja	Gjeometria	Algjebra dhe funksioni	Statistika dhe probabiliteti	Orë përgatitje për provimin e klasës së pestë	Gjithsej orë
22 orë	6 orë	16 orë	4 orë	-----	-----	48 orë

**PERIUdhA E DYTË (JANAR-MARS)**

Nr.	Tematika	Tema mësimore	JAVA	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet materialet didaktike	Data
1 2	(NUMRI) Strategjitë e veprimeve me mend (7 orë)	Cilën strategji? Strategjitë e shumëzimit	1	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	rolet në grupe bashkëpunuese	Vlerësim diagnostikues Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	

<b>3</b> <b>4</b>	Strategjitë të tjera të shumëzimit Strategjitë të tjera të shumëzimit	<b>1</b>	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	mendo, puno në dyshe, shkëmbe mendime	Intervistë me një listë treguesish Kryen shpejt brenda kohës detyrën	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>5</b> <b>6</b>	Dyfishimi dhe përgjysmimi Dyfishimi dhe përgjysmimi	<b>2</b>	Situatë konkrete	di, dua të di, mësova	Vetëvlerësim me listë kontrolli Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>7</b>	Strategji të veprimeve me mend	<b>2</b>	Situatë konkrete	kërkim, hulumtim	Vlerësim formues Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>8</b>	(NUMRI) Veprime me shkrim (13 orë)		Diskutojmë së bashku				
<b>9</b> <b>10</b>	Mbledhja dhe zbritja Mbledhja dhe zbritja	<b>3</b>	Situatë konkrete	rrugëzgjdhje për të lexuarit në matematikë	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	

<b>11 12</b>	Më shumë për mbledhjen dhe zbritjen Më shumë për mbledhjen dhe zbritjen	<b>3</b>	Situatë konkrete	stuhi mendimi në dyshe	Vlerësim i punës në grup Kryen shpejt brenda kohës detyrën	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte te ndryshme	
<b>13 14</b>	Shumëzimi Shumëzimi	<b>4</b>	Situatë konkrete	bashkëbisedim, rrjet diskutimi	Vlerësim mes nxënësish Kryen shpejt brenda kohës detyrën	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>15 16</b>	Shumëzimi i numrave dhjetorë Shumëzimi i numrave dhjetorë	<b>4</b>	Situatë problemore nga jeta	diskutim vëzhgo, analizo	Vlerësim i detyrave të shtëpisë	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>17 18</b>	Pjesëtimi Pjesëtimi	<b>5</b>	Veprime të kundërta me thyesat	diskutim; shpjegim-demonstrim të nxënësve me këmbime	Vetëvlerësim Vlerësim i pjesëtimit dhe i veprimeve me kllapa	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	

19 20		Më shumë për pjesëtimin Më shumë për pjesëtimin	5	Situatë jetësore	parashikim me tema paraprakë, rrjet diskutimi	Vëzhgim me një listë të plotë treguesish	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
21 22	(ALGJEBËR)  Veprime me shkrim (4 orë)	Kllapat Kllapat	6	Situatë konkrete	imagjinatë e drejtuar, mendo, krijo në dyshe, diskuto	Vlerësim diagnostikues Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
23 24		Veprime me shkrim Veprime me shkrim	6	Situatë konkrete	Stuhi mendimi në dyshe, përvijim i të menduarit	Vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
25 26	(NUMRI)  Veprime me shkrim (2 orë)	Përsëritje njohurish Testim për njohuritë e marra për kapitullin e katërt	7	Gjen pjesën e një numri nëpërmjet rolit që kanë gjymtyrët e një thyese	Stuhi mendimi në dyshe, rrjet diskutimi	Prezantim me gojë ose me shkrim Test në përfundim të një kohe të caktuar	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
27 28	(GJEOMETRI) Format gjeometrike (8 orë)	Diskutojmë së bashku Trupat gjeometrikë	7	Situatë konkrete	rrjet diskutimi mendo, krijo në dyshe, diskuto	Vlerësim i përgjigjeve me gojë e me shkrim	Kompleti i trupave gjeometrikë	

29 30	Drejtëzat Këndet	8	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	mendo, krijo në dyshe, diskuto	Vlerësimi i punës në grup projekt kurrikular	Materiale të ndryshme libri fletore pune Raportor, vizore
31 32	Trekëndëshat Simetria	8	Ndarja në pjesë	harta e konceptit. lexim dhe pyetje	Vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë	Figura simetrike dhe jo simetrike
33 34	Shumëkëndëshat Format gjeometrike	9	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	kërkim, hulumtim rishikim në dyshe	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	objekte të ndryshme trupa dhe figura gjeometrike
35 36	Diskutojmë së bashku Koordinatat	9	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	të nxënës me këmbime lexim dhe pyetje	Vëzhgim me një listë të plotë treguesish	Materiale të ndryshme, libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme
37 38	Simetria në lidhje me një drejtëz Simetria në lidhje me një drejtëz	10	Situatë jetësore	kërkim, hulumtim rishikim në dyshe	Prezantim me gojë ose me shkrim	Materiale të ndryshme libri, fletore pune, objekte të ndryshme

<b>39</b> <b>40</b>	Zhvendosjet Vendndodhja dhe lëvizja Përmbledhim dhe përforcime	<b>10</b>	Zbulojmë dhe eksplorojmë	diskutim për njohuritë paraprake hulumtim, shqyrtim i përbashkët	Vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë	Foto, Internet, fletë, gërshtë, libri i nxënës
<b>41</b> <b>42</b>	Përsëritje Testim përmbledhës (për periudhën e dytë)	<b>11</b>	Situatë konkrete	testim përmbledhës	Vlerësim përmbledhës	Foto, internet, fletë, gërshtë, libri i nxënës
<b>43</b> <b>44</b>	Projekt Diskutojmë së bashku  (MATJA) Gjatësia, masa dhe vëllimi (6 orë)	<b>11</b>	Situatë konkrete	përvijim i të menduarit mendo, krijo në dyshe, diskuto	Vëzhgim me një listë të plotë treguesish	Materialle të ndryshme, libri, fletore pune, objekte të ndryshme
<b>45</b> <b>46</b>	Njësitë e matjes Njësitë e matjes	<b>12</b>	Situatë konkrete	kërkim, hulumtim zbulojmë edhe eksplorojmë	Vlerësim i përgjigjeve të sakta e kryerjes së detyrave në kohë	Foto, internet flete gërshtë, libri i nxënës
<b>47</b> <b>48</b>	Matja e gjatësisë Matja e gjatësisë	<b>12</b>	Zbulojmë dhe eksplorojmë	rugëzgjdhje për të lexuarit në matematikë rishikim në dyshe	Vëzhgim me një listë të plotë treguesish	Foto, internet, fletë, gërshtë, libri i nxënës

**FUSHA: MATEMATIKË**  
**LËNDA: MATEMATIKË**  
**KLASA: V**

**PLANIFIKIM PËR PERIUDHËN E TRETË (44 ORË)**

**(PRILL – QERSHOR)**

Numri	Matja	Gjeometria	Algjebra dhe funksioni	Statistika dhe probabiliteti	Orë përgatitje për provimin e klasës së pestë	Gjithsej orë
-----	17 orë	6 orë	----	11 orë	10 orë	44 orë

**TREMUJORI I TRETË (PRILL-QERSHOR)**

Nr.	Tematika	Tema mësimore	JAVA	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet materialet didaktike	Data
1 2	(MATJA) Gjatësia, masa dhe vëllim (8 orë)	Centimetra dhe milimetra Centimetra dhe milimetra	1	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	rolet në grupe bashkëpunuese	Vlerësim diagnostikues Vlerësim i njohurive paraprake dhe aftësive të nxënësve	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
3 4		Matja e masës Matja e masës	1	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	mendo, puno në dyshe, shkëmbe mendime	Intervistë me një listë treguesish Kryen shpejt brenda kohës detyrën	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	



5 6		Matja e vëllimit Matja e vëllimit	2	Situatë konkrete	di, dua të di, mësova	Vetëvlerësim me listë kontrolli. Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
7 8		Gjatësia, masa dhe vëllimi Gjatësia, masa dhe vëllimi	2	Situatë konkrete	kërkim, hulumtim	Vlerësim formues Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
9 10	(MATJA) Koha (9 orë)	Diskutojmë së bashku Këmbimi ndërmjet njësive të kohës	3	Situatë konkrete	rrugëzgjdhje për të lexuarit në matematikë	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	

<b>11</b> <b>12</b>		Përdorimi i orës me sistem 24- orësh  Leximi i tabelave të orareve	<b>3</b>	Situatë konkrete	stuhi mendimi në dyshe	Vlerësimi i punës në grup Kryen shpejt brenda kohës detyrën	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>13</b> <b>14</b>		Llogaritja e intervaleve kohore  Përdorimi i kalendarëve	<b>4</b>	Situatë konkrete	bashkëbisedim, rrjet diskutimi	Vlerësim mes nxënësisht. Kryen shpejt brenda kohës detyrën	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>15</b> <b>16</b>		Koha (përsëritje)  Testim për njohuritë e mara rreth matjes	<b>4</b>	Situatë problemore nga jeta	diskutim vëzhgo, analizo	Vlerësimi i detyrave të shtëpisë	Materiale të ndryshme libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	

17		Projekt	5	Situatë konkrete	stuhi mendimi në dyshe rrjet diskutimi	Vlerësim diagnostikues Vlerësim i njohurive paraprake dhe aftësive të nxënësve	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
18	(GJEOMETRI) Perimetri dhe syprina (6 orë)	Diskutojmë së bashku						
19		Kuptimi për perimetrin	5	Situatë konkrete	imagjinatë e drejtuar mendo, krijo në dyshe, diskuto	Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
20		Kuptimi për syprinën						
21		Llogaritja e syprinës dhe perimetrit të drejtëkëndëshave	6	Situatë konkrete	imagjinatë e drejtuar mendo, krijo në dyshe, diskuto	Nxënësit vlerësohen për dhënien e përgjigjeve të sakta	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
22		Perimetri dhe syprina (përmbledhim)	6					
23		Përmbledhim dhe përforcime	6	Situatë konkrete	rrjet diskutimi mendo, krijo në dyshe, diskuto	Vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	

<b>24</b>	<b>Përpunimi i të dhënave (11 orë)</b>	Diskutojmë së bashku	<b>6</b>	Situatë konkrete	stuhi mendimi në dyshe, përvijim i të menduarit	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë e me shkrim	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
<b>25 26</b>		Tabelat e dendurive dhe piktogramet  Tabelat e dendurive dhe piktogramet	<b>7</b>	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	harta e konceptit. lexim dhe pyetje	Vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	
<b>27 28</b>		Grafikët me shtylla dhe grafikët me vijë  Grafikët me vijë	<b>7</b>	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	mendo, krijo dyshe, diskuto	Vlerësimi i punës në grup	Materiale të ndryshme Libri, fletore pune objekte të ndryshme	
<b>29 30</b>		Probabiliteti Probabiliteti	<b>8</b>	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	analizo, diskuto, nxirr përfundime	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Kompleti i thyesave objekte të ndryshme	

<b>31</b> <b>32</b>	Përpunimi i të dhënave  Përpunimi i të dhënave	<b>8</b>	Sjellje shembujsh dhe diskutimi i tyre	kërkim, hulumtim rishikim në dyshe	Vëzhgim me një listë të plotë treguesish	Materiale të ndryshme, libri i nxënësit, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>33</b> <b>34</b>	Përsëritje njohurish.  Testim përmbledhës (për periudhën e tretë)	<b>9</b>	Analizo, diskuto, nxirr përfundime	përvijim i të menduarit mendo, krijo dyshe, diskuto	Prezantim me gojë ose me shkrim	Materiale të ndryshme Libri, fletore pune, objekte të ndryshme	
<b>35</b> <b>36</b>	<b>Përsëritje (10 orë)</b>  Orë përsëritje për provimin e klasës së pestë  Orë përsëritje për provimin e klasës së pestë	<b>9</b>					
<b>37</b> <b>38</b>	Orë përsëritje për provimin e klasës së pestë  Orë përsëritje për provimin e klasës së pestë	<b>10</b>					



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Numri dhe vendvlera</b> <b>Tema mësimore:</b> Diskutojmë së bashku			
<b>Situata e të nxënit:</b> Sjellje të shembujve për kuptimin e numrave 6-shifrorë.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krijon me shifra të ndryshme numra 6-shifrorë dhe i emërton ato sipas vendvlerave. - Tregon vendvlerën e secilës shifër që përmban secili numër. - Shkruan numrin kur ai është paraqitur në fjali ose si formë e zbërthyer.			
<b>Fjalët kyçe:</b> qindmijëshe, dhjetëmijëshe, mijëshe, presje dhjetore, të dhjetat, të qindtat, rend rritës, rend zbritës.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Vëzhgo-emërto, sill shembuj, diskuto dhe nxirr përfundime, krijim i lirë (punë në dyshe, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Diskutim për njohuritë paraprake. Punë në dyshe</b> Mësuesi/ja paraqet situatën: Krijë një varg me 12 numra dhe kërkon të zgjedhin një numër të plotë nga i cili do të fillojë vargu numerik. Kërkon nga nxënësit të shkruajnë vargun që të përmbajë numra më të mëdhenj dhe më të vegjël se numri që krijojnë në fillim. Më pas kërkon nga nxënësi/ja: - Shkruaj vargun në kutitë e mëposhtme. - Tregoj shokut vargun që formove. - Bëji atij pyetjet e mëposhtme: Sipas së cilës rregull ndryshojnë numrat e vargut? A mund të shtosh edhe nga 10 numra të tjerë përpara dhe pas këtij vargu? Tregohen rendet dhe klasat që përbëjnë numrin e dhënë.  <b>Faza e dytë: Mendo-puno në dyshe, diskuto</b> <b>a. Lojë “Më gjej se cili jam”.</b> Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në dyshe etiketa ku ata do të gjejnë numrin fillestar sipas të dhënave të shkruara. P.sh. Blina krijoi një varg numrash. Ajo kishte dhjetë numra. Rregulla që zbatoi ishte 1,5. Numri i fundit i vargut ishte 7,5. Gjej numrin fillestar të këtij vargu numrash.			

**b. Punë në grup. Diskuto**

Bledi krijoi një varg numrash. Ai kishte pesë numra. Fillonte me 5 dhe mbaronte me 65. Gjej rregullën e zbatuar në këtë varg.

Për këtë ka 3 minuta kohë. Mësuesi/ja shkon nga grupi në grup për të dëgjuar diskutimet e nxënësve.

U kërkohet nxënësve që të paraqesin vargjet e numrave dhe ta emërtojnë atë. Sqarohet se kur numri ka presje kemi formimin e një numri dhjetor.

Kërkon nga nxënësi/ja:

Si vijnë numrat nga e majta në të djathtë? Po nga e djathta në të majtë?

Shkruhen në tabelë 6 shifra dhe kërkon nga nxënësit formimin e numrave 6-shifrorë.

P.sh. 4, 6, 0, 4, 1.

Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit. Nxënësit i radhitin si i morën. I radhitin nga më i madhi.

U kërkohet nga nxënësit si do të emërtohet shifra dhe të shkruajnë me fjalë.

**Faza e tretë: Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Të punuarit në bashkëpunim**

Nxënësit hapin fletoret dhe shkruajnë me fjalë dhe të zbërthyer numrat sipas këtij modeli:  
 $61450 = 6Dhm + 1M + 4Q + 5Dh + 0Nj$  gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë.

Nxënësve u kërkohet të punojnë me vargje sipas një rregulli.

Lexohen ushtrimet nga nxënës të ndryshëm.

Bëhet vlerësimi i punës së nxënësve. Përgëzohen për punën e bërë.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- krijimin me shifra të ndryshme numra 6-shifrorë dhe i emërton ato sipas vendvlerave;
- tregimin e vendvlerës së secilës shifër që përmban secili numër;
- shkrimin e numrit kur ai është paraqitur në fjali ose si formë e zbërthyer.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit do të kërkohen në gazeta, revista, ku bëjnë blerje numra të ndryshëm. Do t'i shkruajë ato në fletore duke formuar numra 6-shifrorë.



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Diskutojmë së bashku – rreth njohurive të klasës së 4-t			
<b>Situata e të nxënit:</b> Të gjejmë vendvlerën duke operuar në mënyra të ndryshme.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Lexon numrat 5, 6-shifrorë dhe tregon vendvlerën e secilit numër. - Radhit nga më i vogli te më i madhi dhe anasjelltas. - Shkruan me shifra numrat e dhënë me fjalë.			
<b>Fjalët kyçe:</b> qindmijëshe, dhjetëmijëshe, mijëshe, presje dhjetore, të dhjetat, të qindtat, rend rritës, rend zbritës.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Vëzhgo-emërto, sill shembuj, diskuto dhe nxirr përfundime, krijim i lirë (punë në dyshe, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Faza e parë: Të nxënit në bashkëpunim.</b> Veprimtari. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të tregojnë ku i shohin numrat. Thuhen disa numra me zë të lartë. Mësuesi/ja: Tani do të punojmë në grupe. Secili grup bën matje të objekteve në klasë. Formuloni secili grup një situatë me numrat e formuar. Koha në dispozicion është10 minuta. Pasi dëgjon mendimet e nxënësve mësuesi/ja pyet: Si vepruat? Çfarë përfundimesh arritët? Shkruani nga më i vogli numrat te më i madhi. Shkruani numrat me fjalë. Nxënësit diskutojnë rreth asaj mënyre zgjidhjeje.			
<b>Faza e dytë: Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Punë në dyshe</b> Nxënësit në dyshe do të shkruajë pesë numra gjashtëshifrorë me shifrat e dhëna dhe do të tregojnë vendvlerën e secilës shifër. Nxënësit prezantojnë punën e kryer. Mësuesi/ja u kërkon në grup nxënësve që të shkruajnë katër numra 6-shifrorë 2 të jenë tek dhe 2 çift, p.sh., 456234 = 400000 + 50000 + 6000 + 200 + 30 + 4 (çift). Shkruajë numrat duke treguar vlerën e secilës shifër. Nxënësit prezantojnë punën e kryer.			

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

Mësuesi/ja shpërndan fleta ushtrimesh të përgatitura dhe nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.

P.sh.: Gjeni numrat që mungojnë në kutizë.

Cili është numri më i vogël? Po më i madhi?

Nxënës të ndryshëm lexojnë përgjigjet e tyre. Shokët plotësojnë sipas ushtrimit. Bëhet vlerësimi i punës së nxënësve dhe komentet.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- tregimin e vendvlerës së secilës shifër që përmban secili numër;
- shkrimin e numrit kur ai është paraqitur në fjali ose si formë e zbërthyer;
- leximin e numrave 5, 6-shifrorë duke treguar vendvlerën e secilit numër;
- radhitjen nga më i vogli te më i madhi dhe anasjelltas.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Zbërtheni numrat 100562, 45912, 148500, 54968, 12358, 475821, sipas vendvlerave. Shkruaji ato me fjalë.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Temat mësimore:</b> Vendvlera			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojëra me numra që tregojnë një larmi të përdorimit të tyre.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Zbërthen një numër sipas vendvlerave të shifrave dhe e kundërta. - Formon numrin kur shifrat e tij janë zbërthyer sipas vendvlerave. - Lexo numrat duke i ndarë shifrat në klasa. - Përcakton vlerën e shifrës sipas rendit			
<b>Fjalët kyçe:</b> qindmijëshe; dhjetëmijëshe; mijëshe; qindëshe; dhjetëshe; njëshe; numër pozitiv; numër negativ; numër dhjetor; të dhjetat; të qindtat; presje dhjetore; (>) më e madhe se; (<) më e vogël se; rendi rritës; rendi zbritës			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Vëzhgo-emërto, sill shembuj, diskuto dhe nxirr përfundime, krijim i lirë (punë në dyshe, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake: Rikujtim i njohurive të mëparshme</b> Mësuesi/ja rikujton vendvlerën e çdo shifre . Mësuesja shpërndan etiketa me shkrime numrash të ndryshëm pesë dhe gjashtë shifrorë e kërkon që nxënësit të tregojnë se ku e kanë më të lehtë që ta lexojnë një numër të tillë. Nxirret përfundimi se nëpërmjet klasës së thjeshtë dhe klasës së mijësheve lihet pak hapësirë. Nxënësve në dyshe u është shpërndarë një tabelë me shifra deri në 6 rende. U kërkohet të zgjedhin një numër nga secila kolonë në tabelën e mëposhtme. - Mblidhi ato dhe formo një numër gjashtëshifrorë. Mësuesi/ja i nxit nxënësit në diskutim duke kërkuar që ata të tregojnë rendin e numrave. Shkruajnë numrin që formuan. Lexohet numri nga nxënës të ndryshëm.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë</b> <b>Marrëdhënia pyetje-përgjigje</b> Mësuesi/ja shkruan në tabelë numrat që kanë këto rende: 4QM, 3DhM, 4M, 3Q, 4Nj = 434304 Nxënësit gjejnë këta numra. Nxënësit hapin librat dhe kalojnë në leximin dhe plotësimin e këtyre veprimtarive. Ata do të kryejnë këto veprimtari:			

- Zgjidh një numër nga secila kolonë në tabelën e dhënë.
  - Mblidhi ato dhe formo një numër gjashtëshifrorë.
  - Shkruaje numrin e formuar.
  - Renditi numrat nga më i vogli te më i madhi.
- Një pjesë të detyrave nxënësit i hedhin në fletoren e klasës ose në fletë.

### **Faza e tretë: Demonstrimi i rezultateve të arritura**

Ndahet klasa në grupe. Secili grup ka situatat e veta.

Situata 1: Melisa zgjodhi 600000, 4000, 60 dhe 2. Cilin numër formoi ajo? Shkruaje numrin.

Situata 2: Dritani zgjodhi 100000, 70000 dhe 900. Cilin numër formoi ai? Shkruaje numrin.

Mësuesi/ja kontrollon punën e grupeve dhe fton grupet të krahasojnë zgjidhjen e gjetur.

Më pas shkruhen numrat e formuar në tabelë.

Diskutimi bëhet me gjithë klasën dhe arritja e rezultateve.

Përgëzohen nxënësit për punën e kryer.

### **Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- zbërthimin e një numëri sipas vendvlerave të shifrave dhe e kundërta;
- formimin e numrit kur shifrat e tij janë zbërthyer sipas vendvlerave;
- leximin e numrave duke i ndarë shifrat në klasa;
- përcaktimin e vlerës së shifrës sipas rendit.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Krijo katër numra me 5 shifra dhe katër numra me 6 shifra. Shkruaji ato me fjalë dhe sipas vendvlerave. Plotëso fletoren e punës, ushtrimi 1.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Temat mësimore:</b> Vendlëra			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojëra me numra që tregojnë një larmi të përdorimit të tyre.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Zbërthen një numër sipas vendlërave të shifrave dhe e kundërta. - Formon numrin kur shifrat e tij janë zbërthyer sipas vendlërave. - Shkruan numrin kur ai është paraqitur në fjali ose si shumë e dy vendlërave.			
<b>Fjalët kyçe:</b> qindmijëshe; dhjetëmijëshe; mijëshe; qindëshe; dhjetëshe; njëshe; numër pozitiv, numër negativ; numër dhjetor; të dhjetat; të qindtat; presje dhjetore; (>) më e madhe se; (<) më e vogël se; rendi rritës; rendi zbritës			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Vëzhgo-emërto, sill shembuj, diskuto dhe nxirr përfundime, krijim i lirë (punë në dyshe, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake: Rikujtim i njohurive të mëparshme</b> Mësuesi/ja paraqet situatën: Dy shokë kanë formuar një numër pesëshifrorë duke përdorur letrat e shifrave nga 0-9 .Njëri zgjodhi 5 letra kurse i dyti zgjodhi 6 letra. Cili prej tyre ka vepruar drejtë? Pse? Përgjigjja arsyetohet duke u mbështetur në njohuritë e mëparshme. Më pas nxënësit diskutojnë përgjigjet. Ndaje numrin në dhjetëmijëshe, qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe. Lexohet nga nxënësit veprimtaria e kryer.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë (Kërkim-hulumtim)</b> Nxënësit hapin librat duke lexuar e plotësuar të pavarur ushtrimin 1 dhe 2. P.sh. ndaje numrin sipas vendlërës. Përsërite këtë veprimtari me një numër më 6 shifra. Nxënësit plotësojnë ushtrimet në libër duke shkruar me fjalë numrat e dhënë. Lexohen numrat nga nxënës të ndryshëm. Krahasohen punët me shokun pranë tyre. Shkruhen disa numra në tabelë nga nxënës të ndryshëm.			
<b>Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (Veprimtari me gjithë klasën)</b> Nxënësit në dyshe punojnë situatën e dhënë në libër. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të formojnë numrin 5-shifrorë; p.sh.: 5 DjM, 6 M, 0 Q, 3 Dh, 2 Nj = 56032			

Shkruhet numri i formuar.

Më pas ndërrojmë vendin e dyshit dhe pesës.

Afërsisht sa më i vogël është numri i ri tani?

Shkruaje numrin e ri.

Në përfundim, nxënësit lexojnë të dy llojet e numrave dhe bëjnë krahasimin e tyre.

Përgëzohen nxënësit për punën e kryer.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- zbërthimin e një numri sipas vendvlerave të shifrave dhe e kundërta;
- formimin e numrit kur shifrat e tij janë zbërthyer sipas vendvlerave;
- shkrimin e numrit kur ai është paraqitur në fjali ose si shumë e dy vendvlerave.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Plotësim i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Temat mësimore:</b> Të dhjetat dhe të qindtat			
<b>Situata e të nxënit:</b> Paraqitja e numrave për të treguar vendvlerën e numrit dhjetor.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Paraqet numrat dhjetorë duke treguar vendvlerën e numrit. - Krahason dy ose më shumë numra dhjetorë duke përcaktuar vendndodhjen e numrit dhjetor. - Shkruan dhe lexon numrat dhjetorë nga një numër dhjetor te tjetri. - Shkruan numrin dhjetorë si thyesë dhjetore.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Shifër, numër, vendndodhje, rend, njëshe, dhjetëshe, të dhjetat, të qindtat			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, edukim fizik, arte	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Vëzhgo-emërto, sill shembuj, diskuto dhe nxirr përfundime, krijim i lirë (punë në dyshe, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Punë në dyshe</b> Mësuesi/ja ka vendosur disa thyesa dhjetore në tabelë. p.sh.: 5/10, 6/10, 8/10, 2/10, 1/10 etj. Kërkon nga nxënësit të emërtojnë thyesat dhjetore. Më pas t'i kthejnë në numra dhjetorë ose në numra me presje. p.sh.: 5/10 = 0,5    15/10 = 1,5    426/10 = 42,6    123/100 = 1,23 etj. Jepen shembuj të ndryshëm të kthimit të numrave dhjetorë në thyesa dhjetore. 0,2 = 2/10, 16,9 = 169/10 etj. Më pas nxënësit diskutojnë përgjigjet.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</b> Ndahet klasa në dyshe. Mësuesi/ja ka vendosur në dyshet e ndara një tabelë ku nxënësit të krijojnë numra dhjetorë. Zbulojmë me 3 letra p.sh. 6, 8, 9. Vendos shifrat në tabelë për të formuar një numër. Sa numra të ndryshëm mund të formosh? Shkruaji numrat e formuar. Lexojnë numrat e formuar. Secila tregon numrat dhjetorë. Po kështu emërtojnë dhe numra të tjerë. Nxënësit punojnë të pavarur. Krahasojnë përgjigjet me shokun pranë tyre dhe zhvillohen në tabelë nga nxënës të ndryshëm.			
<b>Faza e tretë: Demonstrimi i rezultateve të arritura</b> Mësuesi/ja pasi bën një përmbledhje se ku përdoren numrat dhjetorë, nxënësve u kërkohet të punojnë në dyshe ushtrimet në fletoren e punës.			

Lexohen plotësimet e kryera.

Në grup, nxënësve u kërkohet që të shkruajnë 6 mosbarazime me numra dhjetorë.

Mësuesi/ja kontrollon punën e grupeve dhe fton në përfundim secilin grup të krahasojë zgjidhjet e gjetura. Nxënësit përgëzohen për punën e kryer.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- paraqitjen e numrave dhjetorë duke treguar vendvlerën e numrit;
- krahasimin e dy ose më shumë numrave dhjetorë, duke përcaktuar vendndodhjen e numrit dhjetor;
- shkrimin dhe leximin e numrave dhjetorë nga një numër dhjetor te tjetri;
- shkrimin e numrave dhjetorë si thyesë dhjetore dhe anasjelltas.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësim i fletores së punës. Ushtrimi 2 në fletore.



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë <b>Klasa:</b> 5	<b>Data:</b>					
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Numri						
<b>Ora 2</b> <b>Temat mësimore:</b> Të dhjetat dhe të qindtat								
<b>Situata e të nxënit:</b> Eksplorojmë numra dhjetorë nëpërmjet letrave me numra 0-9.								
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krahason numrat dhjetorë. Shkruan dhe lexon numrat dhjetorë nga një numër te tjetri. - Shumëzon ose pjesëton numrin me 10,100. - Rendit numrat dhjetorë sipas rendit rritës dhe zbritës. - Krijon situata të thjeshta problemore.								
<b>Fjalët kyçe:</b> qindmijëshe; dhjetëmijëshe; mijëshe; qindëshe; dhjetëshe; njëshe; numër pozitiv, numër negativ; numër dhjetor; të dhjetat; të qindtat; presje dhjetore; (>) më e madhe se; (<) më e vogël se; rendi rritës; rendi zbritës.								
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik						
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Stuhi mendimesh, kërkim hulumtim, përmbledhje pohim mbështetje (diskutim i ideve, të nxënit në bashkëpunim, ndërtimi i shprehive)								
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>								
<b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Stuhi mendimesh</b> Mësuesi/ja parashtron situatën sipas tabelës së vendvlerave.								
100000	10000	1000	100	10	1	,	Të dhjetat	Të qindtat
						,		
Zgjidh 4 letra me shifra. Krijë një numër 4-shifror. Vendose numrin në tabelë. Shumëzoje numrin me 10. Pasi dëgjohet situata nxënësit punojnë. Shkruaje numrin e formuar. Lexohen numrat nga nxënësit. Vazhdohet veprimtaria duke krijuar numra të tjerë.								
<b>Faza e dytë. Veprimet në situatë. Kërkim-hulumtim</b> Mësuesi/ja tregon se si numrat dhjetorë ndryshojnë kur shumëzojmë ose pjesëtojmë. P.sh. 45,12 x 10 = 451,2 ose 45,12 :10 = 4,512. Nxënësit kalojnë në plotësimin e situatave të dhëna në libër. Ata do të kryejnë këto veprimtari: Krijë një numër tjetër 4-shifror, duke përdorur të njëjtat letra. Vendose numrin në tabelë. Pjesëtoje me 10. Shkruaje numrin e ri të formuar.								

Po kështu veprohet dhe me raste e tjera. Këto veprimtari nxënësit i kryejnë në mënyrë të pavarur. Më pas lexohen numrat me zë të lartë.

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

**Përmbledhje pohim mbështetje**

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të punojnë situatat e dhëna në libër.

Plotësoni duke vepruar si Laerti. Ai e shumëzoi numrin e tij me 10 dhe rezultati i tij doli 134.

Gjeni numrin fillestar. Diskutohet ushtrimi nga nxënës të ndryshëm. Po kështu vazhdoet dhe me situatat e tjera.

Në përfundim nxënësit do të lexojnë rezultatet e kryera.

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të hapin fletoret e punës dhe të bëjnë plotësimin e saj.

Ndiqen gjatë punës. Lexohen situatat e zgjidhura. Në fund përgëzohen për punën e tyre.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- krahasimin e numrave dhjetorë;
- shkrimin dhe leximin e numrave dhjetorë nga një numër te tjetri;
- shumëzimin ose pjesëtimin me numrat 10, 100;
- renditjen e numrave dhjetorë sipas rendit rritës dhe zbritës;
- krijimin e situatave të thjeshta problemore.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit punojnë dy situata problemore me shumëzim dhe pjesëtim.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Numri	
<b>Ora 1</b> <b>Temat mësimore:</b> Rrumbullakimi			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë në gjetjen e dhjetëshes më të afërt dhe të qindështes më të afërt.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Rrumbullakon numra natyrorë me afërsi 10, 100. - Rrumbullakon numra natyrorë me afërsi 10, 100 nëpërmjet boshtit. - Shkruan rrumbullakimin e numrave me afërsi 10 dhe afërsi 100. - Argumenton rrumbullakimin me afërsi 10, 100 të numrave.			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër natyror, rrumbullakim, dhjetështes më të afërt, qindështes më të afërt, bosht numerik.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, tabela me bosht, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Stuhi mendimesh, rrugëzgjdhje për të lexuarit në matematikë, të nxënit në bashkëpunim, diskutim i ideve, punë me gjithë klasën, punë në grupe, punë individuale.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Stuhi mendimesh</b> Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve numra të ndryshëm dhe kërkon se ku mund ta kenë vendin këta numra në boshtin numerik p.sh.: 450, 125, 20, 805, 345 etj. Mësuesi/ja vizaton boshtin numerik në tabelë. Nxënësit i vendosin këta numra në boshtin numerik. P.sh. 400 450 <b>500: 800</b> 805 900. Kërkon nga nxënësit disa numra afër: Cilën shifër do të shohim për rrumbullakimin me afërsi 10, po 100? Si mendoni? A mund të ketë rregulla? Çfarë ndryshon? Nxënësve u kërkohet të plotësojnë tabelën në libër duke rikujtuar rrumbullakimin e numrave me afërsi 10, 100.  <b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Rrugëzgjdhje për të lexuarit në matematikë.</b> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat. Në ushtrimin 1 kërkohet nga nxënësit të zgjidhin në dyshe ushtrimin 1. Sa kushton secili prej librave? A i mjaftojnë këto para? Shpjego pse. Nxënësit tregojnë se si vepruan. Në përfundim bëhet leximi i detyrës.			

Në ushtrimin 2 nxënësit do të tregojnë që pse Dea numrin e saj e rrumbullakoi në rezultatin 870. Numri ishte ndërmjet 850 dhe 900. Cili është numri që ka menduar ajo? Shpjego pse.

Këtë ushtrim nxënësit e punojnë në dyshe. Në përfundim nxënësit lexojnë detyrën.

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.**

**Të nxënit në bashkëpunim**

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të punojnë ushtrimin 3. Veprimtaria zhvillohet me grupe. Secili grup studion situatën duke ndjekur hapat. Në fund ngrihen përfaqësues të grupeve dhe tregojnë rezultatin.

Pse zgjodhët këtë numër?

A e ka menduar mirë Ela? Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Nxënësit përgëzohen për punën e kryer.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- rrumbullakimin e numrave natyrorë me afërsi 100;
- rrumbullakimin e numrave natyrorë me afërsi 100 nëpërmjet boshtit;
- dallimin dhe rrumbullakimin e numrave me afërsi 10 dhe afërsi 100;
- argumentimin e rrumbullakimit me afërsi 100 të numrave.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit plotësojnë fletoren e punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Rrumbullakimi			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë në gjetjen e dhjetëshes më të afërt dhe të qindëshes më të afërt.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Rrumbullakon numra natyrorë me afërsi 10,100 dhe numra dhjetorë. - Zbaton rregullat në rrumbullakimin e numrave. - Shkruan rrumbullakimin e numrave duke i renditur nga më i vogli. - Argumenton rrumbullakimin e numrave në numrin e plotë më të afërt.			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër natyror, rrumbullakim, dhjetëshe më të afërt, qindëshe më të afërt, bosht numerik.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, tabela me bosht, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Stuhi mendimesh, rrugëzgjdhje për të lexuarit në matematikë, të nxënit në bashkëpunim, diskutim i ideve, punë me gjithë klasën, punë në grupe, punë individuale.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Lojë me letra</b> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të praktikojnë aftësitë e tyre në rrumbullakimin e numrave dhjetorë. Zhvillohet një lojë midis nxënësve duke përdorur letra me shifra nga 0-9. Hapen librat dhe eksplorojmë. Mësuesi/ja u kërkon atyre që t'i marrin letrat me radhë një e nga një. Nxënësve u kërkohet që të gjejnë një numër të shënuar brenda yjeve si në figurën që u paraqitet nga mësuesi/ja, i cili mund të rrumbullakohet në numrin që ata kanë zgjedhur. Shembull: është zgjedhur letra me numrin 8. Yjet përkatës do të ishin: ai me numrin dhjetor 7,8 dhe ai me 8,3. Nxënësi/ja mbulon numrin në yllin që ka gjetur me një numërues. Po kështu vazhdohet dhe me raste të tjera derisa të jenë mbuluar të gjitha yjet. Në fund, mësuesi/ja përzgjedh fitues nxënësin me më shumë yje të mbuluara. Të gjithë nxënësit e tjerë paraqesin punën e tyre dhe përgëzohen.			

**Faza e dytë: Veprimet në situatë**

Nxënësit kalojnë në plotësimin e fletores së punës. Lexojnë në dyshe situatën e dhënë.

Nxënësve u kërkohet të zgjedhin 3 letra nga kompleti.

Shkruaj 6 numra dhjetorë të ndryshëm me dy shifra pas presjes dhjetore, duke përdorur 3 numrat që zgjodhe.

P.sh.: Zgjidhen 7,5 dhe 3. Dy numra të formuar sipas kërkesës janë 7,53 dhe 5,37.

Mësuesi/ja parashtron situatën sipas tabelës e cila kërkohet të plotësohet nga nxënësit.

Shembull :

Numri	I rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt
$\frac{5,37}{7,53}$	$\frac{5}{8}$

Shkruaj 5 numra që formove. Nxënësit shkruajnë numrat me rrumbullakosje. Më pas lexohen numrat e formuar (i renditin nga më i vogli).

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura****Të nxënit në bashkëpunim**

Nxënësit hapin fletoret dhe secili do të shkruajë numrat dhjetorë në boshtin numerik të ndërtuar nga vetë ata. Në fund diskutohen dhe përgëzohen punët e nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- rrumbullakimin e numrave natyrorë me afërsi 10, 100 dhe numra dhjetorë;
- zbatimin e rregullave në rrumbullakimin e numrave;
- shkrimin dhe rrumbullakimin e numrave duke i renditur nga më i vogli;
- argumentimin e rrumbullakimin e numrave në numrin e plotë më të afërt.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Krijojnë me letra 5 numra me dy shifra pas presjes dhjetore dhe i rrumbullakosin në numrin e plotë më të afërt.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Renditja dhe krahasimi			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë me letra në renditjen e krahasimin e numrave			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Rendit numrat sipas një vargu rritës(ose zvogëlues), duke ditur rrugën e kalimit nga një kufizë në tjetrën. - Dallon numrin më të vogël nga ai më i madh. - Formon një varg numerik rritës ose zvogëlues duke dhënë tri apo katër kufizat e para. - Përcakton kriterin rritës ose zvogëlues në një varg dhe e plotëson atë.			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër natyror, rrumbullakim, dhjetëshe më të afërt, qindëshe më të afërt, bosht numerik.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, tabela me bosht, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Stuhi mendimesh, të nxënit në bashkëpunim, diskutim i ideve, punë me gjithë klasën, punë në grupe, punë individuale.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Lojë me letra.</b> <b>Stuhi mendimesh</b> Mësuesi/ja shkruan disa numra në tabelë P.sh.: 990,995,1000 Mësuesi/ja shtron pyetjet: Cili është numri më i vogël? Si është vargu rritës apo zbritës? Cila vendvlerë rritet dhe sa? Nxënësit përgjigjen rreth pyetjeve dhe vlerësohen në fund.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Punë në dyshe</b> Nxënësit kalojnë në plotësimin e librit. Lexojnë në dyshe situatën e dhënë. Mësuesi/ja u kërkon që secili të shkruajë nga dhjetë numra në një fletë. Numrat të jenë lloje të ndryshme numrash me numër të ndryshëm shifrash duke përfshirë numrat pozitivë dhe ata negativë. Pritini numrat dhe vendosini përmbys mbi tryezë. Nxënësit me radhë zgjedhin nga një numër dhe e vendosin të zbuluar mbi tryezë.			

Teksa zbuloni numrat, vendosini në tryezë duke i renditur nga më i madhi te më i vogli. Nxënësit shkruajnë numrat e renditur. Kontrollonjë njëri-tjetrin dhe nxjerrin përfundime.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

#### **Të nxënit në bashkëpunim**

Mësuesi/ja kërkon që detyrat e tjera ti punojnë në çifte. Do të shkruajnë mosbarazime për secilin simbol. Do të krahasojnë numrat dhe më pas të shkruajnë çiftet e numrave të krijuar.

Mësuesi/ja kërkon që detyra të punohet në çifte. Do të shkruajnë mosbarazime për secilin simbol duke krahasuar numrat në situatën e dhënë. Nxënësit paraqesin punën e tyre.

Mësuesi/ja kërkon që detyra të punohet në çifte, ku nxënësit të gjejnë një numër që të plotësojë rregullin e dhënë.

Shkruajnë si numra të zbërthyer dhe numra të rregullt numrat e dhënë.

Në përfundim lexohen plotësimet e kryera.

Nxënësit përgëzohen për punën e kryer.

#### **Vlerësimi**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- renditjen e numrave sipas një vargu rritës (ose zvogëlues);
- dallimin e numrit më të vogël nga ai më i madh;
- formimin e një vargu numerik rritës ose zvogëlues;
- përcaktimin e kriterit rritës ose zvogëlues të një vargu.

##### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Renditja dhe krahasimi			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë me letra dhe lojë me zare në renditjen e krahasimin e numrave			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> Rendit numrat sipas një vargu rritës (ose zvogëlues), duke ditur rrugën e kalimit nga një kufizë në tjetrën. Dallon numrin më të vogël nga ai më i madh. Formon një varg numerik rritës ose zvogëlues duke dhënë tri apo katër kufizat e para. Përcakton kriterin rritës ose zvogëlues në një varg dhe e plotëson atë.			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër natyror, rrumbullakim, dhjetëshe më të afërt, qindëshe më të afërt, bosht numerik.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, tabela me bosht, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Stuhi mendimesh, punë në dyshe, mendo-krijo në dyshe-diskuto, vëzhgim-demonstrim.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake</b> <b>Stuhi mendimesh</b> Mësuesi/ja parashton situatën e ushtrimit në tekst (Janë paraqitur 5 termometra). Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit: Trego me anë të ngjyrosjes temperaturat e mëposhtëm në secilin prej termometrave. Nxënësit tregojnë temperaturat e secilit termometër. P.sh. termometri një ngjyroset deri në temperaturën 30 gradë. Lexojnë nxënës të ndryshëm duke bërë krahasimin e temperaturave midis tyre.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë</b> <b>Vëzhgim-demonstrim</b> Zgjidhen dy nxënës të shkruajnë disa fjali numerike para klasës në tabelë. Shkruajnë dhe disa fjali numerike të tjera në tabelë duke përdorur shenjat e krahasimit < , > . Lexohen fjalitë numerike nga nxënësit. Nxënësit shkruajnë në fletore ushtrimin e tekstit individualisht.			

Renditni temperaturat nga më i vogli te më i madhi.  
 Krahato temperaturat duke përdorur shenjat e krahasimit  $<$ ,  $>$ ,  $=$ .  
 Lihen nxënësit të punojnë në kryerjen e ushtrimit sipas kërkesave të dhëna.  
 Pas punës, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit një diskutim të ushtrimeve.  
 Më pas nxënësit hapin fletoren e punës te tema “Renditja dhe krahasimi”.  
 Bëhet plotësimi i fletores së punës dhe diskutimi i saj.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

#### **Mendo, krijo dyshe, diskuto.**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në dyshe.  
 Një nxënës nga dyshja i jep shokut të gjejë pohime të tjera bazuar në fjalitë numerike.  
 P.sh.: Temperatura  $30^{\circ}$  është  $6^{\circ}$  më e lartë se  $24^{\circ}$ .  
 Nxënësi e kontrollon shokun dhe i kërkon shpjegime për mënyrën se si e gjeti.  
 Përsëritet veprimtaria duke këmbyer rolet.  
 Më pas zhvillohet një diskutim me gjithë klasën për shkrimin e fjalive numerike.  
 Në fund përgëzohen nxënësit.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- renditjen e numrave sipas një vargu rritës (ose zvogëlues);
- dallimin e numrit më të vogël nga ai më i madh;
- formimin e një vargu numerik rritës ose zvogëlues;
- përcaktimin e kriterit rritës ose zvogëlues të një vargu.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit shënojnë në fletore temperaturat ditore të mëngjesit, drekës dhe darkës në një termometër të vizatuar.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Vargjet e numrave			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë me letra në formimin e vargjeve numerike.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Formon vargje numerike sipas një rregulli të caktuar. - Shkruan vargje numerike duke ndjekur rregullin. - Përcakton sipas rregullit cilësitë e një vargu. - Shpjegon zbulimin e përfundimeve që dalin.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Vargje numerike, rend rritës, shifër, rregulla, lloji Fibonaçi, shuma e dy numrave.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, vargje numerike, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik, shoqëria dhe mjedisi	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Diskutim për njohuritë paraprake, marrëdhënie pyetje-përgjigje, punë në grup, punë në dyshe, punë me gjithë klasën.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake</b> Lojë Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të kryejmë një lojë me kërcime. Në tabelë janë shkruar dy vargje numerike. P.sh. 2, 5, 6, 9, 10 / 2, 4, 5, 10, 11/ A mund të kërcejmë sipas vargut? Nxënësit kryejnë veprimtarinë me grupe duke parë se si vepruan. Zbulojmë rregullën. Si kërceu grupi i parë? Shkruajmë rregullën grupi 1, vargu: +3, +1. Grupi i dytë, vargu: dyfishi i dyshit, +1. Vazhdon veprimtaria dhe me disa grupe të tjera duke shkruar nxënësit rregullat e renditjes.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë</b> <b>Marrëdhënie pyetje-përgjigje</b> Mësuesi/ja iu drejtohet nxënësve. Çfarë duhet të kemi parasysh në krijimin e vargjeve. Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Hapen librat dhe kalojnë në plotësimin e ushtrimeve në dyshe. Nxënësit në dyshe ndjekin hapat e kryerjes së gjetjes së vargjeve numerike me anë të letrave. P.sh. - Zgjidh tri letra. - Vendosi ato në rendin rritës.			

- Përdori ato për të filluar dy vargje të ndryshme deri në dhjetë numra.
- Mos harro të shkruash rregullën.

Shembull: vargu 1: 3, 6, 7, 10, 11, 14, 15, 18, 19, 22.

Diskutojnë në fund rezultatet e gjetura. Nxënësit argumentojnë formimin e vargjeve.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

#### **Rishikim në dyshe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në dyshe. Hapet fletorja e punës.

Nxënësit zbulojnë në dyshe se si formohen vargjet numerike. Zgjedhin një numër p.sh. 5.

Cakto rregullat e vargut, shkruajë vargun dhe cilësitë që vihen re.

Nxënësit punojnë në krijimin e 5 vargjeve numerike në fletore. Shkruajnë rregullat e vargjeve, vargun e formuar dhe cilësitë që vihen re.

Disa dyshe lexojnë punën e kryer. Nxënësit përgëzohen për punën.

#### **Vlerësimi**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- formimin e vargjeve numerike sipas një rregulli të caktuar;
- shkrimin e vargjeve numerike duke ndjekur rregullin;
- përcaktimin sipas rregullit të cilësive të një vargu;
- shpjegimin dhe zbulimin e përfundimeve që dalin.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit shënojnë në fletore 4 vargje numerike duke caktuar rregullat e vargut shkrimin e tij dhe cilësitë që vihen re.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Vargjet e numrave			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë. Krijojmë vargje sipas rregullës së Fibonaçit.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Formon vargje numerike sipas një rregulli të caktuar. - Shkruan vargje numerike duke ndjekur rregullin. - Përcakton sipas rregullit cilësitë e një vargu. - Shpjegon zbulimin e përfundimeve që dalin.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Vargje numerike, rend rritës, shifër, rregulla, lloji Fibonaçi, shuma e dy numrave.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, vargje numerike, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik, shoqëria dhe mjedisi	
<b>Metodologjia e veprimtarisë e të nxënësve:</b> Diskutim për njohuritë paraprake, vëzhgim-demonstrim, eksplorim, punë në grup, punë në dyshe, punë me gjithë klasën.			
<b>Veprimtarisë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake</b> Diskutim për njohuritë paraprake. Në është shkruar një varg numrash. U kërkohet nxënësve të mendojnë rreth vargut. Drejtojmë pyetjen: Cili është rregulli i vargut? Si e gjete? Cilat janë cilësitë e tij? P.sh. vargu: 1, 1, 2, 3, 5, 8, 13,21. ( $3=2+1$ $5=2+3$ ) Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Tregojnë rregullin e formuar. Pra themi që ky varg është vargu i llojit Fibonaçi: Secili prej numrave është shuma e dy numrave paraardhës. Vazhdon veprimtaria dhe me dy vargje të tjerë.			
<b>Faza e dytë. Veprimet në situatë</b> <b>Vëzhgim-demonstrim</b> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të kalojnë në plotësimin e ushtrimit 1. Kjo veprimtari kryhet në dyshe. Nxënësit sipas rregullit të vargut Fibonaçi kryejnë plotësimin edhe me dhjetë numra të tjerë. Shembull: 3, 5, 8, 13 etj.			

Në ushtrimin 2 vazhdojnë në dyshe në plotësimin e vargjeve të Fibonaçit derisa të kalosh në 100. P.sh. 4, 7, 11, 18, 29, 47 etj. Lexohen vargjet nga disa dyshe.

Në ushtrimin 3 secili nga nxënësit krijon dy vargje Fibonaçi. Shkruajnë vargjet në fletore.

Më pas vargjet e formuara ia tregojnë shokut të bankës duke kërkuar nga ai që të zbulojë vargun e formuar. Lexohen vargjet e shokut duke ndërruar fletoret.

Diskutojnë në fund rezultatet e gjetura.

Nxënësit argumentojnë formimin e vargjeve

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

#### **Rishikim në dyshe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në dyshe.

Nxënësit zbulojnë në dyshe se si formohen vargjet numerike.

Shembull: Unë sfidoj shokun duke krijuar një varg Fibonaçi. Vargu përmban numrin 89.

Vargu fillon me numrin 2. Gjej vargun. Shkruaj 12 numrat e parë të këtij vargu.

Nxënësit punojnë në krijimin e 5 vargjeve numerike në fletore. Shkruajnë rregullin e vargut të formuar dhe cilësitë që vihen re.

Në fund bëjnë leximin e detyrës së kryer. Nxënësit përgëzohen për punën.

#### **Vlerësimi**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- formimin e vargjeve numerike sipas një vargu të llojit Fibonaçi;
- shkrimin e vargjeve numerike duke ndjekur rregullin;
- përcaktimin sipas rregullit të cilësive të një vargu;
- shpjegimin dhe zbulimin e përfundimeve që dalin.

##### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit punojnë fletoren e punës.

<b>Fusha: Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Numrat tek dhe çift			
<b>Situata e të nxënit:</b> Përdorim kube për të gjetur numrat tek dhe çift.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Dallon dhe emërton numrat tek dhe çift. - Shpjegon kuptimin e numrave tek dhe çift. - Kryen veprime me numrat tek dhe çift. - Shpjegon përfundimet e arritura.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Vargje numerike, rend rritës, shifër, rregulla, numër tek, numër çift, shuma e dy numrave.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, vargje numerike, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik, shoqëria dhe mjedisi	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Diskutim i njohurive paraprake, imagjinatë e drejtuar, vëzhgim-demonstrim, punë në grup, punë në dyshe, punë me gjithë klasën.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake</b> Lojë me kube. Provojmë të hedhim kubet për të krijuar numra tek p.sh. 1, 3, 5, 7, 9. Mund të krijojmë mbledhje të numrave tek. Ç’ndodh kur mbledhen dy numra tek? Bëjnë shpjegimin e mbledhjes së numrave tek: tek + tek = çift 7 + 7 = 14 Krijomë dy numra çift dhe i mbledhim ato. Zbulojmë rregullin: çift + çift = çift Po të provojmë të mbledhim 3 numra tek: 3 + 3 + 3 = 9; Po katër numra tek; 1+ 3 + 5 + 7 = 16 Nxënësit kryejnë veprimtari me kube duke bërë mbledhje dhe zbritje të numrave tek dhe çift.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë</b> <b>Të punuarit në bashkëpunim</b> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të kalojnë në plotësimin e ushtrimit 1 dhe 2. Kjo veprimtari kryhet me dyshe. Në secilin ushtrim kryhen këto veprimtari. 1. Në ushtrimin 1 përdor kubet për të gjetur: Ç’ndodh kur mbledhen dy numra tek? Shkruajnë një shembull: 5 + 3. Më pas shkruajnë dhe gjashtë shembuj të tjerë. Tek + tek = çift. Bëjnë shpjegimet që pse ndodh kështu.			

2. Në ushtrimin 2 vazhdo të përdorësh kubet duke mbledhur tre numra tek.

$3 + 5 + 1 = 9$ : tek + tek + tek = tek.

Bëjnë shpjegimet që pse ndodh kështu.

Më pas shkruajnë dhe gjashtë shembuj të tjerë.

Në përfundim nxënësit kryejnë leximin e detyrave.

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.**

**Rishikim në dyshe**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në dyshe.

Nxënësit zbulojnë në dyshe se si duke zbritur dy numra tek ç'ndodh.

Më pas zbresin tre numra tek, më pas katër numra tek.

Shembull:  $7 - 3 - 1 = 3$ ;  $9 - 5 - 3 = 1$ . Shpjegojnë rezultatet e arritura.

Më pas disa ushtrime demonstrohen në tabelë.

Nxënësit përgëzohen për punën.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- dallimin dhe emërtimin e numrave tek dhe çift;
- shpjegimin e kuptimit të numrave tek dhe çift;
- kryerjen e veprimeve me numrat tek;
- shpjegimin e përfundimeve të arritura.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Nxënësit plotësojnë fletoren e punës.



<b>Fusha: Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Numrat tek dhe çift			
<b>Situata e të nxënit:</b> Përdorim kube për të gjetur numrat tek dhe çift			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krijon vargje numerike me numrat tek dhe çift. - Kryen shumëzime të numrave njëshifrorë me numra tek dhe çift. - Kryen shumëzime me numrat tek dhe çift. - Shpjegon rregullat e formimit të vargjeve.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Vargje numerike, mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim, shifër, rregulla, numër tek, numër çift, shuma e dy numrave.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, vargje numerike, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik, shoqëria dhe mjedisi	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Diskutim i njohurive paraprake, Vëzhgim-demonstrim, punë në grup, punë në dyshe, punë me gjithë klasën.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake</b> Diskutim i njohurive paraprake. Eksplorojmë duke hapur fletoren e punës. Mësuesi/ja pyet nxënësit: Çfarë vini re në tabelë? Lexohet shembulli i dhënë. Nxënësit mund të punojnë të pavarur në plotësimin e tabelës. Shkruajnë në fillim rregullin e vargut. Mësuesi/ja: Me çfarë shifre na mbarojnë numrat tek ose më pas çift. Nxënësit japin mendime të ndryshme në rregullat e formimit të vargjeve.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë</b> <b>Rrugëzgjdhje për të lexuarit në matematikë</b> Më pas kalojnë në lojë në dyshe në formimin e vargjeve numerike. Njëri nxënës formon 4 vargje numerike, kurse tjetri formulon rregullën. Hapet teksti dhe nxënësit në grupe dyshe kalojnë në plotësimin e ushtrimeve. Në secilin ushtrim kryhet kjo veprimtari. Ushtrimi 1: Përdor kubet për të gjetur: Çfarë ndodh, kur shumëzohen numrat njëshifrorë me 4? A mendon që rezultatet do të jenë numra tek apo çift, apo herë tek dhe herë çift? Shkruajnë mendimet e tyre dhe verifikojnë mendimet e tyre.			

Ushtrimi 2: Nxënësit kryejnë shumëzimet duke verifikuar mendimet e tyre me anë të kubeve.

Shkruajnë disa shembuj në fletoren e tyre.

Në përfundim, nxënësit kryejnë leximin e detyrave.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritur**

#### **Rishikim në dyshe**

Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë ushtrimin 3 duke shpjeguar rreth shumëzimit me numra çift dhe rreth shumëzimit me numra tek.

Shembull: shumëzimi me numra çift. Kur numrat njëshifrorë shumëzohen me numra çift, përfundimi del numër çift, kurse me numra tek, del numër tek.

Lexohen nga nxënësit të gjitha përgjigjet e dhëna. Nxënësit përgëzohen për punën e bërë.

#### **Vlerësimi**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- krijimin e vargjeve numerike me numrat tek dhe çift.
- kryerjen e shumëzimeve të numrave njëshifrorë me numra tek dhe çift.
- kryerjen e shumëzimeve me numrat tek dhe çift.
- shpjegimin e rregullave të formimit të vargjeve.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Numri dhe vendvlera (Përmbledhim)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë me complete letrash rreth numrave			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Shkruan me shifra numrat e dhënë me fjalë dhe anasjelltas. - Formon numra 5 dhe 6 shifrorë me shifrat e dhëna. - Rrumbullakos në dhjetëshen e qindëshen më të afërt numrat e dhënë. - Krahason numrat duke përdorur simbolet <, >. - Rendit numrat deri në 100000 në rendin rritës dhe zbritës.			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër natyror, rrumbullakim, dhjetëshe më të afërt, qindëshe më të afërt, bosht numerik.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, tabela me bosht, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Rishikim në dyshe, pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake</b> Mësuesi/ja kërkon që një nxënës të shqiptojë një numër 5 ose 6 shifror dhe një nxënës tjetër ta shkruajë atë me shifra dhe me fjalë. P.sh.: 54762 —————> pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy Numrat e shkruar më pas lexohen dhe përsëritet situata me dyshe me nxënësish të ndryshëm.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Lojë me letra</b> <b>Të punuarit në bashkëpunim</b> Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të punojnë në dyshe duke përdorur dy complete letrash me shifra. - Përzieni letrat dhe vendosini ato përmbys mbi tryezë përpara vetes. Secili prej nxënësve zgjedh një letër dhe e kthen atë për të parë shifrën e shkruar. Nxënësit hapin librat dhe në tekst u paraqitet një tabelë me 7 kolona, sipas shifrave, dhe 8 rreshta. - Mendo një vend për të vendosur shifrën e zgjedhur në rreshtin e parë të tabelës. Nxënësit vazhdojnë të plotësojnë rreshtin e parë në mënyrë që të formohet një numër me gjashtë shifra. Më pas ata shkruajnë numrin e formuar në kolonën e fundit.			

- Ndërro vendet e shifrave për të formuar numrin më të madh të mundshëm.  
 Nxënësit diskutojnë më njëri-tjetrit dhe bëjnë krahasime.  
 Sa herë që numri i njërit prej tyre është më i madh se i tjetrit, ai fiton një pikë.  
 Fitues është nxënësi/ja që grumbullon më shumë pikë.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

#### **Rishikim në dyshe**

Mësuesi/ja kërkon që në dyshe nxënësit të kryejnë rrumbullakimet e numrave të formuar.  
 Shkruajnë rrumbullakimet në fletore. Pas rrumbullakimit bëhet leximi i detyrave nga secili nxënës.

Nxënësit përgëzohen për punën e bërë.

#### **Vlerësimi:**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- shkrimin me shifra të numrave të dhënë me fjalë dhe anasjelltas;
- formimin e numrave 5 dhe 6-shifrorë;
- rrumbullakimin në dhjetëshen e qindëshen më të afërt;
- krahasimin e numrave duke përdorur simbolet  $<$ ,  $>$ ;
- renditjen e numrave deri në 100000 në rendin rritës dhe zbritës.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Numri dhe vendvlera (Përforcojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë me komplete letrash rreth numrave			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Shkruan me shifra numrat e dhënë me fjalë dhe anasjelltas. - Formon numra 5 dhe 6 shifrorë me shifrat e dhëna. - Rrumbullakos në dhjetëshen e qindëshen më të afërt numrat e dhënë. - Krahason numrat duke përdorur simbolet <, >. - Rendit numrat deri në 100000 në rendin rritës dhe zbritës.			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër natyror, rrumbullakim, dhjetëshe më të afërt, qindëshe më të afërt, bosht numerik.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, tabela me bosht, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Rishikim në dyshe, pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Faza e parë: Veprimtari paraprake</b> Mësuesi/ja kërkon që një nxënës të shqiptojë një numër 5 ose 6 shifror dhe një nxënës tjetër ta shkruajë atë me shifra dhe me fjalë. P.sh.: 654321 —————> gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e një. Numrat e shkruar më pas lexohen dhe përsëritet situata me dyshe nxënësish të ndryshëm.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Lojë me letra</b>			
<b>Të punuarit në bashkëpunim</b> Mësuesi/ja e ndan klasën në disa grupe nxënësish. Nxënësve u kërkohet të mendojnë në grup një numër katërshifrorë. Më pas ata e shkruajnë numrin e menduar në një vend që të mos duket. Veprohet në të njëjtën mënyrë nga grupet e tjera. Diskutohet mes nxënësve ku: njëri grup i drejton pyetje grupit tjetër për të gjetur numrin e tyre. Përgjigjet mund të jenë vetëm “po” ose “jo”. - Përpiquni të bëni pyetje për të gjetur numrin sa më shpejt të jetë e mundur. Pyetjet më të përshtatshme mund të jenë: - A është shumëfish i 10? - A është numër tek?			

- A rumbullakoset numri në qindëshen që vjen pas?
- A është më i madh se 3200?

Secili prej grupeve mund të bëjë deri në 20 pyetje.

Nxënësve më pas u kërkohet që të shkruajnë numrat që menduan të gjithë shokët e grupit të tyre.

Nxënësit diskutojnë përgjigjet e tyre dhe në fund mësuesi/ja përzgjedh fitues grupin që ka gjetur numrin saktësisht.

Nxënësit përgëzohen në fund për punën.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

#### **Punë në grup**

Mësuesi/ja kërkon që në çift nxënësit të kryejnë rumbullakimet e numrave. Pas rumbullakimit bëhet leximi i detyrave nga secili nxënës.

Më pas nxënësit rendisin numrat nga më i vogli te më i madhi.

Bëjnë krahasime me ata numra, duke përdorur simbolet  $<$ ,  $>$ .

Diskutohet për atë që plotësuan nxënësit.

Në fund, nxënësit përgëzohen për punën e bërë.

#### **Vlerësimi**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- shkrimin me shifra të numrave të dhënë me fjalë dhe anasjelltas;
- formimin e numrave 5 dhe 6-shifrorë;
- rumbullakimin në dhjetëshen e qindëshen më të afërt;
- krahasimin e numrave duke përdorur simbolet  $<$ ,  $>$ ;
- renditjen e numrave deri në 100000 në rendin rritës dhe zbritës.

##### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

**TESTIM PËR NJOHURITË E MARRA NË KAPITULLI E PARË****Lënda: Matematikë****Periudha 1****Tema: Njohuritë e marra në kapitullin e parë (Numri dhe vendvlera)****Emër mbiemër:** \_\_\_\_\_**1. Plotëso me shifra ose me fjalë.****(4 pikë)**

420 800 \_\_\_\_\_

893 580 \_\_\_\_\_

Shtatëqind e dyzet mijë e treqind \_\_\_\_\_

Pesëqind e tetëdhjetë mijë e një \_\_\_\_\_

**2. Numri më i madh me shifrat 8, 1, 9, 2, 5, 6 (pa i përsëritur shifrat) është:** **(1 pikë)****a)** 126589**b)** 891265**c)** 891256**d)** 986521**3. Trego vlerën e shifrës së nënvizuar.****(2 pikë)**48512 \_\_\_\_\_451 414 \_\_\_\_\_**4. Rrumbullakos numrat me afërsi 10, 100, 1000.****(9 pikë)** $\approx 10$  $\approx 100$  $\approx 1000$ 

26546-

36283-

64627-

**5. Qarko me të kuqe numrat tek dhe me blu numrat çift.****(2 pikë)**

185 663

45375

589 607

785 912

769 432

**6. Renditi këta numra nga më i vogli te më i madhi dhe anasjelltas.****(4 pikë)**

\_\_\_\_\_

**7. Zbulo rregullën. Plotëso vargun.****(4 pikë)**

194200, 194400, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ Ky varg është: \_\_\_\_\_

90 000, 70 000, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ Ky varg është: \_\_\_\_\_

**8. Plotëso mosbarazimet.****(3 pikë)**

6 785 &lt; \_\_\_\_\_ 544 792 &lt; \_\_\_\_\_ 765 845 &gt; \_\_\_\_\_

**9. Cili nga numrat rrumbullakoset në 7,4 deri në një shifër dhjetore?****(1 pikë)****a)** 7,24**b)** 7,45**c)** 7,35**d)** 7,29**e)** asnjëra**10. Problemë****(4 pikë)**

Në një fabrikë këpucësh u prodhuan 146 730 palë këpucë për gra, burra dhe fëmijë. 79 543 ishin këpucë grash. Këpucë grash u prodhuan 18 545 më shumë se këpucë burrash. Pjesa tjetër e prodhimit ishte këpucë për fëmijë. Ç'mund të gjesh?

Pikët	0-9	10-14	15-18	19-22	23-26	27-30	31-34
Nota	4	5	6	7	8	9	10

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjesëtimi</b> <b>Tema mësimore:</b> Diskutojmë së bashku			
<b>Situata e të nxënët:</b> Vendosje figurash të ndara në pjesë të ngjyrosura dhe të pangjyrosura ku përcaktohet kuptimi i thyesës.			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Klasifikon në lloje të ndryshme thyesat. - Përcakton thyesat çerek, gjysmë, treçerek, një e plotë. - Gjen pjesën e një numri, nëpërmjet rolit që kanë gjymtyrët e thyesës. - Argumenton gjetjen e pjesës së një numri.			
<b>Fjalët kyçe:</b> pjesë, një e tërë, thyesë, thyesa të barabarta, numër i përzier, thyesë e parregullt ose më e madhe se 1, numërues, emërues, një gjysmë, një e treta, një e katërta, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, përqindje, raport, përpjesëtim.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Stuhi mendimesh, lojëra, pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën, punë në dyshe			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake.</b> <b>Lidhja e temës me njohuritë paraprake</b> Mësuesi/ja e ndan klasën në 5 grupe me nxënës të ndryshëm. Nxënësve u kërkohet të formojnë 5 pica me plastelinë. Çdo picë të ndahet në mënyrë të barabartë. - Ç’pjesë e picës i takon secilit nxënës në çdo grup? P.sh., 1/4, 1/8, 1/12, 1/16 ... - Ç’është numri 4, 8, 12... në thyesë? - Ç’tregon ai numër në secilin rast? - Ç’pjesë u takon 2 nxënësve, 3 nxënësve, 5 nxënësve, të çdo grupi? P.sh., 2/4 , 3/8 , 5/12 ... - Ç’është numri 3, 5, ... te thyesat? - Ç’tregojnë ata te thyesat? Diskutohet në klasë se si formohet një thyesë.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Të punuarit në bashkëpunim</b> Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të punojnë në dyshe duke marrë dy fleta letre në formatin A5 me ngjyra të ndryshme.			



Vështrojini ato. A kanë të njëjtën madhësi?

Nxënësve u kërkohet të marrin njëren prej fletëve, ta palosin dhe ta presin atë përgjysmë.

Ç'pjesë e fletës së plotë është secila prej pjesëve të fletës së prerë? Si quhen pjesët e përftuara nga kjo ndarje?

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të punojnë me dy fleta të formateve të ndryshme.

Nxënësve u kërkohet të vendosin pjesën më të vogël të letrës në mes të fletës së madhe.

Ç'pjesë e fletës së madhe është copa e letrës në mes të saj?

Ç'pjesë e fletës së madhe është pjesa rrotull copës së vogël të letrës?

Më pas nxënësit presin pjesën e letrës rrotull copës së vogël.

Çfarë pjesësh janë dy copat e marra?

Më pas ndajnë pjesën që prenë në katër rripa me gjatësi të njëjtë.

I vendosin rripat mbi fletën tjetër të vogël.

Ç'vini re?

Diskutohet midis nxënësve dhe bëhet vlerësimi i tyre.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.**

Mësuesi/ja u paraqet nxënësve situatën: Yllka mendon se drejtkëndëshi i paraqitur në figurë nuk është i ndarë në katër pjesë të barabarta. Po ju si mendoni?

Nxënësit marrin një letër në formatin A5.

Ata e ndajnë atë në katër pjesë dhe më pas i presin të katërta pjesët.

- A kanë të katërta pjesët të njëjtën madhësi?
- Mund të vërtetoni që secila prej tyre është një e katërta e drejtkëndëshit?

Nxënësit japin përgjigjet e tyre në lidhje me situatën dhe në fund përgëzohen për punën e tyre.


### **Vlerësimi**


#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- klasifikimin e thyesave në lloje të ndryshme;
- përcaktimin e thyesave çerek, gjysmë, treçerek, një e plotë;
- tregimin e plotësisht të thyesave.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore: Thyesat e barabarta</b>			
<b>Situata e të nxënit:</b> Vendosje figurash të ndara në pjesë të ngjyrosura dhe të pangjyrosura ku përcaktohet kuptimi i thyesës.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Klasifikon në lloje të ndryshme thyesat.</li> <li>- Përcakton thyesat çerek, gjysmë, treçerek, një e plotë.</li> <li>- Tregon plotësin e thyesave.</li> <li>- Tregon thyesa të barabarta në një grup thyesash të dhëna.</li> <li>- Shkruan thyesa të barabarta me një thyesë të dhënë.</li> </ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> pjesë, një e tërë, thyesë, thyesa të barabarta, numër i përzier, thyesë e parregullt ose më e madhe se 1, numërues, emërues, një gjysmë, një e treta, një e katërta			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, tabela me bosht, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune, situata me numra thyesorë		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Rishikim në dyshe, pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Faza e parë: Veprimtari paraprake.</b>			
<b>Stuhi mendimesh</b>			
Mësuesi/ja u paraqet nxënësve figurën e mëposhtme:			
- Ç'pjesë e figurës është e vijëzuar? - Ç'pjesë e figurës është e pavijëzuar? - Çfarë përfaqësojnë të dyja thyesat e mësipërme?			
Diskutohet rreth pyetjeve dhe jepen përgjigje nga nxënës të ndryshëm.			
Mësuesi/ja u paraqet nxënësve figurat e mëposhtme:			
			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në sa pjesë të barabarta është ndarë rrethi në çdo rast?</li> <li>• Ç'pjesë e figurës është vijëzuar për çdo rast?</li> <li>• Çfarë vë re nga figura e mësipërme?</li> </ul>			



**Faza e dytë: Veprimet në situatë.****Të nxënit në bashkëpunim**

Mësuesi/ja e ndan klasën në 4 grupe. Secilit grup i jepet një shirit letre.

Grupi i parë —→ Shirit i pa ndarë , i papalosur.

Grupi i dytë —→ Shiriti paloset përgjysmë. Më pas, ai hapet dhe në secilën pjesë vendoset thyesa si në shembullin e mëposhtëm:

$\frac{1}{2}$	$\frac{1}{2}$
---------------	---------------

Grupi i tretë —→ Paloset shiriti përgjysmë e më pas edhe një herë tjetër përgjysmë. Më pas ai hapet dhe në secilën prej pjesëve vendosen thyesat si në shembullin e mëposhtëm:

$\frac{1}{4}$	$\frac{1}{4}$	$\frac{1}{4}$	$\frac{1}{4}$
---------------	---------------	---------------	---------------

Grupi i katërt —→ Paloset shiriti përgjysmë, pastaj edhe një herë përgjysmë, dhe në fund edhe një herë tjetër përgjysmë. Ai hapet dhe shënohet në secilën pjesë të tij thyesa e duhur.

Nxënësve u kërkohet t'i vendosin shiritat sipas madhësisë së ndarjes, nga më e madhja te me e vogla poshtë shiritit të grupit të parë.

Më pas, ato tregojnë pjesët që formuan në secilin shirit.

Nxënësit vlerësohen për punën e bërë.

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë të pavarur në shkrimin e thyesave të barabarta me  $\frac{1}{2}$ ,  $\frac{2}{4}$ ,  $\frac{3}{6}$ ,  $\frac{4}{8}$ .

Këto thyesa të barabarta nxënësit tregojnë që janë përfutur me shumëzim.

Situatë problemore: Nxënësit punojnë në dyshe për të ndarë një shirit letre. Lea do të dijë se sa të gjashta janë të ngjashme me  $\frac{2}{3}$ . Vizatojnë pjesët e barabarta në figurën e treguar.

Nxënësit shkruajnë thyesa të barabarta që dallojnë në të dyja figurat. Lexohen detyrat e kryera dhe shkruhen në tabelë nga disa nxënës. Përgëzohen nxënësit për punën e kryer.

**Vlerësimi:****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- klasifikimin e thyesave në lloje të ndryshme;
- përcaktimin e thyesave çerek, gjysmë, treçerek, një e plotë;
- tregimin e plotësit të thyesave;
- tregimin e thyesave të barabarta në një grup thyesash të dhëna;
- shkrimin e thyesave të barabarta me një thyesë të dhënë.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Thyesat e barabarta			
<b>Situata e të nxënit:</b> Vendosje figurash të ndara në pjesë të ngjyrosura dhe të pangjyrosura ku përcaktohet kuptimi i thyesës.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Gjen thyesa të barabarta me një thyesë të dhënë duke shumëzuar ose pjesëtuar me të njëjtin numër të dyja gjymtyrët. - Përdor thyesën si operatorë mbi numrat. - Tregon hapat që ndiqen për te gjetur pjesën e një numri.			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër thyesor, numërues, vijë thyese, pjesë e ngjyrosur, numër të përzier, thyesë e parregullt.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë dhe numra thyesorë, shirita letre, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune, situata me numra thyesorë		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Rishikim në dyshe, pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Faza e parë: Veprimtari paraprake.</b> <b>Rikujtim njohurish</b> Paraqitet para klasës një “mur thyesash”. Kërkon nga nxënësit të emërtojnë thyesat e barabarta me Thyesat shkruhen në tabelë. 1 = 1/1; 2/2, 3/3, 4/4 etj. Më pas vendosim në mur një numërues mbi të p.sh. 32 si numërues. Sa është ½ e 32? (16) Sa është ¼ e 32? (8) Kryhen dhe raste të tjera kur kemi këtë numërues. Tregojmë se si vepruam. Shkruhen përgjigjet e tyre në fletore.			
<b>Faza e dytë. Veprimet në situatë.</b> <b>Të punuarit në bashkëpunim.</b> Mësuesi/ja u kërkon nxënësve Të hapin librat dhe të plotësojnë në dyshe ushtrimin 1 duke përdorur shiritat e thyesave. Vendosin si numërues të ndryshëm me qëllim që të gjejnë 2/3 e 24; 5/6 e 24; etj. Shpjegojmë se si do të gjejmë pjesën e një numri. P.sh. 1/3 e 24 = 24 : 3 = 8    8 x 1 = 8; 2/3 e 24 = 24 : 3 = 8    8 x 2 = 16			

Nxënësit vazhdojnë në dyshe në zgjidhjen e ushtrimeve me radhë.

Drejtojmë pyetjen: A mund të gjesh një thyesë të barabartë me të? Po dy apo tri thyesa të barabarta me të? Nxënësit mendohen dhe më pas japin përgjigjet.

p.sh.  $\frac{2}{3}$  e 24  $= \frac{4}{6}$  e 24. Nxënësit punojnë sipas hapave që ndiqen për të gjetur pjesën e një numri. Lexohen nga nxënësit zgjidhjet e tyre.

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.**

**Rishikim në dyshe**

Mësuesi/ja kërkon të hapet fletorja e punës dhe të punojnë ushtrimet secili në mënyrë individuale, më pas të shkëmbejnë fletoret me shokun e bankës dhe të korrigjojnë zgjidhjet e njëri-tjetrit.

Diskutohen zgjidhjet me klasën.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- gjetjen e thyesa të barabarta me një thyesë të dhënë duke shumëzuar ose pjesëtuar me të njëjtin numër të dyja gjymtyrët;
- përdorimin e thyesës si operatorë mbi numrat;
- tregimin e hapave që ndiqen për të gjetur pjesën e një numri.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Ushtrimi 2 në fletoren e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë Klasa: 5	Data:
Koha e zgjatjes: 45 minuta		Tematika: Numri	
Ora 1			
Tema mësimore: Thyesat e parregullta			
Situata e të nxënit: Vendosje figurash të ndara në pjesë të ngjyrosura dhe të pangjyrosura ku përcaktohet kuptimi i thyesës.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore: - Kthen një thyesë më të madhe se një në numër të përzier. - Gjen thyesa të barabarta me pjesën thyesore të numrave të përzier. - Kthen një numër të përzier në një numër thyesor. - Tregon hapat që ndiqen për të gjetur pjesën e një numri.			
Fjalët kyçe: numër thyesor, numërues, vijë thyese, pjesë e ngjyrosur, numër të përzier, thyesë e parregullt.			
Burimet, mjetet: libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë dhe numra thyesorë, shirita letre, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune, situata me numra thyesorë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve: Mendo, puno dyshe, diskuto, pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Faza e parë: Veprimtari paraprake Mësuesi/ja paraqet përpara klasës 5 gjysma mollësh. Sa mollë të plota formojmë me këto gjysma? Mësuesi/ja shpjegon që formohen dy mollë dhe mbeti një gjysmë $\frac{1}{2}$ . Pra, u formuan $2\frac{1}{2}$ që është një numër i përzierë. Ky numër themi që është më i madh se dy dhe më i vogël se tre. Paraqitet ky numër në boshtin numerik.			
<div><div></div><div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div></div></div>			

**Faza e dytë: Veprimet në situatë. Të punuarit në bashkëpunim**

Nxënësit kalojnë në plotësimin e ushtrimit 1 dhe 2 në mënyrë të pavarur, ku do të kryhen këto veprimtari: Lidh me vijë çdo thyesë të parregullt me numrin e përzier të barabartë me të.

P.sh.  $7/2 = 3 \frac{1}{2}$  ;  $7/4 = 1 \frac{3}{4}$  etj. Nxënësit kryejnë situatën duke bërë lidhjen me shigjetë.

Në ushtrimin 2 nga numrat e paraqitura në ushtrim zgjedhim vetëm numrat e përzier me pjesë të plotë 3 dhe 4.

Shënohen në boshtin numerik.

P.sh.  $3 \frac{1}{4}$  ;  $3 \frac{5}{8}$  ;  $3 \frac{3}{4}$  etj. ....

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.

Në përfundim të detyrës diskutojnë rreth zgjidhjes duke dhënë sugjerimet përkatëse.

Lexohen plotësimet e kryera.

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë për paraqitjen në bosht numerik të disa numrave të përzier.

Këtë veprimtari nxënësit e kryejnë në dyshe.

Në përfundim paraqiten punët e kryera.

Lexohen disa ushtrime nga nxënësit dhe ata përgëzohen për plotësimet e kryera.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- kthimin e një thyesë më të madhe se një në numër të përzier;
- gjetjen e thyesave të barabarta me pjesën thyesore të numrave të përzier;
- kthimin e një numri të përzier në një numër thyesor;
- tregimin e hapave që ndiqen për të gjetur pjesën e një numri.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

v

<b>Fusha: Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Thyesat e parregullta			
<b>Situata e të nxënit:</b> Vendosje figurash të ndara në pjesë të ngjyrosura dhe të pangjyrosura ku përcaktohet kuptimi i thyesës.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Kthen një thyesë më të madhe se një në numër të përzier.</li><li>- Gjen thyesa të barabarta me pjesën thyesore të numrave të përzier.</li><li>- Kthen një numër të përzier në një numër thyesor.</li><li>- Tregon hapat që ndiqen për të gjetur pjesën e një numri.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër thyesor, numërues, vijë thyese, pjesë e ngjyrosur, numër të përzier, thyesë e parregullt.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë dhe numra thyesorë, shirita letre, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune, situata me numra thyesorë		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Mendo, puno dyshe, diskuto, pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake.</b> <b>Rikujtim i njohurive paraprake</b> Mësuesi/ja: Jepet situata problemore. Kemi ndarë dy pica në tetë pjesë të barabarta. Janë ngrënë 14 pjesë. Si mund ta shprehim me thyesë dhe me numër të përzier pjesën e picave të ngrëna dhe të pangrëna? $16/8$ $14/8$ e ngrënë, $2/8$ e pangrënë. Thyesa e parregullt $8/5$ numri i përzier $1\frac{3}{5}$  <b>Faza e dytë: Veprimet në situatë.</b> <b>Lexim dhe pyetje</b> Nxënësit kalojnë në plotësimin e ushtrimeve në libër. Eksplorojnë në dyshe sipas hapave për situatën dhe mundohen t'i japin zgjidhje. Lexohen kërkesat me kujdes dhe ndiqen hapat e punës. Shkruajnë fjalitë numerike duke treguar se çfarë mendojnë. Vërtetojnë fjalitë numerike sipas rregullit që duhet. Më pas hapen fletoret e punës dhe nxënësit punojnë në mënyrë individuale në kryerjen e ushtrimeve. Ndiqen gjatë punës dhe pasi përfundojnë punën për zgjidhjen e ushtrimit, shkëmbejnë fletoret me shokun e bankës. Më pas, ata diskutojnë në dyshe rreth përfundimeve të gjetura.			



**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë në fletore pesë fjali numerike duke treguar se çfarë mendon.

Kjo është e vërtetë/e gabuar, sepse \_\_\_\_\_. Shembull:  $7/4$  është më e madhe se  $11/8$ . Kjo është e vërtetë, sepse  $7/4 = 1\text{ e }3/4$ ;  $11/8$  është  $1\text{ e }3/8$ .

Këtë veprimtari nxënësit e kryejnë në dyshe.

Në përfundim paraqiten punët e kryera.

Lexohen disa ushtrime nga nxënësit dhe ata përgëzohen për plotësimet e kryera.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- kthimin e një thyese më të madhe se një në numër të përzier;
- gjetjen e thyesave të barabarta me pjesën thyesore të numrave të përzier;
- kthimin e një numri të përzier në një numër thyesor;
- tregimin e hapave që ndiqen për të gjetur pjesën e një numri.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Shkruajnë pesë thyesa të parregullta dhe ktheji në numra të përzier. Gjej thyesa të barabarta me to.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Thyesat dhe numrat dhjetorë – të dhjetat			
<b>Situata e të nxënit:</b> Luajmë me komplete letrash për të formuar numrin dhjetor më të madh dhe numrin dhjetor.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Përcakton në një bosht thyesash të dhëna, thyesat dhjetore. - Paraqet thyesat dhjetore në boshtin numerik. - Krahason thyesat dhjetore. - Shkruan thyesat dhjetore si numra dhjetorë dhe anasjelltas.			
<b>Fjalët kyçe:</b> pjesë, një e tërë, thyesë, thyesa të barabarta, numër i përzier, thyesë e parregullt ose më e madhe se 1, numërues, emërues, një gjysmë, një e treta, një e katërta, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, përqindje, raport, përpjesëtim			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b>  Diskutim i njohurive paraprake, lojë në dyshe, pyetje-përgjigje, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën, punë në dyshe			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Diskutim për njohuritë paraprake.</b> Mësuesi/ja shkruan vargun e thyesave: 2/6; 3/10; 12/20; 27/100; 7/10; 139/1000; 15/100 etj. Nxënësit vëzhgojnë vargun e thyesave dhe qarkojnë thyesat me emërues 10, 100, 1000 etj. Them i që thyesat me emërues 10, 100, 1000 etj. quhen thyesa dhjetore. Thyesat dhjetore i emërtojmë ndryshe si numra me presje. P.sh. 3/10 = 0,3; 27/100 = 2,7; 27/100 = 0,27 etj. Secilit në dyshe i shpërndahen boshte numerike. Udhëzohen: Shëno numrat dhjetorë në boshtin numerik. 1/10 = 0,1 2/10 = 0,2 15/10 = 1,5 Bëjnë kthimin e thyesave dhjetore në numra dhjetorë.			

**Faza e dytë/tretë: Veprimet në situatë. Demonstrim i rezultateve të arritura.**

Hapen librat dhe njihen nxënësit me mësimin.

Plotësojnë të pavarur ushtrimin 1. Bëhet leximi i ushtrimit nga nxënës të ndryshëm.

**Lojë në dyshe**

Luaj me një shok duke përdorur dy komplete letrash.

Përzihen letrat e vendosen përmbys mbi tavolinë.

Secili prej nxënësve zgjedh tri letra, me shifrat e të cilave duhet të formojnë numrin dhjetor më të madh dhe numrin dhjetor më të vogël me një shifër pas presjes dhjetore.

Në shkallën e paraqitur në libër nxënësit duhet të vendosin numrat në mënyrë që numri më i vogël të jetë në fund dhe më i madhi në majë.

Më pas, secili nxënës zgjedh tri letra të tjera, me shifrat e të cilave formojnë përsëri numra dhjetorë të tjerë.

Vendosini numrat në shkallë, gjithnjë duke i renditur nga më i vogli te më i madhi, në drejtimin vertikal nga poshtë-lart.

Nga numrat e formuar, nuk duhet të shënoni në shkallë asnjë numër që prish renditjen, ndryshe humbisni 2 pikë.

Nxënësit vazhdojnë lojën derisa të plotësohet e gjithë shkalla, duke zgjedhur nga tri letra çdo herë.

Pikët e humbura mbahen shënim dhe mbas plotësimit të shkallës ato numërohen.

Fiton lojën lojtari që ka humbur më pak pikë.

Shkruaj numrat dhjetorë të shënuar në shkallë si numra të përzier.

Në fund lexohen nga dyshe të ndryshme plotësimet e bëra.

Nxënësit përgëzohen për punën e tyre.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- përcaktimin në një bosht thyesash të dhëna, thyesat dhjetore;
- paraqitjen e thyesave dhjetore në boshtin numerik;
- krahasimin e thyesave dhjetore;
- shkrimin e thyesave dhjetore si numra dhjetorë dhe anasjelltas.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Shkruaj 10 thyesa dhjetore dhe ktheji ato në numra dhjetorë dhe anasjelltas.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>								
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>									
<b>Ora 2</b>											
<b>Tema mësimore:</b> Thyesat dhe numrat dhjetorë – të dhjetat											
<b>Situata e të nxënët:</b> Luajmë me komplete letrash për të formuar numrin dhjetor më të madh dhe numrin dhjetor.											
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Përcakton në një bosht thyesash të dhëna, thyesat dhjetore. - Paraqet thyesat dhjetore në boshtin numerik. - Krahason thyesat dhjetore. - Shkruan thyesat dhjetore si numra dhjetorë dhe anasjelltas.											
<b>Fjalët kyçe:</b> pjesë, një e tërë, thyesë, thyesa të barabarta, numër i përzier, thyesë e parregullt ose më e madhe se 1, numërues, emërues, një gjysmë, një e treta, një e katërta, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, përqindje, raport, përpjesëtim											
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik									
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Kërkim-hulumtim, Diskutim i njohurive paraprake, lojë në dyshe, pyetje-përgjigje, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën, punë në dyshe											
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake.</b> <b>Diskutim për njohuritë paraprake</b> Mësuesi/ja ka shkruar në dërrasë të zezë një tabelë me disa thyesa dhjetore dhe numra dhjetorë. Nxënësve u kërkohet të bëjnë lidhjen midis thyesës dhjetore dhe numrit dhjetor. Më pas nxënësit shprehin mendimet e tyre duke treguar mënyrën e lidhjes midis tyre.											
		<table><tr><th>Thyesat dhjetore</th><th>Numra dhjetorë</th></tr><tr><td>4 /10</td><td>0,2</td></tr><tr><td>6/10</td><td>0,4</td></tr><tr><td>2/10</td><td>0,6</td></tr></table>		Thyesat dhjetore	Numra dhjetorë	4 /10	0,2	6/10	0,4	2/10	0,6
Thyesat dhjetore	Numra dhjetorë										
4 /10	0,2										
6/10	0,4										
2/10	0,6										
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë.</b> <b>Kërkim-hulumtim</b> Nxënësit hapin librat dhe përqendrohen në ushtrimin 1.											

Mësuesi/ja: Vendos thyesat e mëposhtme mbi boshtin numerik të paraqitur në figurë. Boshti numerik është ndarë në të dhjeta dhe nxënësit vendosin thyesat.

Mësuesi/ja: Shkruaj thyesat dhjetore të barabarta me thyesat e mësipërme.

Mësuesi/ja krahason thyesat mbi boshtin numerik dhe nën boshtin numerik.

Nxënësit arrijnë në konkluzionin se numëruesi dhe emëruesi janë shumëzuar ose pjesëtuar me të njëjtin numër.

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve nëse mund të nxjerrin një përfundim pas këtyre krahasimeve.

Nxënësit do të punojnë në mënyrë individuale për të zgjidhur problemat duke përdorur boshtin numerik që plotësuan.

Në përfundim të çdo probleme, nxënësit diskutojnë mendimet e tyre duke treguar cili ka ose nuk ka të drejtë.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.**

#### **Rishikim në dyshe**

Në këtë fazë, nxënësit do të diskutojnë në dyshe zgjidhjen e problemave 4 dhe 5. Njëri do të lexojë të dhënat e problemës, ndërsa tjetri do të lexojë zgjidhjen e saj duke argumentuar veprimin e tyre mbi situatat e problemave.

#### **Vlerësimi**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- përcaktimin në një bosht thyesash të dhëna, thyesat dhjetore;
- paraqitjen e thyesave dhjetore në boshtin numerik;
- krahasimin e thyesave dhjetore;
- shkrimin e thyesave dhjetore si numra dhjetorë dhe anasjelltas.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Të qindtat			
<b>Situata e të nxënit:</b> Luajmë me komplete letrash për të formuar numrin dhjetor më të madh dhe numrin dhjetor.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krahason dy ose më shumë numra me presje. - Përcakton midis cilëve numra natyrorë ndodhet një numër me presje. - Rrumbullakon një numër dhjetor në numrin e plotë më të afërt. - Rrumbullakon një numër dhjetor në të dhjetat më të afërta.			
<b>Fjalët kyçe:</b> pjesë, një e tërë, thyesë, thyesa të barabarta, numër i përzier, thyesë e parregullt ose më e madhe se 1, numërues, emërues, një gjysmë, një e treta, një e katërta, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, përqindje, raport, përpjesëtim			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Diskutim i njohurive paraprake, kërkim-hulumtim, pyetje-përgjigje, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, shënime mbi shënime.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake.</b> <b>Diskutim për njohuritë paraprake</b> Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa numra me presje si p.sh.: 2,8; 4,2; 5,2. Këto numra nxënësit i vendosin në boshtin numerik të vizatuar në tabelë nga 0-5 . Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të shohë se midis kujt ndodhen këta numra. P.sh., 2,8 ndodhet midis 2 dhe 3. $2 < 2,8 < 3$ dhe $4 < 4,2 < 5$ . Atëherë mund të themi se 2,8 është më e vogël se 4,2. Pra 2,8 afërsisht është 3 dhe 4,2 është afërsisht 4 si numër natyror.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë.</b> <b>Kërkim-hulumtim</b> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vëzhgojnë situatën e dhënë. Klasa do të punojë përsëri me letra. Bëhet shpjegimi i situatës së dhënë.			

Secili do të zgjedhë katër letra me shifra dhe do t'i shkruajë ato në tabelë.

P.sh., 7, 6, 3, 1.

Formojnë numrin me dy shifra pas presjes dhjetore. P.sh., 36,17 .

Rrumbullakojnë në numrin e plotë më të afërt.

Rrumbullakojnë në të dhjetat më të afërta.

Shkruajnë përgjigjet e tyre në tabelë.

Sa numra mund të formosh dhe t'i rrumbullakosh gjatë kohës që ke në dispozicion?

Në cilin përfundim arrijmë kur rrumbullakojmë me numrin e plotë më të afërt? Po me rrumbullakimin në të dhjetat më të afërta?

Përgjigjet e nxënësve mund të jenë: Krahاسimi i numrave dhjetorë bëhet duke patur parasysh krahasimin e numrave natyrorë.

Në të njëjtën mënyrë vazhdon plotësimi i tabelës dhe duke shqyrtuar rrumbullakimet e krahasimet midis numrave dhjetorë.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.**

#### **Shënime mbi shënime**

Nxënësit do të punojnë në dyshe. Nxënësit vëzhgojnë dhe diskutojnë rreth plotësimit të tabelës.

Argumentojnë përgjigjet. Mësuesi/ja pyet për mënyrën e zbatimit të veprimeve.

Krahasojnë gjetjet e bëra duke këmbyer librat me njëri-tjetrin.

Mësuesi/ja mund të japë detyrë për nxënësit që mbarojnë shpejt, të krijojnë një situatë problemore me numrat dhjetorë.

#### **Vlerësimi**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- krahasimin e dy ose më shumë numra me presje;
- përcaktimin midis cilëve numra natyrorë ndodhet një numër me presje;
- rrumbullakimin e një numër dhjetor në numrin e plotë më të afërt;
- rrumbullakimin e një numër dhjetor në të dhjetat më të afërta.

##### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësim i fletores së punës ushtrimi nr. 1.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>																				
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>																					
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Të qindtat																							
<b>Situata e të nxënit:</b> Luajmë me komplete letrash për të formuar numrin dhjetor më të madh dhe numrin dhjetor.																							
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krahason dy ose më shumë numra me presje. - Përcakton midis cilëve numra natyrorë ndodhet një numër me presje. - Rrumbullakon një numër dhjetor në numrin e plotë më të afërt. - Rrumbullakon një numër dhjetor në të dhjetat më të afërta.																							
<b>Fjalët kyçe:</b> pjesë, një e tërë, thyesë, thyesa të barabarta, numër i përzier, thyesë e parregullt ose më e madhe se 1, numërues, emërues, një gjysmë, një e treta, një e katërta, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, përqindje, raport, përpjesëtim																							
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik																					
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Përvijim i të menduarit, lojë në dyshe, hulumtim-shqyrtim i përbashkët, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën.																							
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake.</b> <b>Përvijim i të menduarit</b> Mësuesi/ja praqet boshtin numerik ku janë paraqitur masat në kilogram. <table><tr><td>1/10</td><td>1/10</td><td>1/10</td><td>1/10</td><td>1/10</td><td>1/10</td><td>1/10</td><td>1/10</td><td>1/10</td><td>1/10</td></tr><tr><td>0,1</td><td>0,1</td><td>0,1</td><td>0,1</td><td>0,1</td><td>0,1</td><td>0,1</td><td>0,1</td><td>0,1</td><td>0,1</td></tr></table> Secila ndarje e saj në bosht na tregon 1/10 e kg = 0,1 kg . Mësuesi/ja nxit nxënësit të numërojnë me të dhjetat e kg. P.sh. nga 0,7 deri në 1,5: 0,8 ; 0,9 ; 1,0 ; 1,1 ; 1,2 ; 1,3 ; 1,4 ; 1,5. Mësuesi/ja paraqet renditje të masave të ndryshme të kilogramit, nga më i madhi te më i vogli. P.sh., 49,63 kg; 8,9 kg dhe 8,4 kg.				1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1
1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10	1/10														
0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1														



Pasi bëjnë renditjen nxënësit rrumbullakojnë me të dhjetat më të afërta dhe me numrin e plotë më të afërt.

P.sh.: 49,63 kg rrumbullakimi me të dhjetat më të afërta 49,6 kg; me numrin e plotë 50 kg.

### **Faza e dytë: Veprimet në situatë.**

#### **Hulumtim-shqyrtim i përbashkët**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat. Ajo kërkon që në dyshe nxënësit të përdorin letrat me shifra për të formuar numra me dy shifra pas presjes dhjetore.

Nxënësit udhëzohen të punojnë duke zgjedhur sasi në metra, kilogram ose litra.

Nxënësit vendosin në tabelë shifrat dhe sasinë që zgjedhin.

P.sh. 6, 3, 9, 2 sasia e formuar 63,92.

Plotësojnë tabelën duke rrumbullakuar sipas udhëzimeve të dhëna në të.

Në përfundim të detyrës nxënësit bëjnë krahasime midis dysheve.

Në fund dëgjohen mendimet e dysheve. Ata lexojnë masat e dhëna dhe sasinë e formuar.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.**

#### **Shkëmbe një problemë**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hartojnë një situatë problemore me numrat e plotë të ndodhura në tabelë. Problemën e hartuar ia japin grupit tjetër. Nxënësit pasi kanë marrë problemën e zgjidhin në grup për një kohë të caktuar. Grupi fillestar kontrollon si është zgjidhur problema.

Diskutohen disa nga problemat e krijuara dhe zgjidhjet e tyre.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- krahasimin e dy ose më shumë numra me presje;
- përcaktimin midis cilëve numra natyrorë ndodhet një numër me presje;
- rrumbullakimin e një numër dhjetor në numrin e plotë më të afërt;
- rrumbullakimin e një numër dhjetor në të dhjetat më të afërta.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësim i fletores së punës ushtrimi 2.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore: Përqindjet</b>			
<b>Situata e të nxënit:</b> Krijim përqindjesh brenda disa minutave.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Dallon çmimin e blerjes dhe çmimin e shitjes duke e shkruar në përqindje. - Zgjidh situata problemore duke përdorur veprime me lekë. - Argumenton përgjigjen e dhënë në situata problemore.			
<b>Fjalët kyçe:</b> përqindja, vlera e një numri, situatë, blerje, shifra, shumëfish i 10, renditje, raporti, përpjesëtimi			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Diskutim i njohurive paraprake, lojë në dyshe, marrëdhënie pyetje-përgjigje, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Rikujtim i njohurive të mëparshme.</b> <b>Situatë problemore</b> Mësuesi/ja pyet – Përfytyro sikur 100% e vlerës së një malli është 260 lekë. A mund të shkruash përqindje të tjera të kësaj sasive parash? Sa të tilla mund të gjeshe brenda 2 minutave? Shkruaj në një diagram përgjigjet që gjete. P.sh. 100% = 260 lekë; 50% =130 lekë; 10% = 26 lekë etj. Nxënësit gjejnë edhe përqindje të tjera të vlerës së mallit me këtë sasi lekësh. Shkruajnë përgjigjet që gjetën dhe më pas lexojnë disa nxënës.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Marrëdhënie pyetje-përgjigje</b> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të lexohet problema 1 në libër. Çfarë dimë rreth asaj që lexuam dhe që shohim? Situata: Moza bleu një top me ulje çmimi. Para uljes çmimi i topit ishte 260 lekë. Gjatë uljeve ai ishte 1% më i lirë. Sa lekë më i lirë është topi tani?  Nxënësit plotësojnë ushtrimin në dyshe dhe këmbajnë librat me njëri-tjetrin për t’i kontrolluar. Diskutojnë në dyshe mbi mënyrën e zgjidhjes së ushtrimeve.			

A mund të nxjerrim në përfundim se si e gjetëm vlerën e lekëve pas uljes?

Nxënësit argumentojnë kryerjen e veprimeve.

Nxënësit punojnë në dyshe në problemën dy dhe 3 të tekstit dhe i diskutojnë ato.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.**

#### **Ditari dypjesësh**

Nxënësit ndahen në dy grupe dhe secili grup do punojë nga një problemë pasi u është bërë e qartë metoda që do të ndiqet. Ndahet fleta në dy pjesë.

Në pjesën e parë nxënësit shkruajnë të dhënat e problemës, në pjesën e dytë shkruajnë zgjidhjen e saj.

Në fund këmbëhen problemat për t'u kontrolluar në grupe dhe diskutohen me klasën.

Të dhënat: Fletorja kushton 50 lekë

Zgjidhja:  $100\% = 50 \text{ lekë}$

copa para uljes së çmimit. Çmimi u ul me

$10\% = 5 \text{ lekë}$

20 %

$20\% = 10 \text{ lekë}$

Nxënësit përgëzohen për punën e kryer.

#### **Vlerësimi**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- dallimin e çmimit të blerjes dhe çmimin e shitjes duke e shkruar në përqindje;
- zgjidhjen e situatave problemore duke përdorur veprime me lekë;
- argumentimin e përgjigjes së dhënë në situata problemore.

##### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Krijon një situatë problemore me përqindje.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Përqindjet			
<b>Situata e të nxënit:</b> Krijim përqindjesh brenda disa minutave.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Llogarit sa më shumë përqindje të një numri si shumëfish i 10-ës. - Zgjidh situata problemore duke përdorur veprime me lekë. - Argumenton përgjigjen e dhënë në situata problemore.			
<b>Fjalët kyçe:</b> përqindja, vlera e një numri, situatë, blerje, shifra, shumëfish i 10, renditje, raporti, përpjesëtimi			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Mendo-krijo dyshe-diskuto, role të specializuara në diskutime, lojë në dyshe, vëzhgim, demonstrim, punë me gjithë klasën, punë në dyshe			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Mendo-krijo dyshe-diskuto</b> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librin dhe të punojnë në dyshe në zgjidhjen e situatës: Nxirr tri letra me shifra nga të cila njëra prej tyre të jetë 0. Formo një numër me 3 shifra, shumëfish të 10. Llogarit sa më shumë përqindje të këtij numri brenda 2 minutash. Shkruaj përqindjet e kryera. Më pas, ushtrimi diskutohet duke e kontrolluar njëri-tjetrin në dyshe dhe duke këmbyer librat. Më pas ushtrimi diskutohet me të gjithë klasën.  <b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Role të specializuara në diskutim</b> Mësimi zhvillohet në grupe me nga 4 nxënës ku secili prej tyre ka një numër të caktuar. Numri 1: Lexon problemën dhe analizon të dhënat. Numri 2: Kryen veprime për të zgjidhur problemën. Numri 3: Kontrollon nëse numri i gjetur është i saktë. Numri 4: Raporton zgjidhjen e problemës dhe formulon përgjigjen. Grupet punojnë nga një problemë dhe mësuesi/ja i jep detyrën secilit grup. Më pas problemat zgjidhen në tabelë nga raportuesi (numri 4). Pasi gjejnë zgjidhjen e problemit nxënësit formulojnë përgjigjen e problemës.			

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.****Role të specializuara në diskutime**

Nxënësit ndërrojnë rolet brenda grupit dhe zgjidhin problemën 5.

Numri 4 merr rolin e numrit 1 e kështu me radhë...

Pastaj problemi zgjidhet në tabelë nga një prej raportuesve të një grupi.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- llogaritjen e sa më shumë përqindjeve të një numri si shumëfish i 10;
- zgjidhjen e situatave problemore duke përdorur veprime me lekë;
- argumentimin e përgjigjes së dhënë në situata problemore.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësim i fletores së punës.

<b>Fusha: Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1 Tema mësimore: Përpjesëtimi</b>			
<b>Situata e të nxënët:</b> Situata problemore mbi raportin dhe përpjesëtimin.			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krijon raporte midis dy madhësive me ndihmën e figurave. - Dallon qartë në situata problemore formimin e një përpjesëtimi. - Zbaton raportet dhe përpjesëtimet në situata problemore.			
<b>Fjalët kyçe:</b> përqindja, vlera e një numri, blerje, shifra, shumëfish i 10, renditje, raporti, përpjesëtimi.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik, shoqëria dhe mjedisi.	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Diskutim për njohuritë paraprake, të nxënët me këmbime, shkëmbe një problemë, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grupe			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Diskutim për njohuritë paraprake</b> Mësuesi/ja ka vizatuar një drejtkëndësh të ndarë në 10 pjesë. 7 janë të verdhë, 3 janë të gjelbër. Ç’pjesë të numëruesve përbëjnë ata me ngjyrë të gjelbër? Nxënësit kryejnë veprimet duke shkruar një thyesë. Ç’pjesë të numëruesve përbëjnë ata me ngjyrë të verdhë? Shkruajnë një thyesë. Disa nxënës lexojnë përfundimet në dyshe. Më pas diskutojnë për veprimin e kryer. Shkruhen përfundimet në tabelë nga mësuesi/ja. <b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Të nxënët me këmbime (Ndërrim vendesh)</b> Mësuesi/ja i njeh nxënësit me veprimtarinë me ndërrim vendesh që do të bëjnë. Nxënësit do të zgjidhin problemat nga 2 deri në 5. Në fund të veprimtarisë secili nxënës duhet të dijë zgjidhjen e tyre. Numërojmë me radhë nga 1 deri në 4. Çdo grup është një grup ekspertësh. Nxënësit me numrin një do të zgjidhin problemën 2. Nxënësit me numrin dy do të zgjidhin problemën 3. Nxënësit me numrin tre do të zgjidhin problemën 4. Nxënësit me numrin katër do të zgjidhin problemën 5. Punojnë për disa minuta. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të shkojnë në grupet fillestare. Mësuesi/ja shkon nga grupi në grup për të dëgjuar diskutimet e nxënësve. Diskutohet me të gjithë klasën. Nxënës të ndryshëm nga grupet japin shpjegime për problemat e kryera. <b>Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura. Shkëmbe një problemë</b> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hartojnë në grup një situatë të ngjashme me ato të tekstit dhe t’ia japë grupit tjetër. Nxënësit pasi marrin problemën e zgjidhin në grup për një kohë të caktuar. Grupi fillestar kontrollon si është kryer zgjidhja. Diskutohen disa nga problemat e krijuara dhe zgjidhjet e tyre. <b>Vlerësimi:</b> <b>Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:</b> - krijimin e raporteve midis dy madhësive me ndihmën e figurave; - dallimin qartë në situata problemore formimin e një përpjesëtimi; - zbatimin e raporteve dhe përpjesëtimet në situata problemore. <b>Detyra dhe puna e pavarur:</b> Situatë problemore me kafshët tuaja në shtëpi.			

<b>Fusha: Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2 Tema mësimore: Përpjesëtimi</b>			
<b>Situata e të nxënit:</b> Krijim përqindjesh brenda disa minutave.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krijon raporte midis dy madhësive me ndihmën e figurave. - Dallon qartë në situata problemore formimin e një përpjesëtimi. - Zbaton raportet dhe përpjesëtimet në situata problemore.			
<b>Fjalët kyçe:</b> përqindja, vlera e një numri, situatë, blerje, shifra, shumëfish i 10, renditje, raporti, përpjesëtimi, thyesë e barabartë, një e dyta, numër dhjetor.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Imagjinatë e drejtuar, të nxënit me këmbime, shkëmbe një problemë, diskuto (punë individuale, punë në grup, punë me klasën)			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Imagjinatë e drejtuar</b> Mësuesi/ja shtron para klasës situatën e dhënë në fletoren e punës (ushtrimi 1). Punoni në grup. Ju do të përgatitni lëngje frutash për një festë në shkollë. Keni një shishe 500 ml me lëng portokalli. Kjo sasi lëngu do të ndahet në mënyrë të barabartë në 10 gota që nxënë nga 250 ml secila. Sa ujë duhet për të mbushur 10 kana 1-litërshe me lëng? Ju mund të zgjidhni atë më lehtë, duke e vizatuar. Nxënësit nisin nga puna dhe japin përgjigjen. Njëri grup përgjigjet. A është përgjigjur drejt? <b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Të nxënit me këmbime</b> Nxënësit do të punojnë në dyshe situatat problemore 1, 2, 3 ku do të kryejnë këto plotësime. Pasi lexojnë të dhënat e problemit nxënësit kryejnë veprimet. ½ janë lunë, 2/10 janë majmunë dhe 1/5 janë gjirafa. Për shembull: Janë 20 kafshë gjithsej. Themi kemi 10 luanë, 6 majmunë dhe 4 gjirafa. Gjej dhe një mundësi tjetër. Ushtrimi 2: ¼ e 24 frutave janë mollë, 1/3 e 24 frutave janë mandarina, 1/6 e 24 frutave janë qershi dhe frutat e tjera janë banane. 6 mollë, 8 mandarina, 4 qershi, 8 janë banane. Gjej dhe një mundësi tjetër. Nxënësit raportojnë punën e tyre. Çdo nxënës i dyshes tregon rezultatet e kryera. Diskutimet zgjerohen me të gjithë klasën. <b>Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura. Shkëmbe një problemë</b> Mësuesi/ja kërkon që secili grup të krijojë një situatë problemore ku zbatohet përpjesëtimi dhe t’ia japë atë grupit tjetër. Nxënësit pasi kanë marrë problemën e zgjidhin në grup për një kohë të caktuar, rreth 5 minuta. Grupi fillestar kontrollon se si është zgjidhur problema. Diskutohen disa nga problemat e krijuara dhe zgjidhjet e tyre. Nxënësit përgëzohen për punën e kryer.			
<b>Vlerësimi</b> <b>Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:</b> - krijimin e raporteve midis dy madhësive me ndihmën e figurave; - dallimin qartë në situata problemore të formimit të një përpjesëtimi; - zbatimin e raporteve dhe përpjesëtimeve në situata problemore.			
<b>Detyra dhe puna e pavarur:</b> Plotësim i fletores së punës, faqe 2.			

<b>Fusha: Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore: Raporti</b>			
<b>Situata e të nxënit:</b> Krijimi i raporteve midis dy figurave ose dy madhësive.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krijon raporte midis dy madhësive të dhëna. - Bën dallimin duke zmadhuar ose zvogëluar një madhësi me disa njësi. - Tregon ma anë të vizatimit një figurë sipas situatës. - Zbaton raportet dhe përpjesëtimet në problema.			
<b>Fjalët kyçe:</b> raport, përpjesëtim, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, situatë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra natyrorë, shirita letrash, modele për mësuesin, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, edukim fizik, arte, Shoqëria dhe mjedisi.	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Diskutim për njohuritë paraprake, lexim përmbledhje në dyshe, shkëmbe një problemë (punë me gjithë klasën, punë në dyshe.)			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Diskutim për njohuritë paraprake</b> Krijojmë situata problemore për të përsëritur njohuritë e marra. P.sh.: Në shportë kemi përbërësit për një sallatë me fruta, për 4 persona. 2 mollë, 3 pjeshkë, 4 banane, 5 dardha, 1 litër lëng portokalli. Raporti i mollëve me pjeshkat është 2:3; Sa është raporti i mollëve me bananet? Po i pjeshkave me dardhat? Etj. Nxënësit krijojnë raporte të ndryshme me frutat e dhëna. U kërkohet nxënësve të formulojnë me gojë ushtrime të tilla.  <b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Lexim përmbledhje në dyshe</b> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat. Ndahet klasa në dyshe dhe përcaktohen nxënësit me numrin 1 e 2. Do të zgjidhim situatën e parë me gjithë klasën bashkë me mësuesin/en. Nxënësit me numrin 1 do të lexojnë problemën. Nxënësit me numrin 2 do të përmbledhin me fjalët e tyre përmbajtjen e problemës. Më pas u lihet kohë dysheve për të përcaktuar veprimin e problemës. Nxënësit me numrin 2 formulojnë përgjigjen e problemës, p.sh.: Raporti i mollëve me pjeshkat për 8 persona është 4:6 etj.			



Në zgjidhjen e problemës së dytë do të këmbëhen rolet e njëshave me të dyshave. Gjejnë që raporti i përbërësve ndryshon në përpjesëtim me personat e marrë.

**Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura.**

**Shkëmbe një problemë**

Në këtë fazë punohet me grupe 4-5 veta.

Disa nga grupet do të krijojnë situata problemore që zgjidhen me raportin ndërmjet disa objekteve.

Mund të vizatojnë dhe figura. Mësuesi/ja udhëzon grupet për detyrën dhe se si do të shkëmbejnë problemat zinxhir.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- krijimin e raporteve midis dy madhësive të dhëna;
- bërjen e dallimit duke zmadhuar ose zvogëluar një madhësi me disa njësi;
- tregimin me anë të vizatimit të një figure sipas situatës;
- zbatimin e raporteve dhe përpjesëtimeve në problema.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësim i fletores së punës.

<b>Fusha: Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore: Raporti</b>			
<b>Situata e të nxënit:</b> Krijimi e raporteve midis dy figurave ose dy madhësive			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krijon raporte midis dy madhësive të dhëna. - Bën dallimin duke zmadhuar ose zvogëluar një madhësi me disa njësi. - Tregon ma anë të vizatimit një figurë sipas situatës. - Zbaton raportet dhe përpjesëtimet në problema.			
<b>Fjalët kyçe:</b> raport, përpjesëtim, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, situatë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra dhjetorë, shirita letrash, modele për mësuesin/en, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, edukim fizik, arte, Shoqëria dhe mjedisi.	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Diskutim për njohuritë paraprake, lexim përmbledhje në dyshe, shkëmbe një problemë (punë me gjithë klasën, punë në dyshe.)			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Diskutim për njohuritë paraprake</b> Mësuesi/ja vizaton në tabelë skemën: <div><div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div></div><div><div></div><div></div><div></div><div></div><div></div></div><div>e tëra</div><div>1 pjesë</div></div> U kërkon nxënësve të krijojnë një problemë në bazë të skemës. Nxënësit punojnë në dyshe. Pasi e kanë formuluar dhe zgjidhur lexohet problema nga 2-3 dyshe.  <b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Lexim përmbledhje në dyshe</b> Do të punohen problemat 1; 2; 3 dhe 4 në libër në grupe me nga katër nxënës ku secili ka një rol të caktuar.			

Nxënësi 1 – interpretuesi i problemit; Nxënësi 2 – llogaritësi;

Nxënësi 3 – kontrolluesi; Nxënësi 4 – raportuesi

Grupet e punojnë detyrën për 10 minuta.

Më pas problemat zgjidhen në tabelë nga raportuesi i grupit i cili argumenton dhe veprimin që u zbatua në zgjidhjen e problemës.

Mësuesi/ja: Ku ndryshojnë këto situata problemore nga njëra-tjetra?

Çfarë të reje na mëson situata e dytë? Po e treta?

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura. Shkëmbe një problemë**

Në tabelë paraqitet kjo ndarje:

Të dhënat e problemës	Të panjohurat	Zgjidhje

Mësuesi/ja fton nxënësit të plotësojnë këtë skemë për problemat që sapo zgjidhen.

U kërkon nxënësve të shohin skemën.

Çfarë vini re në këtë skemë?

Çfarë marrëdhëniesh janë dhënë?

Çfarë veprimesh kryejmë kur janë dhënë këto marrëdhënie?

Dëgjohen përgjigjet e nxënësve.

Nxënësit do të punojnë në mënyrë individuale për të plotësuar në fletore tabelën për problemat që ata zgjidhen. Lexohen tabelat e plotësuara nga disa nxënës.

Plotësohet dhe ditari trepjesësh i ndërtuar nga mësuesi/ja në tabelë.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- krijimin e raporteve midis dy madhësive të dhëna;
- bërjen e dallimit duke zmadhuar ose zvogëluar një madhësi me disa njësi;
- tregon me anë të vizatimit një figurë sipas situatës;
- zbatimin e raporteve dhe përpjesëtimeve në problema.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësim i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b> <b>Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Thyesat, numrat dhjetorë, përqindjet, raporti dhe përpjesëtimi (Përmbledhim)			
<b>Situata e të nxënësve:</b> Sa shpejt mund të punosh me thyesat.			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krahason thyesat me emërues të njëjtë duke vendosur shenjën më e madhe më e vogël. - Paraqet pjesët përbërëse të një thyese duke e kthyer në numra dhjetorë dhe përqindje. - Rendit numra dhjetorë sipas një rregulli të caktuar.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Thyesë, raport, përpjesëtim, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, situatë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra thyesorë, shirita letrash, modele për mësuesin/en, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, edukim fizik, arte, Shoqëria dhe mjedisi.	
<b>Metodologjia e veprimtarisë e të nxënësve:</b> Përmbledhje e strukturuar, Role të specializuara në diskutim, puno në dyshe, diskuto në klasë.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Përmbledhje e strukturuar</b> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të tregojnë shkurt njohuritë që u diskutuan në kapitullin për thyesat. Ç’dinë për thyesat dhe veprimet me to. Si e gjejmë pjesën e së tërës? A e gjeni dot 2/3 e 12-ës? Po 3/5 si paraqitet si numër dhjetor? Po përqindja? Nxënësit japin përgjigje dhe përgjigjet e tyre shkruhen në tabelë. <b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Role të specializuara në diskutim</b> Do të punohen në grupe ushtrimi 1 e 2. Sa shpejt mund ta plotësosh tabelën e mëposhtme? Mat kohën që të duhet. Nxënësit punojnë në grup duke ndarë detyrat e secilit brenda grupit. Ata kanë 10 minuta kohë për plotësimin e tabelave. Më pas diskutohen përgjigjet në grup. Janë të gjithë dakord? Mësuesi/ja zgjedh dy grupe të cilët do të zhvillojnë situatat problemore në tabelë. Ushtrimet do të zgjidhen nga përfaqësuesi që do të caktohet nga vetë grupi, p.sh.: 3/5; si numër dhjetor 0,6; si përqindje 60%.			
<b>Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura. Rishikim në dyshe</b> Në këtë fazë, nxënësit hapin fletoret e punës dhe punojnë në dyshe. Ata plotësojnë diagramin merimangë duke shkruar sa më shumë fakte të barabarta me numrat në qendër të tyre. Për shembull: 1/2 = 2/5 = 0,5 = 50%.      75% = 0,75 = 75/100 = 3/4 etj.			
<b>Vlerësimi</b> <b>Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:</b> - krahasimin e thyeseve me emërues të njëjtë duke vendosur shenjën më e madhe më e vogël; - paraqitjen e pjesëve përbërëse të një thyese duke e kthyer në numra dhjetorë dhe përqindje; - renditjen e numrave dhjetorë sipas një rregulli të caktuar.			
<b>Detyra dhe puna e pavarur:</b> Krijoni një tabelë të ngjashme si në klasë.			

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë Klasa: 5	Data:
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Numri	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Thyesat, numrat dhjetorë, përqindjet, raporti dhe përpjesëtimi (Përmbledhim)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Sa shpejt mund të punosh me thyesat.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b> - Krahason thyesat me emërues të njëjtë duke vendosur shenjën më e madhe më e vogël. - Paraqet pjesët përbërëse të një thyese duke e kthyer në numra dhjetorë dhe përqindje. - Rendit numra dhjetorë sipas një rregulli të caktuar.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Thyesë, raport, përpjesëtim, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, situatë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra thyesorë, shirita letrash, modele për mësuesin/en, kompleti i letrave, fletore pune.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, edukim fizik, arte, Shoqëria dhe mjedisi.	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b> Përmbledhje e strukturuar, Role të specializuara në diskutim, puno në dyshe, diskuto në klasë.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b> <b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Përmbledhje e strukturuar</b> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të tregojnë shkurt njohuritë që u diskutuan në kapitullin për thyesat. Ç’dinë për thyesat dhe veprimet me to. Si e gjejmë pjesën e së tërës? A e gjeni dot 2/3 e 12-ës? Po 3/5 si paraqitet si numër dhjetor? Po përqindja? Nxënësit japin përgjigje dhe përgjigjet e tyre shkruhen në tabelë. <b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Role të specializuara në diskutim</b> Do të punohen në grupe ushtrimi 1 e 2. Sa shpejt mund ta plotësosh tabelën e mëposhtme? Mat kohën që të duhet. Nxënësit punojnë në grup duke ndarë detyrat e secilit brenda grupit. Ata kanë 10 minuta kohë për plotësimin e tabelave. Më pas diskutohen përgjigjet në grup. Janë të gjithë dakord? Mësuesi/ja zgjedh dy grupe të cilët do të zhvillojnë situatat problemore në tabelë. Ushtrimet do të zgjidhen nga përfaqësuesi që do të caktohet nga vetë grupi, p.sh.: 3/5; si numër dhjetor 0,6; si përqindje 60%.			
<b>Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura. Rishikim në dyshe</b> Në këtë fazë, nxënësit hapin fletoret e punës dhe punojnë në dyshe. Ata plotësojnë diagramin merimangë duke shkruar sa më shumë fakte të barabarta me numrat në qendër të tyre. Për shembull: 1/2 = 2/5 = 0,5 = 50%.      75% = 0,75 = 75/100 = 3/4 etj.			
<b>Vlerësimi</b> <b>Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:</b> - krahasimin e thyesave me emërues të njëjtë duke vendosur shenjën më e madhe më e vogël; - paraqitjen e pjesëve përbërëse të një thyese duke e kthyer në numra dhjetorë dhe përqindje; - renditjen e numrave dhjetorë sipas një rregulli të caktuar.			
<b>Detyra dhe puna e pavarur:</b> Krijoni një tabelë të ngjashme si në klasë.			

<b>Fusha: Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë Klasa: 5</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Numri</b>	
<b>Ora 2:</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Thyesat, numrat dhjetorë, përqindjet, raporti dhe përpjesëtimi (Përforcimë)			
<b>Situata e të nxënët:</b> Sa shpejt mund të punosh me thyesat.			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave lëndore sipas temës mësimore:</b>			
<ul style="list-style-type: none"><li>- Paraqet pjesët përbërëse të një thyese duke e kthyer në numra dhjetorë dhe përqindje.</li><li>- Rendit numra dhjetorë sipas një rregulli të caktuar.</li><li>- Shkruan informacionin që ka mësuar në një hartë koncepti.</li><li>- Argumenton përgjigjet duke u mbështetur në informacionin për thyesat.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b>			
Thyesë, raport, përpjesëtim, një e pesta, një e gjashta, një e teta, një e dhjeta; thyesë e barabartë, numër dhjetor, situatë.			
<b>Burimet, mjetet:</b>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b>	
libri i nxënësit, situata të thjeshta me numra thyesorë, shirita letrash, modele për mësuesin/en, kompleti i letrave, fletore pune.		Gjuha dhe komunikimi, edukim fizik, arte, Shoqëria dhe mjedisi.	
<b>Metodologjia e veprimtaritë e të nxënësve:</b>			
Hartë konceptesh, kërkim-hulumtim, puno në dyshe, puno me gjithë klasën.			
<b>Veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Faza e parë: Veprimtari paraprake. Hartë konceptesh</b>			
Mësuesi/ja vendos fjalën “thyesat” në qendër të tabelës. Nxënësit renditin lidhjet midis kësaj fjale dhe fjalëve që ata mendojnë. Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të punojnë në dyshe në libër.			
Çfarë dimë për thyesat, numrat dhjetorë, përqindjet, pjesët dhe raportet?			
Secili nxënës shkruan informacionin që ka mësuar në një hartë koncepti.			
Për shembull: Thyesat – pjesa e së tërës; numri poshtë vijës thyesore është emëruesi i thyesës.			
Një për qind është 1 nga 100 pjesë të barabarta.			
Më pas, nxënësit shkëmbejnë fletën me shokun e bankës dhe diskutojnë shënimet e bëra.			
<b>Faza e dytë: Veprimet në situatë. Kërkim-hulumtim (Puno në grup)</b>			
Ndahet klasa në grupe me nga 4 nxënës secili grup. Çdo grupi i jepet nga dy shirita letrë me gjatësi të njëjtë. Dy prej pjesëtareve të grupit u kërkohet ta ndajnë letrën dhe ta ngjyrosin atë me të kuqe që të paraqesin thyesën 3/5, ndërsa dy të tjerëve shiritin blu në 4/5.			

Pastaj u kërkohet nxënësve të krahasojnë shiritat e ngjyrosur.

- Cili është më i gjatë?

- Si mendoni cila është thyesa më e madhe  $\frac{3}{5}$  apo  $\frac{4}{5}$ ?

Kthejnë thyesat në numra dhjetorë dhe në përqindje. Diskutohet në fund rreth tyre.

### **Faza e tretë: Demonstrim i rezultateve të arritura. Rishikim në dyshe**

Në këtë fazë, nxënësit hapin fletoret dhe punojnë individualisht. Nxënësve u kërkohet që të shkruajnë numra dhjetorë dhe thyesorë të paktën 8-10 të tillë.

I paraqesin me tabelë ose në bosht numerik. Pasi përfundojnë punën për zgjidhjen e ushtrimeve, ata shkëmbejnë fletoret me shokun e bankës.

Më pas, ata diskutojnë në dyshe rreth përfundimeve të gjetura. Diskutimi zgjerohet me të gjithë klasën.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- paraqitjen e pjesëve përbërëse të një thyese duke e kthyer në numra dhjetorë dhe përqindje;
- renditjen e numrave dhjetorë sipas një rregulli të caktuar;
- shkrimin dhe informacionin që ka mësuar në një hartë koncepti;
- argumentimin e përgjigjeve duke u mbështetur në informacionin për thyesat.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Krijoni një tabelë të ngjashme si në klasë.

# TESTIM PËR NJOHURITË E MARRA NË KAPITULLIN E DYTË

**Lënda: Matematikë**

**Klasa: V**

**Tema: Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjesëtimi**

**Emër/mbiemër:** \_\_\_\_\_

**Data** \_\_\_\_\_

1. Qarko figurën që tregon një të katërtën. (1 pikë)



2. Blerta kishte disa lekë. Ajo shpenzoi  $\frac{4}{8}$  e tyre për të blerë një top. Ç'pjesë e lekëve i mbetën Blertës? (1 pikë)

a)  $\frac{4}{8}$

b)  $\frac{1}{8}$

c)  $\frac{3}{8}$

d)  $\frac{2}{8}$

3. Rendit thyesat nga më e madhja te më e vogla. (3 pikë)

$\frac{6}{8}$ ;  $\frac{11}{8}$ ;  $\frac{8}{8}$ ;  $\frac{1}{8}$ ;  $\frac{4}{8}$ ;  $\frac{3}{8}$

\_\_\_\_\_

4. Kryej veprimet. Shkruaj përgjigjet në mënyrën më të thjeshtë. (3 pikë)

$$\frac{4}{6} + \frac{2}{6} =$$

$$1 - \frac{2}{8} =$$

$$\frac{8}{9} - \frac{1}{9} =$$

5. Gjej pjesën e një numri. (3 pikë)

$\frac{4}{9}$  e 54 luleve -

$\frac{3}{8}$  e 24 faqeve -

$\frac{2}{5}$  e 100 kubeve -

6. Cila nga thyesat formon numër të përzier? (1 pikë)

a)  $\frac{1}{8}$

b)  $\frac{8}{8}$

c)  $\frac{5}{8}$

d)  $\frac{9}{8}$

7. Gjej shumën e gjysmës së 36 me  $\frac{3}{4}$  e 128. (1 pikë)

a) 100

b) 114

c) 200

d) 137

8. Plotëso. (4 pikë)

$\frac{1}{6}$  e një numri është 12. Sa janë  $\frac{5}{6}$  e tij? \_\_\_\_\_

Po  $\frac{6}{6}$  e tij? \_\_\_\_\_



**9. Shkruaj si numra me presje thyesat që janë dhjetore.** (3 pikë)

$\frac{3}{10}$ ; \_\_\_\_       $\frac{7}{15}$ ; \_\_\_\_       $\frac{21}{10}$ ; \_\_\_\_       $\frac{9}{24}$ ; \_\_\_\_       $\frac{7}{10}$ ; \_\_\_\_

**10. Shkruaj si thyesë dhjetore numrat me presje:** (4 pikë)

$10,7 = \frac{\quad}{10}$ ;       $2,8 = \frac{\quad}{10}$ ;       $14,1 = \frac{\quad}{10}$ ;       $0,9 = \frac{\quad}{10}$ .

**11. Torta ka 6 kg fruta brenda saj. Pjesa e bananeve zë  $\frac{2}{3}$  e tortës. Sa kg portokaj ka në tortë?** (3 pikë)

---

**12. Një nxënës zgjidhi ditën e parë  $\frac{1}{5}$  e ushtrimeve. Më pas ai zgjidhi dhe  $\frac{2}{5}$  e tyre. A i mbaroi ushtrimet ai?** (2 pikë)

---

**13. Problemë** (3 pikë)

Në festën e karnavaleve morën pjesë 680 veta. Gjysma e tyre ishin fëmijë. 25% e fëmijëve ishin vajza. Sa vajza ishin në festën e karnavaleve? Sa djem ishin?

Pikët	0-8	9-12	13-16	17-21	22-26	27-29	30-32
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data:
Koha e zgjatjes: 45 minuta mend		Tematika: Strategjitë e veprimeve me	
Ora 1			
Tema mësimore: Diskutojmë së bashku			
Situata e të nxënit: Veprimtari hulumtuese dhe strategji të ndryshme mbi kryerjen me mend të veprimeve të mësuara.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës			
<div>- Kupton çfarë përfaqëson secila shifër në të gjithë numrat.</div> <div>- Zgjedh strategji të përshtatshme për të realizuar me mend veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit.</div> <div>- Argumenton mënyrën e zgjidhjes së kësaj strategjie.</div> <div>- Shpjegon dhe zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim me mend.</div>			
Fjalët kyçe: Veprime matematikore, vetia e pandryshueshmërisë së mbledhjes dhe zbritjes, shuma, ndryshesa, diferenca, vetia e përdasimit të shumëzimit në lidhje me mbledhjen, vetia e shoqërimit të mbledhjes.			
Burimet, mjetet: Teksti mësimor, fisha me veprime matematikore, modele demonstruese për mësuesin, mjete shkrimi etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuha dhe komunikimi, artet.	
Metodologjia e veprimtaria e të nxënit: vëzhgim-demonstrim, shkëmbe dyshe, punë në dyshe, punë e pavarur, të nxënit në bashkëpunim.			
Zhvillimi i mësimit:			
Faza e parë: Hulumto/Punë në dyshe			
Ndahet klasa në grupe me dy veta. Mësuesi/ja ndan fisha me veprimet me numrat. $398 + 426 =$ , $886 - 28 =$ , $364 \times 10 =$ , $830:10 =$ . Nxënësit punojnë të pavarur në plotësimin e detyrës. Secili grup shpjegon mënyrën e kryerjes së veprimit.			
Faza e dytë: Të punuarit në bashkëpunim			
Mësuesi/ja shkruan shembujt në tabelë $57 + 28 =$ , $557 + 128 =$ , $4357 + 2128 =$ , etj., dhe shtron pyetjen: Çfarë strategjie (rrugë, mënyrë) do të përdorim për të kryer me mend së më shpejt veprimet? Kujtohet nga klasa e katër vetia e pandryshueshmërisë së mbledhjes dhe zbritjes dhe veti të tjera			
Shuma nuk ndryshon, në qoftë se një mbledhor zmadhohet, kurse mbledhori tjetër zvogëlohet me numrin. $(57 + 3) + (28 - 3) = 60 + 25 = 85$ , $(557 + 3) + (128 + 3) = 560 + 125 = 500 + 60 + 100 + 25 = (500 + 100) + (60 + 25) = 685$ etj.			
Ndryshesa nuk ndryshon, në qoftë se i zbritshmi dhe zbritësi zmadhohen me të njëjtin numër, ose në qoftë se i zbritshmi dhe zbritësi zvogëlohen me të njëjtin numër.			

$178 - 46 = (178 + 2) - (46 + 2) = 180 - 48 = 180 - 40 - 8 = 140 - 8 = 32$  etj.

Vetia e përdasisë të shumëzimit në lidhje me mbledhjen.  $1324 \times 5 = (1000 + 300 + 20 + 4) \times 5 = 1000 \times 5 + 300 \times 5 + 20 \times 5 + 4 \times 5 = 5000 + 1500 + 100 + 20 = 6620$  etj.

Shumëzimi dhe pjesëtimi me 10, 100, 1000... dhe zhvillohen shembujt në tabelë.

Nxënësit praktikohen me shembuj të tjerë për të kryer veprimet me mend. Nxënësit orientohen të vëzhgojnë në libër.

### **Faza e tretë: Punë e pavarur. Shkëmbe në dyshe**

Nxënësit kryejnë në libër veprimet duke përdorur strategjitë e tyre. Nxënësit shkëmbejnë librat dhe njihen me mënyrën e përdorur nga shoku.

### **Faza e katërt: Krijo. Pyet shokun**

Nxiten nxënësit që të vetë krijojnë shembuj të ndryshëm duke përdorur strategji të ndryshme të veprimeve me mend. Nxënësit nxiten që të punojnë dyshe duke pyetur njëri-tjetrin për të kryer veprime të ndryshme me mend.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- gjetjen e strategjive të ndryshme;
- shpejtësinë dhe saktësinë e veprimeve me mend;
- bashkëpunimin në grup;
- aftësitë krijuese dhe improvizuese.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit u jepet detyrë të përsërisin sa më shumë shembuj për të kryer veprimet me mend sipas strategjive të ndryshme.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta me mend		<b>Tematika: Strategjitë e veprimeve</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Çiftet e numrave			
<b>Situata e të nxënit:</b> Veprimtari hulumtuese dhe kryerjen e mbledhjes dhe zbritjes te çifteve të numrave dhjetorë numrave dhjetorë duke plotësuar 1. Zbatimi në problema.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Zbulon si të plotësojë të dhjetat në një numri me presje për ta bërë numrin të plotë (pa presje) duke gjetur çifte numrash dhjetorë me shumë 1. - Kryen veprimet në boshtin numerik për të plotësuar njësinë. - Bën kthimin nga numër dhjetor në thyesë dhjetore. - Zbaton këto shprehje në situata problemore dhe problema të ndryshme.			
<b>Fjalët kyçe:</b> çift numrash, numër dhjetor, pjesa e plotë e numrit, numri i plotë, të dhjetat e numrit dhjetor, thyesë dhjetore, bosht numerik, situatë problemore.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Teksti mësimor, etiketa të ndryshme, tabelë demonstruese e mësuesit, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> dituri natyre, gjuha komunikimi.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> vëzhgim-demonstrim, diskutim, punë krijuese, punë në dyshe			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>			
<b>Faza e parë: Hulumto zbul</b> Nxënësve iu shpërndahen fisha ku janë paraqitur numra dhjetorë me një shifër pas presjes. 0,7; 0,5; 0,2; 0,1; 0,9; 0,6; 0,3 etj., dhe kërkohet që të qarkojnë çifte numrash shuma e të cilëve është 1. Kontroll i punës së pavarur të nxënësve.			
<b>Faza e dytë: Punë e drejtuar</b> Mësuesi/ja paraqet para nxënësve tabelën e parapërgatitur ose të shkruar në dërrasë me shembuj të ndryshëm, ku paraqiten barazimet $0,7 + ? = 1$ ; $0,4 + ? = 1$ etj. Përballë secilit barazim shkruhen barazimet me thyesat dhjetore përkatëse, $7/10 + ? = 10/10$ ; $4/10 + ? = 10/10$ etj., dhe përballë barazimeve boshte numerike të vizatuar, në të cilët vendosen numrat dhjetorë dhe bëhet interpretimi i veprimeve në boshtin numerik për të plotësuar njësinë dhe numrin e plotë. Nxënësve i kërkohet të gjejnë me mend $24,2 + ? = 25$ ; $47,3 + ? = 48$ , $? + 0,8 = 50$ etj., si dhe situata të thjeshta problemore, ku të përdorin si këto barazime.			

**Faza e tretë: Të punuarit në bashkëpunim. Punë krijuese**

Nxiten dhe orientohen nxënësit të krijojnë vetë ushtrime dhe probleme të thjeshta nga jeta e përditshme, me matjen e gjatësive, masave të trupave, me mbledhje të numrave dhjetorë çiftet e të cilëve kanë si shumë njësinë dhe të japin vetë përgjigjen ose kërkojnë nga klasa të jepet përgjigja.

**Faza e katërt: Punë e pavarur**

Nxënësit orientohen të vëzhgojnë dhe plotësojnë librin, lidhjen e çifteve të numrave që plotësojnë 1 si dhe problemat e ndryshme ku zbatohen njohuritë e mësipërme.

Bëhet kontroll i punës së nxënësve në libër, si dhe bëhet korrigjimi kolektiv i zgjidhjes së problemave.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- saktësinë e veprimeve në gjetjen e çifteve shuma e të cilëve formon numrin e plotë;
- saktësinë e konvertimit në thyesa dhjetore në numra dhjetorë;
- interpretimin në boshtin numerik;
- aftësinë krijuese të situatave problemore;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Punohet fletorja e punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data:
Koha e zgjatjes: 45 minuta		Tematika: Strategjitë e veprimeve me mend	
Ora 2			
Tema mësimore: Çiftet e numrave			
Situata e të nxënit: Veprimtari eksploruese për kryerjen e mbledhjes dhe zbritjes te numrave dhjetorë me një shifër pas presjes duke plotësuar numrin e plotë. Zbatimi në problema.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës: - Të eksplorojë mbledhjen e çifteve të numrave dhjetorë me një shifër pas presjes, shumën e të cilëve të jetë numër i plotë. - Të shkathtësohen në veprimet me mend. - Të zbatojë këto shprehje në problema të ndryshme. - Të aftësohen në punë krijuese në krijimin e situatave problemore dhe në zgjidhjen e tyre.			
Fjalët kyçe: numër dhjetor, çift numrash, pjesa e plotë e numrit, numri i plotë, të dhjetat e numrit dhjetor, thyesë dhjetore, situatë problemore.			
Burimet, mjetet: Teksti mësimor, etiketa të ndryshme, tabelë demonstruese e mësuesit, mjete shkrimi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: gjuha komunikimi, Dituria e Natyrës.	
Metodologjia e veprimtaria e të nxënit: vëzhgim-demonstrim, diskutim, eksplorim, punë krijuese			
Zhvillimi i mësimi:			
Faza e parë: Hulumto, zbulo Shpërndaj te nxënësit fisha me numra dhjetorë dhe nxënësit qarkojnë çiftet e numrave të cilët japin numër të plotë: 2,7; 3,2; 5,8; 4,3; 2,6; 11, 1; 5,4; 2,9 etj. Kontroll i punës së nxënësve.			
Faza e dytë: Punë e drejtuar Paraqit në dërrasë tabelën e përgatitur ose shkruhet dhe vizatohet në dërrasën e zezë paraprakisht, në të cilën janë shkruar barazime me numra dhjetore, përballë tyre konvertimi në thyesa dhjetore, dhe me bosht numerik të vizatuar. 2,3 + ? = 7    23/10 + ? = 70/10, vizatim dhe interpretim në boshtin numerik. 7,2 + ? = 10    72/10 + ? = 100/10, vizatim dhe interpretim në boshtin numerik etj. Shkruhen në dërrasë numra dhjetorë në dy shtylla dhe kërkohet nga nxënësit të vendosin lidhjen e çifteve që japin numra të plotë.			

Bëj ushtrime ku u jepen nxënësve numra me presje me një shifër dhjetore dhe të gjejnë numrin përkatës shuma e të cilëve është sa numri plotë i dhënë. P.sh.: Cili është numri që potë mblidhet me 3,7 shuma të dalë 8 etj.

Jepen situata të thjeshtë problemore nga praktika me gjatësi, rrugë, masa, vëllime etj. P.sh.:

Shitësja vendosi në peshore 7,8 kg mollë. Sa kg duhet të shtojë që të bëhen 9 kg?

Një çiklist eci 3,4 km. Qyteti ishte 8 km. Dhe sa km i mbetën për të mbërritur në qytet? Etj.

### **Faza e tretë: Të punuarit në bashkëpunim. Punë krijuese**

Nxënësit orientohen të krijojnë vetë ushtrime dhe disa situata problemore nga praktika dhe klasa të japë përgjigje.

### **Faza e katërt: Punë e pavarur**

Orientohen nxënësit të punojnë të pavarur në libër ushtrimin për të lidhur numrat dhjetorë në të majtë me numrat dhjetorë në të djathtë në çifte, shuma e të cilëve është 10.

Orientohen nxënësit që të zgjidhin problemat 1-2, ku të përdorin rezultatet e tabelës së plotësuar me çiftet e numrave. Bëhet kontrolli i punës së nxënësve.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- saktësinë e veprimeve në gjetjen e çifteve shuma e të cilëve formon numrin e plotë;
- saktësinë e konvertimit në thyesa dhjetore në numra dhjetorë;
- interpretimi në boshtin numerik;
- saktësinë dhe shpejtësinë e veprimeve me mend;
- aftësinë krijuese të situatave problemore;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Jepen problemat 3, 4 në libër, si dhe nxënësit të krijojnë dhe zgjidhin dy problema të ngjashme me to.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta <b>me mend</b>		<b>Tematika:</b> Strategjitë e veprimeve	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Fakte të shumëzimit dhe të pjesëtimit			
<b>Situata e të nxënit:</b> Veprimtari konkrete për faktet e shumëzimit dhe pjesëtimit, veprimet me mend të fakteve të shumëzimit dhe pjesëtimit.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Përsërit fakteve të shumëzimit dhe pjesëtimit. - Përsërit konceptet herë më shumë/herë më pak dhe i zbaton ato në problema. - Dallon konceptet herë më shumë/herë më pak, nga më shumë/më pak. - Shkathtësohet në faktet e shumëzimit dhe pjesëtimit si dhe në shumëzimin dhe pjesëtimin e numrave.			
<b>Fjalët kyçe:</b> fakte të shumëzimit dhe pjesëtimit, herë më shumë, herë më pak, më shumë, më pak, faktor, prodhim, pjesëtues, i pjesëtueshëm, herës.			
<b>Burimet, mjetet:</b> teksti mësimor, etiketa me fakte shumëzimi dhe pjesëtimi, mjete shkrimi		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgim-demonstrim, punë në dyshe, punë krijuese në situata problemore.			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  <b>Faza e parë: Zbulim-hulumtim</b> Pyeten nxënësit me gojë për faktet e shumëzimit dhe pjesëtimit dhe evidentohen pasiguritë si dhe shpejtësia e përgjigjeve. Nxënësit ndahen në dyshe dhe ju shpërndahen etiketa me 20 fakte të ndryshme shumëzimi dhe pjesëtimi. Një nxënës shkruan përgjigjen në etiketë tjetri mat kohën (nxënësit përdorin mjetet personale elektronike për matjen e kohës, celularë, ora elektronike etj.). Bëhet konkluzioni i veprimeve të nxënësve duke evidentuar shpejtësinë e kryerjes së tyre.  <b>Faza e dytë: Punë e drejtuar. Punë krijuese</b> Shkruhen ushtrime në tabelë me shumëzime dhe pjesëtime të numrave dyshifrore me numra një shifrorë si p.sh.: $20 \times 6 =$ , $50 \times 7 =$ , $150 : 3 =$ , $180 : 6 =$ etj. Evidentohet shumëzimi dhe pjesëtimi me 0. $7 \times 0 = 0$ , $125 \times 0 = 0$ , $0 \times 36 = 0$ (nëse një faktor është zero prodhimi është zero) $0 : 7 = 0$ , $0 : 38 = 0$ , $9 : 0 = ?$ nuk mundet, $48 : 0 = ?$ nuk mundet (kur pjesëtuesi është zero, pjesëtimi është i pamundur) Evidentohet vetia e ndërrimit të shumëzimit në faktet e shumëzimit $7 \times 9 = 9 \times 7 = 63$ , $60 \times 5 = 5 \times 60 = 300$ etj.			



Bëhen shumëzime dhe pjesëtime të ndryshme të numrave dyshifrorë me numrat një shifrorë me mend duke pyetur nxënës të ndryshëm.

Bëhen ushtrime dhe situata problemore duke përdorur “herë më shumë” dhe “herë më pak” si dhe shembuj me “më shumë” dhe “më pak”, duke evidentuar ndryshimin e veprimit të shumëzimit dhe pjesëtimit me veprimin e mbledhjes dhe zbritjes.

Iu kërkohet dhe orientohen nxënësit të krijojnë pyetje problemore dhe problema duke përdorur konceptet “herë më shumë” dhe “herë më pak” dhe nxënësit e tjerë të japin përgjigjen.

### **Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur në dyshe ushtrimin e parë në libër me fakte të shumëzimit dhe pjesëtimit si dhe, duke krijuar vetë me shkrim fakte të tjera, bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, ku njëri zgjidh me shkrim faktet tjetri të mat kohën. Më pas ndërrojnë rolet. Nxënësit zgjidhin problemat 1-6. Kontroll i punës së pavarur.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- shpejtësinë dhe saktësinë e zgjidhjes së fakteve të shumëzimit dhe pjesëtimit;
- aftësinë krijuese në problema dhe zgjidhjen e tyre;
- në dallimin e koncepteve “herë më shumë” dhe “herë më pak” me konceptet “më shumë” dhe “më pak”;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit të përsërisin faktet e shumëzimit dhe pjesëtimit. Të krijojnë dhe të zgjidhin problema me konceptet “herë më shumë” dhe “herë më pak”.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta <b>me mend</b>		<b>Tematika: Strategjitë e veprimeve</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Fakte të shumëzimit dhe të pjesëtimit			
<b>Situata e të nxënit:</b> Veprimtari eksploruese për pjesëtimin me mend të numrave me 2, 5, 10, 100.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Përsërit faktet e shumëzimit dhe pjesëtimit. - Formon numra të ndryshëm 2, 3, 4-shifrorë dhe bën dallimin se cili pjesëtohet me 2, 3, 4, 5, 10, 100 etj. - Pjesëton numrat dyshifror, treshifror etj., me 2, 3, 4, 5, 10, 100 etj.			
<b>Fjalët kyçe:</b> pjesëtim, fakte të shumëzimit dhe pjesëtimit, i pjesëtueshëm, pjesëtues, herës, rezultat, plotpjesëtim.			
<b>Burimet, mjetet:</b> teksti mësimor, letra (etiketa me shifra 0-9), për çdo nxënës, mjete shkrimi		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha e komunikimi, arte	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> lojë mësimore, punë dyshe, konkurs mësimor			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <b>Faza e parë: Lojë mësimore. Konkurs mësimor</b> Ndaj klasën në dy grupe dhe në tavolinë kam vendosur letrat (50 etiketa me shifrat nga 0-9). Në tabelë bëj një tabelë me ndarje për çdo grup A dhe B ose grupeve iu vendoset nga një emër) dhe për çdo grup me dy ndarje për numrat e formuar dhe pikët për çdo numër të formuar nga nxënësit. Nëse numri i formuar plotpjesëtohet me 2 (kur mbaron me 0 ose numër çift) -1 pikë, nëse plotpjesëtohet me 5 (kur mbaron me 0, 5) -2 pikë, kur plotpjesëtohet 10-3 pikë, me 100 -4 pikë etj. Nxënësit ngrihen nga një për çdo grup dhe formojnë numra të ndryshëm, të cilët shënohen në tabelë së bashku me pikët përkatëse. Bëhet rezultati i pikëve të fituesit.  <b>Faza e dytë: Punë e drejtuar</b> Mësuesi/ja paraqet para nxënësve numra të ndryshëm 1, 2, 3 shifrorë dhe kërkon nga nxënësit që të bëjnë pjesëtimin e tyre me mend duke evidentuar rregullin kur plotpjesëtohet me 2, 5, 10, 100 etj. Jepen shembuj edhe me pjesëtimin me numrin 1 dhe 0 duke theksuar se një numër pjesëtues me një jep vetë numrin, dhe pjesëtimi me 0 nuk është i mundur, nuk ka kuptim. Pjesëtimi i numrit 0 me çdo numër jep si herës numrin 0.			

**Faza e tretë: Punë e pavarur. Puno dyshe**

Nxënësit hapin librat dhe punojnë dyshe duke formuar numra të ndryshëm dhe duke plotësuar tabelën me numrat e formuar dhe pikët e fituara. Nxënësit punojnë të pavarur në dyshe dhe në fund nxënësit bëjnë bëhet llogaritja e pikëve të grumbulluara.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- shpejtësinë e veprimeve;
- saktësinë e veprimeve të pjesëtimit dhe shumëzimit;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit shkruajnë në fletore numra 3, 4, 5-shifrorë, të cilët të plotpjesëtohen me 2, 3, 5, 9, 10, 100.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta <b>me mend</b>		<b>Tematika: Strategjitë e të mësuarit</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Vetitë e numrave			
<b>Situata e të nxënit:</b> Veprimtari për të gjetur me mend shumëfishat dhe faktorët e numrave tek dhe çift.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Dallon cili është shumëfish i një numri. - Dallon cili është faktor i një numri. - Gjen shumëfishat dhe faktorët të numrave tek dhe çift. - Gjen numrat që janë njëkohësisht shumëfisha dhe faktorë të numrave tek ose numrave çift. - Gjen shumëfisha dhe faktorë të numrit që plotësojnë një kusht të caktuar.			
<b>Fjalët kyçe:</b> shumëfish i numri, faktor i numrit, numër çift, numër tek			
<b>Burimet, mjetet:</b> Teksti mësimor, etiketa me numra të ndryshëm një shifrorë dhe dy shifrorë, mjete shkrimi		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimi, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> punë e drejtuar, punë në dyshe, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  <b>Faza e parë:</b> <b>Punë e drejtuar. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Kërkohet nga dy nxënësi të përsëritin vargun e numrave tek dhe numrave çift. Si të dallojnë numrat tek dhe çift, numrat që plotpjesëtohen dhe që nuk plotpjesëtohen me 2, që mbarojnë ose jo me shifër tek ose çift. Theksoj se numri 0 nuk është as tek as çift. Pyeten nxënësit se si i gjejnë shumëfishat e një numri dhe shkruaj në tabelë vargje të shumëfishave të numrave të ndryshëm. Shumëfisha të numrit 6: 6, 12, 18, 24, 30, .....etj. Pyeten nxënësit si cili quhet faktor i një numri, çdo numër që plotpjesëton numrin e dhënë, i gjejnë faktorët e një numri. Theksojmë se numri 1 është faktor i çdo numri pasi plotpjesëton çdo numër etj. I drejtohen nxënësve disa ushtrime me gojë për të gjetur shumëfishat e një numri, shumëfisha dhe faktorë që të gëzojnë njëkohësisht vetinë e numrit tek ose çift, më të mëdhenj ose më të vegjël se një numër etj. Në tabelën e vizatuar në tabelë në të cilën janë vendosur në shtyllë: numër çift, numër tek, shumëfish i numrit 8, faktor i 160 dhe në rresht: shumëfish i 3, faktor i 16, shumëfish i 3, faktor i 24. Nxënësit ftohen një nga një të zgjedhin etiketat e parapërgatitura dhe të shkruajnë numrat në vendin e duhur në tabelë. Vazhdohet deri sa tabela të plotësohet.			

Nxënësve ju drejtohen pyetje të kombinuara p.sh. Kam ndërmend një numër i cili është numër çift, shumëfish i numrit 5, më i madh se 20 dhe më i vogël se 40. Cilin numër kam menduar etj.

**Faze dytë: Punë në dyshe**

Nxënësit hapin librat dhe punojnë në dyshe për të plotësuar në libër tabelën në faqen 44. Bëhet kontrolli dhe konkluzionet e punës së nxënësve.

**Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 29. Pas i përsëritet edhe njëherë se si i gjejmë shumëfishat dhe faktorët, duke përdorur tabelën e shumëzimit dhe pjesëtimit nxënësit plotësojnë fletoren e punës. Bëhet kontrolli i punës së nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- shpejtësinë e veprimeve me mend për të gjetur shumëfisha dhe faktorë të numrit;
- saktësinë e veprimeve;
- përgjigjen e pyetjeve të kombinuara;
- bashkëpunimin në grup.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Nxënësit të plotësojnë në shtëpi një tabelë të përgatitur nga mësuesi/ja paraqitur në tabelë, të ngjashme me tabelën në libër faqe 44.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta <b>me mend</b>		<b>Tematika: Strategjitë e veprimeve</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Vetitë e numrave			
<b>Situata e të nxënit:</b> Eksplorim dhe gjetje të vetive të diferencës së katrorit të numrave.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Gjen katrorin e një numri. - Dallon numrat katrorë deri në 100. - Eksploron me anë të shembujve diferencën e katrori të dy numrave, me ndryshesë 1, 2, 3, 4... etj. - Gjen dhe rregullin e diferencës të katrorit të numrave.			
<b>Fjalët kyçe:</b> në fuqi të dytë, katror i numrit, diferencë, ndryshesë, rregull, veti.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Tekst mësimor, mjete shkrimi		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> demonstrim, eksplorim, punë e pavarur			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  <b>Faza e parë:</b> <b>Njohuri të reja. Të punuarit në bashkëpunim</b> Me nxënësit bëhet një bisedë paraprake ku të theksohet se, numrat kanë shumë veti interesante, dhe mund të themi se ne jetojmë në një “botë magjike” të numrave. Matematika është një lëndë shumë bukur, por më e bukur dhe interesante është aritmetika dhe bota e numrave. “Matematika është mbretëresha e shkencave, kurse aritmetika është mbretëresha e matematikës”. Në mësimin e sotëm do të bëjmë disa veti të numrave në fuqi të dytë ose të ngritur në katror... Iu shpjegohet nxënësve kuptimin e ngritjes në fuqi të dytë ose në katror (pa synuar që të jepet kuptimi i fuqisë si veprim, pasi kjo do të bëhet në klasat më të larta) si prodhim të numrit me vetveten, $2^2 = 2,2$ , $3^2 = 3,3$ , $5^2 = 5,5$ etj. Numër katror quhet numri që shkruhet si prodhim i dy numrave të njëjtë. Iu kërkohet nxënësve të gjejnë në tabelën e shumëzimit, të gjithë numrat katrorë 1, 4, 9, 16, 25, 36, 49, 64, 81, 100. Bëj ushtrime të thjeshta me gojë për të gjetur numrat katrorë.			
<b>Faza e dytë:</b> <b>Punë e drejtuar</b> Shkruhen në tabelë barazime me diferencë të katrorit të numrave të njëpasnjëshëm, me ndryshesë 2, 3 etj. Theksojmë se bëhet në fillim veprimi me katrorin e numrave dhe më pas diferenca e tyre $2^2-1^2=4-1=3$ , $3^2-2^2=9-4=5$ , $4^2-3^2=16-9=7$ , ..... dhe $3^2-1^2=9-1=8$ , $4^2-2^2=16-4=12$ , $5^2-3^2=25-9=16$ , .....			

Ou drejtohet nxënësve të shikojnë se çfarë venë re nga këto barazime. Nxënësit eksplorojnë nëse ka ndonjë rregull. Rregulli është: *nëse diferenca e dy numrave është një, diferenca e katrorëve është sa shuma e numrave, nëse diferenca e numrave është 2, diferenca e katrorëve është sa dyfishi i shumës së numrave, nëse diferenca e numrave është 3, diferenca e katrorëve të tyre është sa trefishi i shumës së tyre, e kështu me radhë.* Nëse nxënësit nuk zbulojnë rregullin, mësuesi/ja u jep kohë dhe i ndihmon që ata ta zbulojnë. Në fund, mësuesi/ja formulon rregullin. Në mësimet dhe klasa të tjera do të bëhen veti të tjera interesante të numrave.

### **Faza e tretë**

#### **Punë e pavarur**

Nxënësit hapin librat dhe bëjnë plotësimin e barazimeve. Nxënësit përshkruajnë rregullin në të tria rastet.

#### **Vlerësimi**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- saktësinë dhe shpejtësinë e veprimeve;
- logjikën në eksplorimin e vetisë dhe zbulimin e rregullës;
- saktësinë në shkrimin e rregullës së zbuluar;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit plotësojnë në fletore vazhdimin e barazimeve me ndryshesë, 4, 5, 6, 7... të numrave dhe të shkruajnë rregullin përkatës. Nxënësve iu sugjerohet të gjejnë rregulla të tjera të numrave nga interneti ose libra jashtëshkollorë etj.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta me mend		<b>Tematika: Strategjitë e veprimeve</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Llogaritja e shumave dhe ndryshesave			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situatë konkrete të veprime me mend të mbledhjes dhe zbritjes.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kryen mbledhje dhe zbritje me mend me numra treshifrorë, duke përdorur metodën e zbërthimit të numrave sipas vend vlerës së tyre. - Bën vlerësimin e strategjisë së ndjekur për të bërë mbledhjen dhe zbritjen e numrave treshifrorë me mend.			
<b>Fjalët kyçe:</b> shumë, ndryshesë, diferencë, vend vlerë e shifrave, zbërthim.			
<b>Burimet, mjetet:</b> komplet letra me shifra, fletë, gërshërë, libri i nxënësit dhe fletorja e punës.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, artet.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Bisedë, stuhi mendimesh, punë e pavarur			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  <b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Mësuesi/ja shkruan në tabelë: $536 + 358 =$ , $537 - 358 =$ . Si do të kryejmë më shpejt mbledhjen dhe zbritjen. Mësuesi/ja orienton nxënësit për të ndarë me mend numrin e dytë ose të zbritshmin në qindëshe, dhjetëshe, njëshe. $536 + 358 = 536 + 300 + 50 + 8 = 836 + 50 + 8 = 886 + 8 = 894$ dhe $536 - 358 = 536 - 300 - 50 - 8 = 236 - 50 - 8 = 186 - 8 = 178$ . Mësuesi/ja përsërit në tabelë disa shembuj sipas kësaj mënyre dhe pyet nxënësit nëse kjo strategji është e dobishme për të kryer veprimet e mbledhjes dhe zbritjen me mend. Mësuesi/ja bën ushtrime me gojë për mbledhjen dhe zbritjen e numrave treshifrorë.			
<b>Fazë e dytë: Punë në dyshe. Punë e pavarur</b> Nxënësit hapin libra dhe plotësojnë tabelën faqen 46, duke kryer me radhe veprimet duke mbledhur/zbritur, qindëshet, dhjetëshet, njëshet. Nxënësit japin mendimin e tyre për strategjinë e mbledhjes dhe zbritjes me mënyrën e ndarjes sipas vend vlerave të shifrave. Nxënësit shpjegojnë pse është/nuk është e dobishme kjo strategji.			
<b>Faza e tretë: Punë e pavarur</b> Nxënësit punojnë faqen 30 të fletores së punës. Duke përdorur komplet letrash me shifra personale, formojnë numra 4 shifrorë dhe duke dhe bëjnë mbledhjen dhe zbritjen e tyre me mënyrën e ndarjes sipas vend vlerave të shifrave për mbledhurin dhe të zbritshmin.			



**Faza e katërt: Punë e drejtpërdrejtë**

Mësuesi/ja përsërit disa shembuj për kryerjen e veprimeve me mend duke kërkuar që nxënësit të gjejnë shpejt shumën dhe ndryshesën.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- shpejtësinë dhe saktësinë e veprimeve me mend;
- bashkëpunimin dhe mendimin e pavarur për dobinë e strategjisë së ndjekur.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit shkruajnë në fletore dhjetë numra 4, 5-shifrorë dhe kryejnë 5 veprimet për mbledhjen dhe zbritjen e tyre me mënyrën e ndarjes sipas modelit në fletoren e punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Strategjitë e veprimeve me mend</b>	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Llogaritja e shumave dhe ndryshesave			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situata konkrete për veprimet me mend të mbledhjes dhe zbritjes.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kryen me mend dhe gjen shumën dhe ndryshesën e numrave 4-5 shifrorë me mënyrën e ndarjes të mbledhorit ose të të zbritshmit sipas vend velave të shifrave. - Krijon problema dhe zgjidh ato duke përdorur veprimet e mbledhjes dhe zbritjes të numra 4-5 shifrorë.			
<b>Fjalët kyçe:</b> vendvlera, ndarje sipas vendvlerave, shumë, ndryshesë, situatë problemore, strategji e veprimit me mend.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Teksti i nxënësit, komplet letrash me shifra.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha komunikimi, dituri e natyrës, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> bisedë, punë krijuese problemore, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Mësuesi/ja shkruan në tabelë dy numra 4-shifrorë dhe shkruan veprimet e mbledhjes dhe zbritjen duke bërë ndarjen e mbledhorit të dytë dhe të zbritshmit sipas vend vlerave të shifrave. $3568 + 2517 = 3568 + 2000 + 500 + 10 + 70 = 5568 + 500 + 10 + 7 = 6068 + 10 + 7 = 6078 + 7 = 6085$ . Dhe $3568 - 2517 = 3568 - 2000 - 500 - 10 - 7 = 1568 - 500 - 10 - 7 = 1068 - 10 - 7 = 1058 - 7 = 1051$ Mësuesi/ja kërkon direkt nga klasa të kryejnë disa veprime me mend me mbledhjen dhe zbritjen e numrave 4-shifrorë. Mësuesi/ja shkruan në tabelë 2 çifte numrash me mbledhje dhe zbritje dhe kërkon nga nxënësit të krijojnë me mend problema të thjeshtë me mbledhje dhe zbritje dhe të japin zgjidhjen e tyre. Nxënësit mund të punojnë në dyshe, njëri të krijojë problemën, tjetri të japë zgjidhjen dhe përgjigjen me mend.			
<b>Faza e dytë: Punë e pavarur</b> Nxënësit hapin librat dhe punojnë faqen 47. Nxënësit formojnë me kompletin e letrave numra katërshifrorë dhe krijojnë, shkruajnë në tabelë problema me mbledhje dhe zbritje dhe zgjidhjen e tyre. Kontroll i punës së nxënësve. Duke pyetur disa të lexojnë problemat e krijuara dhe zgjidhjen e tyre.			

**Faza e tretë: Punë e drejtuar**

Bëhen ushtrime me gojë për mbledhje dhe zbritje. Mësuesi/ja krijon vetë situata problemore me mbledhje e zbritje të numrave 4-5 shifrorë dhe nxënësit nxiten që të kryejnë shpejt veprimet dhe zgjidhjen e problemave.

**Vlerësimi:****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- shpejtësinë dhe saktësinë e veprimeve me mend;
- aftësinë krijuese problemore;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit krijojnë problema me mbledhje dhe me zbritje dhe i zgjidhin ato në fletore.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Ora 1</b>			
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Strategjitë e veprimeve me mend</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Shumëfishat më të afërt			
<b>Situata e të nxënit:</b> Zbulim dhe eksplorim për veprimet e mbledhjes dhe zbritjes me shumëfishat më të afërt.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Mbledh me mend numrat duke përdorur shumëfisha më të afërt të 10, 100. - Zgjidh problema duke përdorur shumëfishat më të afërt të 10,100. - Krijon problema dhe i zgjidh ato me mend duke përdorur mbledhjen dhe zbritjen e shumëfishave më të afërt.			
<b>Fjalët kyçe:</b> shumëfish më i afërt, metodë e shumëfishave, ndryshesa, i zbritshmi, zbritësi shuma.			
<b>Burimet, mjetet:</b> teksti i nxënësit, foto fletë të ndryshme për krijim problemash, gërshërë, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Shpjegim, Diskutim, Demonstrim, Punë e pavarur			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Mësuesi/ja shkruan në tabelë 5-6 numra dyshifrorë që të mbarojnë me shifrat 1 ose 2. P.sh. 31, 52, 71, 82 etj. Secilin prej këtyre numrave duhet ta mbledhim me mend numrin 237 ose t'i zbresim këtij numri numrat e dhënë. Mësuesi/ja pyet nxënësit si do të gjemë me mend këto shuma dhe ndryshesa. Mësuesi/ja demonstroi në tabelë një shembull me shumë dhe ndryshesë duke gjetur shumëfishin më të afërt të dhjetë të mbledhorit dhe zbritësit. $237 + 31 = 237 + 30 + 1 = 267 + 1 = 268$ , $237 - 31 = 237 - 30 - 1 = 207 - 1 = 206$ etj., si dhe duke përdorur shumëfishin më të afërt të 100. $4357 + 298 = 4357 + 300 - 2 = 4657 - 2 = 4655$ dhe $4357 - 298 = 4357 - 300 + 2 = 4057 + 2 = 4059$ . Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të zgjidhin një situatë problemore të krijuar nga ai/ajo ose nga nxënësit, ku të përdoret mbledhja dhe zbritja me shumëfishë të përafërt. Zgjidhjen e shkruan në tabelë dhe shpjegon mënyrën e kryerjes shpejt të veprimeve.			
Mësuesi/ja shkruan në dërrasë 2 shembuj duke përdorur mbledhjen dhe zbritjen në shumëfishin më të afërt të 100, 1000 etj. P.sh.: $3005 - 1997 = 3005 - 2000 + 3 = 1005 + 3 = 1008$ , $6006 + 3697 = 6000 + 3697 + 6 = 9397 + 6 = 9403$ etj.			
Mësuesi/ja jep drejtpërdrejt ushtrime me mbledhje dhe zbritje dhe nxënësit gjejnë shumën dhe ndryshesën me mend. Mësuesi/ja demonstroi 2-3 foto para klasës dhe nxënësit krijojnë problema dhe i zgjidhin me mend duke përdorur strategjinë e shumëfishave më të afërt.			

**Faza e dytë: Punë e pavarur**

Nxënësit hapin librat dhe plotësojnë 48-49. Nxënësit shpjegojnë se si e kryen verimin, çfarë bënë në fillim dhe më pas dhe i shkruajnë në libër hapat. Orientohen nxënësit të zgjidhin problemat duke përdorur strategjinë e shumëfishit më të afërt. Në libër nxënësit shkruajnë si e gjetën përgjigjen e problemit. Nxënësit mund të përdorin edhe strategji të tjera, por mësuesi/ja i nxit të kryejnë veprimet duke përdorur shumëfishin më të afërt. Kontroll i punës së nxënësve.

**Faza e tretë: Punë krijuese problemore drejtpërdrejt**

Mësuesi/ja paraqet para klasës 2-3 foto të printuara, në të cilat të ketë edhe shifra të ndryshme, çmimesh, gjatësi, masa dhe kërkon nga nxënësit të krijojnë problema dhe të bëjnë zgjidhjen e tyre me mend, drejtpërdrejt, duke përdorur strategjinë e shumëfishave më të afërt.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- aftësinë dhe shkathtësinë ë zbulimit të strategjisë të mbledhjes dhe zbritjes;
- shpejtësinë e zgjidhjes së problemave me mend;
- aftësinë krijuese dhe zgjidhjes të problemave.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Faqe 50 e librit dhe fletorja e punës në faqen 31.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes : 45 min Tematika : Numri</b>			
<b>Tema mësimore : Përsëritje njohurish njohurish</b>			
<b>Situata e të nxënit:</b>  <b>Thellon njohuritë në krijimin e situatave me katër veprimet matematikore dhe krijim barazimesh me to.</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b>  - Plotëson vargjet numerike, ku përdoren të 4-t veprimet matematikore. - Gjen prodhimin e numrave në rresht dhe në shtyllë. - Gjen herësin dhe mbetjen në një pjesëtim të dhënë - Zgjidh problemën me veprimin e shumëzimit dhe pjesëtimit.			
<b>Fjalët kyçe : Pjesëtim, i pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi, ndarje në pjesë të barabarta.</b>			
<b>Burimet, mjetet:</b> fletë A4, fisha me shifra, fletë pune të përgatitur nga mësuesja.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b>  <b>Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin. Krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).</b>			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>  a) Nxënësit kanë etiketa me shifra në tavolinë dhe mësuesja u kërkon që të formojnë numra 4-5-shifrorë. Nxënësit në çifte do t'i emërtojnë sipas klasave, si numëror i rregullt, krahasojnë, mbledhin, zbresin dhe rrumbullakojnë në formën e një loje.  b) Mësuesja kërkon që nxënësit në grupe të krijojnë situata të ndryshme problemore me këto llogaritje $2/9$ e $36 = 8 \quad 3/6$ e $36 = 18$  c) Mësuesja kërkon nga nxënësit që të grupojnë të gjitha njohuritë që kanë mësuar për këtë periudhë në një fletë A4. Lexohen nga një pjesëtar grupi mendimet e tyre.  <b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim. Punë në çifte.</b>  Mësuesja ndan klasën në grupe dhe secilit grup i jep nga një fishë me ushtrime e situata problemore.			

**Grupi 1** - Shkruaj me numrat: 2, 8, 9, 4 numrin më të madh e më të vogël.

**Grupi 2** - Nxënësit shkruajnë me shifra numrat e dhënë me fjalë.

**Grupi 3** - Nxënësit tregojnë vlerën e shifrave të vijëzuara.

**Grupi 4** - Nxënësve u kërkohet që të emërtojnë numra që rrumbullakohen në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt.

**Grupi 5** - Formulon vetitë e mbledhjes së numrave duke u ndihmuar nga tabela e mbledhjes. Zbaton vetitë e mbledhjes së numrave në ushtrime.

**Grupi 6** - Zgjidhja e një situatë problemore. Prezantohet detyra e përfunduar para klasës dhe diskutimet përfshijnë gjithë klasën.

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Nxënësit punojnë të pavarur ushtrimet e përgatitura nga mësuesja në fletore. Kjo veprimtari kryhet individualisht. Në përfundim të detyrës nxënësit lexojnë plotësimet e bëra dhe diskutojnë rreth tyre.

**Vlerësimi: Mësuesi vlerëson nxënësit për:**

- Plotëson vargjet numerike, ku përdoren të 4-t veprimet matematikore.
- Gjen prodhimin e numrave në rresht dhe në shtyllë.
- Gjen herësin dhe mbetjen në një pjesëtim të dhënë.
- Zgjidh problemën me veprimin e shumëzimit dhe pjesëtimit.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Ushtrime sipas nivelit të nxënësve.


# TESTIM PËRMBLEDHËS PËR PERIUDHËN E PARË

**Lënda: Matematikë**

**Klasa: V**

**Emër/Mbiemër:** \_\_\_\_\_

**Data** \_\_\_\_\_

1. Çfarë tregon shifra 5 te numërorët e mëposhtëm? (2 pikë)  
 $90\ 352$  \_\_\_\_\_  $630,25$  \_\_\_\_\_
2. Cili është numri më i madh që mund të ndërtoni me shifrat 4,0,9,7? \_\_\_\_\_  
 Po numri më i vogël? (1 pikë)
3. Rrumbullakos në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt. (3 pikë)  
 $4587$  Q  \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 M \_\_\_\_\_
4. Rendit nga më i vogli te më i madhi numrat e mëposhtëm: 844; 43,2; 11,09; 437; 8976 ; 42,13 (6 pikë)
5. Plotëso vargun dhe me tri kufiza. (6 pikë)  
 $2842 ; 284\ 4 ; 2846 ; 2848 ; 2850 ;$  \_\_\_\_\_ ; \_\_\_\_\_ : \_\_\_\_\_ .  
 $111 : 112 ; 113 ; 115 ; 118 ;$  \_\_\_\_\_ ; \_\_\_\_\_ : \_\_\_\_\_ .
6. Krahaso:  $8\ 289$  \_\_\_  $82\ 98$  ;  $0,9$  \_\_\_  $0,42$  ;  $55\%$  \_\_\_  $0,65$  (2 pikë)
7. Kryej veprimet: (5 pikë)  
 $244 \cdot 100 = 2,85 \cdot 1000 = 8000 : 200 = 493,45 : 100 = 8596 + 1589 = 9801 - 4589 =$
8. Krahaso thyesat: (4 pikë)  
 $\frac{4}{5}$  .....  $\frac{7}{5}$   $\frac{6}{3}$  .....  $\frac{4}{5}$   $\frac{2}{8}$  .....  $\frac{3}{8}$   $\frac{5}{9}$  .....  $\frac{2}{9}$   $\frac{5}{8}$  .....  $\frac{1}{3}$
9. Rendit thyesat nga më e vogla te më e madhja. (2 pikë)  
 $\frac{2}{3}$   $\frac{2}{5}$   $\frac{2}{8}$   $\frac{2}{10}$   $\frac{2}{2} \rightarrow$  .....  
 .....



**10.** Gjej pjesën e një numri.

(2 pikë)

$\frac{4}{7}$  e 49 .....

$\frac{2}{5}$  e 450 .....

**11.** Raporti i djemve me vajzat në klasë është 2:3.

a). Nëse vajza janë 12, sa janë djem?

b) Nëse klasa e 5-A ka 35 nxënës, sa vajza dhe sa djem ka klasa?

(3 pikë)

**12.** Dy klasa të pesta kanë 60 nxënës. Nga këta, 20 janë vajza. Sa për qind e nxënësve të klasës janë vajza? Sa për qind janë djem? Sa është numri i vajzave? Sa është numri i djemve?

(4 pikë)

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 13	14 – 19	20 – 25	26 – 29	30 – 33	34 – 37	38 – 40
Pikët e fituara							

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta <b>mend</b>		<b>Tematika: Strategjitë e veprimeve me</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Cilën strategji?			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situata konkrete. Zbulim strategjie të veprimeve me mend.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Mbledh dhe zbret numra 3, 4-shifrorë duke përdorur strategji të ndryshme. - Krijon dhe zgjidh problema me mbledhje të numrave me mend. - Gjen strategjinë më të përshtatshme në veprimet që kryen.			
<b>Fjalët kyçe:</b> strategji e përshtatshme, shumë, ndryshesë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Tekst i nxënësit, zare, komplete letrash me shifra, gërshëre		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> diskutim, pune krijuese, punë në çifte			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Mësuesi/ja me kompletin e letrave në të cilat janë shkruar shifra të ndryshme formon dy numra treshifrorë dhe i shkruan në tabelë. Kërkon nga nxënësit të formojnë një problem që të zgjidhet me veprimin e mbledhjes. P.sh. me numrat 752 dhe 638. <b>Problem:</b> Dy makina u ngarkuan me bimë mjekësore. Makina e parë kishte 752 kg dhe e dyta 638 kg. Sa kg bimë mjekësore kishin të dyja makinat? Zgjidhja: $752 + 638 = 752 + 600 + 30 + 8 = 1390$ . Nxënësit zgjidhin me mend dhe zgjedhin vetë mënyrën, (strategjinë) për të kryer veprimet. Vazhdon me 2-3 shembuj të tjerë ku një nxënës krijon problemin, ndërsa tjetri bën zgjidhjen me mend.  P.sh. me numrat 852 dhe 538. <b>Problem:</b> Një fermer prodhoi në serën e tij 852 kg domate dhe 538 kg spec. Sa kg më shumë domate prodhoi fermeri? Zgjidhja: $538 + 2 + 300 + 12 = 852$ , $300 + 2 + 12 = 314$ kg domate më shumë. Zbritja me anë të mbledhjes. Nxënësit zgjidhin me mend dhe zgjedhin vetë mënyrën, (strategjinë) për të kryer veprimet. Vazhdon me 2-3 shembuj të tjerë ku një nxënës krijon problemin, ndërsa tjetri bën zgjidhjen me mend.			

**Faza e dytë: Punë e drejtpërdrejtë**

Mësuesi/ja jep shembuj të ndryshëm për mbledhjen e numrave 3, 4-shifrorë dhe kërkon nga nxënësit se kush e gjen rezultatin më shpejt me mend.

**Faza e tretë: Punë e pavarur. Punë në çifte**

Nxënësit hapin librat dhe plotësojnë faqen 51-52. Nxënësit punojnë në dyshe dhe përdorin zare ose kompletin e letrave me shifra për të formuar numra 3-shifrorë dhe 4-shifrorë dhe me to krijojnë problema, të cilat i shkruajnë në libër sipas shembullit të zgjidhur. Nxënësit përdorin fletë të tjera për të krijuar dhe zgjidhur problema të ndryshme si në libër. Kontrolli punës së nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- saktësinë dhe shpejtësinë e veprimeve me mend;
- aftësinë krijuese të problemave dhe zgjidhjes së tyre;
- bashkëveprimin me të tjerët.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit krijojnë dhe zgjidhin në fletore, si modeli në libër, problema.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta me mend		<b>Tematika: Strategjitë e veprimeve</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Strategjitë e shumëzimit			
<b>Situata e të nxënit:</b> Veprime konkrete me veprime shumëzimi			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kryen shumëzime me mend të numrave shumëfisha e 10, 100 me një numër njëshifror. - Përdor strategjinë e shumëzimit të numrave dyshifrorë dhe treshifrorë shumëfisha të 10, 100 me një numër një shifror.			
<b>Fjalët kyçe:</b> faktor, prodhim, shumëfisha.			
<b>Burimet, mjetet:</b> teksti i nxënësit, etiketa me shifra e shumëfisha të 10 dhe 100.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Shpjegim, demonstrim, punë në çifte.			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa barazime me shumëzime me numra njëshifrorë, $40 \times 5 =$ , $60 \times 7 =$ , $300 \times 5 =$ , $600 \times 9 =$ , $800 \times 4 =$ etj. Nxënësve iu kërkohet të kryejnë këto shumëzime me mend. Shumëzimi kryhet vetëm me shifrat dhe pastaj shtojmë numrin e zerove. Zhvilloj ushtrime të ndryshme me shumëzime, duke i zgjedhur numrat nga etiketat e parapërgatitura me shifra dhe numra shumëfishë të 10, 100. Bëj pyetje frontale për kryerjen e shumëzimeve.  Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa barazime: $7 \times 19 =$ , $7 \times 21 =$ dhe u kërkon nxënësve që të mendojnë një strategji për të kryer shpejt me mend këto shumëzime. Pasi mësuesi/ja merr përgjigjet nga nxënësi, formulon rregullin se si të kryhen këto shumëzime. Për të shumëzuar një numër me 19, shumëzojmë në fillim me 20, pastaj nga rezultati zbresim atë numër, për të shumëzuar një numër me 21, shumëzojmë në fillim me 20, pastaj nga rezultati shtojmë atë numër. P.sh: $7 \times 20 = 140$ , $140 - 7 = 133$ , pra $7 \times 19 = 133$ ose $7 \times 20 = 140$ , $140 + 7 = 147$ , pra $140 + 7 = 147$ . Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të gjejnë me mend të tjera veprime, si $8 \times 29$ , $8 \times 31$ etj.			

**Faza e dytë: Punë e pavarur. Punë dyshe**

Nxënësit hapin librat dhe punojnë në dyshe në faqen 53. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit se si do të veprojnë. Nxënësit ndjekin veprimet e përshkruara në libër, zgjedhin vetë ngjyrën e numrave në libër, gjejnë prodhimin e tyre dhe llogaritin pikët e grumbulluara. Fitues është lojtari që ka grumbulluar më shumë pikë. Veprimet dhe pikët, nxënësit i shënojnë në një fletë të veçantë.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit se si do të veprojnë duke ndjekur shembullin në faqen 54 të librit. Duke shkruar rezultatet në shkallën e vizatuar në libër. Në fund bëhet konkluzioni i punës në çift dhe rezultatet e nxënësve.

**Faza e tretë: Punë e drejtpërdrejtë**

Mësuesi/ja iu jep nxënësve ushtrime shpejtësie 6 x 29, 6 x 31, 8 x 59, 8 x 61 etj. Kush do të gjejë më shpejt prodhimin e numrave duke i pyetur nxënësit dy e nga dy. Vazhdohet me veprimet me mend për të kryer shumëzimet e kërkuara nga mësuesit/es.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- shpejtësinë dhe saktësinë e veprimeve të shumëzimit;
- bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit të shkruajnë në fletore veprime me shumëzimin e shumëfishave të 10 dhe 100 me numra njëshifrorë.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta <b>veprimeve me mend</b>		<b>Tematika: Strategji të</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Strategji të tjera të shumëzimit			
<b>Situata e të nxënit:</b> Eksplorim i strategjive të veprimeve me mend			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Eksploron mënyra për të shumëzuar një numër dyshifror me 4, me 6. - Kryen veprime me mend me shumëzim me 4, me 6 duke shumëzuar në mënyrë të njëpasnjëshme me faktorët e këtyre numrave. - Zbaton strategjinë e shumëzimit me 4, 6 në problema dhe situata praktike.			
<b>Fjalët kyçe:</b> strategji, dyfisho, trefisho, faktorë, prodhim, zbërthim në faktorë			
<b>Burimet e mjetet:</b> teksti i nxënësit faqe 56, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha e komunikimit, arte	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Bisedë, diskutim, eksplorim, punë e drejtpërdrejtë, punë krijuese, punë dyshe, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  <b>Faza e parë: Bisedë. Eksplorim. Diskutim</b> Bisedohet me nxënësit rreth rëndësisë së veprimeve me mend në zbatimin në jetën përditshme dhe në praktikë. Do të vazhdojmë të eksplorojmë mënyra më të thjeshta për të kryer veprime me mend dhe t'i zbatojmë ato në praktikë. Shkruhet në tabelë barazimet $14 \times 4 =$ , $17 \times 4 = 23 \times 6 =$ , $32 \times 6 =$ . Si do të kryejmë shpejt me mend këto veprime? Merret mendimi i nxënësve, mënyrat e tyre të shumëzimit me mend me 4 dhe 6. Për shumëzimin me 4 dhe 6 do të përdorim këtë strategji: Shumëzimi me 4: shumëzohet 2 herë me numrin 2. $14 \times 4 \longrightarrow 14 \times 2 = 28 \longrightarrow 28 \times 2 = 56$ Shumëzimi me 6: shumëzohet numri me 2 dhe më pas shumëzohet me 2. $23 \times 6 \longrightarrow 23 \times 3 = 69 \longrightarrow 69 \times 2 = 138$			
<b>Faza e dytë: Punë e drejtpërdrejtë</b> Përsëriten veprime me mend me shumëzimin me 4 dhe me 6 duke ndjekur strategjinë e mësipërme. Mësuesi/ja krijon situata praktike problemore nga veprimtaria e përditshme me shumëzime me 4 dhe 6 dhe nxënësit japin përgjigje direkt.			

**Faza e tretë: Punë në dyshe**

Nxënësit punojnë në dyshe duke kryer veprime me mend si dhe problema ku të përdoret shumëzimi me 4 dhe 6. Njëri krijon problemin dhe tjetri e zgjidh me mend.

**Faza e katërt: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 56 të librit. Kontrolli punës së nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- mendimin dhe zbulimin e strategjive në mënyrë të pavarur;
- shpejtësinë dhe saktësinë e shumëzimit me mend me 25;
- aftësinë krijuese dhe zgjidhjen e problemave;
- aftësinë komunikuese dhe bashkëvepruese me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Ushtrime me shumëzime të numrave dyshifrorë me numrat 4 dhe 6 e krijimin e problemave me situata praktike.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minua <b>veprimeve me mend</b>		<b>Tematika: Strategjitë e</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Strategji të tjera të shumëzimit			
<b>Situata e të nxënit:</b> zbulim, i strategjive të tjera për shumëzimin			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Zbulon strategjinë e shumëzimit me mend 25, shkruan hapat për të përdorur këtë strategji. - Kryen veprime me mend të numrave 2-shifrorë me numrin 25. - Zbaton strategjinë e shumëzimit me 25 në situata problemore.			
<b>Fjalët kyçe:</b> strategji, faktorë, prodhim, herës, katërfishim i numrit, gjysmë e numrit, përgjysmim i numrit			
<b>Burimet, mjetet:</b> tekst i nxënësit faqe 55, fletore e punës, complete letrash me numra, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> veprimtari zbuluese, diskutim, pune e drejtuar, punë krijuese, punë e pavarur punë dyshe			
<b>Zhvillimi i mëimit:</b>  <b>Faza e parë: Veprimtari zbuluese. Diskutim</b> Shkruhet në tabelë $26 \times 25 =$ . Si do të kryhet ky shumëzim me mend? Merret mendimi i nxënësve për këtë veprim dhe diskutohen mënyrat dhe strategjitë që mund të mendojnë nxënësit dhe vlerësohen ato. Për të kryer këtë veprim me mend, do të përdorim këtë strategji: <ul style="list-style-type: none"><li>• shumëzojmë me 100: <math>26 \times 100 = 2600</math></li><li>• gjejmë gjysmën e 2600: <math>2600 : 2 = 1300</math></li><li>• gjejmë gjysmën e 1300: <math>1300 : 2 = 650</math></li><li>• prandaj <math>26 \times 25 = 650</math></li></ul> $26 \times 25 \longrightarrow 26 \times 100 = 2600 \longrightarrow 2600 : 2 = 1300 \longrightarrow 1300 : 2 = 650$ Pra, pasi kemi shumëzuar numrin me 100, e kemi rritur prodhimin 4 herë, prandaj duhet pjesëtuar me 4 që prodhimi të mos ndryshojë (pjesëtimin me 4 më lehtë e bëjmë duke pjesëtuar 2 herë radhazi me numrin 2, duke përgjysmuar 2 herë). Vazhdohet me 3-4 shembuj të shumëzimit të numrave dy shifrore me 25 dhe nxënësit gjejnë prodhimin duke kryer me mend hapat e mësipërm.			



**Faza e dytë: Punë e drejtuar. Punë krijuese**

Mësuesi/ja krijoj disa pyetje problemore që zgjidhen me shumëzim të numrave 2-shifrorë me numrin 25. Dhe nxënësit japin përgjigjen me mend. Nëse nxënësit kanë vështirësi, i kryejnë veprimet duke ndjekur hapat e mësipërme të strategjisë të shumëzimit me 25.

**Faza e tretë: Punë dyshe**

Nxënësve ju kërkohet të krijojnë vetë problema me shumëzim me nr. 25. Dhe të jepet zgjidhja e tyre duke punuar në dyshe.

**Faza e katërt: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 55 të librit dhe faqen përkatëse të fletores së punës.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- mendimin dhe zbulimin e strategjive në mënyrë të pavarur;
- shpejtësinë dhe saktësinë e shumëzimit me mend me 25;
- aftësinë krijuese dhe zgjidhjen e problemave;
- aftësinë komunikuese dhe bashkëvepruese me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Ushtrime me shumëzime të numrit 25 me numra 2-shifrorë dhe krijimin e problemave.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta <b>mend</b>		<b>Tematika: Strategjitë e veprimeve me</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Dyfishimi dhe përgjysmimi			
<b>Situata e të nxënit:</b> Zbulim i strategjive dyfishim dhe përgjysmim.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Zbulon strategji të dyfishimit të numrave me presje me një shifër pas presjes. - Kryen me mend dyfishimin dhe përgjysmimin e numrave dhjetorë me një shifër pas presjes. - Zbaton në situata praktike dhe problemore veprimet e dyfishimit dhe përgjysmimit të numrave 2, 3-shifrorë.			
<b>Fjalët kyçe:</b> dyfishim, përgjysmim, prodhim, herës, rezultat i veprimit, numra tek, numra çift.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Teksti i nxënësit faqe 57, faqja përkatëse në fletoren e punës, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Bisedë, diskutim, punë drejtuar, punë krijuese, punë dyshe, punë e pavarur			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>			
<b>Faza e parë: Bisedë. Punë e drejtuar</b> Zhvillohet një bisedë për rëndësinë e veprimeve me mend dhe në veçanti për raste kur kërkohet dyfishim, dyfish i një numri, përgjysmim, gjysma e një numri, sasi etj. Gjetja me mend e dyfishit dhe gjysmës së një numri me presje do të jetë qëllimi i mësimi të sotëm. Shkruhen në tabelë numrat: 5,6; 5,7, 8,4; 8,3. Si do të gjemë dyfishin dhe gjysmën e këtyre numrave. Merret mendimi dhe rruga që ndjekin nxënësit. Për të gjetur dyfishin dhe gjysmën e një numri përdorim këtë strategji: dyfishi i 5,6:                      dyfishi i 56 është 112, atëherë dyfishi 5,6 është 11,2. dyfishi i 1,25:                      dyfishi i 125 është 250, atëherë dyfishi i 1,25 është 2,50 gjysma e 5,6:                      gjysme e 56 është 28, atëherë gjysma e 5,6 është 2,8. Gjysma e 15,8:                      gjysma e 158 është 79, atëherë gjysma e 15,8 është 7,9			
Ndërtohet në dërrasë tabela:			
Numri	Dyfisho numrin	Përgjysmo numrin	
3,4			
8,3			
18, 2			
16,8 etj.			
.....			

Nxënësit ngrihen në tabelë dhe plotësojnë atë me mend, duke dyfishuar dhe përgjysmuar numrat e dhënë.

### **Faza e dytë: Punë e drejtpërdrejtë. Punë krijuese**

Punohen me mend veprime me numra me presje, me dyfishim dhe përgjysmim të tyre. Si dhe problema nga veprimtaria e përditshme.

- Gëzimi ble në dyqan 4,7 kg mollë. Artani bleu dyfishin (gjysmën) e tij. Sa kg mollë bleu Artani?

- Arbeni bleu 5,8 kg patate, të cilat ishin sa gjysma e sasisë që bleu Besniku. Sa kg patate bleu Besniku?

Nxënësit krijojnë problema dhe kërkohet që zgjidhja të kryet me mend.

### **Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 57 të librit. Në fund, nxënësit shkruajnë një fjali ku të përshkruajnë si i gjetën dyfishet dhe gjysmat e numrave. Nxënësit gjithashtu bëjnë radhitjen e 10 numrave nga lista e numrave në libër.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- mendimin dhe zbulimin e strategjive në mënyrë të pavarur;
- shpejtësinë dhe saktësinë e gjetjes së dyfishit dhe gjysmës së numrave;
- aftësinë krijuese dhe zgjidhjen e problemave;
- aftësinë komunikuese dhe bashkëvepruese me njëri-tjetrin.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Fletore e punës, faqe 31.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta <b>veprimeve me mend</b>		<b>Tematika: Strategjitë e</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Dyfishimi dhe përgjysmimi			
<b>Situata e të nxënit:</b> Eksplorimi i strategjive dyfishim dhe përgjysmim			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Eksploron strategji të dyfishimit të numrave shumëfisha të 10 dhe 100. - Kryen me mend dyfishimin dhe përgjysmimin e numrave shumëfisha të 10 dhe 100. - Zbaton në situata praktike dhe problemore veprimet e dyfishimit dhe përgjysmimit të numrave.			
<b>Fjalët kyçe:</b> dyfishim, shumëfish ,përgjysmim, prodhim, herës, rezultat i veprimit, numra tek, numra çift.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Teksti i nxënësit faqe 58, faqja përkatëse në fletoren e punës, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Bisedë, diskutim, punë e drejtuar, punë krijuese, punë në dyshe, punë e pavarur			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>			
<b>Faza e parë: Bisedë. Punë e drejtuar</b> Zhvillohet një bisedë për rëndësinë e veprimeve me mend dhe në veçanti për raste kur kërkohet dyfishim, dyfish i një numri, përgjysmim, gjysma e një numri, sasi etj. Gjetja me mend e dyfishit dhe gjysmës së një numri shumëfish të 10, 100 etj. Shkruhen në tabelë numrat: 260, 780, 2300, 5200. Si do të gjemë dyfishin dhe gjysmën e këtyre numrave. Merret mendimi dhe rruga që ndjekin nxënësit. Për të gjetur dyfishin dhe gjysmën e një numri përdorim këtë strategji: 260:    26 x 2 = 52, pra 260 x 2 = 520,    26 : 2 = 13,   pra 260 : 2 = 130 7600:   76 x 2 = 152, pra 7600 x 2 = 15200,    76 : 2 = 38,   pra 7600 : 2 = 3800 etj.			
Ndërtohet tabela në dërrasë:			
Numri	Dyfisho numrin	Përgjysmo numrin	
360			
480			
3400			
7600 etj.			
.....			

Nxënësit ngrihen në tabelë dhe plotësojnë atë me mend, duke dyfishuar dhe përgjysmuar numrat e dhënë.

**Faza e dytë: Punë e drejtpërdrejtë. Punë krijuese**

Punohen me mend veprime me numra me presje, me dyfishim dhe përgjysmim të tyre. Si dhe problema nga veprimtaria e përditshme.

- Një kamion u ngarkua 230 kv perime, e cila ishte sa dyfishi i ngarkesë së kamionit të dytë. Sa

ishte ngarkesa e kamionit të dytë?

- Largësia ajrore nga Tirana në Paris është 2400 km. Sa km bën avioni vajtje-ardhje Tiranë-Paris?

Nxënësit krijojnë problema dhe kërkohet që zgjidhja të kryet me mend.

**Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 58 të librit. Bëhet kontrolli i punës së nxënësve.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- mendimin dhe zbulimin e strategjive në mënyrë të pavarur;
- shpejtësinë dhe saktësinë e gjetjes së dyfishit dhe gjysmës së numrave;
- aftësinë krijuese dhe zgjidhjen e problemave;
- aftësinë komunikuese dhe bashkëvepruese me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Fletore e punës, faqe 32.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data:
Koha e zgjatjes: 45 minuta mend		Tematika: Strategjitë e veprimeve me	
Ora 1 Tema mësimore: Strategjitë e veprimeve me mend			
Situata e të nxënit: Përsëritja e strategjive të mësuara			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës: - Përsërit strategjitë e mësuara në kapitullin 3. - Kryen veprime me shpejtësi dhe saktësi duke zbatuar këto strategji. - Zbaton këto strategji në zgjidhjen e situatave problemore.			
Fjalët kyçe: Strategji të veprimeve me mend, fakte shumëzimi dhe pjesëtimi, shumëfish, faktor, Katror i numrit, shumëfish më të afërt, vendvlera, dyfishim, përgjysmim, prodhim herës, shumë, ndryshesë.			
Burimet, mjetet: Etiketa ku të jenë shkruar veprime të kryera në këtë kapitull për strategji të ndryshme, teksti i nxënësit, fletore e punës, mjete shkrimi, letër, gërshërë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuha e komunikimit, artet	
Metodologjia e veprimtaria e të nxënit: Përsëritje e njohurive, konkurs, punë në grupe, situata problemore, puna në dyshe, punë e pavarur.			
Zhvillimi i mësimit:			
Faza e parë Stuhi mendimesh. Punë e drejtuar Mësuesi/ja vizaton në tabelën e klasës skemën kllaster dhe shkruan në etiketën e mesit: Strategji të veprimeve me mend.			
<div><div><div>Çiftet e numrave</div><div>Shumëzimi me 10 dhe 100</div><div>Shumëzimi me 19, 25, 4, 6</div></div><div><div>Shumfisha më të afërt</div><div>Vargjet</div></div><div><div>Faktorët</div><div>Dyfishimi dhe përgjysmimi</div><div>Ndryshesa e numrave katrorë</div></div><div>Strategji të veprimeve me mend</div></div>			
Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë skemën e mësipërme duke i pyetur për gjithë strategjitë e mësuara gjatë kapitullit.			

**Faza e dytë:****Konkurs**

Në tavolinën e mësuesit/es janë etiketat e përgatitura me të gjitha rastet e strategjive të mësuara në kapitullin 3 për strategjitë e veprimeve me mend. Etiketat do të jenë në:

$3004 - 1999$	$3999 + 2363$	$1356 \times 4$	$580 : 10$
$0,4 + ? = 1$	$5,7 + ? = 10$	$5^2 - 3^2$	$643 + 532$
$5400 \times 5$	$34 \times 19$	$34 \times 25$	$43 \times 6$
$12,5 \times 2$	$12,5 : 2$	$3600 \times 5$	$4800 : 2$

Në etiketa të përfshihet të gjitha rastet e strategjive të përdorura në këtë kapitull.

Në tabelë është vizatuar tabela në të cilën shkruhen veprimet e nxjerra rastësisht nga etiketat e parapërgatitura e ndarë në dy grupe. Çdo veprim ka 2 pikë, një pikë veprimi dhe një përshkrimi i strategjisë së përdorur.

Ngrihen me radhe dhe të alternuar nxënësit e dy grupeve. Marrin rastësisht një etiketë dhe përshkruajnë strategjinë e përdorur, dhe rezultatin në tabelë. Në fund bëhet llogaritja e pikëve dhe shpallja e grupit fitues.

**Faza e tretë: Punë në grup**

Nxënësit punojnë faqen 80 të librit. Punojnë në grupe për të krijuar problema. Klasa ndahet në 5 grupe dhe secilit grup i jepet një problem për të hartuar dhe zgjidhur në libër. Një nxënës për çdo grup bën leximin e problemit dhe zgjidhjen e tij.

**Vlerësimi:****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- gjetjen e strategjive në mënyrë të pavarur;
- shpejtësinë dhe saktësinë e gjetjes së veprimeve;
- aftësinë krijuese dhe zgjidhjen e problemave duke përdorur strategji të ndryshme;
- aftësinë komunikuese dhe bashkëvepruese me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Faqe 36 në fletoren e punës

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Veprime me shkrim</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Veprime me shkrim</b> <b>Tema mësimore:</b> Diskutojmë së bashku			
<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutim mbi mënyrat e zgjedhura për kryerjen e veprimeve.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Rikujton veprimet e mbledhje dhe zbritjes me shkrim me numra 3, 4-shifrorë. - Rikujton dhe kryen veprimet me shumëzim dhe pjesëtim të numrave 3, 4-shifrorë me një numër njëshifror. - Diskuton për mënyrën më të përshtatshme të veprimeve me shkrim.			
<b>Fjalët kyçe:</b> ndarje, renditje, shumë, mbledhor, vendvlerash, faktorë, prodhim, i pjesëtueshëm, pjesëtues, herës, veprime në kolonë, i zbritshëm, zbritës, ndryshesë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Teksti i nxënësit faqe 61, komplet letrash me shifra, letër, mjete shkrimi		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtarisë e të nxënit:</b> Bisedë, diskutim, punë e drejtuar, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <b>Faza e parë: Bisedë</b> Zhvillohet një bisedë me nxënësit. Në kapitullin paraardhës bëmë strategjitë e veprimeve me mend. Në këtë kapitull do të bëjmë veprimet me shkrim, të cilat i keni bërë edhe në klasat e tjera por këtu do të zhvillohen më tej njohuritë e marra. Ndonjëherë përdorim metoda që prindërit tuaj nuk i kanë përdorur. Diskutoni herë pas here edhe me prindërit tuaj për mënyrat e kryerjes së veprimeve etj. <b>Faza e dytë: Diskutim. Punë e drejtpërdrejtë</b> Shkruajmë në tabelë: 59+313, 781-334, 346x9, 196:6, 7659+2283, 357:7 etj. Kërkohej nga nxënësit se si do të veprojnë për të kryer këto veprime. Në tabelën e mëposhtme jepen disa mënyra të kryerjes të veprimeve të mësuara. Nxënësit nxiten që të përdorin këto strategji dhe strategji të tjera.			
<b>Veprimi</b>	<b>Llogaritja e veprimeve</b>	<b>Menyra e përdorur</b>	
59+313	59 + 313 = (60 - 1) + 313 = (60 + 313) - 1 = 373 -1 = 372	Duke shtuar dhe hequr te njëjtin numër një mbledhori	
59+313	59+313 = (50+9) + (300+10+3) = 300 + 60 + 12 = 372	Me ndarje sipas klasave duke përdorur vetinë e shoqërimit	



59+313	$\begin{array}{r} 313 \\ + 59 \\ \hline 300 \\ +60 \quad (10+50) \\ +12 \quad (3+9) \\ \hline 372 \end{array}$	Mënyra 1 në shtyllë										
59+313	$\begin{array}{r} 313 \\ + 59 \\ \hline 12 \quad (3+9) \\ + 50 \quad (10+40) \\ +200 \\ \hline 262 \end{array}$	Mënyra 2 në shtyllë										
59+313	$\begin{array}{r} \overset{1}{3}13 \quad \overset{1}{7}\overset{1}{6}59 \quad \text{mbledhori} \\ + \overset{1}{5}9 \quad + \overset{1}{2}\overset{1}{2}83 \quad \text{mbledhori} \\ \hline 372 \quad 4992 \quad \text{shuma} \end{array}$	Mënyra e zakonshme në shtyllë										
781-334	$\begin{array}{r} 700 \quad + 70 \quad + 11 \\ - (300 \quad + 30 \quad + 4) \\ \hline 400 \quad + 40 \quad + 7 = 447 \end{array}$	Mënyra 1 zbritja në shtyllë										
781-334	$\begin{array}{r} \overset{7}{7} \overset{8}{8} \overset{1}{1} \quad \text{i zbritshmi} \\ - \overset{3}{3} \overset{3}{3} \overset{4}{4} \quad \text{zbritësi} \\ \hline 4 \quad 4 \quad 7 \quad \text{ndryshesa} \end{array}$	Mënyra e zakonshme e zbritjes në shtyllë										
346x9	$\begin{aligned} 346 \times 9 &= (300+40+6) \times 9 \\ &= (300 \times 9) + (40 \times 9) + (6 \times 9) \\ &= 2700+3600+54 \\ &= 3114 \end{aligned}$	Mënyra e ndarjes dhe vetia e përdasimit										
346x9	<table><tr><td>x</td><td>9</td></tr><tr><td>300</td><td>2700</td></tr><tr><td>40</td><td>360</td></tr><tr><td>6</td><td>54</td></tr><tr><td></td><td>3114</td></tr></table>	x	9	300	2700	40	360	6	54		3114	Mmënyra e rrjetës
x	9											
300	2700											
40	360											
6	54											
	3114											

<p><b>Faza e tretë: Punë e pavarur. Punë dyshe</b></p> <p>Nxënësit punojnë të pavarur. Formojnë numra 3, 4-shifrorë me letrat me shifra dhe i kryejnë me shkrim veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit. Nxënësit punojnë në dyshe njëri formon numrat dhe tjetri kryen veprimet dhe pastaj ndërrojnë rolet. Kontrolli punës së tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi</b></p> <p><b>Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- pavarësinë e mënyrave të kryerjes së veprimeve;</li><li>- saktësinë e kryerjes së veprimeve;</li><li>- përshkrimin me fjalët: shumë, ndryshesë, prodhim, herës etj.</li></ul>
<p><b>Detyra dhe puna e pavarur:</b></p> <p>Nxënësit shkruajnë në fletore veprime e mësuara me numra 3, 4-shifrorë, në mënyrën që dëshirojnë.</p>

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>	
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Veprime me shkrim</b>		
<b>Ora 1</b>				
<b>Tema mësimore:</b> Mbledhja dhe zbritja				
<b>Situata e të nxënit:</b> veprime konkrete me numra				
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kryen mbledhje dhe zbritje me numra 4-shifrorë. - Emërton me fjalë mbledhor, shumë, ndryshesë etj. - Përdor mënyra të ndryshme të mbledhjes dhe zbritjes.				
<b>Fjalët kyçe:</b> mbledhor, shumë, i zbritshëm, zbritës, ndryshesë.				
<b>Burimet, mjetet:</b> Teksti i nxënësit faqe 62, komplet letrash me shifra, letër, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.		
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Punë e drejtpërdrejtë, punë në grupe, punë në dyshe, punë e pavarur				
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>				
<b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Formojmë numra 4-shifrorë me letrat me shifra dhe kryejmë veprimin e mbledhjes në shtyllë. Marrim mendimin e nxënësve për mënyra të tjera, bëjmë mbledhjen me një mënyrë tjetër dhe kontrollin e saktësisë të gjetjes së shumës.  Bëjmë zbritjen në shtyllë e dy numrave të formuar. Aktivizojmë 2-3 nxënës për të kryer të njëjtën zbritje sipas mënyrës së tyre të preferuar. Bëjmë kontrollin e zbritjes duke krahasuar mënyrat e zgjidhjes. Plotësojmë tabelën e vizatuar së bashku me nxënësit.				
Numrat e formuar	Gjetja e shumës	Kontrolli i shumës	Gjetja e ndryshesës	Kontrolli i ndryshesës
3456, 4567	3456 +4567 8023	3M 4Q 5Dh 6Nj +4M 5Q 6Dh 7Nj 8M 0Q 2Dj 3Nj	4567 -3456 1111	4000+500+60+7 3000-400-50-6 =1111
etj.				

**Faza e dytë: Punë në grupe**

Nxënësit punojnë në grupe faqen 62 të librit. Një nxënës formon numrat katërshifrorë, tjetri i shkruan ato në tabelën në libër dhe gjen shumën në mënyrën e tij të preferuar, një nxënës tjetër bën mbledhjen ndryshe dhe bëhet kontrolli i shumës, një nxënës gjen ndryshesën me një mënyrë dhe një nxënës gjen ndryshesën ndryshe dhe bëhet kontrolli i zbritje. Nxënësit punojnë të pavarur dhe plotësojnë tabelën.

**Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 38 të fletores së punës. Nxënësit formojnë numra me shifrat që janë në libër dhe bëjnë mbledhjen dhe zbritjen e tyre duke përdorur mënyrën që dëshirojnë. Kontrolli punës së nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- pavarësinë e mënyrave të kryerjes së veprimeve;
- saktësinë e kryerjes së veprimeve;
- përshkrimin me fjalët: shumë, ndryshesë, prodhim, herës etj.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Ushtime me mbledhje dhe zbritje me numra 4-shifrorë duke përdorur mënyrën e preferuar.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data:</b>			
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Veprime me shkrim				
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Mbledhja dhe zbritja						
<b>Situata e të nxënit:</b> veprime konkrete me mbledhje e zbritje.						
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Mbledh dhe zbrit numra me presje. - Zgjidh problema të thjeshta me mbledhje dhe zbritje me numra me presje.						
<b>Fjalët kyçe:</b> shumë, ndryshesë e numrave, vendvlerë, të dhjetat, të qindta, numër dhjetor.						
<b>Burimet, mjetet:</b> teksti i nxënësit faqe 63, foto të printuara numra me presje me çmime/gjatësi, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.				
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> punë e drejtuar, punë e drejtpërdrejtë, punë e pavarur, punë krijuese						
<b>Zhvillimi i mësimi</b>						
<b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Shkruhen në tabelë numra me presje: 13,7; 25,32; 10,05; 305,39 etj. Numrat me presje vendosen numrat në tabelë duke vendosur shifrat në vend vlerat përkatëse.						
Qindëshe	Dhjetëshe	Njëshe	,	Të dhjetat	Të qindta	Të mijtat
	1	3	,	7		
	2	5	,	3	2	
3	0	5	,	3	9	
Etj.			,			
Mësuesi/ja formon numra të ndryshëm me presje dhe nxënësit i shkruajnë në tabelë. Lexohen numrat sipas vendvlerave 3 qindëshe, 0 dhjetëshe, 5 njëshe, 3 të dhjetat, 9 të qindta etj.						
Bëj disa mbledhje dhe zbritje me numra dhjetorë me 1, 2, 3 shifra pas presjes. Zbritjen e numrave natyrorë me numrat me presje. Kujtoj nxënësit që numrat të vendosen nën njëri-tjetrin sipas vendvlerave dhe presja nën presje, për vend vlerat që mungojnë pas presjes vendosim 0. Pyeten nxënësit se si mund të bëhen ndryshe mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë.						

**Faza e dytë: Punë e drejtpërdrejtë. Punë krijuese**

Mësuesi/ja krijon disa pyetje problemore ku të përdoren numra me presje p.sh.: Rruga nga qendra për në shtëpinë e Ardit ka dy pjesë pjesa e parë është 350,3 m dhe pjesa tjetër 250,7 m. Sa m është largësia nga e shtëpisë së Ardit nga qendra? Etj.

Nxënësit shikojnë fotot, ose nga imagjinata dhe krijojnë problema të thjeshtë me mbledhje dhe zbritje të numrave me presje, dhe i zgjidhin ato në fletë ose fletore.

**Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 63 të fletores së punës. Nxënësit gjejnë se sa është gjatësia e mbetur e perdes duke zbritur nga numri 20 numrat dhjetorë me presje që janë në tabelë.  $20,00 - 10,50 = 9,50$  m etj. Nxënësit japin përgjigjen në fund se mund të qepen dy perde me të njëjtën ngjyrë me ngjyrat e kaltër dhe e kuqe, pasi dyfishi i gjatësisë së tyre nuk e kalon 20 m. Nxënësit kontrollojnë më makinë llogaritëse ose celular rezultatet e gjetura.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- saktësinë e shpejtësinë e veprimeve;
- mënyrat e përdorura për veprimet me numrave me presje;
- aftësinë krijuese.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Të shkruajnë mbledhje dhe zbritje me numrat me presje si dhe të krijojnë dhe zgjidhin problema.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>										
<b>Koha e zgjatjes: 45 minuta</b>		<b>Tematika: Veprime me shkrim</b>											
<b>Ora 1</b>													
<b>Tema mësimore:</b> Më shumë për mbledhjen dhe zbritjen													
<b>Situata e të nxënit:</b> veprime të mbledhjes dhe zbritjes në problema.													
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kryen veprime me mbledhje dhe zbritje me numra 4-shifrorë. - Krijon problema që zgjidhen me veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes.													
<b>Fjalët kyçe:</b> shumë, ndryshesë, situatë problemore.													
<b>Burimet:</b> teksti i nxënësit, letra me shifra 0-9, teksti i nxënësit, letra me shifra 0-9, foto të ndryshme me etiketa me çmime, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.											
<b>Metodologjia e veprimtarisë e të nxënit:</b> Situatë problemore, punë krijuese, punë në grup, pune e pavarur.													
<b>Zhvillimi i mësimi:</b> <b>Faza e parë: Situatë problemore. Punë krijuese</b> Mësuesi/ja paraqet para nxënësve tabelën e mëposhtme:													
<table><tr><th>Linja ajrore</th><th>Largësia ajrore në km</th></tr><tr><td>Tiranë - NewYork</td><td>7432</td></tr><tr><td>Tiranë - Londër</td><td>2514</td></tr><tr><td>Tiranë - Paris</td><td>1993</td></tr><tr><td></td><td></td></tr></table>				Linja ajrore	Largësia ajrore në km	Tiranë - NewYork	7432	Tiranë - Londër	2514	Tiranë - Paris	1993		
Linja ajrore	Largësia ajrore në km												
Tiranë - NewYork	7432												
Tiranë - Londër	2514												
Tiranë - Paris	1993												
Me të dhënat në tabelë krijoni problema dhe zgjidhni nëpërmjet veprimit të mbledhjes ose zbritjes. P.sh.:													
Largësia ajrore nga Tirana në Londër është 2514 km, dhe nga Tiranë në New York është 7432 km. Sa është ndryshimi i largësive në km të dy linjave ajrore?													
Sa km më e madhe është largësia Tiranë-New York vajtje e kthim nga largësia Tiranë-Londër vajtje e kthim? etj.													
Nxënësit krijojnë problema dhe aktivizohen në tabelë për të bërë zgjidhjet e tyre me veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.													
<b>Faza e dytë: Punë e pavarur. Punë krijuese në grup</b>													
Nxënësit punojnë faqen 64 të librit. Mësuesi/ja orienton nxënësit për veprimet që do të bëjnë, krijimin dhe zgjidhjen e problemës. Një nxënës zgjedh katër letra me shifra të ndryshme dhe duke i përzierë formon numra katërshtifrorë. Krijojnë problema, i shkruajnë në fletore duke plotësuar tabelën dhe i zgjidhin ato. Duke përsëritur nxënësit e tjerë të njëjtën veprim, krijojnë dhe zgjidhin duke plotësuar tabelën. Bëhet kontrolli i punës së nxënësve.													

**Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 39 të fletores së punës. Orientohen nxënësit për zgjidhjen e problemave duke kërkuar që të përshkruhet mënyra e zgjidhjes me mend ose me shkrim. Kontrolli punës së nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- aktivizimin dhe aftësinë krijuese të problemeve;
- saktësinë e kryerjes së veprimeve;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Krijim dhe zgjidhje të problemave me veprimin e mbledhjes dhe zbritjes.



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Veprime me shkrim</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Më shumë për mbledhjen dhe zbritjen.			
<b>Situata e të nxënit:</b> veprime konkrete të mbledhjes dhe zbritjes së numrave.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Mbledh dhe zbret numra 3, 4-shifrorë. - Përdor mënyra të ndryshme për të bërë mbledhjen dhe zbritjen. - Krijon problema me mbledhje dhe zbritje. - Vetë kontrollon veprimet me makinë llogaritëse.			
<b>Fjalët kyçe:</b> mbledhorë, i zbritshëm, zbritës, shuma, ndryshesa, mënyra e përdorur.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Teksti i nxënësit, komplete me letra me shifra të nxënësit, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Punë e drejtuar, punë krijuese, Punë në dyshe, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimit</b> <b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Vizatohet nga mësuesi/ja një tabelë:			
<b>Veprimi</b>	<b>Llogaritja e veprimeve</b>	<b>Menyra e përdorur</b>	
59+313	59+313 =(60-1)+313 =(60+313)-1 =373-1 =372	Duke shtuar dhe hequr te njëjtin numër një mbledhori	
59+313	59+313 =(50+9)+(300+10+3) =300+60+12 =372	Me ndarje sipas klasave duke përdorur vetinë e shoqërimit	
59+313	313 + 59 300 +60 (10+50) +12 (3+9) 372	Menyra 1 në shtyllë	

	$\begin{array}{r} 313 \\ + 59 \\ \hline 12 \quad (3+9) \\ + 50 \quad (10+40) \\ + 200 \\ \hline 262 \end{array}$	Mënyra 2 në shtyllë
59+313	$\begin{array}{r} \overset{1}{3}13 \quad \overset{1}{7}659 \quad \text{mbledhori} \\ + 59 \quad + 2283 \quad \text{mbledhori} \\ \hline 372 \quad 4992 \quad \text{shuma} \end{array}$	Mënyra e zakonshme në shtyllë
781-334	$\begin{array}{r} 700 \quad + 70 \quad + 11 \\ - (300 \quad + 30 \quad + 4) \\ \hline 400 \quad + 40 \quad + 7 = 447 \end{array}$	Mënyra 1 zbritja në shtyllë
781-334	$\begin{array}{r} \overset{7}{7} \overset{8}{8} \overset{1}{1} \text{ i zbritshmi} \\ - \overset{3}{3} \overset{3}{3} \overset{4}{4} \quad \text{zbritësi} \\ \hline 4 \quad 4 \quad 7 \text{ ndryshesa} \end{array}$	Mënyra e zakonshme e zbritjes në shtyllë

Nxënësit zgjedhin letrat me shifra rastësisht dhe shkruajnë shifrat në tabelë, formohen çifte numrash dhe gjendet shuma dhe ndryshesa e tyre. Nxënësit përshkruajnë mënyrën e zgjedhur të mbledhjes dhe zbritjes. Përsëritet veprimi 3-4 herë duke aktivizuar nxënës të tjerë.

#### Faza e dytë: Punë në grup. Punë krijuese

Nxënësit punojnë në faqen 65 të librit duke punuar në grupe, për të formuar numra dhe gjetur shumën dhe ndryshesën me mënyrat që dëshirojnë. Pas plotësimit të tabelës bëhet kontrolli i veprimeve me makinë llogaritëse ose celular. Në fund, nxënësit krijojnë dhe shkruajnë në libër një problemë me numra 3-shifrorë dhe e zgjidhin atë. Bëhet kontrolli i punës së pavarur.

#### Fazë e tretë: Pune e drejtpërdrejtë.

Mësuesi/ja shkruan barazimet  $3000 - 1496 =$ ,  $4007 - 2458 =$  etj., dhe kryen veprimet në shtyllë.

2 9 9 10	3 9 9 17
<b>3000</b>	<b>4007</b>
<b>-1496</b>	<b>- 2458</b>
<b>1504</b>	<b>1549</b>

Përsërit veprimet në shtyllë për zbritjen e numrave të tjerë.

#### Vlerësimi

##### Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- saktësinë e kryerjes së veprimeve;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin;
- aftësinë krijuese të problemeve.

#### Detyra dhe puna e pavarur:

Nxënësit kryejnë veprime në shtyllë me mbledhje dhe zbritje, si dhe krijojnë dhe zgjidhin problema.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data:
Koha e zgjatjes: 45 minuta		Tematika: Veprime me shkrim	
Ora 1			
Tema mësimore: Shumëzimi			
Situata e të nxënit: Zbulim i mënyrave të shumëzimit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës: - Kryen shumëzime të numrave 3-shifrorë me një numër njëshifror. - Zbaton mënyra të ndryshme të shumëzimit të numrave.			
Fjalët kyçe: shumëzim, faktor, prodhim, mënyrë e përdorur.			
Burimet, mjetet: libri i nxënësit, njohuritë e mëparshme të nxënësve, komplet me letra me shifra, mjete shkrimi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuha e komunikimit arte.	
Metodologjia e veprimtaria e të nxënit: Punë e drejtpërdrejtë, punë e drejtuar, punë e pavarur.			
Zhvillimi i mësimit:			
Faza e parë: Punë e drejtpërdrejtë Zhvillohet me nxënësit një bisedë rreth shumëzimit, faktorëve e prodhimit. Bëhet një kontroll i shpejtë për faktet e shumëzimit, duke përdorur, termat shumëzim, herë, gjeni prodhimin, me cilin numër është shumëzuar numri që ka dalë ky prodhim, veti të ndërrimit të faktorëve. Përdoren dhe strategjitë e shumëzimit me mend, të mësuara në kapitullin paraardhës, shumëzimi me 0, me shumëfisha të 10, 100, 1000, dyfishimi, shumëzimi me 4, me 19, me 21 etj.			
Faza e dytë: Punë e drejtuar Vizatohet në dërrasë një tabelë si më poshtë. Aktivizohen nxënës për të zgjedhur letrat me shifra dhe të krijojnë numra treshifrorë, të cilët do të shumëzohen me numrat njëshifrorë. Nxiten nxënësit që të përdorin jo vetëm shumëzimin në shtyllë por edhe mënyrat e tjera. Plotësohen 2-3 shumëzime dhe plotësohet tabela duke përshkruar mënyrën e përdorur.			
Shifra e letrave të përdorura	Llogaritja e shumëzimit	Mënyra e përdorur	Përgjigjja
3,4,6	Mënyra 1 $346 \times 9 = (300+40+6) \times 9$ $= (300 \times 9) + (40 \times 9) + (6 \times 9)$ $= 2700 + 3600 + 54$ $= 3114$	Me ndarje sipas klasave dhe vetinë e përdasimit të shumëzimit në lidhje me mbledhjen	3114

3,4,6	Mënyra 2				Metoda 1 e rrjetës	3114
	x		9			
	300		2700			
	40		360			
	6		54			
			3114			
3,4,6	Mënyra 3				Mënyra 1 në shtyllë	3114
	300+40+6					
	X9					
	2700		300x9			
	360		40x9			
	54		6x9			
	3114					
3,4,6	Mënyra 4				Mënyra 2 në shtyllë	3114
	346					
	X 9					
	2700					
	360					
	54					
3114						
3,4,6	Mënyra 5				Mënyra 3 në shtyllë	3114
	346					
	X 9					
	54					
	360					
	2700					
3114						
1,4,3,7	Mënyra 7 (Metoda e rrjetës)				Metoda 2 e rrjetës	7185
	1437x5					
	x	1000	400	30		
	5	5000	2000	150	35	= 7185
1,4,3,7	1437x5				Dyfisho-përgjysmo	7185
	1437x10=14370 (dyfishi)					
	14370:2=7185 (gjysma)					
3,4,6	Mënyra 6				Mbledhja në shtyllë	3114
	4 5					
	3 4 6					
	X 9					
	3 1 1 4					

**Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 66 të librit, duke formuar numra 3-shifrorë dhe bërë shumëzimet me një numër njëshifror, duke përdorur mënyrën që dëshirojnë. Nxënësit bëjnë kontrollin e veprimeve me makinë llogaritëse. Kontrolli i punës së pavarur të nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- aftësinë për të përdorur mënyra të ndryshme të shumëzimit dhe për të përshkruar ato;
- saktësinë e kryerjes së veprimeve të shumëzimit.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Shumëzime të numrave 3, 4-shifrorë me numra njëshifrorë duke përdorur mënyra të ndryshme.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>																				
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Veprime me shkrim																					
<b>Ora 2</b>																							
<b>Tema mësimore:</b> Shumëzimi																							
<b>Situata e të nxënit:</b> shumëzimi në situata konkrete																							
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kryen shumëzime të numrave dyshifrorë. - Përdor mënyra të ndryshme të shumëzimit të dy numrave dyshifrorë. - Zgjidh dhe krijon problema me shumëzim.																							
<b>Fjalët kyçe:</b> faktorë, prodhim, mënyrë e shumëzimit, shumëzimi me ndarje etj.																							
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, komplet me letra me shifra, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.																					
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Punë e drejtuar, punë krijuese, punë e pavarur.																							
<b>Zhvillimi i mësimit</b>																							
<b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Në tabelën e mëposhtme, e cila është e përgatitur ose e shkruar në dërrësë, janë disa mënyra të shumëzimit me numra dyshifrorë. Nxënësit orientohen të përdorin këto mënyra.																							
<b>Shumëzimi</b>	<b>Llogaritja e shumëzimit</b>	<b>Mënyra e përdorur</b>	<b>Përgjigja</b>																				
75x23	<table><tr><td>x</td><td>70</td><td>5</td><td></td><td></td></tr><tr><td>20</td><td>1400</td><td>100</td><td>→</td><td>1500</td></tr><tr><td>3</td><td>210</td><td>15</td><td>→</td><td>225</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1725</td></tr></table>	x	70	5			20	1400	100	→	1500	3	210	15	→	225					1725	Metota 1 e rrjetës	1725
x	70	5																					
20	1400	100	→	1500																			
3	210	15	→	225																			
				1725																			
75x23	<table><tr><td>75</td><td></td></tr><tr><td>X 23</td><td></td></tr><tr><td>225</td><td>225=3x75</td></tr><tr><td>100</td><td>1500=20x75</td></tr><tr><td>1725</td><td>1725=1500+225</td></tr></table>	75		X 23		225	225=3x75	100	1500=20x75	1725	1725=1500+225	Metota 2 e rrjetës	1725										
75																							
X 23																							
225	225=3x75																						
100	1500=20x75																						
1725	1725=1500+225																						

56x27	x	20	7		Metoda 3 e rrjetës	1512
	50	1000	350	1350		
	6	120	42	162		
		1120	392	1512		
56x27	$  \begin{array}{r}  50 + 6 \\  \times (20+7) \\  1000 \quad 50 \times 20 \\  120 \quad 6 \times 20 \\  350 \quad 50 \times 7 \\  \hline  42 \quad 6 \times 7 \\  \hline  1512  \end{array}  $				Metoda 1 e shtyllës	1512
56x27	$  \begin{array}{r}  5 \ 6 \\  \times 2 \ 7 \\  1120 \quad 56 \times 20 \\  392 \quad 56 \times 7 \\  \hline  1512  \end{array}  $				Metoda 2 e shtyllës	1512
56x27	$  \begin{array}{r}  5 \ 6 \\  \times 2 \ 7 \\  392 \\  \hline  112 \\  \hline  1512  \end{array}  $				Metoda e zakonshme në shtyllë	1512

Përsëriten disa raste shumëzimi me këtë mënyrë, duke aktivizuar nxënës në tabelë.

### Faza e dytë: Punë e pavarur. Punë krijuese

Nxënësit punojnë faqen 67 dhe 68 të librit. Nxënësit përdorin letrat për të formuar numra dyshifrorë, plotësojnë problemat në vendet bosh me numra dyshifrorë dhe bëjnë zgjidhjen e tyre, duke përdorur mënyrën e mësipërme të shumëzimit të numrave dyshifrorë ose mënyra të tjera. Nxënësi bëjnë kontrollin e rezultateve me makinë llogaritëse ose celular. Kontroll i punës së nxënësve.

### Faza e tretë: Punë e drejtpërdrejtë

Shkruaj në tabelë dy shumëzime të numrave dyshifrorë me një numër njëshifror:

$  \begin{array}{r}  5 \\  48 \\  \times 7 \\  \hline  336  \end{array}  $	$  \begin{array}{r}  3 \\  86 \\  \times 5 \\  \hline  430  \end{array}  $
--	--

### Vlerësimi

#### Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- aftësinë për të përdorur mënyra të ndryshme të shumëzimit dhe për të përshkruar ato;
- saktësinë e kryerjes së veprimeve të shumëzimit;
- aftësinë krijuese në problema dhe zgjidhjen e tyre.

### Detyra dhe puna e pavarur:

Jepen 3 problemat krijuese të faqes 68 të librit dhe faqja 40 e fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Veprime me shkrim	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Shumëzimi i numrave dhjetorë			
<b>Situata e të nxënit:</b> veprime konkrete me shumëzim numrash dhjetorë			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Shumëzon një numër me një shifër pas presjes me një numër njëshifror. - Shumëzon një numër njëshifror e mënyra të ndryshme.			
<b>Fjalët kyçe:</b> numër dhjetor, prodhim, mënyrë shumëzimi.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, zare, letër, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit , arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Punë e drejtpërdrejtë, punë në dyshe, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Punë e drejtpërdrejtë</b>			
Mësuesi/ja shkruan në tabelë $5,8 \times 7 =$ . Si do të kryhet ky shumëzim. Merret mendimi i nxënësve. Shumëzimi i numrave dhjetorë bëhet njëloj si shumëzimi i numrave pa presje, dhe në fund vendoset presja duke numëruar shifrat nga fundi siç është numri i shifrave pas presjes, prandaj mënyrat e shumëzimit të numrave natyrorë përdoren edhe për numrat dhjetorë.			
$5,8 \times 7$		5	
$50 \times 7 = 350$		$5,8$	
$8 \times 7 = 56$		$\times \underline{7}$	
$350 + 56 = 406$ , prodhimi del 40,6		40,6	
Bëj 3-4 shumëzime të tjera me numrat dhjetorë me një numër njëshifror duke aktivizuar nxënës në tabelë të cilët përshkruajnë mënyrën e zgjedhur.			
<b>Faza e dytë: Punë në dyshe. Punë e pavarur</b>			
Nxënësit punojnë faqen 70 të librit. Nxënësit punojnë në dyshe. Një nxënësi hedh zarin dhe lëviz aq kuti sa tregon numri i zarit bën shumëzimin me numrin me presje. Nëse zari bie 4, nxënësi/ja shkon te kutia e katërt dhe kryen shumëzimin $4,7 \times 4$ . Shoku i vet bën korrigjimin, nëse veprimi është i saktë nxënësi vazhdon lojën, nëse jo ai humbet radhën dhe vazhdon tjetri e kështu me radhë. Fiton lojën ai nxënësi që del i pari në fund.			



**Faza e tretë: Punë drejtpërdrejtë. Punë krijuese**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë etiketa me çmime artikujsh me numër me presje. Dhe kërkon të gjendet kostoja për sasinë e dhënë me numër njëshifror.

Çmimi i një libri është 7,4 \$. Sa kushtojnë 8 libra? Nxënësit zgjidhin problemën dhe japin përgjigje.

Nxënësit krijojnë vetë problema duke mbështetur në etiketat të pasqyruara në tabelë, dhe japin zgjidhjen. Punohet me dyshe një krijon dhe problemën një nxënës tjetër shkruan zgjidhjen në tabelë.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- saktësinë në veprimet me numra me presje;
- aftësinë në punën krijuese me problemat;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit të marrin informacion mbi çmimet e artikujve të ndryshëm në supermarket dhe të krijojnë problema me shumëzim me numra me presje.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Veprime me shkrim	
<b>Ora 1:</b> <b>Tema mësimore:</b> Pjesëtimi			
<b>Situata e të nxënit:</b> veprimtari konkrete me pjesëtimin e numrave			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kryen pjesëtimin e një numri 3-shifror me një numër njëshifror me mbetje. - Shkruan herësi ne pjesëtimin si numër të përzier.			
<b>Fjalët kyçe:</b> pjesëtim, i pjesëtueshëm, pjesëtues, mbetje, numër thyesor, numër i përzier, veprim i kundërt.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, komplet letrash me shifra.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Bisedë, diskutim, punë e drejtuar, punë në dyshe, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimin:</b>			
<b>Faza e parë: Bisedë diskutim</b> Bisedohet dhe diskutohet mbi njohuritë mbi pjesëtimin. Pjesëtimin si veprim i ndarjes në pjesë të barabarta, si veprim i kundërt i shumëzimit, emërtimin i pjesëtueshëm, pjesëtues, herës, mbetje, mbetja është gjithmonë më e vogël se pjesëtuesi, plotpjesëtimin etj.			
<b>Faza e dytë: Punë e drejtuar</b> Shkruaj në tabelë $329 : 8 =$ Si do të kryhet pjesëtimi? Një mënyrë e pjesëtimin është: $329 = 320 + 8 + 1$ $320 : 8 = 40$ , $8 : 8 = 1$ , mbetja 1 $329 : 8 = 41(1)$ , herësi 41, mbetja 1.  Herësi mund të shkruhet edhe si numër i përzierë: $329 : 8 = 41\frac{1}{8}$ <div><div><div>329:8=41 (H)</div><div>329=41x8+1</div><div>-32↓</div><div>9</div><div>-8</div><div>1 (M)</div></div></div>			
Bëj 2-3 pjesëtime duke e paraqitur rezultatin me herës dhe mbetje, si numër thyesor dhe numër të përzier.			
<b>Faza e tretë: Punë në dyshe. Punë e pavarur</b> Nxënësit punojnë faqen 71 të librit. Nxënësit punojnë në dyshe, duke formuar numra treshifrorë me letra me shifra. Njëkohësisht përdorin dhe zarin për të zgjedhur numrin njëshifror. P.sh. Unë zgjodha 3, 4, 6, nga zari ra numri 5, pjesëtoj numrin 346 me 5, herësi 69 mbetja 1, pikët e fituara janë... Sa është mbetja?. Plotësohet tabela. Fiton ai që grumbullon më shumë pikë duke realizuar pesë pjesëtime secili.			

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- saktësinë e kryerjes së pjesëtimit;
- mënyra të ndryshme të kryerjes së pjesëtimit;
- shkrimin e rezultatit si numër thyesor dhe numër të përzierë;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Fletorja e punës në faqen 42.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Veprime me shkrim	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Pjesëtimi			
<b>Situata e të nxënit:</b> zbatime të pjesëtimeve në situata problemore			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kryen pjesëtime të numrave 2, 3-shifrorë me një numër njëshifror. - Krijon dhe zgjidh problema me pjesëtim.			
<b>Fjalët kyçe:</b> situata problemore, herës, mbetje			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, foto të ndryshme të printuara, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Punë krijuese, situata problemore, punë dyshe, shkëmbe një problemë, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimin</b>			
<b>Faza e parë: Punë e drejtuar</b> Mësuesi/ja kujton edhe njëherë pjesëtimin si veprim i ndarjes në mënyrë të barabartë, pjesëtimi si herë më pak. Dhe jep disa shembuj të thjeshtë duke kërkuar të ndajë në mënyrë të barabartë dhe të gjejë sa herë më pak. Mësuesi/ja paraqit para klasë foto të ndryshme. Nxënësit krijojnë problema të thjeshta me pjesëtime. Një nxënës lexon problemin e krijuar, kurse tjetri shkruan zgjidhjen dhe jep përgjigjen.			
<b>Faza e dytë: Punë krijuese. Shkëmbe një problemë. Punë dyshe</b> Nxënësit punojnë faqen 72 të librit. Nxënësit krijojnë problema nga imagjinata sipas modelit të zgjidhur në libër. Nxënësit këmbajnë me njëri-tjetrin problemat e krijuara dhe i zgjidhin. Bëhet kontrolli i punës së nxënësve.			
<b>Faza e tretë: Punë e drejtuar</b> Nxënësit kryejnë pjesëtime dhe i shkruajnë herësin në formë numri të përzier duke sqaruar pjesën e plotë dhe thyesore ku numëruesi është mbetja e pjesëtimin: $457 : 6 = 76 \text{ (1)}, 458 : 6 = 76\frac{1}{6}, 76 \text{ të plota dhe } 1/6, \text{ herësi } 76, \text{ mbetja } 1.$ Nxënësit aktivizohen në tabelë të kryejnë pjesëtime të ndryshme.			

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- aftësinë krijuese në problema;
- saktësinë në zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e veprimeve.

**Detyra dhe puna e pavarur**

Krijim të problemave me pjesëtim.



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>								
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Veprime me shkrim</b>									
<b>Ora 1</b>											
<b>Tema mësimore:</b> Më shumë për pjesëtimin											
<b>Situata e të nxënit:</b> situata konkrete problemore											
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Zgjidhin problema me pjesëtim. - Tregojnë ç’pjesë të së tërës kanë gjetur, pasi kanë gjetur herësin gjatë një plotpjesëtimi.											
<b>Fjalët kyçe:</b> herës, plotpjesëtim, ç’pjesë të tërës, zmadhoj/zvogëlon rezultatin, situatë problemore.											
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.									
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Punë krijuese, punë krijuese, punë e pavarur, punë në dyshe											
<b>Zhvillimi i mësimit</b>											
<b>Faza e parë: Punë e drejtpërdrejtë. Punë krijuese</b> Mësuesi/ja vizaton një tabelë si më poshtë:											
<table><tr><td><b>Numri gjithsej</b></td><td><b>Numri për kuti</b></td></tr><tr><td>450 lapsa</td><td>5 lapsa</td></tr><tr><td>630 çokollata</td><td>7 çokollata</td></tr><tr><td>366 celularë</td><td>6 celularë</td></tr></table>		<b>Numri gjithsej</b>	<b>Numri për kuti</b>	450 lapsa	5 lapsa	630 çokollata	7 çokollata	366 celularë	6 celularë		
<b>Numri gjithsej</b>	<b>Numri për kuti</b>										
450 lapsa	5 lapsa										
630 çokollata	7 çokollata										
366 celularë	6 celularë										
Nxënësit krijojnë problema duke parë informacionin në tabelë. Një nxënës lexon problemin, tjetri shkruan zgjidhjen në tabelë.											
<b>Faza e dytë: Punë në dyshe</b> Nxënësit punojnë faqen 74-75 të librit. Nxënësit punojnë në dyshe. Njëri zgjidh problemin tjetri bën kontrollin me anë të shumëzimit. Dhe gjen ç’pjesë ka gjetur nëpërmjet pjesëtimin. Nxënësit këmbëjnë rolet. Punohen problemat 1-5. P.sh.: Zgjidhja e problemit. Sa gurë zalli ka secili grumbull? $240 : 4 = 60$ gurë një grumbull. Është gjetur $\frac{1}{4}$ pjesë e gurëve. Kontrolli i pjesëtimin $60 \times 4 = 240$ . Kontrolli punës së nxënësve.											

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- aftësinë krijuese në problema;
- zgjidhjen e saktë të problemave;
- bashkëveprimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Formojnë dhe zgjidhin problema me pjesëtim. Bëjnë kontrollin e veprimeve me anë të shumëzimit.

<b>Fusha:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Veprime me shkrim	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Më shumë përpjesëtimin			
<b>Situata e të nxënit:</b> situata konkrete për zgjidhjen e problemave			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Zgjidh problema me pjesëtim. - Tregon nëse është e nevojshme në zvogëlimin apo zmadhimin e rezultatit të pjesëtimin në problemat me pjesëtim me mbetje.			
<b>Fjalët kyçe:</b> herës, situatë problemore, zvogëlim dhe zmadhim të rezultatit.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, foto të ndryshme të printuara, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> punë krijuese, situata problemore, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimin</b>			
<b>Faza e parë: Punë e drejtpërdrejtë. Punë krijuese</b> Nxënësve iu paraqiten skemat e mëposhtme:			
<div><div></div><div><div>580 copë</div><div>60 copë</div><div></div></div></div>			
Nxënësit krijojnë një problemë që zgjidhet me pjesëtim duke parë figurën më sipër. Një ëmbëltore do të ndajë në kuti që merrnin 60 copë 580 copë karamele. Sa kuti do të nevojiten? $580 : 60 = 9$ (40). A është e nevojshme të zmadhoni apo zvogëloni rezultatit? (Duhet të zmadhohmë numrin e karameleve me 20 copë që të mbushen 10 kuti të plota)			
<b>Faza e dytë: Punë e pavarur</b> Nxënësit punojnë faqen 76 të librit. Nxënësit zgjidhin problemat duke kryer pjesëtimet me mbetje. Gjejnë se me sa do të zmadhohjnë ose zvogëlojnë rezultatit, nëse është e nevojshme. Dhe shkruajnë herësin si numër të përzier. P.sh. P.1 $125 : 8 = 15$ (5), $125 : 8 = 15\frac{5}{8}$ . Zvogëlojmë numrin e pakove nga 125, në 120. $120 : 8 = 15$ kuti.			



**Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë faqen 43 të fletores së punës.

Punohet problemi 1.

Sa arka më nevojiten për të ndarë kutitë?  $72 : 15 = 4$ , mbetja 12. Pra duhet 4 arka të cilat mbushen plot dhe 1 arkë e cila do edhe 3 kuti të vogla të mbushet. Pra duhet të zmadhojmë numrin e kutive të vogla me 3 copë, pra 75 copë. Atëherë,  $75 : 15 = 5$  arka. Nxënësit punojnë problemat 2-4. Kontrolli i punës së nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- aftësinë krijuese në problema;
- zgjidhjen e saktë të problemave;
- bashkëveprimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Krijojnë dhe zgjidhin problema me pjesëtim si në faqen 43 të fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Veprime me shkrim</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Kllapat			
<b>Situata e të nxënit:</b> veprimtari konkrete për radhën e veprimeve			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Formon shprehje numerike me veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit duke përdorur kllapat. - Ndjek radhën e veprimeve në shprehjet pa kllapa dhe në shprehjet me kllapa.			
<b>Fjalët kyçe:</b> kllapa, formo shprehjen numerike, radha e veprimeve, vlera e shprehjes numerike			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, komplet letrash me shifrat 1-9, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Demonstrim, shpjegim, punë e drejtuar, punë krijuese, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Shpjegim demonstrim</b> Shkruhet në tabelë një shprehje numerike $48 : 6 \times 4 =$ . Si do të quhet ky barazim? Disa numra të lidhur me veprimet veprime të ndryshme do ta quajmë shprehje numerike. Rezultatin përfundimtar do ta quajmë vlerë të shprehjes numerike. Shpesh gjetja e shprehjes numerike, ka disa rregulla për gjetjen e rezultatit. Në fillim bëhet shumëzimi dhe pjesëtimi, pastaj mbledhja dhe zbritja. Asnjëherë veprimi i mbledhjes dhe zbritjes nuk kryhet para shumëzimit dhe pjesëtimit. P.sh.: $48 : 4 \times 6 = 12 \times 6 = 72$ , $24 + 2 \times 8 - 14 = 24 + 16 - 14 = 40 - 14 = 26$ (më parë u bë shumëzimi), $26 - 27 : 3 + 30 = 26 - 9 + 30 = 19 + 30 = 49$ (më parë u krye pjesëtimi). Numrat 72, 26, 49 quhen vlera të shprehjeve numerike.  Shpeshherë është e nevojshme që radha e veprimeve në një shprehje numerike të ndryshohet, prandaj në përdorim kllapat. Nëse një shprehje numerike ka kllapa, në fillim kryhet veprimi brenda kllapës, pastaj shumëzimi dhe pjesëtimi, mbledhja dhe zbritja. Këto janë rregulla të rëndësishme në matematikë dhe nuk mund të ndryshohen. Në shprehjet që morëm në fillim vendosim kllapat. $48 : (4 \times 6) = 48 : 24 = 2$ , $(24 + 2) \times 8 - 14 = 26 \times 8 - 14 = 208 - 14 = 194$ (më parë u bë veprimi brenda kllapave), $27 - (27 - 6) : 3 + 30 = 21 : 3 + 30 = 7 + 30 = 37$ më parë u krye veprimi i zbritjes brenda kllapave). Vazhdoj dhe me disa shprehje të tjera.			

**Faza e dytë: Punë e pavarur. Punë krijuese**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 77 të librit.

Nxënësit formojnë shprehje numerike duke përdorur dy veprime. P.sh.  $66 : 2 + 4 =$  dhe gjen vlerën e shprehjes numerike, duke kryer veprimet sipas radhës  $66 : 2 = 22$ ,  $33 + 4 = 37$  dhe pastaj shkruajnë shprehjen me kllapa,  $66 : (2 + 4) = 66 : 6 = 11$ , pra, vlera e shprehjes numerike nuk del e njëjtë. Nxënësit plotësojnë krijojnë shprehje numerike dhe plotësojnë tabelën duke dhënë zgjidhjen pa kllapa dhe me kllapa. Kontrolli punës së pavarur.

**Faza e tretë: Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqen 78 të librit, në të cilën janë shprehje me të katër veprimet. Nxënësit plotësojnë tabelën:

Shprehja numerike pa kllapa	Zgjidhja e parë	Shprehje numerike me kllapa	Zgjidhja e dytë
$5 + 4 \times 6 : 2$	$4 \times 6 = 24$ , $24 : 2 + 12$ , $12 + 5 = 17$	$(5 + 4) \times 6 : 2$	$9 \times 6 : 2 = 54 : 2 = 27$

Nxënësit plotësojnë rastet e tjera. Theksohet se vendosja e kllapave nuk është mënyrë tjetër, pasi vlerat e shprehjes nuk janë të njëjta, por rregull në radhën e kryerjes së veprimeve. Bëhet kontrolli punës së nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- saktësinë e kryerjes së veprimeve;
- krijimin e shprehjeve numerike me dhe pa kllapa;
- radhën e kryerjes së veprimeve në shprehje;
- fjalorin matematik të përdorur.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Jepet detyrë të krijojnë shprehje numerike pa kllapa dhe me kllapa dhe të gjejnë vlerën numerike të tyre.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Veprime me shkrim	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Kllapat			
<b>Situata e të nxënit:</b> rikujtim i pjesëtuesve të një numri dhe faktorët			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Gjen pjesëtuesit e një numri dyshifror. - Gjen prodhimin e dy numrave duke zbërthyer njërin numër në faktorë. - Krijon shprehje numerike me kllapa dhe gjen vlerën e shprehjes. - Vendos kllapat në një shprehje numerike të dhënë që të merret vlera numerike e dhënë.			
<b>Fjalët kyçe:</b> faktorë, pjesëtuesit e numrit, prodhim kllapa, vlerë e shprehjes numerike.			
<b>Burimet, mjetet:</b> etiketa me shifrat 1-9, libri i nxënësit faqe 79, fletorja e punës faqe 44-45, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> shpjegim, diskutim, punë krijuese, punë e pavarur			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Shpjegim, diskutim</b> Iu kujtohet nxënësve gjetja e pjesëtuesve të një numri. Pjesëtues të numrit quhet çdo numër që plotpjesëton atë. P.sh.: Pjesëtuesit e numrit 18 janë: 1, 2, 3, 6, 9, 18. Shkruaj disa numra të tjerë dhe nxënësit gjejnë pjesëtuesit e tyre. Shkruhet në tabelë barazimi $36 \times 18 =$ .Një mënyrë për të gjetur prodhimin është të zbërthejmë në faktorë njërin numër dhe të bëhet shumëzimi me faktorët për të gjetur prodhimin: $36 \times 18 = 36 \times 2 \times 3 \times 3 = 72 \times 3 \times 3 = 216 \times 3 = 600 + 30 + 18 = 630 + 18 = 648$			
<b>Faza e dytë: Punë e pavarur. Punë dyshe</b> Nxënësit punojnë të pavarur në dyshe në faqen 79 të librit. Gjen në fillim pjesëtuesit e një numri një nxënës, dhe tjetri për të kryer shumëzimet shkruajnë njërin numër në prodhim faktorësh. Kontrolli punës së pavarur.			
<b>Faza e tretë: Punë e drejtuar. Punë krijuese</b> Me etiketat e numrave me shifra ngre një nxënës dhe zgjedh rastësisht 3 shifra, p.sh. 4, 6, 5. Një nxënës tjetër formon një shprehje numerike duke përdorur të gjithë veprimet e njohura dhe një nxënës tjetër vendos kllapa në shprehje dhe gjen vlerën e shprehjes numerike. Bëhet krahasimi i përfundimeve. Theksohet edhe njëherë radha e veprimeve që kryhen në shprehjet me kllapa. Shkruhet në dërrasë dy shprehje numerike dhe vlera e saj. P.sh.: $3 + 4 \times 8 = 35$ , $8 : 4 \times 2 = 1$ , kërkoj nga nxënësit të vendosen kllapat që barazimi numerik të jetë i vërtetë. Nxënësit mendojnë dhe vendosin kllapat $3 + (4 \times 8) = 35$ , $8 : (4 \times 2) = 1$ .			

Nxënësi punojnë të pavarur faqen dhe 44-45 të fletores së punës. Nxënësit krijojnë duke punuar në grup dhe duke përdorur letrat me shifra, shprehje numerike me kllapa dhe gjejnë vlerën numerike. Në fund vendosin kllapat në shprehje, në mënyrë që shprehjet të jenë të vërteta. Nxënësit shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe bëjnë kontrollin e punës së kryer.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- gjetjen e pjesëtuesit të një numri dyshifror;
- gjetjen e prodhimin e dy numrave duke zbërthyer njërin numër në faktorë;
- krijimin e shprehjes numerike me kllapa dhe gjetjen e vlerës së shprehjes;
- vendosjen e kllapave në një shprehje numerike të dhënë që të merret vlera numerike e dhënë.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Krijim i shprehjeve numerike me kllapa me të 4 veprimet dhe të gjejnë vlerën numerike të tyre.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data:
Koha e zgjatjes: 45 minuta		Tematika: Veprime me shkrim	
Ora 1			
Tema mësimore: Veprime me shkrim			
Situata e të nxënit: përsëritje e mënyrave të kryerjes të veprimeve.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës: - Kryen veprimet me shkrim për mënyrat që ka mësuar. - Përdor veprime të ndryshme në problema. - Krijon dhe gjen vlerën e shprehjeve numerike me kllapa.			
Fjalët kyçe: shumë, ndryshesë, prodhim, herës, shprehje dhe vlerë numerike e shprehjes.			
Burimet, mjetet: skemë me kllastera, mjete shkrimi, etiketa.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuha e komunikimit, arte.	
Metodologjia e veprimitaria e të nxënit: Përsëritje e njohurive, situata problemore, punë krijuese në grup, punë e pavarur			
Zhvillimi i mësimi			
Faza e parë: Punë e drejtuar. Stuhi mendimesh Përgatitet ose vizatohet një skemë kllaster për përsëritjen e mënyrave të ndryshme të mësuara si me poshtë:			

Nxënësit vëzhgojnë skemën kllaster, japin mendimet e tyre si dhe mund të shtojmë etiketa të tjera në skemë për njohuritë e marra në kapitull.

### **Faza e dytë: Punë në grupe**

Duke u mbështetur nxënësit në një fletë shkruajnë nga një rast dhe bëjnë zgjidhjen dhe interpretimin e tyre. Bëhet kontrolli i punës.

### **Faza e tretë: Punë në grupe**

Mësuesi/ja ndalet në disa problema dhe situata ku nxënësit shfaqin vështirësi së bashku me nxënësit zgjidh në tabelë. Problema me shumëzim me numra dyshifrorë, pjesëtim me mbetje dhe numrat e përzierë, shprehje numerike me 4 numra dhe 4 veprime etj.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- aftësinë krijuese në problema dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre;
- saktësinë e veprimeve dhe shpejtësinë e tyre;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit krijojnë dhe zgjidhin ushtrime me mënyrat e mësuara për çdo veprim.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Veprime me shkrim	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Veprime me shkrim			
<b>Situata e të nxënit:</b> përsëritja e mënyrave të veprimeve me shkrim			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kryen veprimet me shkrim për mënyrat që ka mësuar. - Përdor veprime të ndryshme në problema. - Krijon dhe gjen vlerën e shprehjeve numerike me kllapa.			
<b>Fjalët kyçe:</b> shumë, ndryshesë, prodhim, herës, shprehje dhe vlerë numerike e shprehjes.			
<b>Burimet, mjetet:</b> etiketa me veprime të ndryshme dhe me njësi të ndryshme, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimitaria e të nxënit:</b> Përsëritje e njohurive, situata problemore, punë krijuese në grup, punë e pavarur			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>			
<b>Faza e parë: Punë krijuese. Punë në grup</b> Shkruaj në tabelë $7454 - 6398 =$ . Krijoni një problemë që të përdoret barazimi i mësipërm. Në një stadium në një ndeshje kishte 7457 tifozë, kurse në një ndeshje tjetër kishte 6398 tifozë. Sa tifozë më pak kishte në ndeshjen e dytë? Zgjidhja bëhet duke kryer zbritjen me anë të mbledhjes. $6398 + 2 + 600 + 454 = 7454$ , $600 + 454 + 2 = 1056$ tifozë. Etiketat e përgatitura:			
3468 km 2407 km	30 m; 8,93 m  138 rruaza 6 grumbuj	36 faqe; 98 pulla  48 x 12 Shumëzo me zbrëthim në faktorë	Gjatësia 9,7 m Gjërësia 8 m  36, 12 4, 7 kllapa
358 fletore 8 fletore	3 x 7 – 3 = 12 8 : 4 x 2 = 1 vendos kllapa		
Nxënësve iu shpërndahen etiketat, sipas grupeve. Nxënësit mendojnë se si mund të krijojnë problema dhe të kryejnë verimet, duke përdorur mënyrat me shkrim të mësuara. Nxënësit punojnë të pavarur në grupe dhe zgjidhjen e shkruajnë në fletë të veçanta. Një nxënës për çdo grup lexon problemin dhe zgjidhjen e tij.			



**Faza e dytë: Punë krijuese. Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë të pavarur faqet 80-81 të librit. Nxënësit duke diskutuar në grup, shkruajnë idetë e tyre për mënyrat e përdorura të veprimeve me shkrim, zgjedhin mënyrën që do të përdorin, krijojnë problema dhe bëjnë zgjidhjen e tyre.

Mund të përdorin etiketat që u përdorën më sipër duke i këmbyer grupet me njëri-tjetrin. Problemat shkruhen në libër së bashku me zgjidhjen. Kontrolli i punës së nxënësve.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- aftësinë krijuese në problema dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre;
- saktësinë e veprimeve dhe shpejtësinë e tyre;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Fletore e punës faqe 46.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Veprime me shkrim	
<b>Tema mësimore:</b> Përsëritje njohurish			
<b>Situata e të nxënit:</b> njohuritë e mësuara mbi veprimet			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Përsërit veprimet me shkrim për mënyrat që ka mësuar. - Kryen veprime të ndryshme në problema. - Krijon dhe gjen vlerën e shprehjeve numerike me kllapa.			
<b>Fjalët kyçe:</b> shumë, ndryshesë, prodhim, herës, shprehje dhe vlerë numerike e shprehjes.			
<b>Burimet, mjetet:</b> tabelë e përgatitur ku evidentohen të gjitha rastet e veprimeve të mësuara në kapitull, letër, mjete shkrimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuha e komunikimit, arte.	
<b>Metodologjia e veprimitaria e të nxënit:</b> Përsëritje e njohurive, situata problemore, punë krijuese në grup, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Punë në grupe. Punë krijuese</b> Nxënësve iu shpërndahen etiketat sipas grupeve. Nxënësit mendojnë se si mund të krijojnë problema dhe të kryejnë verimet, duke përdorur mënyrat me shkrim të mësuara. Nxënësit punojnë të pavarur në grupe dhe zgjidhjen e shkruajnë në fletë të veçanta. Nxënësit këmbëjnë etiketat dhe plotësojnë në fletë problemat dhe zgjidhjen e tyre. Ndahen detyrat në çdo grup. Një nxënës shkruan problemën një tregon rrugën e zgjidhjes, një bën veprimet dhe shkruan zgjidhjen. Një nxënës për çdo grup lexon problemin dhe zgjidhjen e tij.			
Etiketat e përgatitura:			
3468 - 2407 km (zbritje me anë të mbledhjes)	30 m; 8,93 m	36 faqe; 98 pulla Shumëzime me ndarje/tabelë	9,7m x 8m Shumëzim i numrave dhjetorë
358 fletore, 8 fletore	138 rruaza 6 grumbuj	36, 12, 4, 7 kllapa	3 x 7 – 3 = 12   8 : 4 x 2 = 1 vendos kllapa
	48 x 12 Shumëzo me zbrëthim në faktorë		

**Faza e dytë: Punë e drejtuar**

Mësuesi/ja ndalet në disa problema dhe situata ku nxënësit shfaqin vështirësi së bashku me nxënësit zgjidh në tabelë. Problema me shumëzim me numra dyshifrorë, pjesëtim me mbetje dhe numrat e përzierë, shprehje numerike me 4 numra dhe 4 veprime etj.

**Faza e tretë: Punë e drejtuar**

Mësuesi/ja shkruan disa shprehje me kllapa. P.sh.:  $6 \times (3 + 15) - (40 : 4) =$ . Nxënësit lexojnë shprehjen si dhe u kërkohet të tregojnë se çfarë do të gjejnë dhe cila është radha e veprimeve. Përsëriten raste të tjera dhe kërkohet që nxënësit të shprehen me fjalor matematik (gjejmë vlerën e shprehjes numerike, kryejmë veprimet sipas radhës etj.).

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- aftësinë krijuese në problema dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre;
- saktësinë e veprimeve dhe shpejtësinë e tyre;
- bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit krijojnë dhe zgjidhin ushtrime me mënyrat e mësuara për çdo veprim.

## TESTIM PËR NJOHURITË E MARRA NË KAPITULLIN E KATËRT

Emri/Mbiemri .....

**1- Rendit numrat e mëposhtëm nga më i vogli te më i madhi.**

245; 32,2; 31,08; 437

(1 pikë)

**2- Plotëso vargun edhe me tri kufiza.**

(6 pikë)

a) 11 ; 1 3 ; 15 ; 17 ; 19 ; \_\_\_\_\_ ; \_\_\_\_\_ : \_\_\_\_\_ .

b) 11 : 13 ; 14 ; 17 ; 21 ; \_\_\_\_\_ ; \_\_\_\_\_ : \_\_\_\_\_ .

**4- Paraqit si prodhim numrash të thjeshtë.**

(2 pikë)

a)  $32 =$

b)  $150 =$

**5. Krahaso.**

1 284 \_\_\_\_ 2 952 ;  $0,8$  \_\_\_\_  $0,75$  ;  $-195$  \_\_\_\_  $-432$  ;  $0,95$  \_\_\_\_  $0,85$

(4 pikë)

**6- Kryej veprimet.**

(9 pikë)

318476

90600

374

$985 : 3 =$

$3678 : 14 =$

$+ \underline{729745} \quad - \underline{39327} \quad \bullet \underline{24}$

a)  $12,6 \cdot 5 =$

b)  $57,23 \cdot 7 =$

c)  $45,9 : 3 =$

d)  $79 : 5 =$

**7. Gjej vlerën e shprehjes.**

(2 pikë)

$3 \cdot [ 34 - ( 28 : 4 + 12 ) + 4 \cdot 9 ] =$

**8. Xheni bleu 35 bonbone të vogla. Ajo i ndau ato ndërmjet pesë personave, në mënyrë të barabartë.**

(2 pikë)

- Sa bonbone mori secili prej tyre?

- Ç'pjesë të bonboneve keni gjetur?

9. Xheni dhe Xhorxhia mbledhën 350 guaska në breg të detit. Ato i ndanë guaskat në shtatë grumbuj në mënyrë të barabartë.

(2 pikë)

- Sa guaska ka secili grumbull?
- Ç'pjesë të guaskave keni gjetur?

10. Një makinë ecën me shpejtësi 68,8 km/orë. Sa km përshkon makina për 2.5 orë?

(2 pikë)

11. Harto dhe zgjidhe problemën me këtë llogaritje:  $8454 - 7398$

(3 pikë)

Pikët	0-8	9-12	13-16	17-21	22-26	27-29	30-33
Notat	4	5	6	7	8	9	10

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 min.		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Format gjeometrike</b> <b>Tema mësimore:</b> Diskutojmë së bashku			
<b>Situata e të nxënit:</b> Paraqitje figurash gjeometrike dhe diskutimi rreth tyre.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Përshkruan format trepërmasore sipas cilësive. - Dallojnë figurat gjeometrike nga trupat gjeometrikë. - Dallojnë shumëfaqëshat nga trupat e rrumbullakët. - Gjejnë numrin e kulmeve, brinjëve, faqeve të trupave gjeometrikë.			
<b>Fjalët kyçe:</b> forma trepërmasore, faqe, kulme, bazë, faqe të sheshta, faqe mbështjellëse, trupa të rrumbullakët, trupa të sheshtë, shumëfaqëshat, trupat e rrumbullakët, kulme, brinjë, faqe, rrotullim sipas një brinje			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, forma trepërmasore, seti i trupave gjeometrikë, kub, kuboid, prizma të ndryshëm, piramida të ndryshme, cilindër, kon, sferë.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësit do të hulumtojnë mjedisin e klasës dhe do të identifikojnë sende me forma trepërmasore. P.sh.: dollapi i librave, kutia e ndihmës së shpejtë në formë kuboidi, zari i lojës në formë kubi, lapsi në formë cilindri, topi i futbollit në formë sferë, kapela e ditëlindjes në formë koni etj. Veprimtaria vazhdon duke vendosur mbi tavolinë setin individual të trupave gjeometrikë. Nxënësit, ndërkohë, emërtojnë dhe kapin me dorë trupat e kompletit të tyre si më poshtë:  Gjatë veprimtarisë bëhen pyetje të tilla si:  – Si quhet ky trup gjeometrik? – Përse quhen trupa trepërmasorë? – Çfarë formash kanë trupat trepërmasorë? – Si i kanë faqet ato? – A mund t'i veçojmë nga grupi trupat me faqe të sheshta? Cilët janë?			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b> Diskutim i njohurive paraprake. Vendos disa trupa në tavolinë dhe disa figura gjeometrike.			

Nxënësit vijnë dhe i vëzhgojnë ato. I pyes nxënësit.

- Çfarë shikon mbi tavolinë?


- Grupoji ato në dy grupe

figura

trupa

- Cili është ndryshimi midis tyre?

- A njeh disa nga trupat e paraqitur? Emërtoi ato.



Hapet teksti i nxënësit në faqen 83 dhe lexohet titulli i mësimi. Ata duhet të numërojnë faqet e trupave gjeometrikë të dhënë. Nxiten nxënësit të marrin një kub në dorë dhe ta vëzhgojnë. Çfarë vini re duke e shikuar horizontalisht? (Shikohet një faqe). Çfarë forme ka kjo faqe? (Faqja ka formën katrore). Sa faqe ka të tilla? (Gjithsej ka 6 faqe të tilla).

### Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

**Lojë:** Në këtë fazë organizohet një lojë në dyshe me shokun e bankës. Njëri nxënës mbyll sytë dhe tjetri i vendos në tryezë një trup. Pyetet nxënësi se çfarë trupi është vendosur. Ai duke e prekur me dorë e identifikon atë dhe e emërton. Veprimtaria vazhdon duke ndërruar rolet e nxënësve me njëri-tjetrin.

Punohen individualisht nga nxënësit ushtrimet e tekstit, ku zbatojnë kërkesat në lidhje me emërtimin e trupave gjeometrike, llojin e faqeve të tyre, plotësojnë tabelën duke gjetur nr. e kulmeve, brinjëve, faqeve.







### Vlerësimi

#### Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:

- përshkrimin e formave trepërmasore sipas cilësive;
- dallimin e shumëfaqësheve nga trupat e rrumbullakët;
- evidentimin e nr. të kulmeve, brinjëve, faqeve të trupave gjeometrikë.

### Detyra dhe puna e pavarur:

Plotësimi i fletores së punës.




<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Trupat gjeometrikë			
<b>Situata e të nxënit:</b> Vizatohen trupa gjeometrikë të hapur, emërtohen dhe përshkruhen			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Rendit objekte nga mjedisi të cilët janë të ngjashëm me trupat gjeometrikë. - Përshkruan trupa gjeometrikë duke dalluar brinjët, kulmet, faqet. - Përdor imagjinatën për zgjidhjen e situatave gjeometrike. - Klasifikon trupat gjeometrikë sipas llojit.			
<b>Fjalët kyçe:</b> trupat gjeometrikë kub, kuboid, cilindër, prizëm, piramidë, sferë, kon, faqet, brinjët, kulmet			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, kompleti i trupave gjeometrikë, modele demonstruese të trupave gjeometrikë hapur.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <b>Faza e parë:</b> Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
<b>Veprimtaria e parë: Pyes nxënësit</b> - Cilët janë trupat gjeometrike? Ç’дини për kubin? Sa faqe, kulme, brinje ka? Si i ka faqet? Cilat janë përmasat e tij? Po për kuboidin ç’дини? Sa faqe, kulme, brinjë ka?			
<div></div>			



**Faza e dytë: Njohuritë e reja**

Mësuesi/ja ka përgatitur disa modele të hapura trupash prej kartoni. Ua tregoj nxënësve dhe përcaktojmë së bashku natyrën e faqeve të tij e më pas trupin të cilit i përket ai model.

Jepen hapjet e trupave, emërto.



Hapet teksti në faqen 88.

Nxënësit punojnë të pavarur në libër hapjen e kubit, piramidës, kuboidit dhe prizmit. Ndjek nxënësit dhe ofroj ndihmë për nxënësit që kanë vështirësi. Bëhet korrigjimi kolektiv i punës së nxënësve.

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Mësuesi/ja e ndan punën në grupe dhe u kërkon nxënësve të njërit grup të përshkruajnë një trup gjeometrik në formën e një gjëgjëze dhe t'ia japin grupit tjetër për ta gjetur. Kështu grupet bashkëpunojnë me njëri-tjetrin duke këmbyer përshkrimet mes njëri-tjetrit. Përgëzohen nxënësit për plotësimet dhe të punuarit në bashkëpunim.

**Vlerësimi**

Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:

- emërtimin e trupave gjeometrikë duke i grupuar në dy grupe;
- dallimin dhe përcaktimin e faqeve që e përbëjnë një trup të hapur gjeometrik;
- vizatimin në fletë katrore trupa gjeometrikë të ndryshëm.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Drejtëzat			
<b>Situata e të nxënit:</b> Vizaton lloje të ndryshme vijash në një plan dhe emërton çiftet e drejtëzave paralele dhe pingule.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Dallon drejtëzat që priten. - Emërton drejtëzat pingule dhe ato paralele. - Vizaton çifte drejtëzash prerëse, paralele dhe pingule.			
<b>Fjalët kyçe:</b> drejtëza paralele, drejtëza pingule, drejtëza prerëse			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, vizore, libër, vizore		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë, stuhi mendimesh, grafiku i përvijimit (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  <b>Faza e parë: Stuhi mendimesh</b> Njohja e nxënësve me temën. Përsëritet me nxënësit njohuritë e marra në klasën e katërt në lidhje me drejtëzat duke plotësuar kllasterin.			
<div><div><div>Paralele</div><div></div><div>Prerëse</div></div><div><div></div><div>Vijë e drejtë që nuk ka skaje, pra as fillim as fund</div></div><div><div></div><div>(a)</div><div></div><div>(b)</div><div></div><div>(c)</div><div></div><div>(d)</div></div><p>Në tabelë vizaton figurat.</p><div><div></div><div>(a)</div><div></div><div>(b)</div><div></div><div>(c)</div><div></div><div>(d)</div></div><p>4)</p><p>Kërkoj nga nxënësit të vërejnë figurat dhe të dallojnë drejtëzat, paralele dhe pingule.</p></div>			

**Faza e dytë: Punë e pavarur**

Fillimisht u tregoj nxënësve mënyrën e ndërtimit të dy drejtëzave paralele si dhe të dy drejtëzave pingule.

Më pas, nxënësit do të punojnë individualisht për punimin e detyrave të tekstit. Mësuesi/ ja orienton nxënësit për të vëzhguar shembullin e dhënë në tekst të vizatojnë modelin e vet në hapësirat boshe si dhe do të renditë format që shikon. Paraqes në një tabak vizatimin e bërë nga Dea. Nxënësit identifikojnë me hollësi çdo element të saj duke përfshirë gjithë klasën në diskutim.

**Faza e tretë: Rishikimi në dyshe**

Kontrollojnë ushtrimet me njëri-tjetrin në dyshe. Disa prej ushtrimeve punohen në tabelë. Diskutohet rreth tyre, duke argumentuar secila nga pohimet është e vërtetë dhe cila jo.

**Vlerësimi:****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**


- emërtimin e drejtëzave pingule, prerëse dhe ato paralele;
- vizatimin e çifteve të drejtëzave prerëse, paralele dhe pingule.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Gjeometria	
<b>Tema mësimore:</b> Këndet			
<b>Situata e të nxënit:</b> Prezantimi i llojeve të këndeve dhe klasifikimi i tyre.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Njohin këndin si një figurë të thjeshtë gjeometrike. - Përcaktojnë llojin e këndit nëpërmjet skuadrës (ose duke e krahasuar me një kënd të drejtë). - Përcaktojnë drejtëzat pingule sipas këndeve të drejta që formohen midis tyre.			
<b>Fjalët kyçe:</b> kënd, kënd i drejtë, i ngushtë, i gjerë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, trekëndësh kënddrejtë, raportor, këndngushtë, këndgjerë		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> <b>Veprimtaria e parë: Stuhi mendimesh</b> Ç’është gjysmëdrejtëza? Ç’është segmenti? A ka fillim dhe mbarim drejtëza? Kur drejtëzat janë pingule, paralele dhe priten?			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja</b> <b>Grafiku i përvijimit</b> Në fillim pasqyrojmë diagramin e këndit.			
<div><div><div>Çfarë quhet kënd?</div><div>Këndi</div><div>i drejtë i ngushtë i gjerë i shtrirë i plotë</div><div>kulm brinjë</div></div></div>			

Bashkë me nxënësit marrim një pikë në tabelë (fletë formati). Nga kjo pikë hiqen dy gjysmëdrejtëza jo në një vijë të drejtë.



Në sa pjesë ndahet plani?


Këto quhen kënde.

Pika O → kulmi.

Gjysmëdrejtëzat, OA, OB, quhen brinjë.

Vështro skuadrën. Si janë brinjët e këndit? Këndi është pjesë e planit e formuar nga rrotullimi i gjysmëdrejtëzës rreth origjinës.

**Vizato tri kënde.**



Vendos skuadrën mbi këto kënde.

Çfarë vë re për njërën nga gjysmëdrejtëzat e këndeve?

1 → është brenda skuadrës ( $<$  këndi i drejtë) → i ngushtë

2 → është jashtë skuadrës ( $>$  këndi i drejtë) → i gjerë

3 → është brenda skuadrës (90 gradë) → i drejtë. Hapen librat.

Mësuesi/ja orienton nxënësit rreth detyrës. Individualisht ata do të vizatojnë dhe emërtojnë kënde të drejta, të ngushta, të gjëra duke përdorur vizore. Mësuesi/ja fton nxënësit të matin këndin me raportor duke i rumbullakuar masat deri në 5 gradë më të afërta. Nxënësit gjejnë shumën e këndeve në çdo trekëndësh.

### Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja u ndan detyrën në grupe, e cila zhvillohet në formë gare. Njëri grup vizaton këndin ndërsa grupi tjetër e emërton atë dhe identifikon brinjët, origjinën dhe masën e këndit të përfshirë ndërmjet brinjëve.


#### Vlerësimi

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- përcaktimin e llojeve të këndeve nëpërmjet skuadrës (ose duke e krahasuar me një kënd të drejtë).

#### Detyra dhe puna e pavarur:

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Trekëndëshat			
<b>Situata e të nxënit:</b> Emërton trekëndëshat sipas brinjëve dhe këndeve.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Përkufizon trekëndëshin si shumëkëndëshi më i vogël në numrin e brinjëve. - Klasifikon trekëndëshat sipas madhësisë së brinjëve. - Klasifikon trekëndëshat sipas madhësisë së këndeve. - Vizaton, emërton dhe përshkruan trekëndëshat sipas brinjëve e këndeve.			
<b>Fjalët kyçe:</b> trekëndësh i çfarëdoshëm, trekëndësh dybrinjënjëshëm, trekëndësh barabrinjës, trekëndësh kënddrejtë, trekëndësh këndngushtë, trekëndësh këndgjerë			
<b>Burimet, mjetet:</b> vizore, figura të mësipërme të ndërtuara me karton, komplet figurash gjeometrike		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin. Krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimi: Faza e parë</b> Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Stuhi mendimesh. Mësuesi/ja ka paraqitur përpara klasës pamje figurash gjeometrike dhe kërkon nga nxënësit që të emërtojnë këto figura gjeometrike. - Ç'është shumëkëndëshi? Si pjesë e planit e kufizuar nga një vijë e thyer e mbyllur, së bashku me vijën. Shumëkëndëshat janë figura gjeometrike, që kanë 3 ose më shumë brinjë. - Cili është shumëkëndëshi më i vogël në numrin e brinjëve?			
Jepet.			
<div></div>			
Emërto figurën. Përcakto elementet e figurës. Emërtohen elementët e trekëndëshit: si brinjë, kulm, kënd. - Cilat janë llojet e trekëndëshave sipas brinjëve? - Cilat janë llojet e trekëndëshave sipas këndeve?			


**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

Nxënësit kërkojnë në ambientin rreth klasës forma të trekëndëshave. U kujton nxënësve kuptimin e termave: i ngushtë, i gjerë, i drejtë. Mësuesi/ja vizaton në tabelë lloje e trekëndëshave sipas brinjëve dhe këndeve dhe së bashku me nxënësit identifikon brinjë, kulme, kënde. Mësuesi/ja mat gjatësinë e brinjëve dhe këndeve dhe në bazë të dhënave nxënësit emërtojnë llojet e trekëndëshave.

**Tabela e koncepteve. Punë e pavarur**

	të gjitha brinjët e çfarëdoshme	2 brinjë të =	të gjitha brinjët e =	një kënd të drejtë	një kënd të gjerë	të gjitha këndet e ngushta
<b>Figurat</b>						
I çfarëdoshëm	<b>X</b>					
dybrinjënjëshëm		<b>X</b>				
barabrinjës			<b>X</b>			
këndngushtë						<b>X</b>
kënddrejtë				<b>X</b>		
këndgjerë					<b>X</b>	

Tabela plotësohet duke vendosur shenjën “X” dhe duke pyetur nxënësit. Më pas nxirren disa konkluzione. Hapet teksti. Punohen individualisht nga nxënësit plotësimi i tabelës për vizatimin, emërtimin, përshkrimin e llojeve të trekëndëshave sipas brinjëve e këndeve.

**Faza e tretë: Plotësohet Diagrami i Venit**





Diskutime dhe konkluzione.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- klasifikimin e trekëndëshave sipas madhësisë së brinjëve;
- klasifikimin e trekëndëshave sipas madhësisë së këndeve.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Simetria			
<b>Situata e të nxënit:</b> Paraqitje figurash të ndryshme dhe përcaktimi i drejtëzës së simetrisë.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Ndan një figurë në dy pjesë simetrike, në mënyrë intuitive. - Krijon figura të ndryshme simetrike, duke prerë ose palosur sipas drejtëzës së simetrisë. - Vizaton drejtëzën e simetrisë të figurave të thjeshta gjeometrike. - Shfaq vullnet në arritjen e rezultateve.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Simetri, drejtëz e simetrisë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> teksti i nxënësit, letra, foto të ndryshme, gërshtë, fruta si mollë, portokall etj.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin. Krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Imagjinoni sikur jeni në natyrë. Gjeni disa figura simetrike. Vizato disa prej tyre: flutura, gjethja, ylli, fytyra, lulja etj. Ndajini në mes, duke vizatuar drejtëzën e simetrisë. A u krijuan figura simetrike? Nxënësit zhvillojnë disa veprimtari, të cilat i ndihmojnë për të krijuar figura simetrike. Marr një fletë dhe e palos në dy pjesë të barabarta. Vija e palosjes është drejtëza e simetrisë. Përsëritet veprimtaria nga nxënësit. Shëno një njollë boje nga njëra anë, palose me kujdes sipas drejtëzës së simetrisë që krijove në fillim. Hape pas disa sekondash dhe do të shikosh që ke krijuar një njollë simetrike me të parën në anën tjetër. Marrim një mollë, e presim në mes, kemi krijuar dy pjesë simetrike të njëra-tjetrës.			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim. Punë në çifte</b> Hapen librat. Mësuesi/ja orienton nxënësit të punojnë në dyshe. Njëri nxënës vizaton në njërën anë të boshtit të simetrisë, tjetri duhet të vizatojë të njëjtën figurë në anën tjetër të boshtit të simetrisë. Nxënësit gjejnë drejtëzat e simetrisë së figurave gjeometrike dhe numërojnë se sa figura simetrike mund të ndërtojnë në tekst. Orientoj se drejtëza e simetrisë mund të ndërtohet në drejtime të ndryshme. Mësuesi/ja merr një fletë letre dhe e demonstroi para klasës. Brenda saj vizaton dhe pret një katror. Në njërin kulm vizatoj një pikë. Rrotullohet katrori sa ¼ e rrotullimit katër herë. Pyes nxënësit: Çfarë vë re?			
<div><div></div><div></div><div></div><div></div></div>			



Kjo do të thotë se katrori ka rendin e 4 të simetrisë rrotulluese, sepse përputhet 4 herë me veten gjatë një rrotullimi të plotë. Më pas, nxënësit të ndarë në grupe do të vizatojnë, presin figurat dhe do t'i rrotullojnë ato për të parë nëse kanë simetri rrotulluese.



Nxënësit plotësojnë tabelën duke vizatuar figurat dhe shkruajnë për secilin rendin e simetrisë rrotulluese dhe boshtore.

### **Faza e tretë:**

Në një fletë A4, nxënësit do të vizatojnë një shumëkëndësh me simetri rrotulluese. Pas përfundimit paraqiten fletët në tabelë.






### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- vizatimin e drejtëzave të simetrisë të figurave të thjeshta gjeometrike;
- emërtimin dhe përshkrimin e trupave gjeometrikë duke dalluar: brinjë, kulme, faqe;
- hapjen e trupave gjeometrikë.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Shumëkëndëshat			
<b>Situata e të nxënit:</b> Paraqitja e figurave gjeometrike dhe diskutimi rreth tyre.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikojnë dhe emërtojnë shumëkëndëshat.</li> <li>- Tregojnë disa elemente të ndryshme të shumëkëndëshave.</li> <li>- Përcaktojnë numrin e brinjëve dhe të këndeve të një shumëkëndëshi.</li> </ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> shumëkëndësh, brinjë, kënde, kulm, diagonal, segment.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, vizore, komplet figurash gjeometrike		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin. Krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>  <b>Veprimtaria e parë: Stuhi mendimesh</b>  Më përmend disa figura gjeometrike që njeh? Cila nga figurat është shumëkëndësh? Pse? Çfarë elementesh kanë shumëkëndëshat?  <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;">      </div>			
Përcakto sa është numri i brinjëve, numri i këndeve, numri i kulmeve të shumëkëndëshave të formuar? Si është numri i brinjëve me numrin e këndeve të çdo shumëkëndëshi? Cili është shumëkëndëshi me numër brinjësh më të vogël? Emërtimi i shumëkëndëshit, a është i njëjtë me numrin e brinjëve? Shumëkëndëshat janë figura gjeometrike, që kanë 3 ose më shumë brinjë. Përkufizoj se çfarë është shumëkëndëshi. Theksoj diagonalet si elemente të një shumëkëndëshi.			

**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

Mësuesi/ja kërkon që duke parë figurat gjeometrike në tabelë, nxënësit të dallojnë shumëkëndëshat e rregullt duke parë si karakteristikë gjatësi të njëjtë brinjësh dhe masë këndi të barabartë dhe në këtë grup futen trekëndëshat barabrinjës, katrori dhe gjashtëkëndëshat. Nxënësit bëjnë dy hulumtime.

**Hulumtimi 1:** Ata vizatojnë një drejtkëndësh në një letër me katrorë. Vizatojnë një drejtëz simetrie imagjinare në njërin kulm që të jetë paralele me diagonalen e tij.

**Hulumtimi 2:** Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të vizatojnë sipas kërkesës (kjo veprimtari do të kryhet në çift). Palosin një flete letre katrore përgjysmë dhe më pas paloset përsëri përgjysmë. Vizaton një figurë në një nga çereket e fletës. Shoku i tij zgjedh një nga çerekët e tjerë dhe kopjon figurën, në mënyrë që të jetë simetrike me të parën. E njëjta veprimtari zhvillohet edhe dy herë të tjera që fleta të ketë modelin e plotë. Vizatohet në tekst modeli i përfunduar. Më pas nxënësit punojnë individualisht ushtrimet në faqen 97, ku plotësojnë tabelën me emërtimin e shumëkëndëshave dhe numrin e drejtëzave të simetrisë.

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Në fletoren e klasës, nxënësit vizatojnë shumëkëndësha i emërtojnë ato dhe shkruajnë disa nga vetitë e veçanta që kanë katërkëndëshat. Kontrollonjë ushtrimet me njëri-tjetrin në dyshe. Diskutohet rreth: shumëkëndëshave, diagonalet e tyre dhe tregojnë elementet për secilin shumëkëndësh.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- dallimin dhe emërtimin e shumëkëndëshave;
- përcaktimin e elementet që përbëjnë një shumëkëndësh;
- dallimin e shumëkëndëshave të rregullt.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Format gjeometrike			
<b>Situata e të nxënit:</b> Ndërtojmë dhe përshkruajmë trupat gjeometrikë			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Dallon dhe emërton trupat gjeometrikë (kub, kuboid, cilindër, prizëm me bazë katrore, piramidë, sferë, kon). - Klasifikon trupat gjeometrikë në dy grupe: shumëfaqësja dhe trupa rrotullimi. - Përshkruan trupat gjeometrikë duke treguar vetitë e tyre si: numri i brinjëve, i faqeve, i kulmeve.			
<b>Fjalët kyçe:</b> trupat gjeometrikë :kub, kuboid, cilindër, prizëm, piramidë, sferë, kon.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, Paketa me trupat gjeometrikë modele trupash me plastelinë demonstruese për mësuesin.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>			
<b>Veprimtaria e parë:</b> Mësuesi/ja paraqet në tabelë trupat gjeometrikë dhe kërkon që nxënësit t’i emërtojnë ato. U kërkohet nxënësve të renditin emrat e disa objekteve që kanë formën e një trupi gjeometrik në ambientin e klasës dhe në natyrë duke plotësuar ditarin dypjesësh.			
Objektet në klasë		Forma gjeometrike	
Objektet në natyrë		Forma gjeometrike	
<b>Faza e dytë: Të punuarit në bashkëpunim</b>			
Nxënësit nxjerrin kompletin me trupat gjeometrikë. Ata do të punojnë në grupe. Me plastelinë do të ndërtojnë trupat gjeometrikë. Më pas do të plotësojnë tabelën ku përcaktojnë elementet përbërëse të trupit gjeometrik: numrin e faqeve, numrin e sipërfaqeve të lakuara, format e faqeve, numri i kulmeve, numri i brinjëve.			

Trupi gjeometrik	Kub	Kuboid	Piramidë trekëndore	Prizëm trekëndor	Sferë	Kon	Cilindër
Numri i faqeve	6	6	4	5	1	2	3
Numri i brinjëve	12	12	6	9	0	0	0
Numri i kulmeve	8	8	4	6	0	1	0
format e faqeve	katrore	Drejtken dështa	Trekën dështa	Trekën dështa	Të lakuar		

### Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të përshkruajnë një trup gjeometrik në formën e një gjëgjëze dhe t'ia japin për ta gjetur grupit tjetër. Kështu grupet këmbajnë përshkrimet mes njëri-tjetrit. Stimulohen nxënësit për plotësimet dhe të punuarit në bashkëpunim.

#### Vlerësimi

##### Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:

- dallimin dhe emërtimin e trupave gjeometrikë: kub, kuboid, cilindër, prizëm, piramidë, sferë, kon;
- klasifikimin e trupat gjeometrikë në dy grupe: shumëfaqësha dhe trupa rrotullimi;
- përshkruan trupat gjeometrikë duke treguar vetitë e tyre si: numri i brinjëve, i faqeve, i kulmeve.

##### Detyra dhe puna e pavarur:


Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Vendndodhja dhe lëvizja</b> <b>Tema mësimore:</b> Diskutojmë së bashku			
<b>Situata e të nxënit:</b> Nxënësit bashkëveprojnë njëri me tjetrin në veprimtari për të lëvizur sipas drejtimeve të horizontit, drejtimit kundërorar dhe drejtimeve të ndërmjetme.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Përdor instruksione për pozicione, drejtime apo lëvizje të ndryshme me drejtim sipas pikave të horizontit e drejtim kundërorar. - Përdor imagjinatën dhe busullën për orientim në terren. - Vizaton dhe përshkruan në planimetri drejtimet që përshkruan.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Veri, veriperëndim, verilindje, majta, rrotullim, drejtim kundërorar.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, skicë e një shkolle, top pingpongu		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>  <b>Veprimtaria e parë:</b> Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se do të luajnë një lojë. Imagjinoni që ju jeni në një ekuipazh të një anijeje gjatë një stuhie në det. Nxënësit do të imagjinojnë se anija e tyre po lëkundet para, pas, majtas, djathtas dhe kështu ata duhet të lëvizin me anijen dhe të përcaktojnë drejtimet e lëvizjes: lindja në perëndim, nga veriu në jug, drejtim orar, drejtim kundërorar. Nxënësit orientohen me anën e një busulle të gjejnë pozicionet.			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b>  Mësuesi/ja paraqet në një tabak letre skicën e shkollës. Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve:  Në cilin drejtim lëvizet për në shkollë?  Ku ndodhet hyrja? Çfarë shihni në të djathtë të hyrjes së shkollës? Po në të majtë?  Në cilin drejtim është palestra e shkollës? Po kaldaja e shkollës?			

Nxënësit identifikojnë në skicë klasat, bibliotekën, tualetet, shkallët e emergjencës, zyrat e drejtorit, psikologes, parashkollorin duke përdorur termat: Veri, veriperëndim, verilindje, majta, rrotullim, drejtim kundërorar. Më pas vizatojnë në planimetri rrugën dhe përshkruajnë drejtimet që përshkruan. Hapet teksti dhe nxënësit do të tregojnë se si shkohet nga hyrja nëpër klasa të ndryshme. Në grupe, nxënësit do të hartojnë pyetje për drejtimet e ndryshme të lëvizjes. Mësuesi/ja ndjek punën e tyre dhe ndihmon nxënësit që mund të kenë vështirësi.

### **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Lojë: Nxënësit punojnë në grup. Në një tabak letre vizatohet një rreth dhe katër drejtimet. Një nxënës hedh topin e pingpongut dhe të tjerët do të gjejnë drejtimin e lëvizjes së topit.



### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- përcaktimin e drejtimeve apo lëvizje të ndryshme me drejtim sipas pikave të horizontit;
- përdorimin e imagjinatës për orientim në terren apo në hartë;
- përdorimin e busullës për orientim në terren apo në hartë;
- demonstrimin e pavarësisë në lidhjen me figura nga jeta reale.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Koordinatat			
<b>Situata e të nxënit:</b> Kryhen manipulime të ndryshme në rrjetin koordinativ.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Gjen vendndodhjen e disa objekteve sipas koordinatave të dhëna. - Përcakton koordinatat kur janë dhënë figurat. - Krijon rrjete koordinative me figura dhe përcakton koordinatat.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Rrjet koordinativ, koordinata vertikale, horizontale, vendndodhje			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, modele demonstruese të rrjetit kordinativ		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>			
<b>Veprimtaria e parë: Vëzhgo-diskuto-nxirr përfundim</b> Mësuesi/ja organizon këtë situatë: paraqet para nxënësve një rrjet katrorësh me drejtim vertikal e horizontal, pra në rresht e ne shtyllë. Këto drejtime do t’i quajmë koordinata. Koordinata e parë quhet horizontale, koordinata e dytë quhet vertikale. Leximi fillon gjithmonë nga drejtimi horizontal. Bashkimi i dy koordinatave japin një pikë apo një figurë. Brenda në rrjet janë të vendosur disa pika të ndryshme. Me ndihmën e koordinatave përcaktojmë vendndodhjen e këtyre pikave brenda rrjetit koordinativ. Lexohen koordinatat p.sh.: Pika a ndodhet në (3, 2), pika h (8, 4) etj.			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja</b>			
Hapet teksti dhe nxënësit në ushtrimi 1 do të shkruajnë koordinatat në rrjetin koordinativ dhe në ushtrimin 2 do të shënojnë pikat që kanë këto koordinata (10,10), (6,7), (2,7), (4,6), (7,3), (9,5). Pas bashkimit të pikave, nxënësit do të emërtojnë figurën.			
<b>Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Punë në çifte</b>			
Në faqen 103 është dhënë një rrjet koordinativ. Njëri nxënës shënon tri kulme të një katrori të vogël në rrjet. Shoku i tij do të gjejë koordinatat e kulmit që mungon për të formuar katrorin. Pyete shokun: Pse e vendose kulmin e katërt këtu? Vazhdohet veprimtaria me një trekëndësh kënddrejtë dhe një trekëndësh me një kënd të gjerë.			




**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- gjetjen e vendndodhjen e disa pikave sipas koordinatave të dhëna;
- përcaktimin e koordinatave kur janë dhënë pikat;
- krijimin e rrjeteve koordinative me figura gjeometrike dhe përcaktimin e koordinatave.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Simetria në lidhje me një drejtëz			
<b>Situata e të nxënit:</b> Pasqyrimi i simetrikut të një figure në një rrjet koordinativ.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Dallon drejtëzën e simetrisë në një figurë. - Ndërton pikën simetrike me një pikë të dhënë në rrjetin koordinativ. - Ndërton simetrike të figurave të thjeshta gjeometrike në rrjetin koordinativ kur është dhënë drejtëza e simetrisë dhe figura gjeometrike. - Vizaton në rrjetin koordinativ simetrike të një figure të dhënë, në lidhje me një drejtëz paralele me boshtin koordinativ.			
<b>Fjalët kyçe:</b> drejtëz simetrie, figure simetrike, rrjet koordinativ, vendndodhja, pikat, koordinatat, boshti horizontal, boshti vertikal, simetria në rrjetin koordinativ.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, modele me simetrinë e figurave të ndryshme gjeometrike në një tabak.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>			
<b>Faza e parë:</b> Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
Veprimtaria e parë: Si mendoni, si janë këto figura?			
1. nga forma;			
2. nga përmasat.			
			
Drejtëza (d) është drejtëz simetrie e drejtkëndëshit ABCD.			
- Çfarë mund të themi për pikat A me B dhe D me C, nëse paloset figura sipas drejtëzës (d)?			
- Si janë largësitë OA me OB dhe DE me EC? Pse themi që pikat janë simetrikë?			
Pse themi që segmentet janë simetrikë? Sepse po ta palosim fletën sipas drejtëzës së simetrisë, segmentet përputhen. Segmentet simetrike kanë gjatësi të njëjtë.			

**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

Nxënësit punojnë individualisht ushtrimin në faqen 104. Orientohen nxënësit të vëzhgojnë figurat në rrjetet koordinative. Ata do të pasqyrojnë secilën prej tyre në anën tjetër të diagonales.

Në ushtrimin e faqes 105 nxënësit do të pasqyrojnë figurat në lidhje me secilin bosht, në mënyrë që të jenë katër figura në çdo kuadrat. Pas matjeve dhe krahasimeve do të dalin në përfundimin se figurat janë simetrikë.

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**


Në fletoren e klasës, nxënësit do të vizatojnë një figurë sipas dëshirës në rrjet koordinativ dhe do të pasqyrojnë simetriken e saj. Mësuesi/ja ndjek punën e tyre dhe ndihmon nxënësit që mund të kenë vështirësi.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- vizatimin në rrjetin koordinativ të simetrikes së një figure të dhënë, në lidhje me një drejtëz paralele me boshtin koordinativ;
- vizatimin e simetrikes së një figure në lidhje me një drejtëz simetrie;
- pasqyrimin e figurave në lidhje me secilën bosht, në mënyrë që të jenë katër figurat në çdo kuadrat.


**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Simetria në lidhje me një drejtëz			
<b>Situata e të nxënit:</b> Pasqyrimi i simetrikes së të një figure në një rrjet koordinativ.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Lexon dhe vendos koordinatat në të katra kuadratet. - Ndërton simetrike të figurave të thjeshta gjeometrike në rrjetin koordinativ kur është dhënë drejtëza e simetrisë dhe figura gjeometrike. - Vizaton në rrjetin koordinativ simetrike të një figure të dhënë, në lidhje me një drejtëz paralele me boshtin koordinativ.			
<b>Fjalët kyçe:</b> rrjet koordinativ, koordinatë e pikës, simetri			
<b>Burimet, mjetet:</b> teksti, modele demonstruese, modele me simetrinë e figurave të ndryshme gjeometrike në një tabak.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>			
Veprimtaria e parë: Bashkë me nxënësit zhvillohet një përsëritje për njohuritë që ata kanë mbi rrjetin koordinativ. Cilët janë elementet e një rrjeti koordinativ? Çfarë është simetria? Çfarë është një drejtëz simetrie? Kur dy figura janë simetrike? Si pasqyrohen figurat në çdo kuadrat? Mendimet e nxënësve shënohen në mënyrë të përmblodhur në tabelë.			
<div></div>			

**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

Hapet teksti dhe nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurat në rrjetin koordinativ. Mësuesi/ja vizaton në tabelë një figurë gjeometrike në rrjetin koordinativ dhe e pasqyron në anën tjetër të diagonales duke shpjeguar hap pas hapi lëvizjen e figurës në çdo kuadrat.



Orientohen nxënësit si të pasqyrojnë figurat në lidhje me secilin bosht, në mënyrë që të jenë katër figurat në çdo kuadrat. Katër nxënës punojnë në tabelë pasqyrimin e figurave në këtë rrjetet koordinative. Kontrollohen dhe ndihmohen nxënësit gjatë punës së pavarur dhe ndihmohen ata që paraqesin vështirësi.

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Punohet në fletë e punës ushtrimi 1 dhe pas përfundimit diskutohet zgjidhja në tabele nga një nxënës.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:**

- leximin dhe vendosjen e koordinatave në të katra kuadratet;
- ndërtimin e simetrikes së figurave të thjeshta gjeometrike në rrjetin koordinativ kur është dhënë drejtëza e simetrisë dhe figura gjeometrike;
- vizatimin në rrjetin koordinativ të simetrikes së një figure të dhënë, në lidhje me një drejtëz paralele me boshtin koordinativ.


**Detyra dhe puna e pavarur:**

Ushtrime të përgatitura nga mësuesi/ja sipas niveleve.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 min.		<b>Tematika:</b> Gjeometria	
<b>Tema mësimore:</b> Zhvendosjet			
<b>Situata e të nxënit:</b> përcaktimi i zhvendosjes së simboleve të vizatuara në rrjetin koordinativ.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Zhvendos paralelisht simbole të ndryshme gjatë një veprimtarie praktike. - Përcakton llojet e ndryshme të zhvendosjes vertikale, horizontale, pjerrtas. - Kupton që zhvendosja është një ndryshim vendndodhje.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Rrjet koordinativ, vendndodhja, pikat, koordinatat, boshti horizontal, boshti vertikal, simetria në rrjetin koordinativ.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, modele demonstruese me simbole të ndryshme në rrjet koordinativ.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>			
<b>Faza e parë:</b> Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
<b>Veprimtaria e parë:</b> Punë në grupe. Ndaj secilit grup një fletë A4 me një rrjet koordinativ ku u kërkoj që të vendosin një simbol (një lule, një top, një laps, një yll) etj. Nxënësit do të zhvendosin simbolin e vizatuar në pozicione të ndryshme. Ata do të përgjigjen duke përdorur termat: në të djathtë, poshtë, në të majtë, lart etj.			
<b>Faza e dytë:</b> Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim  Mësuesi/ja orienton nxënësit rreth detyrës që kanë në tekst në faqen 106. Nxënësit punojnë në çift. Njëri nxënës vizaton një figurë në rrjetin koordinativ dhe e zhvendos atë sipas udhëzimeve të dhëna në tabelë nga mësuesi/ja.			
<div>3 në të djathtë, 4 poshtë, 1 në të djathtë, 3 poshtë, 6 në të djathtë, 6 lart, 2 në të majtë, 1 lart, 2 në të djathtë.</div>			

Këto udhëzime ia jep shokut për të kontrolluar nëse rezultatet e tij janë të njëjta me të tuat.

Punohet në çift ushtrimi në faqen 107. Jepet një rrjet koordinativ ku tregohen 5 figura të zhvendosura paralelisht nga një zonë në tjetrën. Ata do t'i përshkruajnë me radhë zhvendosjen e figurave. Figurat nuk duhet të kalojnë nëpër katrorët e ngjyrosur. Ngre 2-3 çifte nxënësish dhe përshkruajnë zhvendosjet e figurave duke përdorur termat e zhvendosjes.



### Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në tekst zhvendosjen e figurave në rrjet koordinativ duke përcaktuar udhëzimet vetë. Pas përfundimit kontrollohet detyra me shokun e bankës. Një nxënës punon në tabelë dhe diskutimet përfshijnë gjithë klasën.

#### Vlerësimi

##### Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:

- zhvendosjen paralelisht të simboleve të ndryshme;
- përcaktimin e llojeve të ndryshme të zhvendosjes vertikale, horizontale, pjerrtas, majtas, djathtas.

##### Detyra dhe puna e pavarur:

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Vendndodhja dhe lëvizja			
<b>Situata e të nxënit:</b> Paraqitja e një rrjeti katrorësh dhe përcaktimi i vendndodhjes së figurave të ndryshme.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Përdor koordinatat për të përcaktuar vendndodhjen e objektit në rrjetin koordinativ. - Gjen koordinatat kur është dhënë figura. - Krijon një fjalëkalim për hartën e dhënë duke përfshirë koordinatat dhe emrin e objektit.			
<b>Fjalët kyçe:</b> rrjet koordinativ, vendndodhja, pikat, koordinatat, boshti horizontal, boshti vertikal			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, modele demonstruese të përgatitura nga mësuesi/ja, krijon situata të thjeshta me figurat e ndryshme gjeometrike.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>			
<b>Veprimtaria e parë:</b> Kjo veprimtari zhvillohet në grup në formë loje. Secili grup ka mbi tavolinë kuti shahu ose një vizatim kuti shahu ku do udhëzohen që të kryejnë zhvendosje e një guri shahu ose një objekt tjetër si: zhvendosu majtas, zhvendosu djathtas, zhvendosu lart, zhvendosu poshtë, zhvendosu pjerrtas, lart, zhvendosu pjerrtas poshtë. Guri i shahut ose objektet e tjera do të zhvendosen në lidhje me një objekt tjetër të palëvizshëm që e vendos vetë.			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b>			
Nxënësit kalojnë në plotësimin e ushtrimit të faqes 109 në grup ku do të gjejnë koordinatat për kafshët e ndryshme të dhënë në figurë. Veprimtaria zhvillohet në formë gare. Njëri nxënës jep koordinatat dhe cili nga pjesëtarët e grupit e thotë më shpejt emrin e kafshës. Përsëritet veprimtaria disa herë. Më pas, mësuesi/ja i udhëzon nxënësit që të krijojnë një fjalëkalim për hartën e dhënë.			



**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Në fletoren e klasës, nxënësit do të vizatojnë një rrjet koordinativ. Brenda rrjetit do të vizatojnë një kafshë dhe koordinatat ku ndodhet ajo. Më pas vizatojnë rrugën e kalimit në rrjet.

Mësuesi/ja ndjek punën e tyre dhe ndihmon nxënësit që mund të kenë vështirësi.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- përdorimin e koordinatave për të përcaktuar vendndodhjen e objektit në rrjetin koordinativ;
- gjetjen e koordinatave kur është dhënë figura;
- krijimin e një fjalëkalimi për hartën e dhënë.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.





<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Përmbledhim dhe përforcojmë			
<b>Situata e të nxënit:</b> Paraqitje e një tabele njohurie dhe diskutimi për ato që janë mësuar.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Emërton llojet e këndeve. - Përcakton elementet në një shumëkëndësh. - Emërton katërkëndëshat dhe tregon vetitë e tyre. - Emërton trupat gjeometrikë dhe i përshkruan ata.			
<b>Fjalët kyçe:</b> trupat gjeometrikë (kub, kuboid, cilindër, prizëm, piramidë, sferë, kon), faqet, brinjët, kulmet.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Modele demonstruese për mësuesin.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>  <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Veprimtaria e parë: Në këtë fazë të mësimit diskutohet mbi të gjitha njohuritë e marra gjatë këtij kapitulli. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve se çfarë mësuan për secilën nga këto njohuri: për këndet; shumëkëndëshat, për vetitë e katërkëndëshave, për gjetjen e drejtëzës së simetrisë, për veçoritë e trupave gjeometrikë. Kjo veprimtari do të punohet me grupe ku secili grup do të diskutojë për një njohuri të dhënë.  <b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b> Nxënësit pas diskutimit të njohurive të marra në gjeometri kalojnë në plotësimin e ushtrimeve të përgatitura në tabelë. Mësuesi/ja është e lirë në përgatitjen e ushtrimeve. Në ushtrimin 1 emërtojnë këndet dhe vizatojnë ato në fletore. Në ushtrimin 2 shikojnë shumëkëndëshat dhe tregojnë për llojin e këndeve të figurave dhe t'i emërtojnë me shkronjë. Në ushtrimin 3 lexojnë dhe plotësojnë me po ose me jo pohimet e vërteta për njohuritë gjeometrike. Në ushtrimin 4 emërtojnë katërkëndëshat dhe tregojnë për brinjët dhe këndet. Në përfundim të çdo ushtrimi lexohen përfundimet.			

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që me kunja dhëmbësh dhe me plastelinë të ndërtojnë trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe t'i përshkruajnë në fletore.

**Model.**

**Plotëso tabelën për trupat gjeometrikë.**

Trupat gjeometrikë	Emërtimi	Vetitë
		
		
		
		

Në fund lexohen përfundimet.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- emërtimin e llojeve të këndeve;
- përcaktimin e elementeve në një shumëkëndësh;
- emërtimin e katërkëndësive dhe tregon vetitë e tyre.
- emërton trupat gjeometrikë dhe i përshkruan ata.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Ushtrime të përgatitura nga mësuesi/ja sipas niveleve.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Gjeometria</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Përsëritje			
<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutimi, shoqërim me shembuj i njohurive të marra për to.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Vizaton drejtëzën e simetrisë të figurave të thjeshta gjeometrike. - Vizaton në rrjetin koordinativ simetrikën e një figure të dhënë, në lidhje me një drejtëz paralele me boshtin koordinativ. - Përdor koordinatat për të përcaktuar vendndodhjen e objektit në rrjetin koordinativ. - Gjen numrin e kulmeve, brinjëve, faqeve të trupave gjeometrikë. - Klasifikon trekëndëshat sipas madhësisë së këndeve.			
<b>Fjalët kyçe:</b> drejtëz simetrie, figurë gjeometrike, kënd, rrjet koordinativ			
<b>Burimet, mjetet:</b> Modele demonstruese për mësuesin, fletë A4		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>			
<b>Veprimtaria e parë:</b> Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe për secilin grup jep detyrat: Grupi i parë: Çfarë dini për format gjeometrike. Grupi i dytë: Vizatoni, emërtoni trekëndëshat sipas këndeve dhe shkruani vetitë e tyre. Grupi i tretë: Vizatoni, emërtoni trekëndëshat sipas brinjëve dhe shkruani vetitë e tyre. Grupi i katërt: Vizatoni, emërtoni llojet e këndeve dhe masën e tyre. Grupi i pestë: Vizaton në rrjetin koordinativ simetrikën e një figure të dhënë, në lidhje me një drejtëz paralele me boshtin koordinativ.			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b>			
Nxënësit pas diskutimit të njohurive të marra në gjeometri kalojnë në plotësimin e fletës së punës. Mësuesi/ja ka përgatitur një fletë pune për njohuritë e marra në këtë kapitull.			
<b>Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>			
Prezantimi dhe zgjidhja e ushtrimeve në tabelë nga nxënës të ndryshëm dhe diskutim me gjithë klasën.			

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- vizatimin e drejtëzës së simetrisë të figurave të thjeshta gjeometrike;
- vizaton në rrjetin koordinativ simetrien e një figure të dhënë, në lidhje me një drejtëz paralele me boshtin koordinativ;
- përdor koordinatat për të përcaktuar vendndodhjen e objektit në rrjetin koordinativ;
- gjetjen e numrit të kulmeve, brinjëve, faqeve të trupave gjeometrikë;
- klasifikimin e trekëndëshave sipas madhësisë së këndeve.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës

## TEST - PERIUDHA E DYTË

Emri/Mbiemri: \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

1. Jepen shifrat 5, 9, 3, 1, 0. Cili është numri më i madh që mund të ndërtoni me këto shifrat

Po numri më i vogli? \_\_\_\_\_ (2 pikë)

2. Gjej prodhimin duke përdorur strategjitë e shumëzimit. (2 pikë)

$$6 \times 19 =$$

$$28 \times 28 =$$

3. Kryej veprimet. (4 pikë)

a)  $12,7 \cdot 5 =$

b)  $57,23 \cdot 8 =$

c)  $95,4 : 6 =$

d)  $69 : 5 =$

4. Kryej veprimet në shtyllë: (5 pikë)

$$179604 - 640 =$$

$$429 \times 87 =$$


$$4,25 + 2 =$$

$$25416 : 125 =$$


5. Një blerës bleu 76,5 litra vere me 5,5 leke/litri. Ç'mund të gjejmë? (3 pikë)

6. Gjej masën e këndit që mungon. (2 pikë)

Trekëndëshi [ABC]



7. Jepet trupi. Emërto atë. (4 pikë)




Numri i faqeve është...

Numri i kulmeve është...

Numri i brinjëve është...


**8. Përcakto drejtëzën e simetrisë në figurat e dhëna.**

(4 pikë)

**9. Vendos pikat në rrjetin koordinativ. Përcakto koordinatat.**

(6 pikë)

$A = (2; 3)$	$B = (3; 2)$
$C = (1; 5)$	$D = (5; 0)$
$E = (7; 7)$	$F = (0; 5)$
$K = (1; \dots) \quad L = (5; \dots) \quad M = (3; \dots)$	

**10. Gjeni vlerën e shprehjes numerike.**

(2 pikë)

$$420 : (14 + 6) - 2 + (2 \times 3) =$$

**11. Problemë:**


(6 pikë)

Një familje me dy prindër dhe dy fëmijë po udhëtonin me autobus në Vlorë. Bileta për të rritur kushton 1600 lekë, kurse për fëmijë sa gjysma e çmimit të biletës së të rriturve. Babai i dha fatorinos një kartëmonedhë 5000 lekëshe. Sa lekë do t'i kthejë fatorinoja babait? (me kërkesa)

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 13	14 – 19	20 – 25	26 – 29	30 – 33	34 – 37	38 – 40
Pikët e fituara							

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Gjatësia, masa dhe vëllimi</b> <b>Tema mësimore:</b> Diskutojmë së bashku			
<b>Situata e të nxënit:</b> Përdor km, metrin, centimetrin, milimetrin, kg, gramin dhe litrin si njësi standarde për matjen e të objekteve të ndryshme			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Identifikon njësitë matëse përkatëse për matjen e gjatësive.</li><li>• Përdor njësinë e përshtatshme për matjen e një objekti të dhënë.</li><li>• Përdor njësitë matëse për matjen e gjatësive të ndryshme.</li><li>• Gjen vëllimin e masës së lëngjeve.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> gjatësi, njësi gjatësie, mjetet matëse të gjatësisë, peshë, masë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, tabela me njësitë matëse të gjatësisë, peshës dhe masës.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <b>Faza e parë:</b> Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. <b>Veprimtaria e parë:</b> Kërkoj nga nxënësit të thonë cila është njësia kryesore e matjes së gjatësisë peshës dhe masës si dhe cilat janë shumëfishat dhe nënfishat e tij si dhe këmbimet midis tyre.			
<div><div>Metri</div><div><div>shumëfishat</div><div>Nënfishat</div></div><div><div><div>kilometri (km)</div><div>hektometri (hm)</div><div>dekametri (dam)</div></div><div><div>decimetri (dm)</div><div>centimetri (cm)</div><div>milimetri (mm)</div></div></div></div> <div><div>1 m = 100 cm</div><div>1 m = 1000 mm</div><div>1 cm = 10 mm</div><div>1 m = 10 dm</div><div>1 dm = 10 cm</div><div>1 dm = 100 mm</div><div>1 km = 1000 m ..... etj.</div></div>			





### Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim

Nxënësit në grupe do të matin objekte të ndryshme në klasë dhe të sjella nga shtëpia për matjen e gjatësisë, peshës dhe vëllimit dhe më pas do të plotësojnë tabelën.

OBJEKTET	NJËSITË MATËSE

Pas përfundimit, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë detyrën.

Hapet teksti në faqen 111 dhe nxënësit kalojnë në plotësimin e ushtrimit në mënyrë të pavarur. Ata do të lidhin me vijë secilën prej njësive të matjes me emërtimin e shkruar të saj, me mjetin matës dhe me figurën përkatëse. Pas përfundimit nxënësit kontrollojnë detyrën në çifte. Lexojnë dy nxënës detyrën e përfunduar.

### Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në fletoren e klasës, nxënësit punojnë një situatë problemore të përgatitur nga mësuesi/ja. Për secilat nga situatat e mëposhtme tregoni madhësinë që do të matni dhe një sitë që do të përdorni (Mësuesi/ja është e lirë të hartojë situatë tjetër).

Lartësia e një pallati-gjatësia e lumit Drin-sasia e ujit në liqenin e Shkodrës-sasia e verës në një shishe-trashësia e librit të matematikës, masa e një thesi me miell-gjatësia e rrugës për në shkollë. Një nxënës e punon në tabelë. Kontrollohen dhe ndihmohen nxënësit gjatë punës së pavarur dhe sidomos nxënësit që paraqesin vështirësi. Detyra e përfunduar diskutohet me të gjithë nxënësit.

### Vlerësimi

#### Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:

- identifikimin e njësive matëse përkatëse për matjen e gjatësive;
- përdorimin e njësive të përshtatshme për matjen e një objekti të dhënë;
- gjetjen e vëllimit e masës së lëngjeve.

#### Detyra dhe puna e pavarur:

Plotësimi i fletores së punës dhe një ushtrim i përgatitur nga mësuesi/ja.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Njësitë e matjes			
<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutim për mjetet dhe njësitë matëse të gjatësisë.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Identifikon njësitë matëse të masës.</li><li>- Përdor letrat me shifra për të treguar sa më shumë njësi matëse të masës.</li><li>- Rrumbullakos sasinë e shprehur të masës në 10-shen, 100-shen dhe 1000-shen më të afërt.</li><li>- Kthen njësitë e gjatësisë te njëra-tjetra.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> njësitë matëse, kg, g, rrumbullakim			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, letra me numra, mjete demonstruese matëse të masës.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> <b>Veprimtaria e parë:</b> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të emërtojnë shumëfishat dhe nënfishat e kg. <div><div>Shumëfishat ton</div><div>( t)</div><div>kilogrami</div><div>Grami (g)</div><div>Nënfishat</div><div>miligrami (mg)</div><div>1 t = 1000 kg      1 kg = 1000 g</div></div>			
<b>Lojë mes grupeve:</b> Një grup shkruan në një fletë A4 sende të ndryshme dhe grupi tjetër shkruan njësinë matëse të saj. Fiton grupi që punon shpejt e më saktë.			

**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

Hapet teksti dhe punohet faqja 113. Mësuesi/ja i ndan secilit grup letra me shifra. Nxënësit do të krijojnë një numër me katër shifra. Shkruajnë: Numri im tregon \_\_\_\_ gram (g).

Me këto shifra në ushtrimin 1, me të njëjtën radhitje do të tregojnë këtë sasi, duke përdorur sa më shumë njësi matëse të masës. Në ushtrimin 2, nxënësit do të rumbullakojnë sasinë e shprehur në gram në 10-shen, 100-shen dhe 1000-shen më të afërt. Zhvillohet e njëjta veprimtari duke **ndryshuar** renditjen e letrave me shifra për të formuar një numër të ri. Pas çdo përfundimi të ushtrimit grupi lexon detyrën duke përfshirë nxënësit në diskutim.


Në faqen 114, nxënësit do të punojnë në çift. Në listën që ndodhet në fund të faqes do të plotësojnë tabelën:

Njësi të përziera	Njësi me numra dhjetorë	Njësia më e vogël
1 kg 750 g	1,75 kg	1750 g

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Në fletoren e klasës, mësuesi/ja krijon 4 numra.

Me këto shifra siç janë radhitur tregojnë sasi duke përdorur sa më shumë njësi matëse të masës. Më pas i rumbullakojnë në gram në 10-shen, 100-shen dhe 1000-shen më të afërt. Mësuesi/ja kontrollon, ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon ata që paraqesin vështirësi. Kontrollon detyra në çift.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- identifikimin e njësive matëse të masës;
- përdorimin e letrave me shifra për të treguar sa më shumë njësi matëse të masës;
- rumbullakimin sasinë e shprehur të masës në 10-shen, 100-shen dhe 1000-shen më të afërt.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Matja	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Njësitë e matjes			
<b>Situata e të nxënit:</b> Njehson gjatësinë, masën, vëllimin e një objekti duke përdorur njësinë e përshtatshme të matjes.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Identifikon njësitë e matjes së gjatësisë, të masës dhe të vëllimit. - Përzgjedh dhe përdor njësitë standarde të matjes. - Kthen njësitë matëse në njësi të përziera dhe i konverton në njësi më të vogla. - Kthen një njësi matëse në tjetrën duke lëvizur presjen dhjetore deri në tri shifra.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Njësitë e gjatësisë: m, cm, mm. Njësitë e masës: kg, g. Njësitë e vëllimit: l, ml.			
<b>Burimet, mjetet:</b> Libri i nxënësit, tabela, objekte të sjella nga shtëpia për t’u matur, modele demonstruese të njësive të matjes.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>  Veprimtaria e parë: Nxënësit punojnë në grupe dyshe. Një nxënës shkruan emrin e një objekti apo të një matjeje dhe nxënësi tjetër bën përshkrimet. Objekti që është 2,5 mm e gjatë – goma Objekti që peshon 1 kg – 3 libra Një vend që është 5 m larg shkollës – libraria Gjerësia e klasës – 5 m Vëllimi i një shisheje me ujë – 500 ml Veprimtaria e dytë: Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që në grupe të klasifikojnë me përafërsi masat e objekteve të sjella nga shtëpia sipas njësisë matëse. Më pas ato i matin me njësitë matëse standarde dhe diskutojnë matjet në grup.P.SH.Më pak se 1 kg bidoni me ujë, hamburgeri, një vazo e vogël luleje. Tavolina më e gjatë se 1 m.1 coca cola më pak se 500 ml. Në përfundim lexojnë plotësimet.			

**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

Mësuesi/ja ka vendosur në secilin grup nxënësish nga një objekt. U kërkon nxënësve që njësitë e përziera t'i kthejnë në njësi me numra dhjetorë dhe më pas te njësia më e vogël. Pyeten se çfarë vënë re nga këmbimi i njësive. Nxënësit thonë se kur këmbejmë njësitë shumëzohet ose pjesëtohet me fuqi të 10, duke zhvendosur presjen dhjetore. Udhëzohen nxënësit rreth plotësimit të tabelës me listën që është në fund të faqes. Jepet një shembull nga mësuesi/ja për plotësimin e tabelës në tekst në faqen 113.

Njësi të përziera	Njësi me numra dhjetorë	Njësia më e vogël
<b>1 kg 750 g</b>	<b>1,75 kg</b>	<b>1750 g</b>

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Në fletoren e klasës, nxënësit do të punojnë një ushtrim të përgatitur nga mësuesi/ja. P.sh.:

- gjeni vëllimin dhe gjatësinë e shishes së ujit që keni në çantë dhe shkruani njësitë matëse në mënyra të ndryshme:
- vëllimi = 500 ml = 0,5 l
- gjatësia = 25 cm = 250 mm = 0,25 m.
- gjatësia e një kavanozi me mjaltë = 20 cm = 0,2 mm
- masa 1 kg = 1000 g

Pas përfundimit nxënësit lexojnë dhe diskutojnë rreth kthimit të njësive matëse.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- identifikimin e njësisë së matjes së gjatësisë, të masës dhe të vëllimit;
- përzgjedhjen dhe përdorimin e njësive standarde të matjes;
- kthimin e njësive matëse në njësi të përziera dhe i konverton në njësi më të vogla;
- kthimin e një njësie matëse në tjetrën duke lëvizur presjen dhjetore deri në tri shifra.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Fletore pune dhe ushtrime të përgatitura nga mësuesi/ja.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Matja e gjatësisë			
<b>Situata e të nxënit:</b> Sjellje shembujsh gjatësish dhe diskutimi për mjetet dhe njësitet matëse të gjatësisë.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Identifikon njësitë matëse të gjatësisë.</li><li>- Bën emërtimet e gjatësive si njësi standarde dhe jostandarde, duke gjetur ndryshesën ndërmjet tyre.</li><li>- Përdor vizoren dhe metrin në matjen e gjatësive.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> gjatësi, njësi gjatësie, mjetet matëse të gjatësisë, njësi standarde dhe jostandarde.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, metri, vizore, plastelinë		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimin</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> <b>Veprimtaria e parë:</b> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit mjetet matëse të gjatësisë dhe njësitë përkatëse për matjen e tyre. Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve: Cili është mjete dhe njësia standarde e matjes së gjatësisë? Për matjen e gjatësive të vogla, cilat njësitë përdoren? (decimetri (dm), centimetri (cm), milimetri (mm).) Çfarë njësie matëse përdorim për matjet e gjatësive të mëdha? (kilometër (km)). Tregoni lidhjen midis njësive të gjatësisë? (1m = 10 dm = 100 cm = 1000 mm. 1km = 1000 m)			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b> Mësuesi/ja i ka porositur nxënësit një orë më parë për të sjellë plastelinë. Kjo lojë zhvillohet si garë mes nxënësve. Secili nxënës do të formojë me plastelinë brenda 30 sek. litarin më të që mundet. Ndahet klasa në grupe. Secili grup do të vendosë litarët nga më i shkurtri te më i gjati. Nxënësit gjejnë në fillim me përafërsi gjatësinë e litarit më të shkurtër dhe më pas përdorin vizoren për të matur gjatësinë e këtij litari. Njëlloj vepohet edhe për litarët e tjerë. Të gjitha matjet shënohen në tabelën e paraqitur në tekst në faqen 114.			

Emri	Gjej me përafërsi	Gjej me matje	Ndryshesa

**Faza e tretë:** Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Në fletoren e klasës nxënësit punojnë ushtrimin e përgatitur nga mësuesi/ja. Mësuesi/ja është i lirë të përgatitë edhe ushtrim tjetër: Mattia

Në një garë kërcimi së gjati, një atlet rus kërcëu 76 cm. Një atlet gjerman kërcëu 750 cm. Cili ka kërcyer më shumë? \_\_\_\_\_

Sa më shumë? \_\_\_\_\_

#### **Vlerësimi:**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- identifikimin e njësive matëse të gjatësisë;
- emërtimet e gjatësive si njësi standarde dhe jostandarde duke gjetur ndryshesën ndërmjet tyre;
- përdorimin e vizores dhe metrit në matjen e gjatësive.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Matja e gjatësisë			
<b>Situata e të nxënit:</b> Përzgjedh dhe përdor njësitë standarde të matjes.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor njësitë matëse të gjatësisë dhe kryen llogaritje të thjeshta.</li> <li>• Përzgjedh dhe përdor njësitë matëse standarde.</li> <li>• Interpreton leximin në shkallë të ndryshme për të gjetur largësinë midis dy vendeve.</li> <li>• Interpreton leximet në metra të ndryshëm.</li> </ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> njësi matëse, shkallë zvogëlimi, largësi			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, metra, shirit, skicë		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> <b>Veprimtaria e parë:</b> U kërkoj nxënësve që të punojnë në grupe dyshe. Ata do të matin njëri-tjetrin me metrin shirit. Kryej matjen e parë në cm, duke përdorur një vlerë të përafërt të lartësisë së një personi në cm konvertoje atë në m. Shkruajnë të gjitha të dhënat në tabelë.			
Emri	Gjatësia në cm	Gjatësia në m	
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b> Hapen librat në faqen 115. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të punojnë në çifte. Çiftet do të zgjedhin në hartë e cila është e paraqitur në tekst, një në anën perëndimore dhe një në anën lindore. Gjeni një rrugë ndërmjet dy vendeve dhe vizatojeni këtë rrugë në hartë. Përdorni shkallën e zvogëlimit (1 cm në figurë përfaqëson 2 km në terren) për të gjetur largësinë ndërmjet dy vendeve. Pas kryerjes së matjeve, nxënësit plotësojnë tekstin duke u përgjigjur pyetjeve të dhëna dhe duke përdorur ngjyrat e ndryshme për rrugët e zgjedhura në hartë. Në përfundim, nxënësit lexojnë plotësimet e bëra.			



**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Mësuesi/ja kërkon që në çifte të kalojnë në zgjidhjet e situatave problemore. Nxënësit shkruajnë të dhënat dhe zgjidhin situatën.

**Situata:** Një pallat ndodhet 20 km larg një pallati tjetër. Sa larg ndodhen në hartë me shkallë e zvogëlimit. Përdorni shkallën e zvogëlimit 1: 20 (1 cm në figurë përfaqëson 2 km në terren).

Pa përfundimit lexohen plotësimet e kryera.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- përdorimin e njësive matëse të gjatësisë dhe llogaritjet e thjeshta;
- përzgjedhjen dhe përdorimin e njësive matëse standarde;
- interpretimin dhe leximin në shkallë të ndryshme për të gjetur largësinë midis dy vendeve.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Centimetra dhe milimetra			
<b>Situata e të nxënit:</b> Japin shembuj gjatësish dhe diskutimi për mjetet dhe njësitë matëse të gjatësisë.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Identifikon njësitë e gjatësisë.</li><li>• Emërton gjatësitë në tri mënyra të ndryshme në centimetra, në centimetra dhe milimetra dhe në centimetra.</li><li>• Përdor vizoren në matjen e gjatësive.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> gjatësi, njësi gjatësie, mjetet matëse të gjatësisë, cm, mm.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, vizore për matjen e gjatësive.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>			
<b>Veprimtaria e parë:</b> Ndahet klasa në grupe dhe secilit grup i jepet një fletë A4 ku do të lidhin objektin me njësinë matëse. Objektet janë të ndryshme për secilin grup. P.sh., Lidhin me shigjetë objektin me njësitë matëse			
Trashësia e kapakut te një blloku shënimesh			cm
Gjatësia e një lapsi			mm
Gjatësia e një ore muri			mm
Gjatësia e kuletës			cm
Gjatësia e gishtit të dorës			mm
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b>			
Hapen librat dhe nxënësit punojnë të pavarur. Ata punojnë individualisht në matjen e segmenteve të dhëna në tekst. Nxënësit shkruajnë gjatësitë në tri mënyra të ndryshme në centimetra, në centimetra dhe milimetra dhe në centimetra. Do të përdorin vizoren në matjen e segmenteve.			

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Në fletoren e klasës, nxënësit do të vizatojnë segmente me gjatësitë e dhëna në tekst. Një nxënës i punon në tabelë. Kontrollohen nxënësit gjatë punës së pavarur dhe ndihmohen nxënësit që paraqesin vështirësi. Nxënësit lexojnë plotësimet e kryera dhe kontrollojnë matjet me nxënësin që ka punuar në tabelë.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- identifikimin e njësive të gjatësisë;
- emërtimin e gjatësive në tri mënyra të ndryshme në centimetra, në centimetra dhe milimetra dhe në centimetra;
- përdorimin e vizores në matjen e gjatësive.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Plotësimi i fletores së punës.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data:
Koha e zgjatjes: 45 minuta		Tematika: Matja	
Ora 2			
Tema mësimore: Centimetra dhe milimetra			
Situata e të nxënit: Matjet janë të sakta vetëm me një shkallë të caktuar saktësie.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës: <ul style="list-style-type: none"><li>Përzgjedh dhe përdor njësitet standarde dhe jostandarde të matjes.</li><li>Identifikon sisteme standarde të matjes së gjatësisë.</li><li>Kryen matje të thjeshta me mm dhe cm me ndihmën e vizores.</li></ul>			
Fjalët kyçe: Njësitet e gjatësisë: cm, mm.			
Burimet, mjetet: libri i nxënësit, objekte të ndryshme për matje në cm, mm		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
Metodologjia e veprimtaria e të nxënit: Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
Zhvillimi i mësimi:			
Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Veprimtaria e parë: Nxënësit ndahen në çifte dhe diskutojnë me njëri-tjetrin: Mësuesi/ ja u drejton pyetjen: Kur ju është dashur të masni një objekt këtë javë? Rëndisin në tabelë në tri kolona, të gjitha njësitet matëse që përmendin. Pastaj iu kërkohet nxënësve të nxjerrin objekte nga çanta në tavolinë dhe të tregojnë njësitet e përshtatshme të matjes për to p.sh.: gjatësia e fletores (20 cm); gjatësia e lapsit; gjatësia e kuletës; gjatësia plastelinës; gjatësia e shkumës; gjatësia e façoletave etj.			
Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim Veprimtari: Puno me një shok. Punë në çift Hapet teksti në faqen 118. Njëri nga nxënësit përdor gjerësinë e gishtit tregues për të gjetur me përafërsi gjatësinë e pëllëmbës sate. Nxënësi/ ja shkruan vlerën që gjeti me përafërsi. Shoku i tij mat me vizore pëllëmbën dhe matjet i shkruajnë në tabelë.			
Gjatësia e pëllëmbës sate		Gjatësia e pëllëmbës së shokut tënd	
Nxënësit matin me pëllëmbë sende të ndryshme të sjella nga shtëpia dhe ato çfarë ka në klasë. Pasi gjen një vlerë me përafërsi, përdor vizoren për të matur objektin me saktësi. Nxënësit krahasojnë çdo matje me vizore e çdo vlerë të gjetur me përafërsi. Mësuesi/ ja orienton nxënësit të plotësojnë tabelën për të paraqitur rezultatet.			



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Matja e masës			
<b>Situata e të nxënit:</b> Mat masën e një trupi, sa i lehtë dhe i rëndë është ai dhe diskutimi për mjetet dhe njësitë matëse të saj.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Identifikon njësitë e masës.</li><li>• Lexon peshoret e ndara në kg dhe gram.</li><li>• Kryen matje masash me njësi jostandarde.</li><li>• Operon me njësitë e masës në situata të ndryshme me njësi standarde e jostandarde.</li><li>• Gjen masën e trupave me anë të peshoreve konkrete.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> kg, g, kv, t, shumëfishat e kg, nënfishat e kg, peshore, masë, peshore, njësi të masës			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, libri, fleta e punës, sende të ndryshme që kanë në etiketë masën e tyre.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> <b>Veprimtaria e parë:</b> Diskutohet me nxënësit rreth njohurive të marra për njësitë e masës, gjatësisë, vëllimit, sipërfaqes etj. Nxirren pamje peshorësh të ndryshme dhe tregohet se si bëhet peshimi i sendeve me këto peshore. Në pjatën e peshores vendosim sendin që do të peshojmë p.sh. (mollë) dhe në anën tjetër të saj është ndarja në kg e në g. Merren disa sende dhe kërkohet nga nxënësit të lexojnë masën e shkruar në etiketë. Përmend disa njësi të masës që njeh. Theksoj që masën më të madhe e ka ai që rëndon më shumë. Mjeti matës është peshorja. Masën e shprehim me kg ose g. U kërkoj nxënësve të përmend disa njësi të masës që njeh. Njësia bazë e matjes së masës është kg. Kemi shumëfisha dhe nënfisha të kg. 1 kg = 1000 g      1 g = 1000 mg 1 kv = 100 kg      1 t = 10 kv 1t = 1000 kg			

Plotëso.

1 kg = ... g.

3000 g = ... kg.

10 kg = ... g.

**Veprimtaria e dytë: Punoj me nxënë një situatë në treg:**

Në një magazinë u vendosën ditë e parë 15 kg 250 g mollë. Ditën e dytë 27 kg 920 g dardha. Me sa kg fruta u mbush magazina?

**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

Njihen nxënësit me temën e mësimit. Hapet teksti në faqen 118 dhe orientoj nxënësit rreth veprimtarisë që do të kryejnë. Nxënësit do të punojnë në grup. Nxënësit janë porositur më parë të sjellin nga shtëpia objekte që mund të maten me peshore në klasë ose zgjedhin 4 objekte në klasë. Në fillim do të gjejnë me përafërsi masën e secilit prej objekteve dhe do të bien dakord si grup për një vlerë me përafërsi. Grupi vendos për njësinë matëse më të përshtatshme që do të përdorin. Pas përfundimit të matjeve, nxënësit plotësojnë tabelën.

Objekti	Njësia	Gjej me përafërsi	Gjej me matje	Diferenca

Nxënësit mund të përdorin presjen dhjetore nëse u duhet.

Nxënësit matin me peshore këto objekte. Krahasojnë masën reale të secilit objekt me vlerën e përafërt dhe masën reale. Më pas, nxënësit do të renditin masat nga më e lehta te më e rënda.

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Në fletoren e klasës, nxënësit do të punojnë një ushtrim të përgatitur nga mësuesi/ja në tabelë. Një pako peshon 33 kg e 560 g. Sa pako të tilla mund të ngrejë një ashensor që thotë se pesha duhet të mos jetë më e lartë se 268 kg?

A) 5 B) 6 C) 7 D) 8 E) 9

Një kalë peshon 600 kg dhe  $\frac{1}{3}$  e peshës së tij. Sa peshon kali?

Mësuesi/ja është e lirë të japë ushtrim tjetër. Diskutohen ushtrimet e plotësuara në tabelë.

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- identifikimin e njësive të masës;
- leximin e peshoreve të ndara në kg dhe gram;
- kryerjen e matjeve të masave me njësi jostandarde;
- gjetjen e masës së trupave me anë të peshoreve konkrete.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.





Në cilin rast të veprimtarisë gjetët masën e përafërt të frutave? Po masën e saktë si e gjetët? Në tekst janë paraqitur peshore ku nxënësit do të shënojnë një shigjetë në çdo peshore për të treguar masën e secilës frutë. Nxënësit gjejnë masën e të gjitha frutave së bashku në tri mënyra të ndryshme. Pas plotësimit të ushtrimit, diskutojnë dhe interpretojnë tri mënyrat e ndryshme.

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit hapin fletoren e klasës dhe punojnë ushtrimet e përgatitura nga mësuesi/ja. Në një magazinë

kishte 356 kg mollë. Pjeshkë kishte 56 kg më pak se mollë. Dardha kishte 2 herë më pak se pjeshkë. Sa kg fruta kishte në magazinë?

**Vlerësimi**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- identifikimin e njësive standarde të gjatësisë dhe jostandarde.
- përzgjedhjen dhe përdorimin e njësive matëse standarde.
- zgjedhjen e njësive të përshtatshme për të bërë matjen e objekteve të caktuara.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Ora 1</b> <b>Tema mësimore:</b> Matja e vëllimit			
<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutimi për mjetet dhe njësitë matëse të lëngjeve.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Identifikon njësitë e matjes së vëllimit të lëngjeve.</li><li>• Gjen vëllimin e lëngjeve në trupa të ndryshëm me përafërsi dhe sipas vlerëreale.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> Litër, mililitër, njësi vëllimi të lëngjeve, mjete matëse, njësi matëse			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, litër, mililitër, njësi vëllimi të lëngjeve, mjete matëse, njësi matëse, enë e shkallëzuar.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <b>Faza e parë:</b> Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Veprimtaria e parë: Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të rikujtojnë njohuritë që u morën për njësitë e matjes së vëllimit të lëngjeve. Bëhet diskutimi me gojë. Për të matur vëllimin te lëngjet përdoret një njësi e posaçme që quhet litër. Litri është njësia bazë për matjen e vëllimit të lëngjeve. Vëllim do të thotë hapësira që zë një trup i lëngët. Litri ka shumëfishat dhe nënfishat. Shumëfishat e litrit përdoren shumë rrallë. Si mjete për matjen e vëllimit përdoren enët e shkallëzuara në litër dhe mililitra. Vëllimi i një litri është sa vëllimi i një kubi me brinjë 10 cm. 1 litër = 1 dm <sup>3</sup> 1 litër = 1000 ml.			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b> Demonstroj para nxënësve enë të shkallëzuara dhe masë vëllimin e një gote me ujë, një luge gjelle, një filxhani. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të bëjnë matjen e vëllimit në katër enë të ndryshme. Në fillim si grup do të gjejnë me përafërsi vëllimin e këtyre enëve. Ata duhet të bien dakord vetëm për një vlerë me përafërsi. Më pas vendosin për njësinë më të përshtatshme që do të përdorin. Të dhënat që mbledhin do t'i shkruajnë në tabelë në njësinë dhe vlerën e përafërt për vëllimin e saj.			

Ena	Njësia matëse	Vëllimi i përafërt	Vëllimi real	Diferenca

Nxënësit do të mbushin secilën prej enëve për të gjetur vëllimin real. Pas çdo matjeje ata plotësojnë tabelën ku mund të përdorin edhe presjen dhjetore. Nxënësit bëjnë krahasimin e vëllimit të secilës enë me vlerë e përafërt që bënë në fillim. Njëkohësisht bëjnë diferencë ndërmjet vlerës së përafërt me vëllimin real. Grupet prezantojnë matjet e bëra dhe konkluzionet.

### **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Nxënësit punojnë në grupe në një fletë A3 ushtrime të përgatitura nga mësuesi/ja. Mësuesi/ja është e lirë të punojë edhe ushtrime të tjera.

Në një fabrikë të përpunimit të qumështit ka një sasi qumështi të vendosur në 18 bidonë 5 litërsh dhe 15 bidonë 6 litërsh. Sa bidonë 9 litërsh duhen për të vendosur të gjithë këtë sasi me qumësht?

2.9 litra lëng frutash iu nda në mënyrë të barabartë 20 sportistëve para ndeshjes. Sa ml lëng frutash do të pijë secili nga sportistët?

Një kuti e vogël kartoni me lëng molle përmban 250 ml. Sa ml lëng ka në 8 kuti të tilla? Jepni përgjigjen edhe në litra.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- identifikimin e njësisë së matjes së vëllimit të lëngjeve;
- gjetjen e vëllimit të lëngjeve në trupa të ndryshëm me përafërsi dhe sipas vlerë reale.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Ora 2</b> <b>Tema mësimore:</b> Matja e vëllimit			
<b>Situata e të nxënët:</b> Sjellje shembujsh për vëllimin dhe diskutimi për mjetet dhe njësitë matëse			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Tregon njësitë e matjes së vëllimit të lëngjeve.</li><li>• Gjen vëllimin e lëngjeve në trupa të ndryshëm.</li><li>• Identifikon sisteme standarde të matjes së vëllimit.</li><li>• Interpretin leximet në masa të ndryshme.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> Litër, mililitër, njësi vëllimi të lëngjeve, mjete matëse, njësi matëse			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, litër, mililitër, njësi vëllimi të lëngjeve, mjete matëse, njësi matëse, letra me shifra.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënët:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Veprimtaria e parë: Orën e mësimit e nis me këtë situatë. Secili grup do të luajë brenda grupit shitblerësi i lëngjeve. Është një ditë vere dhe bën shumë vapë. Kërkoni shitësit nga një gote lëng ose kënaçe për të shuar etjen. Përdorni termat: Litër, mililitër. Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve: <ul style="list-style-type: none"><li>- Cila është njësia themelore për matjen e lëngjeve?</li><li>- Cilët janë njësitë më të vogla dhe më të mëdha se litri?</li></ul>			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b> Njihen nxënësit me temën e mësimit. Ndaj klasën në grupe dhe orientoj nxënësit sesi do të realizojnë detyrën në grup. Nxënësit janë porositur të sjellin enë të shkallëzuar. Secilit grup i ndaj nga tri letra me shifra. Me këto shifra, nxënësit formojnë një numë treshifror. Numri i formuar do të tregojë vëllimin e një ene në ml. Shkruajnë vëllimin në fletë. Me po të njëjtat letra krijojnë tri vëllime të reja dhe i shkruajnë përsëri në fletë. Nxënësit në grupe do te gjejnë enët që mendojnë se e kanë vëllimin sa sasinë që kanë numrat që krijuan. Më pas, ato matin vëllimin real në enët e shkallëzuara. Të dhënat do të hidhen në tabelën që e ka çdo grup.			

Vlera e përafërt e vëllimit	Vëllimi i enës	Diferenca ndërmjet vëllimit të përafërt dhe atij real.

Pas plotësimit të tabelës me të dhënat, nxënësit do të shënojnë nivelin e ujit në enët matëse. Nxënësit do të gjejnë shumën e katër vëllimeve. Këtë shumë ata e shkruajnë në tri mënyra të ndryshme.

Renditin vëllimet duke filluar nga më i vogli.

### **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e përgatitura nga mësuesi/ja.

Si do ta përshkruanit blerjen e 2l qumësht? Një enë ka 3l e 7 ml ujë. Sa ml ujë ka ena? Ushtrimet zgjidhen në tabelë nga dy nxënës dhe pas përfundimit diskutohet me gjithë klasën.

### **Vlerësimi**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- tregimin e njësive të matjes së vëllimit të lëngjeve;
- gjetjen e vëllimit të lëngjeve në trupa të ndryshëm;
- identifikimin e sistemeve standarde të matjes së gjatësisë, të masës dhe të vëllimit;
- interpretimin e leximeve në masa të ndryshme.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika: Matja</b>	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Gjatësia, masa dhe vëllimi			
<b>Situata e të nxënët:</b> Shkruan receta gatimi me gjithë përbërësit duke përdorur njësitë matëse standarde të peshës dhe vëllimit të lëngjeve.			
<b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Tregon njësitë e matjes së masës dhe vëllimit të lëngjeve. <ul style="list-style-type: none"><li>• Gjen vëllimin e lëngjeve dhe peshën në trupa të ndryshëm.</li><li>• Identifikon sisteme standarde të matjes së masë e vëllimit.</li><li>• Interpretin leximet në masa të ndryshme.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> Litër, mililitër, njësi vëllimi të lëngjeve, mjete matëse, njësi matëse			
<b>Burimet , mjetet:</b> libri i nxënësit, litër, mililitër, njësi matëse të peshës, vëllimi të lëngjeve, mjete matëse, njësi matëse, lista me përbërës të ëmbëlsirave		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënët:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën)			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>			
<b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> <b>Veprimtaria e parë:</b> Nxënësit e ndarë në grupe diskutojnë receta ëmbëlsirash. Më pas ata shkruajnë përbërësit me gjithë njësitë matëse. Shkruan recetën secili grup në një fletë A4, ku rendisin njësitë matëse të masës dhe vëllimit.			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim</b> Nxënësit njihen me temën e mësimit dhe hapin librat në faqen 123. Nxënësit punojnë përsëri në grup. Lexohet receta e Dejvit dhe nxënësit ndihmojnë Dejvin me mendimet e tyre në vështirësitë që ai ka hasur. Nxënësit shkruajnë atë që mendojnë. Nxënësit tregojnë se si janë bërë ndarjet në peshore dhe shkruajnë udhëzimet për Dejvin që ai të arrijë të bëjë kekun që dëshiron. Lexohen dhe diskutohen udhëzimet e grupeve.			
<b>Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b> Në fletoren e klasës, nxënësit do të shkruajnë një lloj ëmbëlsire që u pëlqen me gjithë përbërësit njësitë matëse. Lexohen disa prej tyre nga nxënësit.			

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- tregimin e njësive të matjes së masës dhe vëllimit të lëngjeve;
- gjetjen e vëllimit të lëngjeve dhe peshën në trupa të ndryshëm;
- identifikimin e sistemeve standarde të matjes së masë e vëllimit;
- interpretimin e leximit në masa të ndryshme.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës

<b>Fusha:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data:</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 minuta		<b>Tematika:</b> Matja	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Gjatësia, masa dhe vëllimi			
<b>Situata e të nxënit:</b> Veprimtaria e matjes së gjatësisë, masës dhe vëllimit të objektit.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përzgjidh dhe përdor njësitet standarde të matjes.</li><li>- Dallon njësitet matëse të gjatësisë km, dcm, m, dm, cm, mm.</li><li>- Mat objekte sipas njësisë matëse.</li><li>- Dallon njësitet e matjes së masës t, kv, kg, g.</li><li>- Mat masat e trupave sipas njësive matëse.</li><li>- Dallon njësitet e matjes së vëllimit për lëngjet, litri, ml dhe trupat e ngurtë m<sup>3</sup>, dm<sup>3</sup>, cm<sup>3</sup>, mm<sup>3</sup> etj.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> vëllim, gjatësi, masë			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, njohuritë paraprake të nxënit, njësitet e matjes së gjatësisë, metri, vizore, njësi të matjes së masës, gurë peshoreje në kg, gr, njësi të matjes së vëllimit të lëngjeve, enë e shkallëzuar në litra e ml.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> gjuha dhe komunikimi, arte, edukim fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin, krijim i lirë (punë në çifte, punë në grupe, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <b>Faza e parë:</b> Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
<div><div><div>Gjatësia</div><div>Gjatësia, masa dhe vëllimi</div><div>Vëllimi</div><div>Lëngje</div><div>Litri (l) Mililitri (ml) Centilitri (cl) Decilitri (dl)</div><div>1l=10dl 1l=100cl 1l=1000ml</div></div><div><div>masa</div><div>Kunjtal (kv) Kilogram (kg) Grami</div><div>Toni (t)</div><div>1t=10kv 1kv=100kg 1kg=100g</div></div><div><div>Trupa të ngurtë</div><div>Mm3 cm3 dm3 m3</div><div>1m3=1000dm3 1m3=1000000cm3 1m3=1000000000mm3 1dm3=1l 1cm3=1ml</div></div></div>			



**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim Punë në grupe.** Ndahet klasa në 3 grupe

Grupi 1 -> masin gjatësi të objekteve të ndryshme si: lapsa, gomë, gjatësi të librit, bankën klasën, oborrin, derën etj. duke mbajtur shënime në fletore.

Grupi 2 -> Masin masat e objekteve të ndryshme si: libri, goma, çantën, fruta, shokun etj., shkruajnë në fletore vëzhgimet matjet e kryera.

Grupi 3 -> Matin vëllimin e lëngjeve p.sh.: ujin, qumësht, pije të ndryshme.

Matin vëllimin e trupave të ngurtë p.sh., kubi, kuboidi, trupat në formë kubi dhe kuboidi duke mbajtur shënime: vëllimi i kubit axaxa, vëllimi i kuboidit axaxc.

Diskutohen veprimtaritë e kryera nga grupet duke theksuar njësine matëse të objekteve të ndryshme të gjatësisë, masës.

Nxënësit ndahen në grupe dhe merren konkretisht me matje gjatësish objektesh konkrete. Në fund grupet japin rezultatet e matjes duke bërë kështu edhe ballafaqimin e rezultateve të arritura.

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Përforsim i njohurive: veprimtari individuale, diskutim në dyshe, shkëmbim**

- a) Ndërtoni situata problemore për matjen e gjatësisë, masës dhe vëllimit të trupave.
- b) Zbatime praktike me njësitë e gjatësisë, masës, vëllimit.

1. Plotëso:

5 km = \_\_\_\_\_ m 7000 m = \_\_\_\_\_ km

1200 cm = \_\_\_\_\_ m

14 m = \_\_\_\_\_ dm = \_\_\_\_\_ cm = \_\_\_\_\_ dm = \_\_\_\_\_ m

2. Plotëso:

1 t = \_\_\_\_\_ kv 5 t = \_\_\_\_\_ kv 30 kv = \_\_\_\_\_ t 7 kg = g

8 t = \_\_\_\_\_ kv = \_\_\_\_\_ kg = \_\_\_\_\_ g 9000000 g = kg = kv = t

3./a Gjej vëllimin e kubit me brinjë 5 cm  $V = \quad \text{cm}^3$

b) Gjej vëllimin e kuboidit me gjatësi 5 cm, lartësi 2 cm dhe gjerësi 4 cm.

$V = \quad \text{m}^3$

**Vlerësimi**

Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:


- dallimin e njësive të gjatësisë, masës, vëllimit të objekteve të ndryshme;
- matjen e saktë të gjatësisë, masës e vëllimit të trupave;
- këmbimin e njësive të mëdha në të vogla dhe anasjelltas;
- punën në grup, situatat problemore dhe vlerësimin e shokut.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotësimi i fletores së punës.

Krijoni situata problemore me njësitë e gjatësisë, masës, vëllimit me objekte që keni në shtëpinë tuaj.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min <b>Tematika: Matjet</b>			
<b>Koha</b> <b>Tema mësimore:</b> Diskutojmë së bashku			
<b>Situata e të nxënit:</b>  Situata konkrete nga jeta e përditshme.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Rendit njësitë e kohës: sekondë, minutë, orë, ditë, javë, muaj, vit...etj.</li><li>• Përdor lidhjen midis njësive të kohës.</li><li>• Zbaton lidhjen midis njësive të kohës për të zgjidhur situata nga jeta e përditshme.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> orë, minutë, sekondë, ditë, javë, muaj, vit, dekadë, shekull, mijëvjeçar, orë analoge, orë digjitale, dje, sot, nesër, së shpejti, 12 orë, 24 orë, vit i brishtë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, situata të thjeshta me njësi të kohës, modele për mësuesin/en		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet, Edukimi fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b>  vëzhgo – rendit; punë në grupe; punë individuale, lexo – nxirr përfundimin, plotëso			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Ndahet klasa në 4 grupe pune: <b>Grupit të parë</b> i jepet për detyrë të renditë fjalët kyçe për të formuar këtë zinxhir kohe: <b>sekondë → minutë → orë → ditë → javë → muaj → vit → dekadë → shekull →mijëvjeçar</b></li></ul>			
<b>Grupit të dytë</b> i jepet për detyrë të bëjë prezantimin e orës digjitale në ndërtim dhe funksion; <div><div>tregon orën në drejtimin orar dhe kundërorar akrepa fushë me numra numrat nga 0-12</div><div><div>ndërtimi</div><div>Ora analoge</div></div></div>			




**Grupit të tretë** i jepet për detyrë të bëjë prezantimin e orës *analoge në ndërtim dhe funksion*

*Orë me numra*

*Numrat 1-12 tregojnë paraditen*

*Numrat 13-24 tregojnë pasditen*

*Numrat 0-59 tregojnë minutat*



**Grupit të katërt** i jepet për detyrë të tregojë kuptimin e fjalëve: *dje, sot, ditë-natë, nesër, së shpejti, vit i brishtë*.

U jepet kohë rreth 3-4 minuta grupeve për të punuar. Secili grup prezanton punën e zhvilluar.

**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

- Nxënësit kalojnë në plotësimin e tabelës në libër, te rubrika “Diskutojmë së bashku”.

Punojnë në grupe prej 4 vetash.

- Punojnë të pavarur për të shkruar përshkrimet poshtë fjalëve të tabelës.

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Duke përdorur fjalët kyçe të dhëna te fletorja e punës, secili nxënës sajon dy situata nga jeta e përditshme dhe i shkruan e i zgjidh ato në fletore.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- renditjen e saktë të njësive të kohës: sekondë, minutë, orë, ditë, javë, muaj, vit... etj.;
- përdorimin në situata të jetës së përditshme të lidhjeve midis njësive të kohës;
- zbatimin e lidhjes midis njësive të kohës për të zgjidhur situata nga jeta e përditshme.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Përdor më lehtë një orë digjitale apo një orë analoge? Pse? Argumento përgjigjen me shkrim.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika: Matjet</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Këmbimi ndërmjet njësive të kohës (zbulojmë + eksplorojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situata nga përditshmëria e gjithsecilit e diskutimi i tyre.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Kthen në orë e minuta intervale kohore të dhëna në minuta. <ul style="list-style-type: none"><li>• Këmben minutat me orët dhe anasjelltas.</li><li>• Këmben ditët në orë dhe anasjelltas.</li><li>• - Ndërton e zgjidh situata nga jeta e përditshme duke kryer veprime me njësitë e kohës.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> këmbim, minutë, muaj, ditë			
<b>Burimet dhe mjetet:</b> libri i nxënësit, fletore e punës, situata të thjeshta me njësi të kohës		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b>  Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin. Krijim i lirë (punë në dyshe, punë në grupe, punë me të gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b></li></ul> Rikujtoj me nxënësit lidhjet ndërmjet njësive të kohës: 60 sekonda = 1 minutë; 60 minuta = 1 orë; 24 orë = 1 ditë. Paraqes dy situata: <ul style="list-style-type: none"><li>➤ 80 minuta i duhen Zanës për të parë një film. Sa orë e minuta zgjat filmi? Këmbejmë 80 minutat me 1 orë e 20 minuta</li><li>➤ Për 30 minuta Eni mbaron detyrat e matematikës dhe për 45 minuta mbaron edhe mësimin e Historisë e të Gjuhës shqipe së bashku. Sa minuta studioi ai? Sa orë? 30 minuta + 45 minuta = 75 minuta Këmbejmë 75 minutat me 1 orë e 15 minuta.</li></ul>			

Ndaj klasën në 3 grupe pune. Secili grup do të zgjidhë një situatë me këmbime ndërmjet këtyre njësive të kohës. Shpërndaj në fisha situatat:

- Një lojë futbollit zgjat 90 minuta. Sa orë e minuta zgjat ajo?
- Blerta lexoi për 32 minuta një libër dhe pa për 90 minuta një film. Sa orë e minuta harxhoi ajo?
- Blerti udhëtoi 72 orë për të vizituar gjyshërit. Sa ditë e orë i mori udhëtimi? Grupet punojnë për 3-4 minuta dhe prezantojnë rezultatin.

• **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

- Nxënësit kalojnë në punën me librin. Plotësohen situatat e dhëna në libër nga secili nxënës, duke këmbyer minutat në sekonda, vitet në muaj, minutat në orë e minuta. Në tabelën e dytë realizon shumën në minuta dhe i këmben ato në orë të plota e minuta.
- Bëhet diskutimi në dyshe i përfundimeve të gjetura dhe prezantohen rezultatet.

• **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Punohen situatat e dhëna në fletoren e punës, në faqen 70. Prezantohen përfundimet e gjetura nga disa nxënës.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- këmbimin në orë e minuta të intervaleve kohore të dhëna në minuta dhe anasjelltas;
- këmbimin e ditëve në orë dhe anasjelltas;
- zgjidhjen e situatave nga jeta e përditshme, duke kryer veprime me njësitë e kohës.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotëson në shtëpi faqen 71 të fletores së punës që punoi në klasë.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika: Matjet</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Përdorimi i orës me sistem 24-orësh (zbulojmë + eksplorojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Lexim dhe interpretim i orës në jetën e përditshme			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Lexon orën digjitale dhe atë analoge dhe i interpreton ato.</li><li>• Përdor orën në saje të sistemit 24-orësh.</li><li>• Zgjidh situata problemore duke përdorur orën me sistem 24-orësh.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> këmbim, minutë, muaj, ditë			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, orë me akrepa, orë digjitale		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b>  Vëzhgo, emërto, sill shembuj, puno me <i>grupe ekspertësh</i> , lexo dhe nxirr përfundime. Krijim i lirë (punë në grupe treshe, punë në grupe më të mëdha, punë me gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Vëzhgohet ndërtimi i tabelës së mëposhtme në saje të përgjigjeve të nxënësve:</li></ul>			
<b>Ora analoge</b>  - është e pajisur me një fushë; - është e pajisur me 2 ose 3 akrepa - ka mbi fushë numrat nga 1-12 - tregon orën në drejtimin orar dhe kundërorar		<b>Ora digjitale</b>  - orë me numra     _ _ : _ _ - numrat 1-12 tregojnë periudhën e paradites e vendosen para: - numrat 13-24 tregojnë periudhën e pasdites e vendosen para: Numrat 0-59 tregojnë minutat e vendosen pas:	

Sillen shembuj konkretë të leximit të orës në të dyja versionet.

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

- Punë me të gjithë klasën. Nxënësit kalojnë në punën me librin. Ata lidhin me vijë orën digjitale dhe orën analoge me kohën përkatëse të dhënë me fjalë.

- *Grupet e ekspertëve:* Emërtoj në një grup prej tre nxënësish: njërin me numrin 1, tjetrin me numrin 2 dhe të tretin me numrin 3. Nxënësi me numrin 1 do të punojë në mënyrë të pavarur situatën 1 dhe 2 në faqen 8B.

Drini u kthye në shtëpi në 14 e 20 + 2 orë e 15 minuta = 16 e 35 minuta. Rea i filloi punët në 12 e 45 minuta – 1 orë e 30 minuta = 11:15 minuta.

Nxënësi me numrin 2 do të punojë situatën 3 dhe 4.

Filmi zgjati 16:25 – 14:10 = 2 orë e 15 minuta. Programi zgjati 17:40 – 15:05 = 2 orë e 35 minuta.

Nxënësi me numrin 3 do të punojë në mënyrë të pavarur situatën 5. Meli i përfundoi detyrat për 1 orë. Meli i mbaroi për 16:55 – 15:10 = 1 orë e 45 minuta.

Melitin iu deshën 45 minuta më shumë për të përfunduar detyrat.

Bëhet ndarja e detyrës në çdo treshe nxënësish. Nxënësit punojnë për 5 minuta.

Prezantohen zgjidhjet nga disa prej tyre.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Punohen situatat e dhëna në fletoren e punës, faqe 72. Prezantohen përfundimin e gjetura nga disa nxënës.

### **Vlerësimi:**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**



- leximin e orës digjitale dhe analoge dhe për interpretimin e tyre;
- përdorimin e orës në saje të sistemit 24-orësh;
- zgjidhjen e situatave problemore duke përdorur orën me sistem 24-orësh.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Nxënësit ndërtojnë vetë një problemë të ngjashme me situatat e punuara në libër.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Matjet	
<b>Tema mësimore:</b> Leximi i tabelave të orareve (zbulojmë + eksplorojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b>  Situata konkrete nga jeta e përditshme			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>Lexon dhe interpreton orën digjitale të dhënë nëpër situata të ndryshme.</li><li>Gjen saktë ndryshesën apo shumën midis intervaleve kohore të dhëna në situata.</li><li>Zgjidh situata problemore duke llogaritur e shkruar saktë kohën e kërkuar.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> orë, minutë, orari i nisjes, orari i mbërritjes, koha e mbetur etj.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, situata të thjeshta me njësi të kohës, modele për mësuesin/en		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet, Edukimi fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b>  vëzhgo – gjej; punë individuale; punë në grupe; lexo – nxirr përfundimin, plotëso			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li><b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Pyes nxënësit mbi orën e nisjes nga shtëpia për në shkollë dhe orën e mbërritjes në shkollë. Ndërtoj në dërrasë një tabelë si kjo më poshtë:</li></ul>			



Ora e nisjes nga shtëpia	Ora e mbërritjes në shkollë	Koha që i duhet
07:15	07:45	 $07:45 - 07:15 = 30 \text{ minuta}$
07:05	07:55	 $07:55 - 07:05 = 50 \text{ minuta}$

Diskutoj me nxënësit rrugën e zgjidhjes dhe orientimin në bosht.

• **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Të punuarit në bashkëpunim**

- Nxënësit kalojnë në plotësimin e tabelës në libër, te njësia mësimore 8C rubrika “Zbulojmë”, pasi është sqaruar tabela e orareve. Për secilin rast të kërkuar, ndërtojmë grafikun dhe shënojmë ndryshesën e orarit të mbërritjes me atë të nisjes. Punohet me të gjithë klasën. Vëzhgohet tabela e orareve të avionëve drejt Francës në 8C. Duke aktivizuar nxënësit të ndryshëm, bëjmë llogaritjen e kohëzgjatjes së udhëtimit me avion drejt Parisit. Secili nxënës kalon në plotësimin e situatave në libër. Babai i Gencit merr fluturimin 8, që ka kohëzgjatjen më të shkurtër të udhëtimit: 3 orë. Diskutohet rreth kohëzgjatjes së madhe të udhëtimeve dhe argumentohen shkaqet. Diskutohet çdo përfundim i gjetur.

• **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Punoj me grupe nxënësish situatat e fletores së punës në faqet 72-73. Ndaj klasën në 4 grupe pune. Secili grup përzgjedh një nga situatat e dhëna .

1.  $14 \text{ e } 20 + 1 \text{ orë e } 45 \text{ minuta} = 15 \text{ e } 65 \text{ minuta} = 16:5$ , sepse këmbejmë 60 minuta me 1 orë.
2.  $19:40 + 135 = 19 \text{ e } 175 \text{ minuta} = 21:55$ , sepse këmbejmë 135 minuta me 2 orë e 55 minuta.
3.  $17:45 + 1 \text{ orë e } 20 \text{ minuta} = 18:65 \text{ minuta} = 19:5$ , sepse këmbejmë 65 minuta me 1 orë e 5 minuta.
4.  $12:50 + 2 \text{ orë e } 45 \text{ minuta} = 14 \text{ orë e } 95 \text{ minuta} = 15:35$ , sepse këmbejmë 95 minuta me 1 orë e 35 minuta.

Secili grup prezanton zgjidhjen e tij .

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**


- leximin dhe interpretimin e orës digjitale të dhënë nëpër situata të ndryshme;
- gjetjen e saktë të ndryshesës apo të shumës midis intervaleve kohorë të dhëna në situata;
- zgjidhjen e situatave problemore, duke llogaritur e shkruar saktë kohën e kërkuar.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Përfundon detyrën në fletoren e punës, të cilën e nisi në klasë.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja: 45 min</b>		<b>Tematika: Matjet</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Llogaritja e intervaleve kohore (zbulojmë + eksplorojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situata nga përditshmëria e gjithsecilit dhe diskutimi rreth tyre			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Llogarit intervale të ndryshme kohore duke i pasqyruar mbi boshte numerike.</li> <li>- Mbledh, zbret dhe krahason intervale kohore të dhëna.</li> <li>- Ndërton e zgjidh situata nga jeta e përditshme, duke kryer veprime me njësitë e kohës.</li> </ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> minutë, orë, digjital, analog			
<b>Burimet mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, situata të thjeshta me njësi të kohës, letra me shifra, orë digjitale dhe orë analoge		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  Vëzhgo, emërto, sill shembuj, lexo dhe nxirr përfundimin. Krijim i lirë (punë në dyshe, punë në grupe më të mëdha, punë me të gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>            U shpërndaj nxënësve fisha me intervale kohore të përcaktuara:           <div style="display: flex; justify-content: space-around; margin-top: 10px;"> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 10px; padding: 10px; text-align: center;">             16:20 2 orë e 25 minuta           </div> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 10px; padding: 10px; text-align: center;">             2 orë e 5 minuta 18:50           </div> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 10px; padding: 10px; text-align: center;">             15:50 17:35           </div> </div> <p style="margin-top: 20px;">Kërkoj nga nxënësit që të krijojnë me gojë situata të ndryshme problemore, mbështetur mbi intervalet kohore të dhëna, p.sh.:</p> <div style="display: flex; align-items: center; margin-top: 20px;"> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 10px; padding: 10px; text-align: center; margin-right: 20px;">             16:20 2 orë e 25           </div> <div style="font-size: 4em;">←</div> <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; flex-grow: 1;">             Mira doli në 16:20 nga shtëpia dhe shëtiti për 2 orë e 25 minuta. Në cilën orë u kthye ajo në shtëpi ?           </div> </div> </li> </ul>			

Vizatohet boshti numerik me intervalet kohore:



Bëhet llogaritja e kohës:  $16:20 + 2 \text{ orë e } 25 \text{ minuta} = 18:45 \text{ minuta}$ .

Ndiquet e njëjta rrugë edhe për dy situatat e tjera. Diskutohen zgjidhjet e tyre.


• **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Puna në bashkëpunim**

- Nxënësit punojnë në libër, në njësinë mësimore 8D. Lexohen dhe llogariten **situatat** e dhëna në libër, duke punuar në grupe me nga dy.

1.  $\rightarrow 14:20 + 2 \text{ orë e } 25 \text{ minuta} = 16 : 45 \text{ minuta}$ .

2.  $\rightarrow 18:20 - 2 \text{ orë e } 05 \text{ minuta} = 16 : 15 \text{ minuta}$ .

3.  $\rightarrow 17:35 - 15 : 50 = 16 : 95 - 15 : 50 = 1 \text{ orë e } 45 \text{ minuta}$ .



këmbejmë

4  $\rightarrow 16 : 25 - 07 : 15 = 9 \text{ orë e } 10 \text{ minuta}$ .

5.  $\rightarrow$  Ada  $\rightarrow 16 : 10 - 14 : 25 = 15 : 70 - 14 : 25 = 1 \text{ orë e } 45 \text{ minuta}$ .

Miri  $\rightarrow 1 \text{ orë e } 45 \text{ minuta} + 1 \text{ orë e } 10 \text{ minuta} = 2 \text{ orë e } 55 \text{ minuta}$ .

- Bëhet diskutimi në dyshe i përfundimeve të gjetura dhe prezantohen rezultatet.

• **Faza e tretë : Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Organizohet loja me letra për të ndërtuar një orë, p.sh.: 9:45. Vizatohen orët me akrepa për të demonstruar këtë kohë të formuar me letra e më pas shkruhet edhe ora digjitale 12-orëshe. Vazhdohet e njëjta situatë loje në njësinë mësimore 8D në libër.

Në varësi të kohës së mbetur, nxënësve u kërkoj të plotësojnë fletoren e punës në faqet 74 dhe 75.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi vlerëson nxënësin për:**

- llogaritjen e intervaleve të ndryshme kohore duke i pasqyruar mbi boshte numerike;  
- mbledhjen, zbritjen dhe krahasimin e intervaleve kohore të dhëna;

- ndërtimin dhe zgjidhjen e situatave nga jeta e përditshme, duke kryer veprime me njësitë e kohës.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotëson në shtëpi ushtrimet që i mbeten pa zgjidhur në klasë të fletorja e punës (faqet 74, 75).

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja: 45 min</b>		<b>Tematika: Matjet</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Përdorimi i kalendarëve (zbulojmë + eksplorojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situata nga përditshmëria e gjithsecilit dhe diskutimi rreth tyre			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• përdor kalendarin si mjet konkret për llogaritjen e kohës;</li><li>• llogarit intervale kohore të shprehura në javë e ditë;</li><li>• zgjidh situata nga jeta e përditshme, duke kryer veprime me njësitë e kohës.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> minutë, orë, digjitale, analoge			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, situata të thjeshta me njësi të kohës, kalendar		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  Vëzhgo, emërto, ndiq në veprime dhe nxirr përfundimin. Krijim i lirë (punë në dyshe, punë në grupe më të mëdha, punë me të gjithë klasën).			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Në orën e mëparshme, nxënësit janë porositur për t’u pajisur secili me një kalendar të vitit. Punohet një situatë konkrete me kalendar me të gjithë klasën (frontalisht).<ol style="list-style-type: none"><li>1. Qarkohet nga të gjithë data 8 Mars, Dita e Gruas.</li><li>2. Qarkohet nga të gjithë data 28 Nëntor, Dita e Flamurit.</li><li>3. Sa kohë pas Ditës së Gruas është Dita e Flamurit?</li></ol>Listohen disa mënyra për llogaritjen e kësaj kohe:<ul style="list-style-type: none"><li>- 1. Numërohen ditët në kalendar (e lodhshme dhe e zgjatur në kohë si mënyrë veprimi).</li><li>- 2. Numërohen javët e plota, duke u nisur që nga data 8 Mars –18 mars = 1 javë ... deri në 8 nëntor janë plot 35 javë.</li><li>- Llogariten ditët e mbetura të muajit 28 – 8= 20 ditë.</li><li>- Koha midis këtyre datave është 35 javë e 20 ditë.</li></ul></li></ul>			

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Puna në bashkëpunim**

Punë individuale me librin: Secili nxënës punon në mënyrë të pavarur njësinë 8E në libër dhe faqet 76, 77 në fletoren e punës.

Informohen nxënësit që koha ndërmjet datave në kalendar të llogaritet në javë dhe në ditë.

- Bëhet diskutimi në dyshe i përfundimeve të gjetura dhe prezantohen rezultatet.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Organizohet eksplorimi në formë loje mbështetur në njësinë mësimore 8E, duke punuar në grupe me nga 4 nxënës. Të orientuar në hapat e veprimeve që do të bëjnë, ata llogaritin ditën e saktë të datëlindjes së Arditit. Nxënësi do të ketë parasysh lidhjen mes orës dhe ditës në harkun kohor:  $24 \text{ orë} : 1 \text{ ditë} = 24 \text{ orë}$ .

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- përdorimin e kalendarit si mjet konkret për llogaritjen e kohës;
- llogaritjen e intervaleve kohore të shprehura në javë e ditë;
- zgjidhjen e situatave të jetës së përditshme, duke kryer veprime me njësitë e kohës.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Shëno 5 data të rëndësishme të familjes tënde në kalendar dhe llogarit intervalet kohore midis tyre.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja: 45 min</b>		<b>Tematika: Matjet</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Koha (përsëritje) <b>- përmbledhim + përforcojmë -</b>			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situata nga përditshmëria e gjithsecilit dhe diskutimi rreth tyre			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Llogarit kohëzgjatjen e një veprimtarie duke u mbështetur tek orari i nisjes e përfundimit të veprimtarisë. - Krahason kohëzgjatjen e veprimtarive të ndryshme.  - Zgjidh situata nga jeta e përditshme, duke kryer veprime me njësitë e kohës.			
<b>Fjalët kyçe:</b> minutë, orë, akrepa, orar, digjitale, analoge			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, situata të thjeshta me njësi të kohës		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  Krijim i lirë (punë në dyshe, punë në grupe më të mëdha, punë individuale). Vëzhgo, emërto, ndiq në veprime dhe nxirr përfundimin.			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  • <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> - Nxënësit janë porositur një ditë më parë të bëjnë një listë me të paktën 4 programe televizive të preferuara prej tyre. - Ndahet klasa në grupe pune me nga 4 anëtarë secili. - Secili grup organizon punën mbi bazën e hapave të dhënë në njësinë mësimore “8 Koha” – Përmbledhim – Tabelat që do të plotësohen në grup, do të jenë format i madh në A2, që të duken para klasës. - Grupet e punës punojnë 10 minuta për të plotësuar tabelën me programet e preferuara. Nga lista personale e programeve të preferuara, çdo anëtar i grupit përzgjedh 1 program për ta hedhur në tabelën e grupit. Punët e përfunduara prezantohen para klasës nga përfaqësuesi i grupit.			

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Puna në bashkëpunim**

Punë individuale me librin: Secili nxënës punon në mënyrë të pavarur, duke plotësuar tabelën përkatëse në njësinë “8 Koha” në libër dhe zhvillon situatat në faqen 78 në fletoren e punës.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Organizohet eksplorimi në formë, loje mbështetur në njësinë mësimore “8 Koha”, duke punuar në grupe me nga dy vetë. Të orientuar në hapat e veprimeve që do të bëjnë, nxënësit plotësojnë situatat e dhëna në libër. Nxënësi do të ketë parasysh lidhjen e njohurive që ka marrë për njësitë e matjes së kohës, intervalet kohore, njësitë e barasvlershme të kohës e tabela oraresh. Në fund të veprimtarisë, ai do të tregojë ndjesitë e veta, duke qarkuar gjendjen e tij emocionale në orën mësimore përkatëse.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- llogaritjen e kohëzgjatjes së një veprimtarie, duke u mbështetur në orarin e nisjes dhe të përfundimit të veprimtarisë;
- krahasimin e kohëzgjatjeve të veprimtarive të ndryshme;
- zgjidhjen e situatave nga jeta e përditshme, duke kryer veprime me njësitë e kohës.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Krijo 3 situata të ngjashme me ato të faqes 78 në fletoren e punës dhe zgjidhi në fletore.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min <b>Tematika:</b> Përforcim njohurish			
<b>Tema mësimore:</b> Testim për njohuritë e marra rreth matjes			
<b>Situata e të nxënit:</b> <b>Sillen shembuj dhe diskutohet rreth tyre.</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b>  – Përdor njësitë e peshës, masës dhe gjatësive. – Përdor matjen e kohës me njësitë e veta.			
<b>Fjalët kyçe:</b> masë, centimetër, milimetër, kg, g, orë, minutë, sekondë			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  punë me grupe, punë me të gjithë klasën, vëzhgo-plotëso dhe nxirr përfundimin, punë e pavarur, turi i galerisë			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  • <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>			
<b>Pyesim</b>		<b>Përgjigjemi</b>	
Cilat janë njësitë e gjatësisë? Cili është mjeti që shërben për matjen e masës? Cilat janë njësitë e matjes së masës? Po njësitë e matjes së vëllimit? Cilat janë njësitë e matjes së kohës? Cila është lidhja mes tyre? Përse na shërben kalendari? Si matet koha? Çfarë është ora digjitale dhe ajo analoge?			
Prezantohen dhe përforcohen njohuritë e marra gjatë kapitullit.			
<b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Punë e pavarur</b>			



**Testim njohurish për kapitullin “Koha”**


Shkalla: II Klasa: V Lënda: Matematikë

Emër /mbiemër \_\_\_\_\_

Klasa \_\_\_\_\_

Shkolla \_\_\_\_\_

Grupi A

**1.** Vizato segmentet me gjatësitë e dhëna më poshtë: (3 pikë )**a)** 25 mm; **b)** 4,7 cm; **c)** 5 cm; **d)** 3 mm.**2.** Radhit gjatësitë e segmenteve të mëposhtme, duke filluar nga gjatësia më e vogël. (5 pikë)**3.** Shkruaj masat e dhëna në g dhe në kg. (4 pikë )

<b>Masa në g</b>	820		3600	
<b>Masa në kg</b>		0,53		2,8

**4.** Radhit masat e mëposhtme, duke filluar nga më e madhja. (4 pikë )

1,35 litra, 720 ml, 0,253 litra, 457ml

**5.** Për të bërë një gatim, Ilirit i nevojiten  $\frac{4}{10}$  litra qumësht,  $\frac{1}{4}$  kg gjalpë,  $\frac{1}{4}$  kg miell misri. Ndhimjoje Ilirin të përgatitë recetën, duke llogaritur sa ml kos, sa g gjalpë dhe sa g miell misri i duhet. (3 pikë )

**6.** Plotëso duke pasur parasysh lidhjet midis njësive të kohës. (7 pikë )


15 minuta = \_\_\_\_ sekonda ; \_\_\_\_ vjet = 240 muaj ; 52 vjet = \_\_\_\_ muaj

745 minuta = \_\_\_\_ orë dhe \_\_\_\_ minuta


47 minuta + 75 minuta = \_\_\_\_ orë dhe \_\_\_\_ minuta

7. Vizato numrat brenda fushës, akrepin e orës dhe atë të minutave, kur ora shënon: (4 pikë)

**08:55 minuta**



**21:25 minuta**



8. Mirela doli nga shtëpia në orën 12:35 minuta. Vizitoi bibliotekën e lagjes për 1 orë e 25 minuta dhe u kthye te gjyshja për 2 orë e 15 minuta. Sa ishte ora kur ajo u kthye në shtëpi?

(2 pikë)

9. Makina niset nga Tirana në orën 10:50 minuta. Ajo mbërrin në Elbasan në orën 12:15. Gjatë rrugës, shoferi bëri një pushim prej 20 minutash. Sa kohë zgjati udhëtimi?

(2 pikë)

Shkallët	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 8	9-13	14-17	18-21	22-25	26-30	31-34

**Testim njohurish për kapitullin “Koha”**

Shkalla: II Klasa: V Lënda: Matematikë


Emër /mbiemër \_\_\_\_\_

Klasa \_\_\_\_\_

Shkolla \_\_\_\_\_

Grupi B

1. Vizato segmentet me gjatësitë e dhëna më poshtë: ( 3 pikë )

**a)** 41 mm; **b)** 1,7 cm; **c)** 6 cm; **d)** 8mm.2. Radhit gjatësitë e segmenteve të mëposhtme, duke filluar nga gjatësia më e vogël.  
(5 pikë)

3. Shkruaj masat e dhëna në g dhe në kg. (4 pikë )

<b>Masa në g</b>	790		4800	
<b>Masa në kg</b>		0,59		6,6

4. Radhit masat e mëposhtme, duke filluar nga më e vogla: (4 pikë )

3,35 litra; 520 ml; 0,343 litra; 735 ml.

-----



5. Për të bërë një gatim, Erjonës i nevojiten  $\frac{6}{10}$  litra qumësht,  $\frac{3}{4}$  kg gjalpë,  $\frac{2}{4}$ kg miell misri. Ndhmoje Erjonën të përgatitë recetën, duke llogaritur sa ml kos, sa g gjalpë dhe sa g miell misri i duhet. (3 pikë)

**6. Plotëso duke pasur parasysh lidhjet midis njësive të kohës. (7 pikë )**

65 minuta = \_\_\_\_ sekonda; \_\_\_\_ vjet = 480 muaj; 49 vjet = \_\_\_\_ muaj;

535 minuta = \_\_\_\_ orë dhe \_\_\_\_ minuta;

58 minuta + 45 minuta = \_\_\_\_ orë dhe \_\_\_\_ minuta.

**7. Vizato numrat brenda fushës, akrepin e orës dhe atë të minutave, kur ora shënon: (4 pikë)****09:10 minuta****19:45 minuta****8. Mira doli nga shtëpia në orën 10:35 minuta. Vizitoi bibliotekën e lagjes për 1 orë e 15 minuta dhe u kthye te gjyshja për 3 orë e 20 minuta. Sa ishte ora kur ajo u kthye në shtëpi?**

(2 pikë)

**9. Makina niset nga Tirana në orën 10:50 minuta. Ajo mbërrin në Vlorë në orën 15:35. Gjatë rrugës, shoferi bëri një pushim prej 40 minutash. Sa kohë zgjati udhëtimi? (2 pikë)**

Shkallët	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 8	9-13	14-17	18-21	22-25	26-30	31-34

**Vlerësimi:**

Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:

- shkathtësitë e fituara në përdorimin e njësive të peshës, masës dhe gjatësive;
- shkathtësitë e fituara mbi përdorimin dhe matjen e kohës me njësitë e veta.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Çdo nxënës punon në shtëpi mbi përforcimin e njohurive.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data
Koha e zgjatjes: 3 orë (nga 45 min)		Tematika: Matja e kohës	
<div>➤ Tema e projektit: Ora si mjet dhe njësi matëse</div> <div>➤ Qëllimi: Të saktësojë dhe thellojë njohuritë e tij/saj mbi orën si njësi e matjes së kohës dhe si mjet matës; të japë ndihmën e tij/saj në të mirë të komunitetit të shkollës ku mëson.</div> <div>➤ Aktorët: nxënësit, prindërit, komuniteti.</div> <div>➤ Menaxheri: mësuesi/ja.</div> <div>➤ Përfituesi: nxënësit, shkolla, klasat përgatitore të ciklit fillor të shkollës.</div> <div>➤ Vendi i aplikimit: klasa, oborri i shkollës, korridori i shkollës etj.</div>			
<div>Situata e të nxënës:</div> <div>Luajmë me orën, shuajmë kureshtjen rreth saj dhe zgjerojmë njohuritë.</div>			
<div>Rezultatet e të nxënës të kompetencave lëndore sipas temës:</div> <div>Në përfundim të projektit nxënësi/ja:</div> <div>- Siguron informacionin e nevojshëm mbi ndërtimin e llojit të orës (digjitale apo analoge) dhe kryen saktë leximin e saj.</div> <div>- Llogarit kohëzgjatjen e një veprimtarie duke u mbështetur tek orari i nisjes dhe i përfundimit të veprimtarisë; krahason kohëzgjatjen e veprimtarive të ndryshme.</div> <div>- Ndërton me teknika të ndryshme orë digjitale dhe analoge, duke përdorur sa më shumë materiale të riciklueshme.</div> <div>- Zgjidh situata nga jeta e përditshme, duke kryer veprime me njësitë e kohës.</div> <div>- Shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij/saj, duke i dhuruar krijimet e veta në dobi të komunitetit të shkollës.</div>			
<div>Fjalët kyçe: minutë, orë, akrepa, orar, digjitale, analoge, veprimtari, riciklim, mjete, historik, lashtësi, kohë</div>			
<div>Burimet, mjetet:</div> <div>libri i nxënësit, fletorja e punës, vizore, figura të ndryshme gjeometrike; orë të 2 llojeve, plastelinë, letra me ngjyra, vizore, ngjithës etj.</div>		<div>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</div> <div>Gjuha dhe komunikimi, Artet, Mjedisi dhe shoqëria</div>	
<div>Metodologjia e veprimtaria e të nxënës :</div> <div>Faza e parë: bisedë, kllaster, diagram Veni, 5-vargësh, shkrim i lirë, turi i galerisë.</div> <div>Faza e dytë: punë në grupe, diskutim, kompozim, turi i galerisë.</div> <div>Faza e tretë: turi i galerisë, bisedë, vizitë në klasat e parashkollorit për të dhuruar punimet e bëra.</div>			

**Zhvillimi i projektit sipas orëve:**

**Ora e parë** – Çdo nxënës do të punojë orën e parë rreth këtyre pikave:

- grumbullimi i informacionit mbi historikun e lindjes së orës si mjet matës;
- llojet e orëve si mjete matëse dhe evoluimi i tyre deri në ditët tona;
- llojet e orëve (anët e forta e të dobëta; të veçantat dhe të përbashkëtat midis orës digjitale dhe asaj analoge, diagram Veni);
- 5-vargësh mbi orën si mjet;
- një shkrim i shkurtër rreth dëshirës personale mbi llojin e orës që ka dhe të asaj që do të donte të kishte;
- turi i galerisë, prezantimi i etapës së parë të projektit, që mund të bëhet në klasë, në oborrin e shkollës etj.

**Ora e dytë** – Punë në grup. Ndahet klasa në grupe pune për të ndërtuar orë me materiale të riciklueshme, si: CD, pjata plastike, karton, kuti metalike, plastelinë, dru.

- Secili grup kryhen llogaritjen e situatave të ndryshme kohore të aktiviteteve që bën gjatë një dite mësimore. Turi i galerisë përmbledh ekspozimin në një kënd të klasës të materialeve të ndërtuara nga çdo grup, që mund të realizohet edhe në oborrin e shkollës etj.

**Ora e tretë** – Prezantimi i gjithë punës së zhvilluar në grup dhe individualisht nga çdo nxënës:

- vizitë në klasat e parashkollorit në orët e planifikuara për këto klasa, si komunitet i shkollës.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- saktësinë e informacionit mbi ndërtimin e llojit të orës (digjitale apo analoge) dhe kryen saktë leximin e saj;
- llogaritjen e kohëzgjatjes së një veprimtarie duke u mbështetur tek orari i nisjes dhe i përfundimit të veprimtarisë; krahason kohëzgjatjen e veprimtarive të ndryshme;
- ndërtimin me teknika të ndryshme të orëve digjitale dhe analoge, duke përdorur sa më shumë materiale të riciklueshme;
- zgjidhjen e situatave nga jeta e përditshme, duke kryer veprime me njësitë e kohës;
- shprehjen e ndjenjave dhe të emocioneve, duke dhuruar krijimin e tij në dobi të komunitetit të shkollës;
- gjuhën e përdorur dhe prezantimin e punës.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Projekti mund të filmohet apo fotografohet, sipas mundësive.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data
Kohëzgjatja: 45 min		Tematika: Gjeometri	
Perimetri dhe syprina e katrorit dhe e drejtkëndëshit Tema mësimore: Diskutojmë së bashku			
Situata e të nxënit: Luajmë me figura, gjejmë perimetrin dhe syprinën e tyre.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës: - Vizaton figura duke përdorur saktë vizoren si mjet. - Mat saktë gjatësitë e brinjëve të figurave gjeometrike. - Gjen perimetrin e figurave të ndërtuara duke mbledhur gjatësitë e brinjëve të figurës. - Gjen syprinën e figurave të ndërtuara duke shumëzuar përmasat e brinjëve fqinje të figurës.			
Fjalët kyçe: perimetër, centimetër, vizore, brinjë, metër, sipërfaqe, syprinë			
Burimet, mjetet: Letër e ndarë në një rrjet katrorësh me gjatësi 1 cm secili, vizore, gomë, gërshërë, ngjyra		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Artet	
Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit: Rrjet diskutimi, punë në grupe, punë në dyshe, vëzhgim, interpretim, <i>turi i galerisë</i> , prezantim			
Zhvillimi i mësimi: Diskutim. A mendoni se disa figura që kanë perimetra të barabartë, kanë edhe syprina të barabarta? Po figurat që kanë syprina të barabarta, a mund të kenë edhe perimetra të barabartë? Këtyre dy pyetjeve do t'u japim përgjigje në mësimin e sotëm. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme: Figura që kanë perimetra të barabartë, a mund të kenë edhe syprina të barabarta? Figurat që kanë syprina të barabarta, a mund të kenë edhe perimetra të barabartë? Hapi 1: Ndahen nxënësit në 2 grupe pune. Njëri grup do të punojë për pyetjen e parë, tjetri për pyetjen e dytë. Hapi 2: Përcaktimi i materialeve që u duhen: laps, letër me katrorë me brinjë 1 cm, e siguruar që në orët e mëparshme. Hapi 3: Brenda grupeve caktohen detyrat përkatëse.			

Grupi i parë	Grupi i dytë
<p>- Ky grup do të punojë në dyshe. Çdo dyshe nxënësish do të vizatojë në një fletë një katror me brinjë 1 cm. Secili prej katrorëve të vizatuar, duhet ta ketë gjatësinë e brinjës 10 cm.</p> <p>- Pritini katrorët.</p>	<p>- Edhe ky grup do të punojë në dyshe. Çdo dyshe nxënësish do të vizatojë në një fletë një katror me brinjë 1 cm. Secili prej katrorëve të vizatuar duhet ta ketë gjatësinë e brinjës 10 cm.</p> <p>- Pritini katrorët.</p>
<p>- Me katrorët e formuar ndërtohen dy figura në sajë të bashkimit të katrorëve më njëri-tjetrin me kusht që secila figurë duhet të ketë të njëjtin numër katrorësh të bashkuar .</p> <p>- Syprinat e tyre janë të barabarta.</p> <p>- Llogaritni perimetrat e tyre.</p> <p>Nxirrni përfundimet se çfarë ndodh me perimetrat e tyre .</p>	<p>- Me katrorët e formuar ndërtohen dy figura, në sajë të bashkimit të katrorëve më njëri-tjetrin, me kusht që të dyja figurat ta kenë të njëjtë shumën e gjatësive të brinjëve të tyre.</p> <p>- Perimetrat e tyre janë të barabartë.</p> <p>- Llogaritni syprinat e figurave duke numëruar katrorët brenda tyre.</p> <p>Nxirrni përfundime se çfarë ndodh me syprinat e tyre.</p>
<p><b>Hapi 4:</b>Të dyja grupet nisin nga puna. Nxjerrin rezultatin.</p> <p><b>Hapi 5:</b> Demonstrimi i rezultatit në formën e një poster, në një kënd të dukshëm të klasës.</p> <p><b>Hapi 6:</b> Prezantimi i punës në grup para klasës.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b></p> <p><b>Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kreativitetin, bashkëpunimin, kontributin e tij në realizimin e punës së përbashkët;</li> <li>- argumentimin e përfundimit të gjetur;</li> <li>- prezantimin e punës së grupit dhe të rezultateve.</li> </ul>	
<p><b>Detyra dhe puna e pavarur:</b></p> <p>Çdo nxënës përgatit një punë të ngjashme me punën e organizuar nga grupi i tij në një format A4 dhe e sjell në klasë.</p>	



Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data
Kohëzgjatja: 45 min		Tematika: Gjeometri	
Tema mësimore: Kuptimi për perimetrin			
Situata e të nxënit: Luajmë me figura dhe matim përmasat e tyre.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës: - Vizaton figura duke përdorur saktë vizoren si mjet. - Mat saktë gjatësitë e brinjëve të figurave gjeometrike. - Gjen perimetrin e figurave të ndërtuara duke mbledhur gjatësitë e brinjëve të figurës.			
Fjalët kyçe: perimetër, centimetër, vizore, brinjë.			
Burimet, mjetet: libri i nxënësit, fletore e punës, vizore, figura të ndryshme gjeometrike		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Artet	
Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:  Brainstorming, punë në grupe, vëzhgo dhe nxirr përfundimin, punë në dyshe, lexo, plotëso, përforco njohuritë. Krijim i lirë			
Zhvillimi i mësimi:  <ul style="list-style-type: none"><li>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve U kujtoj nxënësve njohuritë që kanë marrë për figurat gjeometrike.</li></ul>			
<div>Një figurë gjeometrike ka: 2 përmasa, brinjë, kënde, kulme, perimetër, syprinë. Mjeti që përdorim për të matur gjatësinë e brinjëve është vizorja.</div>			
Ndaj klasën në 4 grupe të mëdha. Secilit grup i jap një format A4, ku është vizatuar një figurë gjeometrike. Detyrat për secilin grup i shënoj në tabelë: - shkruani sa është gjatësia e secilës brinjë të figurës që keni të vizatuar, duke e matur me sy të lirë; - këmbeni fletën me grupin që keni pranë në drejtimin orar dhe matni me vizore gjatësitë e brinjëve të figurës së vizatuar në A4;			

- këmbeni sërish fletën me grupin pranë dhe gjeni ndryshesën midis matjes me sy të lirë dhe asaj me vizore.

Koha e përgatitjes së detyrës për çdo grup do të drejtohet nga një sinjal i dhënë nga mësuesja.

Prezantohen para klasës punët e përfunduara dhe jepen përfundimet mbi matjen e gjatësive të brinjëve:

- Shuma e gjatësive të brinjëve të një figure quhet **perimetër**.

- Sa më e vogël të jetë ndryshesa mes dy llojeve të matjeve të figurës, aq më shumë **I jeni afruar** perimetrit të saktë.

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Puna në bashkëpunim**

- Nxënësit kalojnë në punën me librin. Punojnë të ndarë në grupe dyshe për të ndjekur hapat e njësive mësimore 9A, me të cilët u njohën në fazën e parë të mësimi.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.**

Nxënësit punojnë tani të pavarur faqen pasuese 9A. Matin gjatësitë e brinjëve dhe gjejnë perimetrimin për secilën figurë.

#### **Vlerësimi:**

##### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- vizatimin e figurave gjeometrike duke përdorur saktë vizoren si mjet;
- matjen e saktë të gjatësive të brinjëve në figurat gjeometrike;
- gjetjen e perimetrit të figurave të ndërtuara duke mbledhur gjatësitë e brinjëve të figurës.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Vizato 4 figura gjeometrike dhe gjej perimetrimin e secilës prej tyre.

<b>Fusha:</b> Matematikë	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Gjeometri	
<b>Tema mësimore:</b> Kuptimi për syprinën (zbulojmë + eksplorojmë)			
<b>Situata e të nxënësit:</b>  Vizatojmë figura dhe zbulojmë hap pas hapi cilësitë e tyre			
<b>Rezultatet e të nxënëtit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vizaton në fletë (me katrorë) drejtkëndësh e katror, duke u mbështetur në cilësitë e brinjëve fqinje të këtyre figurave;</li> <li>- llogarit perimetrin, kur di syprinën e figurave të dhëna {drejtkëndësh e katror};</li> <li>- llogarit syprinën, kur di perimetrin e figurave të dhëna {drejtkëndësh e katror}.</li> </ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> figurë, drejtkëndësh, katror, perimetër, syprinë, cm, cm <sup>2</sup>			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, figurë, drejtkëndësh, katror		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënëtit:</b> Punë me të gjithë klasën: vëzhgo dhe nxirr përfundimin, emërto, sill shembuj, lexo. Krijim i lirë, (nxënësit punojnë në grupe dyshe).			
<b>Zhvillimi i mësimimit:</b>			
<p>•       <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b></p> <p>- Prezantohet në tabelë një figurë gjeometrike. E ndaj figurën në katrorë të vegjël me brinjë 1 cm. Për të gjetur syprinën e drejtkëndëshit, numërojmë katrorët brenda tij.</p> <p>- Tani zmadhoj syprinën e figurës. <b>Çfarë ndodh me perimetrin e saj? Bëjmë matjet.</b></p> <p>Japim përfundimet. Sa herë që syprina e një figure zmadhohet, zmadhohet edhe perimetri i saj.</p> <p>Po syprinën, si mund ta llogaritim? Numërojmë katrorët brenda saj.</p> <p>Syprina <b>A</b> = 4 katrorë     Syprina <b>B</b> = 8 katrorë.</p> <p style="margin-left: 40px;">= 4cm<sup>2</sup>                      = 8cm<sup>2</sup></p> <p>Katrorët i numërojmë hap pas hapi, por edhe më shpejt, duke shumëzuar numrin e katrorëve që ka figura në gjatësinë e saj me numrin e katrorëve të gjerësisë. {2 x 2 = 4 dhe 2 x 4 = 8}</p> <p>E njëjta situatë është edhe me figurën e katrorit, por me ndryshimin që katrori i ka brinjët të barabarta.</p>			



• **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Punë në bashkëpunim**

- Nxënësit kalojnë në punën me librin. Plotësohen situatat e dhëna në libër nga secili nxënës, duke zbatuar hap pas hapi kërkesat e njësishë 9B në rubrikën “Zbulojmë”.

Gjen syprinat e figurave përkatëse në rubrikën “Eksplorojmë”, duke numëruar katrorët brenda tyre në mënyrën më të shpejtë (kujtojmë rreshtimet dhe përmasat e tyre). Nxënësi shkruan rezultatin e syprinës së çdo figure në vendin përkatës. Më pas këmbëjnë librin me shokun para dhe kontrollojnë rezultatet.

• **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Punohen në grupe situatat e dhëna në fletoren e punës: 9 A/B perimetri dhe syprina.

Nxënësi do të llogaritë syprinën kur njih perimetrin e një drejtkëndëshi. Drejtkëndëshi i ka brinjët dy e nga dy të barabarta.  $16 : 2 = 8$  cm, pra shuma e dy brinjëve fqinje është 8 cm.

Ato mund të jenë: 6 cm dhe 2cm; 3cm dhe 5cm; 7cm dhe 1cm.

Syprina për çdo rast do të jetë:  $6 \times 2 = 12 \text{ cm}^2$ ;  $3 \times 5 = 15 \text{ cm}^2$ ;  $7 \times 1 = 7 \text{ cm}^2$ .

Kur syprina është  $20 \text{ cm}^2$ , brinjët fqinje do të jenë: 5 cm x 4 cm; 2 cm x 10 cm; 20 cm x 1 cm.

Perimetri do të ishte:  $5 \text{ cm} + 5 \text{ cm} + 4 \text{ cm} + 4 \text{ cm} = 18 \text{ cm}$ ;  $2 \text{ cm} + 2 \text{ cm} + 10 \text{ cm} + 10 \text{ cm} = 24 \text{ cm}$ ;

$20 \text{ cm} + 20 \text{ cm} + 1 \text{ cm} + 1 \text{ cm} = 42 \text{ cm}$ .

Llogaritet edhe syprina apo perimetri i katrorit, me ndryshimin e vetëm se katrori i ka brinjët fqinje të barabarta. Diskutohen përfundimet e gjetura në faqet 80 dhe 81.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi vlerëson nxënësin për:**

- vizatimin në letër me katrorë të drejtkëndëshit dh katrorit, duke u mbështetur te cilësitë e brinjëve fqinje të këtyre figurave;
- llogaritjen e perimetrit, kur di syprinën e figurave të dhëna (drejtkëndësh dhe katror);
- llogaritjen e syprinës, kur di perimetrin e figurave të dhëna (drejtkëndësh dhe katror).

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Plotëson në shtëpi detyrat e fletores së punës në faqet 80-81.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika: Gjeometri</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Llogaritja e syprinës dhe e perimetrit të drejtkëndëshave (zbulojmë + eksplorojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Luajmë me figura dhe matim përmasat e tyre.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Vizaton figura duke përdorur saktë vizoren si mjet. - Mat saktë gjatësitë e brinjëve të figurave gjeometrike. - Gjen perimetrat e figurave të ndërtuara, duke mbledhur gjatësinë e brinjëve të secilës figurë. - Gjen syprinat e figurave të ndërtuara, duke shumëzuar përmasat e brinjëve fqinje të secilës figurë.			
<b>Fjalët kyçe:</b> perimetër, centimetër, vizore, brinjë, metër, sipërfaqe, syprinë.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, vizore, figura të ndryshme gjeometrike		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  <i>Brainstorming</i> , zbulojmë hap pas hapi, lexo, plotëso, vëzhgo dhe nxirr përfundimin, punë në dyshe			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  • <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> - Bëj një kujtesë me nxënësit për drejtkëndëshin: figurë 2 D, ka 4 kënde, 4 kulme, 4 brinjë dy e nga dy të barabarta. - Hapim librin në faqen e njësisë mësimore 9C dhe punojmë paralelisht me tabelën, hap pas hapi. Syprina e sheshpushimit është 24 cm <sup>2</sup> . Përmasat e mundshme të tij janë: 24 m <sup>2</sup> = 4 m x 6 m; 24 m <sup>2</sup> = 2 m x 12 m ; 24 m <sup>2</sup> = 1 m x 24 m; - I vizatojmë këta drejtkëndësha sipas përmasave të mësipërme, duke përdorur shkallën e zvogëlimit 1cm : 1m. Përmasat e zvogëluara të drejtkëndëshave do të jenë:			

4 cm me 6 cm; 2 cm me 12 cm; 1 cm me 12 cm.

- Nxënësit vizatojnë 3 drejtkëndëshat në libër, duke përdorur saktë vizoren.
- Diskutim mbi formën më të përshtatshme për sheshpushim. Forma më e përshtatshme është ajo më përmasat 4 cm me 6 cm.

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur njësinë mësimore 9C, duke ndjekur e zbatuar hap pas hapi kërkesat e dhëna. Sa më e vogël të jetë diferenca e rezultateve, aq më shumë i është afruar nxënësi reales.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë në grupe dyshe fletët 84 në fletoren e punës. Diskutohet rreth vizatimit të drejtkëndëshit me syprinën më të madhe të mundshme, kur dihet se perimetri i rrethimit është 36 cm. Diskutohen zgjedhjet e mundshme. Kjo fazë mund të realizohet edhe në terren, nëse është e mundur.

### **Vlerësimi:**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- vizatimin e figurave gjeometrike duke përdorur saktë vizoren si mjet;
- matjen e saktë të gjatësive të brinjëve në figurat gjeometrike;
- gjetjen e perimetrit të figurave të ndërtuara duke mbledhur gjatësitë e brinjëve të figurës;
- gjetjen e syprinës së figurave të ndërtuara, duke shumëzuar përmasat e brinjëve fqinje të figurës.

### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Punohet faqja 85 në fletoren e punës.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min Ora e parë		<b>Tematika: Gjeometri</b>	
<b>Tema mësimore:</b> Perimetri dhe syprina (përmbledhim)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Luajmë me figura dhe matim përmasat e tyre.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Vizaton figura duke përdorur saktë vizoren si mjet. - Mat saktë gjatësitë e brinjëve të figurave gjeometrike. - Gjen perimetrin e figurave të ndërtuara duke mbledhur gjatësinë e brinjëve të figurës. - Gjen syprinën e figurave të ndërtuara duke shumëzuar përmasat e brinjëve fqinje të figurës.			
<b>Fjalët kyçe:</b> perimetër, centimetër, vizore, brinjë, metër, sipërfaqe, syprinë			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, vizore, figura të ndryshme gjeometrike		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  <i>Brainstorming</i> , zbulojmë hap pas hapi, lexo, plotëso, punë në grup, vëzhgo dhe nxirr përfundimin, punë në dyshe.			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  • <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> - U kujtoj sërish nxënësve njohuritë për drejtkëndëshin: <div><div>figurë 2 D, ka 4 kënde, 4 kulme, 4 brinjë dy e nga dy të barabarta</div></div> - Nxënësit hapin librin në faqen e njësisë mësimore 9 dhe punojmë paralelisht me tekstin përmbledhës, hap pas hapi.			

Perimetri i stallës ku qëndron kali i Armindës është 50 m. Atëherë caktojmë përmasat e drejtkëndëshit me perimetër 50 m.

$$50 : 2 = 25 \text{ m}$$

Pra, shuma e brinjëve fqinje të drejtkëndëshit do të jetë 25 m.

Mundësitë janë:

$$1 + 24 / 2 + 23 / 3 + 22 / 4 + 21 / 5 + 20 / 6 + 19 / 7 + 18 / 8 + 17 / 9 + 16 / 10 + 15 / 11 + 14 / 12 + 13$$

- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet një nga alternativat e mësipërme.

Ai vizaton drejtkëndëshin me shkallë zvogëlimi 1 m:1 cm, dhe llogarit syprinën.

Përfundimet e grupeve prezantohen para klasës. Evidentohet syprina më e madhe, e cila do t'i japë mundësi kalit të shëtisë e të ecë më lirshëm.

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Punë e pavarur**

Nxjerrim përfundimin se perimetri i një drejtkëndëshi gjendet duke mbledhur gjatësitë e të 4 brinjëve të tij ose duke mbledhur dyfishin e gjatësisë së brinjëve fqinjë. Nëse shënojmë a gjatësinë e njërës brinjë dhe b gjatësinë e brinjës tjetër shkruajmë:

$$P = [2 \times a] + [2 \times b] \text{ dhe syprina } S = a \times b.$$

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur detyrën 1, 2, 3 në faqen 86 të fletores së punës.

Në përfundim këmbëjnë fletoren me shokun ose shoqen e bankës dhe kontrollojnë veprimet.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Është mirë që kjo fazë të punohet jashtë klasës. Nxënësit dalin në grupe dhe matin përmasat e mjediseve të ndryshme të shkollës, si: korridorin, klasën, oborrin, këndi sportiv, dhe llogaritin perimetrin dhe syprinën e tyre.

### **Vlerësimi:**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- vizatimin e figurave gjeometrike, duke përdorur saktë vizoren si mjet;
- matjen e saktë të gjatësive të brinjëve në figurat gjeometrike;
- gjetjen e perimetrit të figurave të ndërtuara, duke mbledhur gjatësinë e brinjëve të figurës;
- gjetjen e syprinës së figurave të ndërtuara, duke shumëzuar përmasat e brinjëve fqinje të figurës.

#### **Detyra dhe puna e pavarur:**

Ndërtohet një situatë e ngjashme me atë të librit nga vetë nxënësi/ja.



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>	
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min Ora e dytë				<b>Tematika: Gjeometri</b>
<b>Tema mësimore:</b> Perimetri dhe syprina (përforcojmë)				
<b>Situata e të nxënit:</b> Luajmë me figura dhe matim përmasat e tyre.				
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Vizaton figura duke përdorur saktë vizoren si mjet. - Mat saktë gjatësitë e brinjëve të figurave gjeometrike. - Gjen perimetrin e figurave të ndërtuara duke mbledhur gjatësinë e brinjëve të figurës. - Gjen syprinën e figurave të ndërtuara duke shumëzuar përmasat e brinjëve fqinje të figurës.				
<b>Fjalët kyçe:</b> perimetër, centimetër, vizore, brinjë, metër, sipërfaqe, syprinë				
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, vizore, figura të ndryshme gjeometrike			<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  <i>Brainstorming, Zbulojmë hap pas hapi; lexo, plotëso, punë e pavarur, vëzhgo dhe nxirr përfundimin, punë në dyshe.</i>				
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <ul style="list-style-type: none"><li><b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b></li></ul> - U kujtoj nxënësve njohuritë që kanë marrë për katrorin.				
figurë 2 D,      ka 4 kënde,      4 kulme,      4 brinjë të barabarta				

Secili nxënës punon në mënyrë të pavarur njësinë mësimore 9. Ai ndërton figurat e kërkuara dhe llogarit syprinat e perimetrit të tyre. Vë në zbatim formulat që ka hasur më parë:

Për drejtkëndëshin:  $P = [2 \times a] + [2 \times b]$  dhe syprina  $S = a \times b$ .

Për katrorin:  $P = 4 \times a$  dhe syprina  $S = a \times a$ .

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Punë në grupe dyshe**

Nxënësit punojnë në grupe dyshe detyrat 4, 5, 6 në faqen 86 të fletores së punës. Më pas ndërtojnë në fletore 2 drejtkëndësha dhe 3 katrorë dhe llogaritin syprinën e perimetrit të tyre.

Në fund, nxënësit këmbëjnë fletoren me shokun ose shoqen e bankës dhe kontrollojnë veprimet që kanë kryer.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Është mirë që kjo fazë të punohet serish jashtë klasës. Nxënësit dalin në grupe dhe matin përmasat e mjediseve të ndryshme të shkollës, si: korridori, klasa, oborri, këndi sportiv, dhe llogaritin perimetrit dhe syprinën e tyre.

### **Vlerësimi:**

#### **Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- vizatimin e figurave gjeometrike duke përdorur saktë vizoren si mjet;
- matjen e saktë të gjatësive të brinjëve në figurat gjeometrike;
- gjetjen e perimetrit të figurave të ndërtuara, duke mbledhur gjatësinë e brinjëve të figurës;
- gjetjen e syprinës së figurave të ndërtuara, duke shumëzuar përmasat e brinjëve fqinje të figurës.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Llogarit perimetrit dhe sipërfaqet e ambienteve brenda shtëpisë.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Përpunimi i të dhënave	
<b>Përpunimi i të dhënave</b> <b>Tema mësimore:</b> Diskutojmë së bashku			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situatë konkrete, ku sillen shembuj studimi statistikor dhe paraqitjeje të të dhënave nga një tabelë dendurie në një diagram.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Liston të paktën 3 emërtime grafikësh për të paraqitur të dhënat mbi një studim rasti. - Analizon të dhënat e grumbulluara, duke u mbështetur mbi grafik. - Ndërton piktogramin, grafikun me shtylla, diagramin e Venit, mbi tabelën e të dhënave të marra.			
<b>Fjalët kyçe:</b> grup vijash, grafik me shtylla, grafikë me vijë, tabela e dendurive, bosht, diagrami i Venit.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, tabela me lloje të ndryshme grafikësh		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia e veprimtarisë e të nxënit:</b> rrjet diskutimi, punë me të gjithë klasën, vëzhgo-plotëso dhe nxirr përfundimin, punë në grupe.			
<b>Zhvillimi i mësimin:</b>  <ul style="list-style-type: none"><li><b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Zhvillohet një diskutim me nxënësit mbi rrugën e ndjekur për të nxjerrë rezultatin e të dhënave që kemi mbi një dukuri të caktuar. Dalim në përfundimin se rruga e ndjekur do të kalojë në 4 hapa: 1. Përzgjedhja e dukurisë apo e rastit që do të studiohet. → Rasti duhet të ketë mjaftueshëm të dhëna për të tërhequr vëmendje studimi. 2. Grumbullimi i të dhënave. → Të dhënat e grumbulluara në tabela përmes anketës, pyetësorit; 3. Organizimi i të dhënave. → Analizohen të dhënat e marra, përcaktohet vlera më e ulët, vlera më e lartë, moda, mesorja, mesatarja. 4. Interpretimi i të dhënave. → Ndërtohen grafikë, diagrame dhe mënyra të ndryshme interpretimit të të dhënave.</li><li><b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Punë me të gjithë klasën</b> Punë me librin. Hapen libri në faqen e njësisë mësimore 10. Bëhet evidentimi i mënyrave të interpretimit të të dhënave: grafik rrethor; grafik me shtylla; diagrami i Venit; tabela e dendurive; grafik me vijë; piktogram. Tregohet në vija të përgjithshme, mënyra e ndërtimit të tyre (në varësi të kohës në dispozicion).</li></ul>			

• **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë në grupe dyshe, ku falë njohurive të deritanishme, bëhet i mundur prezantimi i një dukurie.

Dukuria —————→ ngjyra e syve e nxënësve të klasës sonë.

Grumbullimi i të dhënave —————→ votimi i drejtpërdrejtë dhe vendosja në tabelën e dendurisë.

Organizimi i të dhënave —————→ tani nxënësit do të punojnë me grupe pune për të ndërtuar secili grup njërin prej këtyre grafikëve: piktogram, grafik me shtylla, diagrami i Venit.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- saktësinë e emërimit të llojit të grafikut që paraqet të dhënat mbi një studim rasti;
- analizimin e të dhënave të grumbulluara;
- ndërtimin e piktogramit, grafikut me shtylla, diagramit të Venit.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Studim rasti: numri i faqeve të lexuara çdo ditë, gjatë një jave. Paraqitja me grafik (grafiku mund të ndërtohet sipas dëshirës apo i përcaktuar nga mësuesi/ja).

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Përpunimi i të dhënave	
<b>Ora 1</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Tabelat e dendurive dhe piktogramet			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situata konkrete nga jeta e përditshme.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Ndërton saktë pyetjen për studim të rastit.</li><li>• Grumbullon të dhënat në tabelë.</li><li>• Ndërton tabelën e dendurisë dhe piktogramin.</li><li>• Analizon përfundimet e studimit.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> të dhënat, tabela e dendurive; anketa, pyetja, denduria, rezultate			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, lapsa me ngjyra		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet, Edukimi fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> rrjet diskutimi; pune me gjithë klasën; punë në grupe me nga dy; lexo - nxirr përfundimin, plotëso.			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Pyeten nxënësit se cili është informacioni që do të donin të dinin për shokët e klasës së tyre. Shënohen të gjitha përgjigjet e shprehura në formë pyetjesh në tabelë dhe bëhet përzgjedhja e përgjigjes më interesante.</li></ul>			
<b>Pyetja</b>		<b>Përgjigjet</b>	
Cili është informacioni që do të doje të dije për shokët e klasës?		<ul style="list-style-type: none"><li>- Sa faqe librash jashtëshkollorë lexon në javë një nxënës?</li><li>- Cilat sporte ndiqen më shumë nga nxënësit e klasës?</li><li>- Sa orë në javë kalon një nxënës para kompjuterit?</li></ul>	
<b>Diskutohet mbi mënyrat e marrjes së informacionit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- me anketa</li><li>- me pyetësor</li></ul>			
<ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Puna në bashkëpunim me të gjithë klasën</b> Bihet dakord me nxënësit për pyetjen që do të përzgjidhet për studim nga përgjigjet e dhëna.</li></ul>			

**Sa kohë kalon një nxënës para kompjuterit në një javë?**

Nxënësit hapin librin në faqen e njësisë mësimore 10 A, për të punuar në grup mbi studimin e rastit të përzgjedhur. Shkruhet pyetja në vendin e kërkuar në tekst.

Përgjigjet merren me anketim për pyetjen: Sa orë në javë kalon para kompjuterit?

**7 orë    14 orë    0 orë    më pak se 7 orë    më shumë se 14 orë**

Vizatohet tabela e dendurive, në të cilën shënohen rezultatet e anketës për 36 nxënës.

Koha që kalon në kompjuter	Numërimi me vija	Denduria
7 orë	IIII IIII IIII IIII	20
14 orë	IIII III	8
0 orë		0
më pak se 7 orë	IIII	4
më shumë se 14 orë	IIII	4

Ndërtojmë një piktogram mbi tabelën e mësipërme.

Vendosim fillimisht që 4 nxënës t'i shënojmë simbolikisht me një

7 orë	😊😊😊😊😊
14 orë	😊😊
0 orë	
më pak se 7 orë	😊
më shumë se 14 orë	😊

**Nga leximi i rezultateve nxjerrim se:**

Të gjithë nxënësit janë përdorues të kompjuterit.

Pjesa më e madhe e përdorin 1 orë çdo ditë

Vetëm 4 nxënës e përdorin më shumë se të tjerët kompjuterin.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në faqen 88 të fletores së punës mbi hapat e mësipërm. Ata marrin informacion mbi frekuentimin e bibliotekës dhe mbi bazën e leximit të të dhënave, ndërtojnë piktogramin.

**Vlerësimi:****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- ndërtimin e saktë të pyetjes për studim të rastit;
- grumbullimin e të dhënave në tabelë;
- ndërtimin e tabelës së dendurisë dhe piktogramin;
- analizimin e përfundimeve të studimit.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Sa faqe të një libri jashtëshkollor lexon çdo ditë të javës? Ndërto tabelën e dendurisë dhe piktogramin e saj.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Përpunimi i të dhënave	
<b>Ora 2</b>			
<b>Tema mësimore:</b> Tabelat e dendurive dhe piktogramet			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situata konkrete nga jeta e përditshme			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Grumbullon të dhënat në tabelë.</li><li>• Ndërton tabelën e dendurisë dhe piktogramin.</li><li>• Analizon përfundimet e studimit.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> të dhënat, tabela e dendurive; tabela e dendurive , piktogrami			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletore e punës, lapsa, ngjyra		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet, Edukimi fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b>  <i>Stuhi mendimi</i> në dyshe, vëzhgo-interpreto, përvijim i të menduarit, të punuarit në bashkëpunim me të gjithë klasën, punë në dyshtë.			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Të ndarë në grupe me nga dy, nxënësit rifreskojnë njohuritë e marra mbi përpunimin e të dhënave të një rasti të caktuar. Shënimet e bëra i prezantojnë para klasës. Në momentin që dorëzojnë shënimet, ata bëjnë të njohur një nga informacionet e shënuara.</li><li>• <b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Vëzhgo, interpreto, përvijim i të menduarit, të punuarit në bashkëpunim me gjithë klasën.</b> Hapen librat për të punuar së bashku me të gjithë klasën njësinë mësimore 10A. Eksplorohet tabela e dendurive të konsumimit të ushqimeve të shpejta. Nga leximi i saj merret informacioni i mëposhtëm:<ul style="list-style-type: none"><li>- kokoshkat janë ushqimi i shpejtë më i konsumuar nga 9 fëmijë;</li><li>- karota është ushqimi më pak i lakmuar nga vetëm 3 fëmijë.</li><li>- në ushqimet e shpejta, fëmijët konsumojnë më shpesh fruta ( 8 + 6 + 3 = 17 nxënës) sesa ushqime të gatuar ( 9 + 5=14).</li></ul></li></ul>			

Përbri tabelës së dendurive është ndërtuar dhe piktogrami përkatës, ku çdo simbol fëmije i vizatuar përfaqëson 2 nxënës.

- Nxënësit vazhdojnë të punojnë në grupe dyshe njësinë mësimore 10A. Mbi tabelën e dendurive të mësimit të mëparshëm, nxënësit do të bëjnë vizatimin e një piktogrami.

- Ata do të ndërtojnë një piktogram, duke mbështetur mbi të dhëna të tjera. Nxënësit mund të shkruajnë të dhënat e tyre në lidhje me konsumimin e këtyre ushqimeve të shpejta nga ata vetë gjatë një jave.

Pasi ta kenë ndërtuar piktogramin, shkruajnë tri fjali rreth të dhënave të tij.

• **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur faqen 89 të fletores së punës. Ndërtojnë një tabelë dendurish dhe më pas vizatojnë një piktogram për të paraqitur ushqimet e preferuara të shokëve të Arbrit.

**Vlerësimi:**


**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- grumbullimin e të dhënave në tabelë;
- ndërtimin e tabelës së dendurisë dh të piktogramit;
- analizimin e përfundimeve të studimit.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Ndërto tabelën e dendurive dhe piktogramin, duke përdorur të dhëna rreth një rasti të përzgjedhur nga vetë nxënësi.



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data:</b>												
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika :</b> Përpunimi I të dhënave													
<b>Tema mësimore:</b> Grafikët me shtylla dhe grafikët me vijë (zbulojmë + eksplorojmë)															
<b>Situata e të nxënit:</b> Situata konkrete nga jeta e përditshme															
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Grumbullon të dhënat në tabelë.</li><li>• Ndërton grafikun me shtylla.</li><li>• Analizon përfundimet e studimit.</li></ul>															
<b>Fjalët kyçe:</b> të dhënat, tabela e dendurive, grafiku me shtylla, moda.															
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, lapsa, ngjyra		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet, Edukimi fizik													
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  <i>Stuhi mendimi, vëzhgo-interpreto, përvijim i të menduarit, të punuarit me gjithë klasën, punë në dyshe, punë e pavarur.</i>															
<div><table><tr><th>Frutë</th><th>Frekuenca</th></tr><tr><td>portokaj</td><td>8</td></tr><tr><td>molle</td><td>6</td></tr><tr><td>karota</td><td>3</td></tr><tr><td>kokoshka</td><td>9</td></tr><tr><td>biskota</td><td>5</td></tr></table></div>				Frutë	Frekuenca	portokaj	8	molle	6	karota	3	kokoshka	9	biskota	5
Frutë	Frekuenca														
portokaj	8														
molle	6														
karota	3														
kokoshka	9														
biskota	5														

**Zhvillimi i mësimit:**

- **Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Zhvillohet *një stuhi mendimi* për gjithë klasën nga mësuesi/ja, ku mblidhet informacioni rreth njohurive që kanë nxënësit për grafikët me shtylla.

Grafikun me shtylla e ndërtojmë mbi një bosht horizontal, mbi të cilin ngrihen shtyllat që rriten në njësi. Kështu, mbështetur në tabelën e dendurive ushqimeve të shpejta, e punuar gjatë orës së mëparshme, ndërtohet një grafik me shtylla.

Përcaktohet moda e të dhënave.

**E dhëna me dendurinë më të madhe quhet modë e një vargu të dhënash.**

Punohet njësia mësimore 10B. Studiohet rasti i lëvizjes së kamionit dhe varësia midis kohës dhe kilometrave larg nga shtëpia .Mbështetur në diagramin me vijë, iu jepet përgjigje pyetjeve në tekst.

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Vëzhgo, përzgjidh, përvijim i të menduarit, të punuarit në grup, zbatim njohurish**

Hapet libri në njësinë mësimore 10B. Të ndarë në grupe me nga 4, nxënësit përzgjedhin rastin që do të studiojnë nga alternativat e dhëna në tekst apo të gjetura nga anëtarët e grupit. Mblidhen të dhënat në një tabelë dendurish dhe më pas ndërtohet grafiku me shtylla. Interpretohen të dhënat rreth grafikut, përcaktohet moda e të dhënave dhe grumbullohen pyetje rreth grafikut, të cilat njëri grup do t'ia drejtojë grupi tjetër.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë në faqen 90 të fletores së punës. Më pas këmbëjnë librin me shokun dhe provojnë njohuritë e tyre.

**Vlerësimi:****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- grumbullimin e të dhënave në tabelë;
- ndërtimin e grafikut me shtylla;
- analizën e përfundimeve të studimit.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Punimi i fletës së punës në faqen 91.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Përpunimi i të dhënave	
<b>Tema mësimore:</b> Grafikët me vijë (zbulojmë + eksplorojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b>  Situata konkrete nga jeta e përditshme			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Lexon të dhënat në tabelë.</li><li>• Ndërton grafikun me vija.</li><li>• Analizon përfundimet e studimit.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> të dhënat, tabela e të dhënave, grafiku me vijë, moda.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, lapsa, ngjyra		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet, Edukimi fizik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  punë në grupe, vëzhgo-interpreto, përvijimi i të menduarit, të punuarit me gjithë klasën, punë në dyshe, punë e pavarur.			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Punohet me grupe me nga dy nxënës. Grupet e formuara punojnë me njësinë mësimore 10C. Lexojnë me kujdes të dhënat në tabelë. Vizatojnë grafikun me vijë mbi rezultatet e temperaturave gjatë një harku kohor prej 12 orësh. Përcaktojnë modën. Plotësojnë pyetjet mbi gjetjen me përafërsi të temperaturës në orët e caktuara, duke u mbështetur në grafikun me vijë. Hartojnë tri pyetje për t’ua drejtuar shokëve.</li><li>• <b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Vëzhgo-përzgjidh, përvijimi i të menduarit, punë e pavarur, zbatim njohurish</b> Punohet me të gjithë klasën (frontalisht) njësia mësimore 10C. Prezantohet dhe studiohet grafiku me vijë i paraqitur si tregues i ndryshimit të temperaturave përgjatë 13 orëve në Tiranë.</li></ul>			

- Studimi i ndërtimit të tij, vendosja e kohës, që rritet me 1 orë për njësi në boshtin horizontal dhe temperaturat, të cilat rriten me 5 njësi në boshtin vertikal.

- Lexohet grafiku dhe u jepet përgjigje pyetjeve poshtë tij, në mënyrë të organizuar në 5 grupe pune, ku secili grup studion dhe jep përgjigje për 1 nga pyetjet e dhëna.

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur faqet 92-93 të fletores së punës. Secili prej tyre plotëson grafikun me vijë sipas të dhënave të vendosura në drejtimin horizontal dhe në atë vertikal. Grafikët me vijë mund të përdoren për të paraqitur ndryshimet e temperaturave gjatë një dite. Këto të dhëna quhen të dhëna të vazhdueshme, për arsye se ato ndryshojnë vazhdimisht. Pas ndërtimit të grafikut, gjenden me përafërsi temperaturat në orët e kërkuara. Paraqiten rezultatet para klasës.

• **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë të pavarur për të ndërtuar tabelën e të dhënave kur kanë një grafik me vijë, të dhënë nga mësuesi/ja si punë në grupe.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- leximin e të dhënave në tabelë;
- ndërtimin e grafikut me vija;
- analizën përfundimtare të studimit.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Ndërtimi i grafikut mbi temperaturat e javës së kaluar. Të dhënat mund të gjenden nga shërbimi meteorologjik në internet.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data</b>
<b>Koha e zgjatjes:</b> 45 min <b>Tematika:</b> Përpunimi i të dhënave			
<b>Tema mësimore:</b> Probabiliteti (zbulojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Ngjarje që ndodhin, nuk ndodhin apo kanë pak apo shumë mundësi që të ndodhin.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>Evidenton ngjarje që përputhen me mundësinë e të ndodhurit.</li><li>Argumenton saktë përzgjedhjen e ngjarjes sipas kushteve të vëna.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> probabiliteti, e pamundur, ka pak mundësi të ndodhë, ka shumë mundësi, do të ndodhe patjetër,;			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, lapsa me ngjyra		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet, Edukimi fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> Punë me gjithë klasën, përvijim i të menduarit vëzhgo- përgjigju, argumento, të punuarit me koncepte, punë e pavarur, punë në dyshe;			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li><b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Zhvillohet një bisedë paraprake në lidhje me shpeshtësinë e ndodhjes apo përsëritjes së një ngjarjeje të dhënë. Ndërtohet një tabelë para klasës dhe nxiten nxënësit të japin mendimin e tyre. Mendimet shkruhen në tabelë.</li></ul>			
<b>Mundësia</b>		<b>Ngjarja</b>	
E pamundur	Të bjerë borë në Tiranë në muajin gusht.		
Ka shumë pak mundësi	Të marrë notën 4 një nxënës shumë i mirë në mësim.		
Ka pak mundësi	Të thyhet xhami nga era e fortë e një dite dimri.		
Ka mundësi të barabarta	Të fitojnë kupën në një kampionat futbollit midis klasave të pesta të shkollës.		
E mundur	Të fryjë erë e fortë në plazh në një ditë vere.		
Ka shumë mundësi	Të marr një dhuratë, nëse dal mirë në provim.		
Do të ndodhë patjetër	Në përfundim të vitit, të vlerësohem me notë në lëndën e Matematikës.		

### Argumentohen përgjigjet e dhëna nga nxënësit.

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Përvijimi i të menduarit, punë e pavarur, zbatim njohurish**

Punohet njësia mësimore 10D. Secili nxënës punon në mënyrë të pavarur duke plotësuar tabelën. Evidenton dhe më pas argumenton përzgjedhjen e bërë mbi një ngjarje të sigurt dhe një ngjarje të pasigurt. Këmbehet libri me shokun ose shoqen e bankës dhe vlerësohen përgjigjet reciproke.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Nxënësit punojnë në dyshe faqen 94 të fletores së punës.

### Vlerësimi:

#### Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:

- evidentimin e ngjarjeve që përputhen me mundësinë e të ndodhurit;
- argumentimin saktë të përzgjedhjes së ngjarjes sipas kushteve të vëna.

### Detyra dhe puna e pavarur:

Vazhdon në fletoren e punës ndërtimi i grafikut që nisi në klasë.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Përpunimi i të dhënave	
<b>Tema mësimore:</b> Probabiliteti (eksplorojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Ngjarje që ndodhin, nuk ndodhin apo kanë pak apo shumë mundësi që të ndodhin.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Evidenton ngjarje që përputhen me mundësinë e të ndodhurit.</li><li>- Argumenton saktë përzgjedhjen e ngjarjes sipas kushteve të vëna.</li></ul>			
<b>Fjalët kyçe:</b> probabiliteti, e pamundur, ka pak mundësi të ndodhë, ka shumë mundësi, do të ndodhe patjetër.			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, lapsa me ngjyra, monedhë 50-lekëshe, zar		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet, Edukimi fizik	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b>  punë me gjithë klasën, përvijimi i të menduarit, vëzhgo-përgjigju, argumento, të punuarit me koncepte, punë e pavarur, punë në dyshe.			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Luajmë, argëtohem i mësosh së bashku. Në dërrasën e zezë ndërtohet një tabelë. Merret një monedhë 50 lekëshe dhe nis loja .Hidhet në ajër monedha. Për një numër të caktuar hedhjesh, p.sh. 15, mbahet shënim faqja e dukshme e monedhës kur ajo bie përtokë. Pas çdo hedhjeje shënohet rezultati me një shenjë.</li></ul>			
<b>Ana e monedhës</b>		<b>Denduria</b>	
Ana e numërorit 50		x x x x x x x x x x	
Ana e figurës së mbretit Gent mbi kalë		x x x x x	
Tregojmë për mundësinë që ka monedha për të rënë në anën që ne duam. Ajo ka mundësi të bjerë...			

- **Faza e dytë: Njohuritë e reja. Përvijimi i të menduarit, punë e pavarur, zbatim njohurish**

Hapet libri dhe punohet njësia mësimore 10D. Të ndarë në grupe dyshe, nxënësit përsëritin lojën. Vazhdon situata me hedhjen e zareve. Në hedhjen e zarit për një numër të caktuar hedhjesh, matet denduria e rënies së 6 faqeve të tij.

Argumentohen përgjigjet në përfundim të lojës dyshe nga nxënësit.

- **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.=**

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për të plotësuar tabela dendurish me hedhje monedhash apo zares sipas dëshirës.

**Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- evidentimin e ngjarjeve që përputhen me mundësinë e të ndodhurit;
- argumentimin e saktë të përzgjedhjes së ngjarjes sipas kushteve të vëna.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Vazhdimi i punës së nisur në klasë.



<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Përpunimi i të dhënave	
<b>Tema mësimore:</b> Përpunimi i të dhënave (përmbledhim)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situatë konkrete, ku sillen shembuj të përpunimit të të dhënave.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - Analizon të dhënat e grumbulluara duke u mbështetur në tabelë. - Ndërton grafikun me shtylla, duke u bazuar në tabelën e të dhënave të marra.			
<b>Fjalët kyçe:</b> grup vijash, grafik me shtylla, tabela e dendurive, piktogrami			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, tabela me lloje të ndryshme grafikësh		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia dhe veprimtaria e të nxënit:</b>  punë me grupe, punë me tërë klasën, vëzhgo-plotëso dhe nxirr përfundimin, punë e pavarur, turi i galerisë			
<b>Zhvillimi i mësimit:</b>  <ul style="list-style-type: none"><li><b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Prezantohet tabela e dendurive, që tregon numrin e medaljeve të fituara nga 10 vendet e para në Lojërat Olimpike 2012. Studiohen të dhënat dhe më pas klasa ndahet në grupe pune, të cilat ndjekin hapat e mëposhtëm:<ul style="list-style-type: none"><li>Ndërtohet grafiku me shtylla për numrin e medaljeve që ka fituar çdo vend.</li><li>Ndërtohet grafiku me shtylla për numrin e medaljeve prej ari.</li><li>Ndërtohet grafiku me shtylla për numrin e medaljeve prej bronzi.</li><li>Ndërtohet grafiku me shtylla për numrin e medaljeve prej argjendi.</li><li>Prezantohen grafikët e përfunduar.</li></ul></li><li><b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Punë e pavarur</b> Nxënësit studiojnë dhe plotësojnë të dhënat mbi rastin e grupit tjetër, duke plotësuar kështu përfundimisht studimin e njësisë mësimore 10.</li></ul>			

• **Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Çdo nxënës ndërton vetë një tabelë dendurish mbi një rast të përzgjedhur prej tij dhe ia jep tabelën shokut apo shoqes pranë për të ndërtuar piktogramin, diagramin. Grafikët e ndërtuar ekspozohen në një kënd të klasës, si turi i galerisë së diagrameve.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- analizimin e të dhënave të grumbulluara;
- ndërtimin e grafikut me shtylla, duke u bazuar në tabelën e të dhënave të marra.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Çdo nxënës punon në shtëpi studimin e rastit të grupit tjetër.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda:</b> Matematikë	<b>Shkalla:</b> E dytë	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Përpunimi i të dhënave	
<b>Tema mësimore:</b> Përpunimi i të dhënave (përforcojmë)			
<b>Situata e të nxënit:</b> Situatë konkrete, ku sillen shembuj të përpunimit të të dhënave.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> - analizon të dhënat e grumbulluara, duke u mbështetur në tabelë; - ndërton grafikun me shtylla, duke u bazuar në tabelën e të dhënave të marra.			
<b>Fjalët kyçe:</b> grup vijash, grafik me shtylla, tabela e dendurive, piktogrami			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, tabela me lloje të ndryshme grafikësh		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b>  punë me grupe, punë me të gjithë klasën, vëzhgo-plotëso dhe nxirr përfundimin, punë e pavarur, turi i galerisë			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b>  <ul style="list-style-type: none"><li><b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> Ndahet klasa në grupe pune. Njëri grup studion rastin e paraqitur në tabelën e dendurive, duke nxjerrë informacionin për makinat me ngjyrën më të kërkuar, më pak të kërkuar dhe për modën. Grupi tjetër do të studiojë rastin e piktogramit me fruta, duke evidentuar frutën më të lakmuar, atë më pak të lakmuar dhe modën. Grupi i tretë do të studiojë grafikun me shtyllë, ndërsa grupi i katërt, grafikun me vijë. Prezantohen përfundimet para klasës.</li><li><b>Faza e dytë: Njohuritë e reja. Punë e pavarur</b> Nxënësit studiojnë dhe plotësojnë të dhënat për rastin e grupit tjetër, duke plotësuar përfundimisht studimin e njësisë mësimorë 10.</li><li><b>Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b> Secili nxënës ndërton një tabelë dendurish mbi një rast të përzgjedhur prej tij dhe ia jep tabelën shokut apo shoqes pranë për të ndërtuar piktogramin, diagramin. Grafikët e ndërtuar ekspozohen në një kënd të klasës, si turi i galerisë së diagrameve.</li></ul>			

**Vlerësimi:****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- analizimin e të dhënave të grumbulluara;
- ndërtimin e grafikut me shtylla, duke u bazuar në tabelën e të dhënave të marra.

**Detyra dhe puna e pavarur:** Secili nxënës punon në shtëpi studimin e rastit të grupit tjetër.

<b>Fusha:</b> <b>Matematikë</b>	<b>Lënda: Matematikë</b>	<b>Shkalla: E dytë</b>	<b>Data</b>
<b>Kohëzgjatja:</b> 45 min		<b>Tematika:</b> Përforsim njohurish	
<b>Tema mësimore:</b> Përsëritje njohurish			
<b>Situata e të nxënit:</b> Sillen shembuj dhe diskutohet rreth tyre.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:</b> -Përdor njësitet e peshës, masës dhe gjatësisë. - Përdor matjen e kohës me njësitet e veta. Ndërton diagrame, piktograme dhe përpunon të dhënat.			
<b>Fjalët kyçe:</b> masë, centimetër, milimetër, kg, g, grup vijash; grafik me shtylla, tabela e dendurive, piktogram			
<b>Burimet, mjetet:</b> libri i nxënësit, fletorja e punës, tabela me lloje të ndryshme grafikësh		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi, Artet	
<b>Metodologjia e veprimtaria e të nxënit:</b> punë me grupe, punë me të gjithë klasën, vëzhgo-plotëso dhe nxirr përfundimin, punë e pavarur, turi i galerisë			
<b>Zhvillimi i mësimi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li><b>Faza e parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b> <b>Prezantohen dhe përforcohen njohuritë e marra gjatë periudhës prill-qershor.</b></li></ul>			
<b>Pyesim</b>		<b>Përgjigjemi</b>	
Cilat janë njësitet e gjatësisë? Cili është mjeti që shërben për matjen e masës? Cilat janë njësitet e matjes së masës? Po njësitet e matjes së vëllimit? Cilët janë hapat që ndiqen gjatë një studimi statistikor? Cilat janë diagramet e paraqitjes së një klasifikimi të dhënash? Çfarë prezanton një tabelë dendurish? Çfarë është piktogrami? Çfarë është grafiku me vijë? Po ai me shtylla? Përse na shërben kalendari? Si matet koha? Çfarë është ora digjitale? Po ora analoge?			

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësipërme, duke rifreskuar kështu njohuritë e marra.

**Faza e dytë: Njohuritë e reja. Punë e pavarur**

Secili nxënës punon ushtrime dhe detyra të përcaktuara nga mësuesi/ja, të cilat përmbledhin njohuritë e përforcuara më sipër.

Ushtrime për vizatimin e segmenteve të dhëna në cm e në mm.

Këmbime të kg në g dhe anasjelltas; rrumbullakim të masës në kg më të afërt.

Këmbime të minutave me sekonda, orë, ditë dhe anasjelltas.

Llogaritja e intervaleve kohore

Përdorimi i kalendarëve

Gjetja me formulë e syprinës dhe e perimetrit të drejtkëndëshit e katrorit

Ndërtime të diagrameve, duke u mbështetur në tabela dendurish.

Përpunimi i të dhënave

**Faza e tretë: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Çdo nxënës i prezanton shokut ose shoqes pranë, punën e kryer dhe vlerësohet për arritjet personale.

**Vlerësimi:**

**Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- shkathtësitë e fituara në përdorimin e njësive të peshës, masës dhe gjatësisë;
- shkathtësitë e fituara në përdorimin e matjes së kohës me njësitë e veta;
- ndërtimin e diagrameve, piktogrameve dhe përpunimin e të dhënave.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Çdo nxënës punon në shtëpi mbi përforcimin e njohurive.

### Testim njohurish për periudhën e tretë

**Shkalla: II      Klasa: V      Lënda: Matematikë**

**Emër/mbiemër** \_\_\_\_\_

**Klasa** \_\_\_\_\_

**Shkolla** \_\_\_\_\_

**Grupi A**

- Vizato segmentet me gjatësitë e dhëna më poshtë: (3 pikë )
  - 45 mm
  - 5,3 cm
  - 7 cm 9 mm
- Radhit gjatësitë e segmenteve të mëposhtme, duke filluar nga gjatësia më e vogël. (5 pikë)

<b>4,34 m</b>	<b>3,7 cm</b>	<b>18 mm</b>	<b>2,54 cm</b>	<b>7cm 4mm</b>

- Shkruaj masat e dhëna në g dhe në kg. (4 pikë )

<b>Masa në g</b>	840		4300	
<b>Masa në kg</b>		0,57		4,8

- Radhit masat e mëposhtme, duke filluar nga më e madhja: (4 pikë )

1,65 litra;    850 ml;    0,182 litra;    437 ml.

-----


- Për të gatuar një kek, Mirës i nevojiten  $\frac{2}{10}$  litra kos,  $\frac{3}{4}$  kg gjalpë,  $\frac{1}{4}$  kg miell. Ndhmoje Mirën të përgatitë recetën, duke llogaritur sa ml kos, sa g gjalpë dhe sa g miell i duhet. (3 pikë)

- Plotëso duke pasur parasysh lidhjet midis njësive të kohës. (7 pikë)


4 minuta = \_\_\_\_\_ sekonda ;      \_\_\_\_\_ vjet = 60 muaj ;      42 vjet = \_\_\_\_\_ muaj  
 513 minuta = \_\_\_\_\_ orë dhe \_\_\_\_\_ minuta  
 67minuta + 35 minuta = \_\_\_\_\_ orë dhe \_\_\_\_\_ minuta

7. Vizato numrat brenda fushës, akrepin e orës dhe atë të minutave, kur ora shënon: (4 pikë)

11:15 minuta



23:20 minuta



8. Era doli nga shtëpia në orën 14:35 minuta. Ajo shëtiti nëpër qytet për 2 orë e 34 minuta. Sa ishte ora kur ajo u kthye në shtëpi? (1 pikë)
9. Makina niset nga Tirana në orën 07:50 minuta. Ajo mbërrin në Shkodër në orën 12:00. Sa kohë zgjat udhëtimi? (1 pikë)
10. Një figurë e ka syprinën  $25 \text{ cm}^2$ . Gjej perimetrin e saj. (3 pikë)
11. Figura e ka perimetrin 18 cm. Llogarit syprinën e saj. (3 pikë)
12. Jepet tabela e dendurive si më poshtë vijon. Gjej modën, ndërto piktogramin dhe diagramin me vijë. (Shkëput një fletë me rrjet katrorësh.) (9 pikë)

Librat e preferuar nga nxënësit për të lexuar në kohën e lirë gjatë një jave:	Numri i nxënësve	Moda
Përralla	12	
Tregime	8	
Poezi	7	
Gjëegjëza	9	

Në përfundim të grafikëve, shkruaj 3 pohime në lidhje me ta. (3 pikë)

---



---



---



---

Shkallët	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 12	13-19	20-26	27-32	33-38	39 -44	45 - 50



# Testim njohuirish për periudhën e tretë

**Shkalla: II Klasa: V Lënda: Matematikë**

**Emër /mbiemër** \_\_\_\_\_

**Klasa** \_\_\_\_\_

**Shkolla** \_\_\_\_\_

**Grupi B**

1. Vizato segmentet me gjatësitë e dhëna më poshtë: (3 pikë)

- a) 3 4mm
- b) 7,5 cm
- c) 5 cm 8 mm

2. Radhit gjatësitë e segmenteve të mëposhtme, duke filluar nga gjatësia më e madhe.

(5 pikë)

<b>2,75 m</b>	<b>6,9 cm</b>	<b>15 mm</b>	<b>1,34 cm</b>	<b>8 cm 5 mm</b>

3. Shkruaj masat e dhëna në g dhe në kg. (4 pikë)

<b>Masa në g</b>	720		3800	
Masa në kg		0, 82		7,4

5. Radhit masat e mëposhtme, duke filluar nga më e vogla:

(4 pikë)

2,75 litra; 3750 ml; 0,134 litra; 243 ml      -----      -----      -----      -----

6. Për të gatuar një kek, Mirës i nevojiten  $\frac{3}{10}$  litra kos,  $\frac{1}{4}$  kg gjalpë,  $\frac{3}{4}$  kg miell.

Ndihmoje Mirën të përgatitë recetën, duke llogaritur sa ml kos, sa g gjalpë dhe sa g miell i duhet.

(3 pikë)

7. Plotëso duke pasur parasysh lidhjet midis njësive të kohës.


(7 pikë)

2 minuta = \_\_\_\_ sekonda ;      \_\_\_\_ vjet = 48 muaj ;      34 vjet = \_\_\_\_ muaj  
 432 minuta = \_\_\_\_ orë dhe \_\_\_\_ minuta      47minuta + 52 minuta = \_\_\_\_ orë dhe \_\_\_\_ minuta


8. Vizato numrat brenda fushës, akrepin e orës dhe atë të minutave, kur ora shënon:

(4 pikë)

12:35 minuta



21:45 minuta



9. Dora doli nga shkolla në orën 12:35 minuta. Eci në këmbë drejt shtëpisë për 1 orë e 15 minuta. Sa ishte ora kur ajo u kthye në shtëpi? (1 pikë)
10. Avioni niset nga Tirana në orën 09:40 minuta. Ai mbërrin në Paris në orën 12:00. Sa orë zgjat udhëtimi? (1 pikë)
11. Një figurë e ka perimetrin 26 cm. Gjej syprinën e saj. (3 pikë)
12. Figura e ka syprinën 25 cm<sup>2</sup>. Llogarit perimetrin e saj. (3 pikë)
13. Jepet tabela e dendurive si më poshtë. Gjej modën, ndërto piktogramin dhe diagramin me shtylla. (Shkëput një fletë me rrjet katrorësh.) (9 pikë)

Frutat e preferuara nga nxënësit në një orë mësimore	Numri i nxënësve	Moda
Banane	8	
Mollë	6	
Portokall	3	
Qersh	9	

Në përfundim, shkruaj 3 pohime në lidhje me grafikët që ndërtove.

(3 pikë)

---



---



---



---

Shkallët	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 12	13-19	20-26	27-32	33-38	39 -44	45 - 50

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: E dytë	Data:
Projekt: Trupat gjeometrikë			
Koha e zgjatjes: 3 orë nga 45 minuta		Tematika: Gjeometria	
<ul style="list-style-type: none"><li>Tema e projektit: Qyteti i ëndrrave të mia</li><li>Qëllimi: Të saktësojë dhe thellojë njohuritë e tij mbi trupat gjeometrikë e cilësitë e tyre që i karakterizojnë dhe të japë lidhjen e tyre me jetën reale duke prezantuar përdorimin e gjerë të formave e trupave gjeometrikë në jetën e përditshme të gjithsecilit.</li><li>Aktorët: nxënësit, prindërit, komuniteti</li><li>Menaxheri: mësuesi/ja</li><li>Përfutuesi: nxënësit, shkolla, klasat përgatitore të ciklit fillor të shkollës</li><li>Vendi i aplikimit: Klasa, oborri i shkollës, korridori i shkollës etj.</li></ul>			
Situata e të nxënit: Lidhja e trupave e figurave me përditshmërinë e fantazinë e gjithsecilit prej nesh.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës:			
Në përfundim të projektit nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>komunikon marrëdhënien ndërmjet formave 2D dhe 3D;</li><li>demonstron kërshëri dhe kuriozitet për figurat 2D dhe trupat 3D;</li><li>përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve gjeometrike;</li><li>vetëvlerësohet, përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta;</li><li>krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga jeta e përditshme duke përdorur emërtimet përkatëse; paraqet figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;</li><li>respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë;</li><li>demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.</li></ul>			
Fjalët kyçe: kub, kuboid; piramidë; sferë, gjysmësferë; kon; cilindër; prizëm; katërfaqësh elips; trekëndësh; trekëndësh katror, drejtkëndësh; pesëkëndësh			
Burimet, mjetet: libri i nxënësit, fletore e punës, vizore, figura të ndryshme gjeometrike; trupa gjeometrikë, plastelinë, letra me ngjyra, vizore, ngjitës, shkopinj druri kopsa... etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: gjuha dhe komunikimi, arte, mjedisi e shoqëria	
Metodologjia e veprimtarisë së nxënit: Faza e parë: bisedë, hulumtim, kllaster, shikim i lirë, demonstrim, turi i galerisë Faza e dytë: punë në grupe, diskutim, kompozim, realizim i teknikave të ndryshme, turi i galerisë Faza e tretë: turi i galerisë, bisedë, shikim i shpejtë, 5-vargësh, vizitë te klasat e parashkollorit për të dhuruar maketin e kompozuar si qytet i ëndrrave			

**Zhvillimi i projektit sipas orëve:****Ora e parë**

Ndahet klasa në 7 grupe pune: grupi i kubit, grupi i kuboidit, grupi i prizmit, grupi i piramidës, grupi i sferës, grupi i cilindrit, grupi i konit.

Secili grup do të sjellë informacione për trupin përkatës të saktësuar në këto pika:

- historiku i shfaqjes për herë të parë të formës së trupit;
- kuriozitete mbi përdorimin e cilësive të trupit në jetën e përditshme;
- ndërtimin e trupit, numrin e faqeve, brinjëve, kulmeve;
- modele të hapura të trupave;
- llojet e prezantuara brenda linjës së trupit, nëse ka (piramida 3-këndore, 4-këndore... shumë etj.)

Prezantimi i punëve të orës së parë bëhet në këndin e caktuar që mund të jetë në klasë, oborrin e shkollës etj.

**Ora e dytë**

Çdo grup ka si detyrë që duke operuar vetëm me llojin e trupit të tij të bëjë një krijim 3D – maket - duke kombinuar një numër të madh trupash të të njëjtit lloj për të ndërtuar një objekt (që mund të jetë një godinë, pallat, kështjellë) në përmasa deri në 1 metër lartësi.

Grupet do të përdorin mjete të riciklueshme sipas imagjinatës së tyre. Vlerësohen si kritere:

- larmishmëria e mjeteve të riciklueshme që përdor grupi për realizimin e maketit;
- numri sa më i madh i trupave të përdorur në sasi;
- larmishmëri ngjyrash e pamjesh të formuara te maketi.

Prezantimi i maketit për çdo grup do të bëhet në këndin e caktuar që mund të jetë në klasë, oborrin e shkollës, etj. Secili maket do të jetë i shoqëruar dhe nga fleta e historikut të tij.

**Ora e tretë**

Prezantimi i gjithë punës së zhvilluar në grup nga një nxënës përfaqësues i grupit. Bashkimi i të 7 maketeve bën të mundur formimin e qytetit të ëndrrave apo të së nesërme.

Prezantimi i tyre. Në këtë orë, çdo nxënës mund të bëjë një shkrim të shpejtë, ose një 5-vargësh me temë: Qyteti i ëndrrave dhe unë përballë tij’.

Vizitë te klasat e parashkollorit të shkollës e falja e maketit të qytetit klasave të parashkollorit si pjesë e komunitetit të shkollës e cila do t’u shërbejë atyre për të dalluar më mirë trupat gjeometrikë nga njëri-tjetri.

**Vlerësimi****Mësuesi/ja vlerëson nxënësin për:**

- komunikimin e marrëdhënies ndërmjet formave 2D dhe 3D;
- demonstrimin e kërshërive dhe kuriozitet për figurat 2D dhe trupat 3D;
- përdorimin e imagjinatës dhe kreativitetit për zgjidhjen e problemeve gjeometrike;
- vetëvlerësimin e përdorimin e mendimit kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta;
- krijimin e modeleve të thjeshta të figurave dhe objekteve nga jeta e përditshme duke përdorur emërtimet përkatëse;
- paraqet figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;
- respektimin e punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë;
- demonstrimin e vullnetit në arritjen e rezultateve.

**Detyra dhe puna e pavarur:**

Projekti mund të filmohet apo fotografohet sipas mundësive.